RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË PËRPUTHSHMËRISË

NË
SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS TIRANË

Tiranë 2021

Përmbajtja

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....3
1.Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit.....3
2.Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....3
3.Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinion i auditimité é é é é é é é é é é é é é é é 9

II.HYRJA.....11
1. Objekti i auditimit.....16
2. Qëllimi i auditimit.....11
3. Identifikimi i çështjes.....11
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....11
5. Përgjegjësit e audituesve.....12
6. Kriteret e vlerësimit.....12
7. Standartet e auditimit.....12
8. Metodat e auditimit.....13
9. Dokumentimi i auditimit.....13
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....13
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.....13
2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....14
2.1. Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së.....14
2.2. Planifikimi, realizimi dhe zbatimi i buxhetit.....18
2.3. Zbatimi i strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.....47
2.4. Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dita brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj).....47
2.5. Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit, plotësimi i pasqyrave financiare në afat, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë.....58
2.6. Përputhshmëria ligjore dhe rregullshmëria financiare në planifikim dhe në realizimin e prokurimit të fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime.....63
2.7. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.....138
2.8. Mbi zbatimi i dispozitave ligjore për dhënien dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale.....140
2.9. Auditimi i fondeve të akorduara dhe shpenzuar për përballimin e situatës së pandemisë së COVID-19.....144
2.10. Zbatimi i procedurave për arkivimin e dokumentacionit referuar VKM nr. 4, datë 19.06.2017 ñPër miratimin e Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisëò, dal në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 ñPër Arkivatò.....148
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET..... 150

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrimi i shkurtër i projektit

Auditimi i Spitalit Universitar i Traumës, Tiranë me synimin dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kritereve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj, si dhe aspektet e rregullshmërisë (respektimi i kritereve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik), promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

I.2 Gjetjet kryesore të konstatuara.

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Referenca në raport	Rëndësia	Rekomandimi
1	KLSH ka rikërkuar zbatimin e **tre** rekomandime të cilat kanë rezultuar në proces zbatimi referuar shkresës së KLSH nr. 470/38 prot., datë 14.08.2019, protokolluar në SUT me nr. 2235 prot., datë 20.08.2019, të cilat përsa i përket kompetencave ligjore të SUT janë pranuar dhe janë zbatuar plotësisht dy rekomandime, ndërsa një është zbatuar pjesërisht. Konkretisht është zbatuar pjesërisht rekomandimi: ñ*Të punohet për plotësimet në draftin e rregullores së re, të miratohet brenda një afati të shkurtër, me qëllim përputhjen e saj me strukturat aktuale të funksionimit të Spitalit Universitar të Traumës",* pasi Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), ka shfaqur një qasje aspak bashkëpunuese, ndaj kërkesave të përsëritura të SUT, duke bërë që angazhimi i Spitalit Universitar të Traumës për zbatimin e këtij detyrimi, të mbetet i pambështetur, për mungesë bashkëpunimi nga ana e MSHMS, në shkelje të parashikimeve normative, të cilat kushtëzojnë këtë dikaster të përmbushë detyrimet e veta funksionale. Konkretisht Drejtori i Spitalit A. Z. , i ka kërkuar dhe rikërkuar zyrtarisht Ministres së MSHMS Znj. O.M., në cilësinë e Kryetares së Bordit, me shkresat nr. 1355 prot., datë 20.05.2019, nr. 2780 prot., datë 16.10.2019 dhe nr. 1365	Pika 2.1, fq 14-18	E lartë	Nga Bordi i Spitalit Universitar i Traumës, të merren masa për miratimin e statutit, rregulloren e organizimit dhe funksionimit, strukturës organizative, projektbuxhetin dhe buxhetin, raportin vjetor të veprimtarisë financiare, rregullat dhe procedurat e punësimit të strukturës shëndetësore universitare.

	prot, datë 14.07.2020, mbledhjen e bordit për miratimin e buxhetit të SUT, miratimin e statusit të SUT, miratimin e rregullores të organizimit dhe funksionimit të SUT, miratimin e organikës sipas propozimeve përkatëse, në zbatim të parashikimeve të nenit 10 të VKM nr. 66, datë 03.02.2017 ñ*Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për ngritjen e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore Universitare*ò. Deri në datën 07.05.2021 që përfundoj auditimi, nga Ministrja e MSHMS, Znj. O.M., në cilësinë e Kryetares së Bordit, nuk është kthyer asnjë përgjigje për sa kërkuar në mënyrë të përsëritur nga SUT			
2	Për 8 proçedura prokurimi për vlerën 557,425 mijë lekë lidhja e kontratave është realizuar mbi bazën e marrëveshjeve kuadër, e cila pavarësisht se ka ndikuar në uljen e çmimit për njësi, por si shpenzim ka shkuar tek fondi limit, duke rritur numrin e pjesëve/njësive dhe në rastet e audituara asnjëherë uljen e numrit të pjesëve/njësive si dhe pakësimin jo vetëm të fondit limit por edhe as të vlerës së prokuruar, dhe mbart në të ardhmen riskun e lart të përzgjedhjes së pjesëve/njësive me vlerë më të lart, duke mos arritur në këtë mënyrë uljen kostove të blerjeve/shërbimeve. Veprime në kundërshtim me Udhëzim e APP nr. 6, datë 16.01.2018 ñPër përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeò, me ndryshimet vijuese të tij, pikat 7.1,7.2 dhe 7.3.	Pika 2.9, fq 63-138	E mesme	Lidhja e kontratave mbi bazën e marrëveshjeve kuadër, duhet konsideruar si rast i veçantë dhe Autoriteti Kontraktor nuk duhet në asnjë rast të abuzojë me përdorimin e këtij instrumenti, me qëllim shtrembërimin e konkurrencës. Përdorimi i kësaj forme prokurimi detyrimisht duhet të arrij reduktimin e kostove transaksionale, përmirësimin e vazhdueshëm në harkun e marrëdhënieve afat-gjatë ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Operatorëve Ekonomik, në interes të konsumatorit, në rastin konkret përmirësimin e shërbimit të pacientit në spital.
3	Urdhri i Ministrit të Mbrojtjes nr. 1643, datë 24.12.2020, protokolluar në SUT me nr. 2465, datë 30.12.2020 ñPër dhënien e shpërblimit dhe miratimin e listës emërore të përfituesve, përfshirë ditët e angazhimit dhe diagnostikimin dhe trajtimin e personave të prekur nga COVID-19ò, edhe pse i referohet pikave nr. 1 dhe 2 të VKM nr. 207/2020, është në kundërshtim me këto pika pasi në mënyrë eksplicite:Në pikën 1 të këtij vendimi është shprehur në mënyrë eksplicite se ñDhënien e shpërblimit mujor, në masën 125 000 (njëqind e njëzet e pesë mijë) lekë, për personelin mjekësor, specialistë të shëndetit publik që merren me epidemiologjinë, infermierë dhe specialistë të shërbimit laboratorik, të angazhuar në diagnostikimin dhe trajtimin mjekësor të personave të prekur nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19ò.Në pikën 2 të këtij vendimi është	Pika 2.9, fq 144-148	E lartë	Nga Drejtor i Spitalit ti bëhet prezent Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, problematika e krijuar në SUT referuar Urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 1643, datë 24.12.2020 ñPër dhënien e shpërblimit dhe miratimin e listës emërore të përfituesve, përfshirë ditët e angazhimit dhe diagnostikimin dhe trajtimin e personave të prekur nga COVID-19ò, me qëllim marrjen

	shprehur në mënyrë eksplicite se ñDhënien e shpërblimit mujor, në masën 65,000 lekë, për personelin mbështetës, i angazhuar në institucionet ku trajtohen personat e prekur nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19ò.Në pikën 6 të këtij vendimi është shprehur në mënyrë eksplicite se ñNgarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimiò. Së dyti. Që nga marsi 2020 që ka dal VKM nr. 207/2020, ky urdhër është dërguar nga Ministria e Mbrojtjes me nr. 7035/1 prot., datë 24.12.2020, protokolluar në SUT me nr. 2465, datë 30.12.2020, pra 9-muaj me vonesë, duke krijuar një situatë të pa qartë për administratën e SUT, për shpërblimin e mjekëve, pasi mjekët e të njëjtit spital për vonesën 9-muaj të urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes, janë vënë në një standard të dyfishtë, mjekët civil të shpërblehen, ndërsa ushtarakët jo.			e masave për korrigjimin e kësaj praktike, por edhe për të parandaluar në të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.
4	Nga mos zbatimi i specifikime teknike të kontratave në marrëveshjen kuadër ñPër kryerjen e shërbimit të lavanterisë dhe hotelerisë për një periudhë 48 mujoreò në vlerën 199,290 mijë lekë pa TVSH, viti 2020, për periudhën tetor 2020 deri më mars 2021 operatori ekonomik ñS....ò Shpk, ka përfituar padrejtësisht vlerën ***3,536,421 lekë, duke krijuar në këtë mënyrë dëm ekonomik në të njëjtën vlerë.*** Mos zbatimi i specifikimeve teknike lidhet me materialin e butë; çarçaf i poshtëm, çarçaf i sipërm dhe çarçaf i zarf, ku peshat përkatësisht nga 0.77 kg, 0.77 kg dhe 1.1 kg gjatë zbatimit të kontratës (likuidimeve) kanë rezultuar në 1.1 kg, 1.1 kg dhe 1.3 kg. Veprim në kundërshtim me: -Marrëveshjen kuadër të lidhur me nr. 7/26 prot, datë 17.07.2020, ndërmjet SUT dhe operatori ekonomik ñS...ò Shpk, ku është përcaktuar ñkontraktori me an të ofertës së tij, bie dakort të furnizoj mallra, ashtu siç janë specifikuar në kushtet e përcaktuara në këtë kontratë, formularin e deklarimit të ofertës, specifikimet teknike, formulari i çmimit të ofertës dhe dokumentet standard të tenderitò. - Kontratat e lidhur me nr. 7/32 prot., datë 20.07.2020, nr. 7/37 prot., datë 11.12.2020 nr. 7/40 prot., datë 30.12.2020, ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës dhe operatorit/e shoqërisë ñS....ò Shpk, nenet 8,12 dhe 14. -Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 60, pika 1, e cila përcakton se: ñ1. Kushtet e kontratës,	Pika 2.7 fq 63-138	E lartë	SUT të marrë masa dhe të ndjekë të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës së 3,536,421 lekë nga shoqëria ñS....ò Shpk. Kjo vlerë ka të bëjë me mos zbatimin e specifikime teknike, pjesë e kontratave në marrëveshjen kuadër të lidhur me nr. 7/26 prot., datë 17.07.2020 ñPër kryerjen e shërbimit të lavanterisë dhe hotelerisë për një periudhë 48 mujoreò.

	të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fitueseò. - Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 ñKodi Civil i Republikës së Shqipërisëò, nenet 419, 420, nenet 659, 698 dhe neni 690 në të cilin është shprehur ñ.....Mos përmbushja e detyrimeve përkatëse sjell lindjen e përgjegjësisë juridiko-civile për palën mos përmbushëse, përgjegjësi e cila konkretizohet në detyrimin për ti shpërblyer palës/palëve të tjera shpërblimin e dëmit të pësuar në formën dëmit efektiv dhe fitimit të munguarò. - Shtojca 5. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike dhe të Termave të Referencës nga operatori ekonomik ñS...ò Shpk.			
5	Kontrata e punimeve civile ñRikonstruksion i pavijonit dhe ndërtim i sallave të operacionit të këmbës diabetike, në SUTò, është nënshkruar me datë 20.02.2019, me OE ñ A...Mò, me vlerë 66,882,234 lekë. Për mbikëqyrjen e punimeve është përzgjedhur Shoqëria ñN...ò SHPK, me të cilën është nënshkruar kontrata nr. 258/6 prot., datë 20.02.2019. Gjatë zbatimit të kontratës janë nevojitur ndryshime të disa zërave të punimeve me shtesa dhe zbritje si dhe përfshirje të zërave të rinj të punimeve. Në aplikimin e disa zërave të rinj të punimeve të cilat nuk janë pjesë e preventivit, si dhe nga verifikimi i saktësisë së volumeve të përshkruara në librezën e masave, janë konstatuar mangësi si më poshtë: -Për zërin A.7.An ñF.V profil mbrojtës për muret MDFò është hartuar analiza për furnizim dhe vendosje me çmim 520 lekë/ml, ku është përfshirë materiali (sipas ofertave të OE) dhe vendosja. Nga verifikimi i dokumentacionit të ofertave të marrë nga OE të ndryshëm, rezulton se për këtë zë, nga ana e OE ñRi.-Gi.ò, është paraqitur çmimi 253 lekë ml, çmim i cili përfshin furnizimin e materialit dhe vendosjen. Si rezultat, shpenzimet për vendosjen janë përfshirë dy herë. Vlera 98,790 lekë [370 ml x (520 ï 253)], është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori ñA...Mò SHPK dhe përbën dëm ekonomik. - Zëri A.4.An ñFurnizim vendosje davancale mermeri 2 cmò, është aplikuar çmimi referuar analizës së çmimeve nr. 2.273/1, me çmim 6,981 lekë/m2. Kjo analizë çmimi i përket materialit granit dhe jo mermer. Bazuar në	Pika 2.7, fq 63-138	E lartë	SUT të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 334,881 lekë nga Kontraktori ñA-Mò SHPK, përfituar si pasojë e referencave të gabuara në përcaktimin e çmimeve për zëra të rinj punimesh.

	manualin e çmimeve të ndërtimit 2015, për këtë zë të ri punimi referenca e çmimit duhet të ishte marrë sipas analizës 2.273, që i përket materialit mermer, me çmim 4,488 lekë/m2. Sasia e likuiduar sipas këtij zëri është 6.0 m2. Vlera e përfituar më tepër nga Kontraktori ñA...Mò SHPK është 11,346 lekë [6 m2 x (6,981-5090)], vlerë e cila përbën dëm ekonomik. -Zëri A.4 2.198 ñHidroizolim me emulson bituminoz dhe 3 shtresa katramaò është likuiduar në sasinë 857 m2. Nga verifikimi i saktësisë së volumeve për këtë zë punimi rezulton sasia 835 m2, me diferencë 22 m2. Vlera 26,400 lekë (22 m2 x 1,200 lekë/m2), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori ñA...Mò SHPK dhe përbën dëm ekonomik. - Zëri A.5. An ñVeshje fasade me alukobondò certifikuar sasia 33 m2. Në këtë sasi është përfshirë sasia 7.2 m2, riparim alukobond ekzistues. Vlera 67,903 lekë (7.2 m2 x 9,431 lekë/m2), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori ñA...Mò SHPK dhe përbën dëm ekonomik. - Në lidhje me zërin e punimeve A.6.2.297/b, është përcaktuar ñTavan me kartonxhes (gips kundër lagështirës, jeshil) dopioò, nga verifikimi i përllogaritjeve të bëra sipas librezës së masave konstatohet se në sipërfaqen e përgjithshme, nuk është zbritur sipërfaqja që zënë punimet elektrike, konkretisht vendosja e plafonierave me dimensione 60 x 60 cm, në sasinë 181 copë me sipërfaqe 65.8 m2 [183 copë x (60 cm x 60 cm)]. Vlera 130,442 lekë (65.8 m2 x 1,980 lekë/m2), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori ñA...Mò SHPK dhe përbën dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 15.08.2007 ñPër informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të ndërtimitòi ndryshuar, pika 2 dhe11, si dhe Udhëzimin e Këshillit Të Ministrave nr. 2, datë 08.05.2003 ñPër klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimitò.			
6	Pasqyrat financiare vjetore nuk janë miratuar nga Bordi i Spitalit Universitar i Traumës (miratimi i raportit vjetor të veprimtarisë financiare), veprim në kundërshtim Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 66, datë 03.02.2017 ñPër përcaktimin e kritereve e të procedurave për ngritjen e organizimin e	Pika 2.6, fq 58-63	E Mesme	Nga Bordi i Spitalit Universitar i Traumës të merren masa për miratimin i e përvitshëm të pasqyrave financiare vjetore

	shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitareò, pika 10/c.			
7	Pasqyrat financiare vjetore, edhe pse janë depozituara në Degën e Thesarit të Rrethit Tiranë, nuk provohet nga ana shkresore të jetë bërë konfirmimi nga kjo e fundit, pastaj të dërgoheshin në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe në Ministrinë e Mbrojtjes (vetëm provohet protokollimi në Degën e Thesarit), veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, kapitulli IV, pika 117.	Pika 2.6, fq 58-63	E mesme	Nga Drejtoria e SUT, sektori i financës të merren masa që pasqyrat financiare vjetore të dërgohen në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe në Ministrinë e Mbrojtjes, pasi të jenë konfirmuar paraprakisht nga Dega e Thesarit të Rrethit Tiranë.
8	Në 7 procedura prokurimi për vlerën 522,153 mijë lekë, përllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, i spitaleve te tjera (QSUT, Shefqet Ndroqi etj), veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 59, pika 2.	Pika 2.7, fq 63-138	E lartë	Nga Autoriteti Kontraktor të merren masa që përllogaritja e vlerës së kontratave të prokurimit publik, të vlerësohet si një operacion mjaftë i vështirë dhe në të njëjtën kohë mjaftë i rëndësishëm, për shkak se zbatimi i procedurave të përzgjedhjes të prokurimit publik, do të varet përkatësisht nga përcaktimi i kësaj vlere, por dhe efektiviteti maksimal i shpenzimeve publike. Pikërisht për këtë arsye, duhet zbatuar me rigorozitet legjislacioni i posaçëm për këtë procedurë specifike, kjo edhe për të mënjanuar shmangien nga rregullat e prokurimit nëpërmjet ndarjes apo pjesëtimit të vlerës së kontratave të prokurimit publik**.**
9	Në 4 procedura prokurimi për vlerën 428,225 mijë lekë, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë,veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 46, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñRregullat e Prokurimitò, i ndryshuar, neni 63 pika 3, neni 67, Ligjin nr. 44/2015 ñKodi i Procedurave Administrative	Pika 2.7, fq 63-138	E lartë	Nga Institucioni t`i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi rëndësia e procesit të shqyrtimit,

	të Republikës së Shqipërisëò nenet 108-118.			kualifikimit dhe shpallja fitues të operatorëve është me rëndësi kapitale.
10	Për 8 procedura prokurimi për vlerën 548,163 mijë lekë në hartimin e dokumenteve të tenderit, për kriteret e veçanta për kualifikimit nuk është dhënë asnjë argument për përcaktimin e tyre dhe nuk është dokumentuar me procesverbal ky përcaktim, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 61, pika 2.	Pika 2.7, fq 63-131	E lartë	Autoriteti Kontraktor, në vijim duhet të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim/specifikimet teknike, që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mos diskriminim dhe konkurrencë. Kërkesat/specifikimet teknike duhet të jenë të shkruara në mënyrë të tillë që të argumentohet nevoja që dikton vendosjen e këtyre kritereve, duke parandaluar në këtë mënyrë para përzgjedhjen paraprake të kandidatit fitues, në zbatim me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik.

I.3. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

Është audituar veprimtaria ekonomiko-financiare e Spitalit Universitar të Traumës, Tiranë për periudhën nga data 01.01.2018 deri më datë 31.12.2020, e cila ka përfshirë: organizimin dhe funksionimin e Spitalit, funksionimin e strukturave drejtuese dhe ligjshmërinë për emërimet dhe vendimet e marra prej tyre, strukturën organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve, programet ekonomiko-financiar (buxhetet vjetor), rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë dhe bankë, mbajtjen e evidencës kontabile, zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, dhënien dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale, zbatimin e procedurave për arkivimin e dokumentacionit.

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinioni i auditimit i modifikuar/kualifikuar:
Ne kemi audituar përputhshmërinë e aktivitetit të Spitalit Universitar të Traumës, Tiranë. Auditimi është bazuar në ligjin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit, Manualin e Përputhshmërisë, Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik ISSAI 4000 .
Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Spitalit Universitar të Traumës, Tiranë janë evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e ñBazës për Opinioninò, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar.
Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit, mbi të cilat janë formuluar gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, përmbledhur në bazën për opinion, si rrjedhojë e ekzekutimit të

procedurave audituese, rezulton se aktiviteti i Institucionit, për shkak të rëndësisë të anomalive të trajtuara në këtë raport, ka devijime materiale, por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar.

Baza për Opinionin

Për gjetjet nga auditimi dhe rekomandimet, jemi dakortësuar me Menaxhmentin e Institucionit, si dhe jemi siguruar prej Tij, që vendimmarrjet në ardhmen të jenë më të spikatura, që të japin shërbime më të mira dhe vlerë më të mirë për paranë. Për të arritur këtë, Menaxhmenti i këtij Institucioni të jetë përgjegjës, jo vetëm për marrjen e vendimeve financiare, por edhe për të siguruar që këto vendime janë dobiprurëse dhe në interesin më të mirë të publikut. Kjo do të thotë, të sigurohet se paratë publike shfrytëzohen mirë dhe shfrytëzimi i tyre shtrihet sa më shumë që është e mundur, nëpërmjet përdorimit efikas, efektiv dhe ekonomik të burimeve, si personeli, pasuritë dhe buxheti sipas programit ekonomik.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin ñPërgjegjësitë e audituesit për Auditimin e Përputhshmërisëò të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Spitali Universitar i Traumës, theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin e përputhshmërisë në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë. Menaxhmenti i Institucionit është përgjegjës për marrjen e masave të nevojshme në drejtim të garantimit të përputhshmërisë së aktivitetit me kushtet e dispozitave ligjor në fuqi. Gjithashtu menaxhmenti i Institucionit është përgjegjës kryesor për ngritjen e sistemeve të kontrollit dhe marrjes së masave të sinjalizimit për veprime korruptive në realizimin e të ardhurave dhe kryerjen e shpenzimeve, duke nisur nga hartimi i rregullave të brendshme, strukturës në dispozicion, duke përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrimet e çdo punonjësi të këtij Institucioni, mbi të gjitha duke shmangur dhe mbikëqyrur konfliktin e interesit.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë.

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse aktiviteti i Institucionit, nuk paraqet anomali materiale, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion mbi përputhshmërinë e aktivitetit me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit të treguesve fiskalë të konsoliduar. Përveç standardeve të ISSAI, ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të aktivitetit. Gjithashtu, ne u mundësojmë drejtuesve një deklaratë ne lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave ne kemi kryer punën tonë audituese, dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e përputhshmërisë dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e KLSHò, në zbatim të projektit dhe programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH nr. 130/1 prot., datë 27.01.2021, nga data 01.02.2021 deri 07.05.2021, në Spitalin Universitar të Traumës, Tiranë për periudhën nga data 01.01.2018 deri më datë 31.12.2020, u krye auditimi ñPërputhshmërisëò me përbërje:

1. F. I. , Përgjegjës grupi
2. A. R. , Auditues
3. A. T. , Auditues
4. A. S. , Auditues

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

a. Objekti i auditimit: Objektivi kryesor i grupit të auditimit të KLSH-së, është dhënia e opinionit për përdorimin ligjor të fondeve dhe rregullshmëria financiare e paraqitjes së dokumentacionit, që SUT, u ka bërë fondeve në dispozicion, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, udhëzuesve të donatorëve, duke audituar rregullaritetin, ligjshmërinë e transaksioneve, si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të veprimtarisë së Projektit.

b. Qëllimi i auditimit:
Auditimi ka për qëllim të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, si edhe shfrytëzimin me eficencë, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ky sistem bën të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, rritjen e përgjegjshmërisë, llogaridhënies, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara si dhe parandalimin e shkeljeve, me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve.

c. Identifikimi i çështjes:
Spitali Universitar të Traumës Tiranë duhet të ketë organizimin e duhur, duhet të funksionojë duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi për arritjen në cilësi të shërbimeve shëndetësore të ofruara, duke patur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet.

d. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:
Menaxhmenti është përgjegjës për kryerjen e transaksioneve financiare në pajtim me kornizën e aplikueshme ligjore dhe që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me Ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003 ñPër shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar; Ligjin nr. 10383, datë 24.02.2011 ñPër Sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar; Ligjin nr. 147/2014 ñPër shërbimin e urgjencës mjekësoreò; Ligjin nr. 9323, datë 25.11.2004 ñPër barnat dhe shërbimin farmaceutikò, i ndryshuar; Ligjin nr. 89/2014 ñPër pajisjet mjekësoreò; Ligjin nr. 9936/2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, me

ndryshimet vijuese të tij, Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik, me ndryshimet vijuese të tij, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 ñProcedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së përgjithshmeò.

e. Përgjegjësitë e audituesve:
Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit për auditimin. Auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI. Janë respektuar kërkesat etike, është planifikuar dhe kryer auditimi, sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së kërkuar.

f. Kriteret e vlerësimit: Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA)IFAC; Kushtetuta dhe Baza Ligjore:
Ligji nr. 154/2014 ñMbi Organizimin dhe Funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetitò; Manualet e Auditimit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH;
Ligji nr. 9106, datë 17.07.2003 ñPër shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar; Ligji nr. 10383, datë 24.02.2011 ñPër Sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar; Ligji nr. 8615, datë 01.06.2000 ñPër Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar; Ligji nr. 147/2014 ñPër shërbimin e urgjencës mjekësoreò; Ligji nr. 105/2014, datë 31.7.2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik"; Ligji nr. 89/2014 ñPër pajisjet mjekësoreò; Ligji nr. 9718, datë 19.4.2007 ñPër urdhrin e infermierit në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar; Ligji nr. 9936/2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, me ndryshimet vijuese të tij; Ligji nr. 25/2018, ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, Ligji nr. 8510, datë 15.07.1999 ñPër përgjegjësinë jashtë kontraktore të organeve të administratës shtetëroreò, i ndryshuar; Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò, i ndryshuar; Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 ñKodi i Punës i Republikës së Shqipërisëò, i ndryshuar; Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, i ndryshuar; Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, me ndryshimet vijuese të tijò; Ligji nr. 44/2015 datë 30.04.2015 ñKodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisëò; Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 òPër tatimin mbi të ardhuratò, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 527, datë 01.11.1993 òPër përcaktimin e çmimeve në sistemin shëndetësor shtetërorò, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 508 datë 13.09.2017 ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Socialeò; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1661 datë 29.12.2008 ñPër financimin e shërbimeve spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësorò, i ndryshuar; VKM nr. 143, datë 18.2.2015 ñPër përcaktimin e marzheve të tregtimit dhe fabrikimit të barnaveò; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik, me ndryshimet vijuese të tij, Udhëzimi nr. 2/2012 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, me ndryshimet vijuese të tij.

g. Standardet e auditimit:
-ISSAI 100– (*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*).
-ISSAI 400– (*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*).
-Kodi etik i KLSH.

h. Metoda e auditimit:
Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje

i. Dokumentimi i auditimit:
Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.2015, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 ñDokumentimi i Auditimitò.
Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim
Spitali Universitar i Traumës është person juridik, publik, buxhetor, në varësi administrative të Ministrisë së Shëndetësisë. SUT është pjesë e rrjetit të integruar të shërbimit mësimor e kërkimor shkencor dhe spitalor në Republikën e Shqipërisë, funksionon si strukturë shëndetësore universitare e përgjithshme, e cila realizon funksione diagnostikuese e trajtuese në përmbushje të ofrimit të kujdesit shëndetësor terciar, si pjesë e Ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, si dhe funksione mësimore e kërkimore-shkencore për të realizuar formimin universitar të specialistëve të shëndetësisë, si pjesë e Universitetit të Mjekësisë Tiranë dhe ndjek e zbaton aktet ligjore e nënligjore në fushën e shëndetësisë. Funksionimi i tij kryhet në përputhje me VKM nr. 357, datë 18.7.2002 ñPër dhënien e statusit "Spital Universitar", Spitalit Ushtarak Qendrorò, Ligjin nr. 9106, datë 17.7.2003 ñPër shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisëò, VKM nr. 1001, datë 02.12.2015 ñPër integrimin e spitalit universitar të traumës dhe spitalit ushtarak të forcave të armatosura në një strukturë të bashkuarò, VKM nr. 657, datë 10.11.2017 ñPër miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të spitalit universitar të traumësò, VKM nr. 892, datë 24.12.2012 ñPër ndryshimin e emërtimit të spitalit ushtarak qendror universitar në "Spitali universitar i traumës" dhe kalimin e përgjegjësisë së administrimit të tij nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Shëndetësisë, si dhe për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 515, datë 18.7.2003 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", VKM nr. 66, datë 3.2.2017 ñPër përcaktimin e kritereve e të procedurave për ngritjen e organizimin e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitareò.
Objekti i veprimtarisë së Spitalit Universitar të Traumës është:
Spitalit Universitar i Traumës është Institucion Shëndetësor Publik Kombëtar mjekimi, mësim dhënie dhe kërkimi shkencor.
Spitali Universitar i Traumës, si strukturë shëndetësore universitare e përgjithshme, realizon funksione diagnostikuese e trajtuese në përmbushje të ofrimit të kujdesit shëndetësor terciar, si pjesë e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, si dhe funksione mësimore e kërkimore-shkencore për të realizuar formimin universitar të specialistëve të shëndetësisë, si pjesë e Universitetit të Mjekësisë Tiranë.

Mënyra e funksionimit të Spitalit Universitar të Traumës, si strukturë shëndetësore universitare, përcaktohet në statutin e tij, i cili miratohet me urdhër të përbashkët të Ministrit përgjegjës për arsimin dhe Ministrit përgjegjës për shëndetësinë, detyrim i përcaktuar në VKM nr. 657, datë 10.11.2017 ñPër miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të spitalit universitar të traumësò, pika 2, status i cili deri më datë 07.05.2021 që përfundon auditimi, ky spital nuk ka status.
Departamentet përkatëse të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, që përbëhen nga shërbime në bazë specialiteti, propozojnë fushat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor për shërbimet shëndetësore universitare, që ofron Spitali Universitar i Traumës, të cilat miratohen me urdhër të Ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe Ministrit përgjegjës për arsimin.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së.

SUT ka marrë Raportin Përfundimtar të auditimit të KLSH-së me nr. 983 prot., datë 25.06.2018, dhe ka kthyer përgjigje KLSH me shkresën nr. 1136 prot., datë 11.07.2018, shoqëruar me planin e masave të miratuar nga titullari, ku janë përcaktuar strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet përkatëse.
Brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, ku përcaktohet se ky informacion duhet dërguar brenda 6-muajve nga marrja dijeni, SUT i ka dërguar informacion KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor me shkresën nr. 2738 prot., datë 17.12.2018 ñRaportim 6-mujor mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSHò.
Me program auditimi nr. 450/21 prot., datë 26.06.2019 me objekt ñPër zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të ushtruar në SUT, Tiranë të evaduara në 6-mujorin e dytë të vitit 2018 dhe gjashtëmujorin e parë të vitit 2019ò.
Për zbatimin e rekomandimeve nga SUT, nga audituesit e autorizuar të KLSH është mbajtur aktverifikimi nr. 1, pa datë, protokolluar në SUT me nr. 1700/1 prot., datë 01.07.2019.
KLSH ka rikërkuar zbatimin tre rekomandime të cilat kanë rezultuar në proces zbatimi referuar shkresës nr. 470/38 prot., datë 14.08.2019, protokolluar në SUT me nr. 2235 prot., datë 20.08.2019, të cilat përsa i përket kompetencave ligjore të SUT janë pranuar dhe janë zbatuar plotësisht dy rekomandime, ndërsa një është zbatuar pjesërisht.
Konkretisht është zbatuar pjesërisht rekomandimi: ñTë punohet për plotësimet në draftin e rregullores së re, të miratohet brenda një afati të shkurtër, me qëllim përputhjen e saj me strukturat aktuale të funksionimit të SUTò, pasi Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Këtu e në vazhdimësi MSHMS), ka shfaqur një qasje aspak bashkëpunuese, ndaj kërkesave të përsëritura të SUT, duke bërë që angazhimi i SUT për zbatimin e këtij detyrimi, të mbetet i pambështetur, për mungesë bashkëpunimi nga ana e MSHMS, në shkelje të parashikimeve normative, të cilat kushtëzojnë këtë dikaster të përmbushë detyrimet e veta funksionale.
Në mënyrë të detajuar zbatimi i rekomandimeve të rikërkuar paraqitet si më poshtë vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet nga SUT gjatë vitit 2017 janë nxjerrë jashtë përdorimit aktive në vlerën 49,854,683 lekë. Referuar procedurës dhe procesverbaleve të nxjerrjes jashtë përdorimi dhe asgjësimit nga ana e SUT për asgjësimin e këtyre materialeve nuk ka asnjë dokumentacion lidhur me procedurën e kryer nga komisioni i asgjësimit, si vlerësimi dhe ndarja e materialeve sipas destinacionit të tyre, materiale për ankand ose materialeve që

duhet të groposen, mjetin e transportit i cili ka kryer transportin e tyre, si dhe vend ndodhjen e groposjes së tyre, djegien etj. të shoqëruar me fotot përkatëse, duke mos e faktuar nxjerrjen jashtë përdorimi dhe asgjësimin e materialeve në vlerën 49,854,683 lekë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò.
Komisionet e vlerësimit të aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit, në përfundim të procesit të inventarizimit të aktiveve të SUT, nuk kanë përpiluar një raport përmbledhës mbi rezultatin e inventarëve, duke krahasuar gjendjen kontabël me atë fizike të raportuar nga komisionet e inventarizimit të aktiveve në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, më hollësisht trajtuar në pikën II/d faqe 42-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.
Për sa më sipër rikërkojmë:
Nga SUT të merren masa që kryerja e inventarëve të aktiveve, nxjerrja jashtë përdorimit dhe asgjësimi i tyre, duhet të shoqërohen me procesverbalet e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit të aktiveve, bashkëlidhur me dokumentacionin mbi procedurën e kryer për vlerësimin dhe ndarjen e materialeve sipas destinacionit të tyre, për ankand, groposje, vend ndodhjen e groposjes së tyre, djegien etj, shoqëruar me fotot përkatëse, mjetin e transportit i cili ka kryer transportin e tyre, duke e dokumentuar nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e materialeve në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò.
Komisionet e Vlerësimit të Aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit, në përfundim të procesit të inventarizimit të aktiveve të përpilojnë një raport përmbledhës mbi procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës.

Në vijimësi

Zbatimi i rekomandimit.
Nga drejtori i spitalit, me plan veprim me nr 983/1 prot., datë 05.07.2018, pika 5, është ngarkuar sektori i financës dhe i planifikimit. Nga sektori i financës është përpiluar relacioni përmbledhës i inventarëve me nr. 573/3, datë 11.03.2019 për inventarizimin e hotelerisë, pajisjeve mjekësore dhe farmacisë spitalore, dhe i është drejtuar titullarit të institucionit. Referuar këtij relacioni përmbledhës, është kryer inventarizimi i veshmbathjes në të gjitha pavijonet me vlerë 6,608,962 lekë për periudhën 01.03.2019 deri më 04.03.2019. Për periudhën 05.03.2019-07.03.2019, ka përfunduar inventari i kazermimit në të gjitha shërbimet me vlerë 132,514, 316 lekë. Për periudhën 08.03.2019-11.03.2019, ka përfunduar inventarizimi në të gjitha shërbimet me vlerë 1,262,220,029 lekë.
Në lidhje me nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të SUT-së, për periudhën objekt auditimi: Janë hartuar dhe miratuar procesverbalet përkatëse të asgjësimit të shoqëruar me fotografimet përkatëse: Konkretisht: Procesverbali i datës 20.06.2019 për materiale të buta, të hekurta, drusore, referuar flet-daljes nr. 4/1, date 02.06.2019 i firmosur nga komisioni i asgjësimit i përberë nga L. K. , S. Gj. , A. L. , S. K. dhe E. T. . Tre procesverbale të datës 26.06.2019, për material dhe medikamentet mjekësore i firmosur nga komisioni i asgjësimit i përberë nga A. Sh. , E. Sh. , P. S. , K. L. , E. H. .
Koment i grupit të auditimit. Ky rekomandim është pranuar dhe është zbatuar plotësisht.
10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi menaxhimin financiar në Spitalin Universitar të Traumës, ka rezultuar se organizimi dhe veprimtaria administrative, mbështeten në një rregullore të brendshme të vitit 2010. Nga SUT është përgatitur draft rregullorja e re, e cila nuk është

miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, më hollësisht trajtuar në pikën VI faqe 97-104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.
Për sa më sipër rikërkojmë:
Të punohet për plotësimet në draftin e rregullores së re, të miratohet brenda një afati të shkurtër, me qëllim përputhjen e saj me strukturat aktuale të funksionimit të Spitalit Universitar të Traumës.

Në vijimësi

Zbatimi i rekomandimit.
Me urdhrin e Drejtorit të Spitalit, me nr. 584, datë 06.06.2018, është ngarkuar për zbatim grupi i punës për hartimin e draft rregullores. Drafti është dërguar në MSHMS me shkresën nr. 1157/1 prot., datë 13.07.2018.
Drejtori i Spitalit A. Z. , me shkresën nr. 1355 prot., datë 20.05.2019, i ka kërkuar Ministres së MSHMS Znj. O.M., në cilësinë e Kryetares së Bordit, në zbatim të VKM nr. 66, datë 03.02.2019 ñPër përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për ngritjen e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore Universitareò, caktimin e një date për mbledhjen e Bordit të SUT, për diskutimin dhe miratimin e çështjeve si më poshtë:
- Diskutimin dhe miratimin e propozimeve për strukturën administrative dhe shëndetësore të SUT dhe numrin e personelit të shërbimeve shëndetësore universitare;
- Miratimin e rregullores të organizimit dhe funksionimit të SUT.
Drejtori i Spitalit A. Z. sërish, me shkresën nr. 2780 prot., datë 16.10.2019, i ka kërkuar Ministres së MSHMS Znj. O.M., në cilësinë e Kryetares së Bordit, në zbatim të VKM nr. 66, datë 03.02.2019 ñPër përcaktimin e kritereve e të procedurave për ngritjen e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore Universitareò, caktimin e një date për mbledhjen e Bordit të SUT, për diskutimin dhe miratimin e çështjeve si më poshtë:
- Diskutimin dhe miratimin e propozimeve për strukturën administrative dhe shëndetësore të SUT dhe numrin e personelit të shërbimeve shëndetësore universitare;
- Miratimin e rregullores të organizimit dhe funksionimit të SUT.
Drejtori i Spitalit A. Z. , edhe një herë, me shkresën nr. 1365 prot, datë 14.07.2020, i ka kërkuar Ministres së MSHMS Znj. O.M., në cilësinë e Kryetares së Bordit, në zbatim të VKM nr. 66, datë 03.02.2019 ñPër përcaktimin e kritereve e të procedurave për ngritjen e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore Universitareò, caktimin e një date për mbledhjen e bordit të SUT, për diskutimin dhe miratimin e çështjeve si më poshtë:
- Miratimin e Buxhetit të SUT;
- Miratimin e statusit të SUT;
- Miratimin e rregullores të organizimit dhe funksionimit të SUT;
- Miratimin e organikës sipas propozimeve përkatëse.
Deri në datën 07.05.2021 që përfundoj auditimi, nga Ministrja e MSHMS, Znj. Orgeta Manastriliu, në cilësinë e Kryetares së Bordit, nuk është kthyer asnjë përgjigje për sa kërkuar në mënyrë të përsëritur nga SUT.
Koment i grupit të auditimit.
Me urdhër të Ministrit nr. 714, datë 24.10.2019, është ngritur Bordi i Spitalit Universitar i Traumës, i përbërë nga: A. I. , përfaqësuese e Universitetit të Mjekësisë Tiranë, anëtare; R. D. , përfaqësuese e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, anëtare; A. K. , përfaqësues i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, anëtar dhe V. R. , përfaqësues i Spitali Universitar i Traumës, anëtar.
Bordi kryesohet nga Ministrja e MSHMS Znj. O.M..

Në këtë urdhër përcaktohet: ñSUT të marr masa për organizimin dhe mbledhjen e Bordit, në përputhje me VKM nr. 66, datë 03.02.2017 ñPër përcaktimin e kritereve e të procedurave për ngritjen e organizimin e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitareò. Në zbatim të këtij urdhri Drejtori i Spitalit i ka kërkuar zyrtarisht Kryetares së Bordit të SUT, Ministres së MSHMS jo vetëm mbledhjen e bordit, por edhe përmbushjen e detyrimeve ligjore nga ana e tij, të cilat sipas parashikimeve të nenit 10 të VKM nr. 66, datë 03.02.2017, lidhen me funksionet, si më poshtë: ñMiraton projektbuxhetin, strukturën administrative, strukturën shëndetësore universitare dhe numrin e personelit të shërbimeve shëndetësore universitare; miraton raportin e veprimtarisë shëndetësore dhe kërkimore shkencore të shërbimeve shëndetësore universitare; miraton raportin vjetor të veprimtarisë financiare; miraton rregulloret e funksionimit të strukturës shëndetësore universitare; miraton rregullat dhe procedurat e punësimit të strukturës shëndetësore universitare dhe kërkon raport nga drejtori i përgjithshëm për zbatimin e tyreò.

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i regjistrit të shërbimit me shtretër për muajin tetor nëntor dhe dhjetor 2017, i cili plotësohet mbi bazën e kartelave të shtrimit sipas pavijoneve rezulton se për këta muaj numri i pacientëve të shtruar gjendje çdo mbi bazën e kartelave ditore të shtrimit për pacientët është më i madh se kapacitetet ditore të shtretërve (numri ditor i shtretërve spitalorë është 236). (pasqyrat përkatëse nr. 1 dhe 1/1), (pasqyrat përkatëse nr. 2 dhe 2/1), (pasqyrat përkatëse nr. 3 dhe 3/1) bashkëngjitur raportit të auditimit, më hollësisht trajtuar në pikën V faqe 84-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër rikërkojmë:

Nga SUT, mjekët, kryeinfermierët të merren masat që në plotësimin e kartelave të shtrimit të bazohen në numrin e pacientëve të shtruar gjendje çdo ditë, kapacitetet ditore të shtretërve sipas pavijoneve dhe regjistrin e shërbimit me shtretër të plotësuar mbi bazën e kartelave të shtrimit.

Në vijimësi

Zbatimi i rekomandimit.

Nga drejtori i spitalit, me plan veprim me nr. 983/1 prot, datë 05.07.2018 , pika IX dhe urdhrit nr. 1187, datë 16.07.2018, janë ngarkuar në zbatim në vijimësi, shefat e shërbimeve, kryeinfermierët, grupi i punës të ndjekjes së gatimit dhe shpërndarjes dhe lavanterisë dhe sektori i financës. Ku është urdhëruar të merren masa nga mjekët dhe kryeinfermierët të bëjnë plotësimin e kartelave të shtrimit bazuar në numrin e pacientëve të shtruar për çdo ditë, kapacitet ditore të shtretërve, sipas shërbimeve dhe regjistrin e shërbimit me shtretër të plotësuar mbi bazën e kartelave. Shefat e shërbimeve dhe kryeinfermierët të marrin masa që pasqyrat e gjendjes së lëvizjes së forcës ditore të SUT, për shërbimin e gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit në SUT, ti plotësojnë mbi bazën e numrit të pacientëve të shtruar në SUT, referuar regjistrit të shërbimit në shtretër, plotësuar mbi bazën e kartelave të shtrimit dhe kapacitetet e shtretërve sipas shërbimeve.

Kryeinfermierët e shërbimeve dhe komisioni i marrjes në dorëzim të mallit, duhet të marrin masa që në kërkesat që bëjnë shërbimet për materialin i cili duhet ti nënshtrohet shërbimit të lavanterisë, duhet të shënohet numri i shtretërve të zënë për çdo datë, gjendja e pacientëve të rinj të shtruar, arsyeja kur ndërrimi i shtratit të pacientit bëhet i domosdoshëm. Të dokumentohen sasitë e trajtuara nga lavanteria të cilat janë marrë nga kryeinfermierët në copë të shpërndarë për çdo shërbim nga sipërmarrësi sipas përcaktimeve të kontratës.

Për zbatimin e rekomandimit, për të 12 pavijonet që ka spitali, u verifikua kapaciteti i pavijoneve dhe shtrimi sipas kartelave, për datat 25.12.2018, 26.12.2018 dhe 27.12.2018, 25.09.2019, 26.09.2019, 27.09.2019, 25.03.2020, 26.03.2020 dhe 27.03 2020, dhe rrezultoj në total numri i të shtruarave ishte 235 nga 248 që është kapaciteti total për të 12 pavijonet.

Koment i grupit të auditimit. Rekomandim është pranuar, dhe është zbatuar plotësisht.
1. Titulli i Gjetjes: Mos përmbushja e detyrimeve ligjore të Bordit të Spitalit Universitar të Traumës.
Situata: KLSH ka rikërkuar zbatimin e **tre** rekomandime të cilat kanë rezultuar në proces zbatimi referuar shkresës së KLSH nr. 470/38 prot., datë 14.08.2019, protokolluar në SUT me nr. 2235 prot., datë 20.08.2019, të cilat përsa i përket kompetencave ligjore të SUT janë pranuar dhe janë zbatuar plotësisht dy rekomandime, ndërsa një është zbatuar pjesërisht.
Konkretisht është zbatuar pjesërisht rekomandimi: ñ*Të punohet për plotësimet në draftin e rregullores së re, të miratohet brenda një afati të shkurtër, me qëllim përputhjen e saj me strukturat aktuale të funksionimit të Spitalit Universitar të Traumës",* pasi Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), ka shfaqur një qasje aspak bashkëpunuese, ndaj kërkesave të përsëritura të SUT, duke bërë që angazhimi i Spitalit Universitar të Traumës për zbatimin e këtij detyrimi, të mbetet i pambështetur, për mungesë bashkëpunimi nga ana e MSHMS, në shkelje të parashikimeve normative, të cilat kushtëzojnë këtë dikaster të përmbushë detyrimet e veta funksionale. Konkretisht Drejtori i Spitalit A. Z. , i ka kërkuar dhe rikërkuar zyrtarisht Ministres së MSHMS, znj. O. M. , në cilësinë e Kryetares së Bordit, me shkresat nr. 1355 prot., datë 20.05.2019, nr. 2780 prot., datë 16.10.2019 dhe nr. 1365 prot, datë 14.07.2020, mbledhjen e bordit për miratimin e buxhetit të SUT, miratimin e statusit të SUT, miratimin e rregullores të organizimit dhe funksionimit të SUT, miratimin e organikës sipas propozimeve përkatëse, në zbatim të parashikimeve të nenit 10 të VKM nr. 66, datë 03.02.2017 ñ*Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për ngritjen e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore Universitare*ò.
Deri në datën 07.05.2021 që përfundoj auditimi, nga Ministrja e MSHMS, znj. O. M. , në cilësinë e Kryetares së Bordit, nuk është kthyer asnjë përgjigje për sa kërkuar në mënyrë të përsëritur nga SUT.
Kriteri: VKM nr. 66, datë 03.02.2017 ñPër përcaktimin e kritereve e të procedurave për ngritjen e organizimin e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitareò, neni 10.
Shkaku: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka shfaqur një qasje aspak bashkëpunuese, ndaj kërkesave të përsëritura të SUT, duke bërë që angazhimi i Spitalit Universitar të Traumës për zbatimin e këtij detyrimi, të mbetet i pambështetur, për mungesë bashkëpunimi nga ana e MSHMS, në shkelje të parashikimeve normative, të cilat kushtëzojnë këtë dikaster të përmbushë detyrimet e veta funksionale.
Rëndësia: E lartë
Ndikimi/Efekti: Keq menaxhimi i SUT nga Bordi i Spitalit.
Rekomandimi: Nga Bordi i Spitalit Universitar i Traumës, të merren masa për miratimin e statutit, rregulloren e organizimit dhe funksionimit, strukturës organizative, projektbuxhetin dhe buxhetin, raportin vjetor të veprimtarisë financiare, rregullat dhe procedurat e punësimit të strukturës shëndetësore universitare.

2.2. Planifikimi, realizimi dhe zbatimi i buxhetit.
2/1. Përshkrim i përgjithshëm për buxhetimin e Spitalit Universitar të Traumës.
Në bazë të VKM nr. 1001, datë 02.12.2015,*"Për integrimin e Spitalit Universitar t*ë *Traum*ës *dhe Spitalit Ushtarak t*ë *Forcave t*ë *Armatosura n*ë *nj*ë *struktur*ë *t*ë *bashkuar", neni 10, "Planifikimi buxhetor për funksionimin normal të Spitalit Universitar të Traumës kryhet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Mbrojtjes, sipas përgjegjësive përkatëse"*që nga viti 2016 SUT kaloi në varësi buxhetore të Ministrisë së Mbrojtjes dhe në varësi administrative të

Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Çdo vit marrëdhënia buxhetore e SUT me MSHMS finalizohet nëpërmjet kontratës që lidh SUT me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm Kombëtar Shëndetësor (FSDKSH). Bazuar në Urdhrin e MSHMS, nr. 573, datë 27.12.2016 ñPër kalimin e Shërbimit të Traumatologjisë ï Ortopedisë, nga Qendra Spitalore Universitare ñNënë Terezaò, në ñSpitalin Universitar të Traumësò, në përmbajtje të kësaj kontrate argumentohet financimi i pjesshëm buxhetor që i bëhet SUT - së në artikujt 600,601,602 pavarësisht kërkesave për fonde që SUT ka në këto tre zëra gjatë vitit buxhetor. Buxheti që alokohet në fillim të vitit, që nga 2016 e në vazhdim,është një buxhet i cili nuk mjafton për kërkesat e Spitalit Universitar të Traumës,si për paga dhe shpërblime, blerje medikamente dhe shpenzime të tjera spitalore.

2/2. Zbatimi i kritereve në çeljen e buxhetit për periudhën objekt auditimi, detajimi i planit fillestar, kompetencat, domosdoshmëria dhe argumentimi i transferimeve të fondeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në mbështetje të dispozitave ligjore e nënligjore.

Pas miratimit nga MFE, të Udhëzimit nr. 10, datë 28.02.2017, ñPër përgatitjen e PBA 2018-2020ò, me shkresën nr. 2102/1 prot, datë 04.04.2017 ñDërgohet Udhëzimi i PBA 2018-2020ò (nr. 477 prot, datë 05.04.2017 protokolli i SUT) të ardhur pranë njësisë shpenzuese SUT, nga Ministria e Mbrojtjes përcillet Udhëzimi Plotësues i MFE nr. 6 prot., datë 04.04.2017 ñPër përgatitjen e PBA 2018-2020ò, në zbatim të Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të Udhëzimit nr. 23 datë 22.11.2016 ñPër Procedurat Standarde të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëmò, të VKM nr. 197, datë 15.03.2017 ñPër miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve për PBA 2018-2020ò, të Udhëzimit të MF nr. 10, datë 28.02.2017 ñPër përgatitjen e PBA 2018-2020ò.

Me shkresën nr. 541 prot., datë 18.04. 2017 të STU janë dërguar kërkesat për zërat buxhetorë të PBA 2018 ï 2020,pranë Ministrisë së Mbrojtjes për fazën e parë.

Me shkresën nr. 4911 prot, datë 08.08.2017 ñDërgohet Udhëzimi i PBA 2018-2020ò pranë njësisë shpenzuese SUT, nga Ministria e Mbrojtjes përcillet Udhëzimi i MFE nr. 8 prot., datë 08.08.2017 ñPër përgatitjen e PBA 2018-2020ò.

Me shkresën nr. 932/1 prot., datë 15.08. 2017 të STU janë dërguar kërkesat e PBA 2018 ï 2020 pranë Ministrisë së Mbrojtjes, për fazën e dytë.

Po ashtu, më parë, nëpërmjet shkresës nr. 878 prot., të datës 14.07.2017 STU ka përcjellur kërkesat buxhetore të fazës së dytë, në ngarkim të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe në ngarkim të FSDKSH -së, në përgjigje të shkresës nr. 2855 prot., datë 07.06.2017, ardhur nga MSHMS, pranë Spitalit Universitar të Traumës.

Me shkresën nr. 576/1 prot, datë 31.01.2018 ñRidërgohet detajimi i artikullit 231 ñShpenzime kapitaleò për vitet 2018-2020ò nga Ministria e Mbrojtjes i përcillen Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të dhënat mbi detajimin e zërit buxhetor 231, në përgjigje të shkresës së MFE nr. 16148/141, datë 15.01.2018 ñÇôngurtësim fondiò, për efekt të miratimit të VKM 747, datë 13.12.2017.

Me shkresën nr. 576/2 prot, datë 01.02.2018 ñDërgim detajimi i buxhetit për vitet 2018, 2019 dhe 2020, për shpenzimet korrenteò (nr. 222 prot, datë 02.02.2018 protokolli i SUT) të ardhur pranë njësisë shpenzuese SUT, Ministria e Mbrojtjes përcjell tabelat e detajimit për shpenzimet korrente të viteve të mësipërme.

Më poshtë paraqiten parashikimi i shpenzimeve në të dy fazat e PBA 2018-2020 (MM dhe MSHMS), sipas fazave:

Faza e parë

Parashikimi i Shpenzimeve për t'u buxhetuar nga Ministria e Mbrojtjes

FAZA I

Tabela. 1.1 **000/lekë**

Zërat	PBA 2018-2020		
Parashikimet sipas Artikujve	*2018*	*2019*	*2020*
600 - Paga	*392,817*	*392,900*	*392,975*
601 - Sigurime Shoqërore	*60,308*	*60,320*	*60,337*
602 - Mallra dhe Shërbime të Tjera"	*880,093*	*924,098*	*970,303*
606 - Transferta për Buxh. Fam. & Individ	-	-	
231 - Kapitale të Trupëzuara	-	-	
Totali Buxhetor	***1,133,218***	***1,377,318***	***1,423,615***

Burimi i të dhënave: Spitali Universitar i Traumës

Faza e dytë

Parashikimi i shtesës së shpenzimeve për t'u buxhetuar nga Ministria e Mbrojtjes

FAZA II

Tabela. 1.2 **000/lekë**

Zërat	PBA 2018-2020		
Parashikimet sipas Artikujve	*2018*	*2019*	*2020*
600 - Paga	*45,817*	*45,900*	*45,975*
601 - Sigurime Shoqërore	*8,808*	*8,820*	*8,837*
602 - Mallra dhe Shërbime të tjera	*479,593*	*498,598*	*544,803*
606 - Transferta për Buxh. Fam. & Individ	*1,200*	*1,200*	*1,200*
231 - Kapitale të Trupëzuara	*175,028*	*405,000*	-
Totali Buxhetor	***710,446***	***959,518***	***600,815***

Burimi i të dhënave: Spitali Universitar i Traumës

Parashikimi i shpenzimeve për t'u buxhetuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

FAZA II

Tabela. 1.3 **000/lekë**

Zërat	PBA 2018-2020		
Parashikimet sipas Artikujve	***2018***	***2019***	***2020***
600 - Paga	-	-	-
601 - Sigurime Shoqërore	-	-	-
602 - Mallra dhe Shërbime të Tjera	*133,503*	*137,906*	*139,354*
606 - Transferta për Buxh. Fam. & Individ	*259*	*460*	*460*
231 - Kapitale të Trupëzuara	-	-	-
Totali Buxhetor	***133,762***	***138,366***	***139,814***

Burimi i të dhënave: Spitali Universitar i Traumës

Pas miratimit nga MFE të Udhëzimit nr. 7/1, datë 28.02.2018 ñPër përgatitjen e PBA 2019-2021ò, ky akt normativ i përcillet SUT-së me shkresën nr. 2202/2 prot, datë 28.03.2018 nga Ministria e Mbrojtjes.
Pas miratimit nga MFE të Udhëzimit nr. 7/2, datë 09.07.2018 ñPër përgatitjen e PBA 2019-2021ò,
me shkresën nr. 5971/4 prot., datë 22.08.2018, MM i përcjell SUT Udhëzimin Plotësues të MM nr. 3/1 prot., datë 22.08.2017 ñPër përgatitjen e PBA 2018-2020ò, në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të Udhëzimit nr. 23 datë 22.11.2016 ñPër Procedurat Standarde të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëmò, të VKM nr. 476/2018, ñPër miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve për PBA 2019-2021ò, të Udhëzimit të MFE nr. 7/2, datë 09.07.2018 ñPër përgatitjen e PBA 2019-2021ò.
Me shkresën nr. 1674 prot., datë 06.09. 2018 të STU janë dërguar kërkesat e PBA 2019 ï 2021 pranë Ministrisë së Mbrojtjes për Fazën e Dytë.
Më datë 03.08.2018, SUT ka përcjell kërkesat buxhetore të fazës së dytë për tôu buxhetuar me fonde të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,të cilat përfitohen në zbatim të Kontratës nr. 170 prot., datë 18.01.2019, që SUT lidhi me FSDKSH -në për vitin 2019.
Me shkresën nr. 685/1 prot, datë 04.02.2019 (nr. 399, datë 05.02.2019, protokolli i brendshëm i SUT) nga Ministria e Mbrojtjes i dërgohen SUT - së detajimet i artikullit ñShpenzime kapitaleò për vitin 2019ò.
Me shkresën nr. 873/1 prot, datë 08.02.2019 (nr. 456, datë 11.02.2019, protokolli i brendshëm i SUT) nga Ministria e Mbrojtjes i dërgohen SUT - së detajimet i artikullit ñShpenzime korenteò për vitet 2019-2021ò.
Më poshtë paraqiten parashikimi i shpenzimeve në të dy fazat e PBA 2019-2021.

Faza e parë

Parashikimi i Shpenzimeve për t'u buxhetuar nga Ministria e Mbrojtjes

FAZA I

Tabela. 2.1 **000/lekë**

Zërat	PBA 2019-2021		
Parashikimet sipas Artikujve	***2019***	***2020***	***2021***
600 - Paga	*351,230*	*351,230*	*351,230*
601 - Sigurime Shoqërore	*63,945*	*63,945*	*63,945*
602 - Mallra dhe Shërbime të Tjera	*430,375*	*440,825*	*440,825*
606 - Transferta për Buxh. Fam. & Individ	-	-	-
231 - Kapitale të Trupëzuara	-	-	*200,000*
Totali Buxhetor	***845,550***	***856,000***	***1,056,000***

Burimi i të dhënave: Spitali Universitar i Traumës

Faza e dytë

Parashikimi i Shpenzimeve për t'u buxhetuar nga Ministria e Mbrojtjes

FAZA II

Tabela. 2.2 **000/lekë**

Zërat	PBA 2019-2021		
Parashikimet sipas Artikujve	***2019***	***2020***	***2021***
600 - Paga	*351,230*	*351,230*	*351,230*
601 - Sigurime Shoqërore	*63,945*	*63,945*	*63,945*
602 - Mallra dhe Shërbime të Tjera	*428,375*	*478,175*	*478,175*
606 - Transferta për Buxh. Fam. & Individ	*2,000*	*2,200*	*2,200*
231 - Kapitale të Trupëzuara	*30,000*	-	*200,000*
Totali Buxhetor	***875,550***	***895,550***	***1,095,550***

Burimi i të dhënave: Spitali Universitar i Traumës

Parashikimi i Shpenzimeve për t'u buxhetuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

FAZA II

Tabela. 2.3000/lekë

Zërat	PBA 2019-2021		
Parashikimet sipas Artikujve	***2019***	***2020***	***2021***
600- Paga	-	-	-
601- Sigurime Shoqërore	-	-	-

602- Mallra dhe Shërbime të Tjera	*176,538*	*185,745*	*190,971*
606- Transferta për Buxh. Fam. & Individ	*267*	*418*	*467*
231- Kapitale të Trupëzuara	-	-	-
Totali Buxhetor	***176,805***	***186,163***	***191,237***

Burimi i të dhënave: Spitali Universitar i Traumës

Pas miratimit nga MFE të Udhëzimit nr. 8, datë 28.02.2019 ñPër përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022ò, ky akt normativ i përcillet SUT ï së (shkresa nr. 996 datë 09.04.2019, prot. i brendshëm i SUT) me shkresën nr. 1966/2 prot., datë 08.04.2019 nga Ministria e Mbrojtjes.
Me Urdhrin nr. 991, datë 09.04.2019, të Drejtorit të SUT ï së, urdhërohet ngritja e Grupit të Punës për përgatitjen e PBA ï së 2020 ï 2022 i cili po ashtu të përgatisë brenda datës 24.04.2020 Programin Buxhetor Afatmesëm. Çështjet e mësipërme ngarkohet tõ ndjekë Zv/Drejtori Ekonomik i SUT ï së.
Nga Ministria e Mbrojtjes i përcillet SUT -së Udhëzimi Plotësues i MM nr. 4 prot., datë 15.04.2019 ñPër përgatitjen e PBA 2020-2022ò.
Me shkresën nr. 1270 prot., datë 10.05. 2019 të STU janë dërguar kërkesat e PBA 2019 ï 2021 pranë Ministrisë së Mbrojtjes për Fazën e Parë.
Nga FSDKSH përcillet pranë SUT -së kërkesa për hartimin e treguesve të programit buxhetorë afatmesëm 2020 ï 2022, me shkresën nr. 4 prot., datë 15.04.2019 ñPër përgatitjen e PBA 2020-2022ò.
Udhëzimi Plotësues i MFE -së nr. 21 prot., datë 10.07.2019 ñPër përgatitjen e PBA 2020-2022ò, me shkresën nr. 13217/1 prot., datë 10.07.2019 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dërgohet pranë MM, e cila ia përcjell SUT më datë 02.08.2019, me nr. 5047 prot..
Me shkresën nr. 1857 prot., datë 11.07. 2019 nga STU i janë dërguar kërkesat e PBA 2020 ï 2022 FSDKSH - së.
Nga Ministria e Mbrojtjes i përcillet SUT -së Udhëzimi Plotësues i MM nr. 8 prot., datë 07.08.2019 ñPër përgatitjen e PBA 2020-2022ò.
Me shkresën nr. 2230 prot., datë 20.08. 2019 nga STU i janë dërguar kërkesat e PBA 2020 ï 2022 Ministrisë së Mbrojtjes për Fazën e Dytë.
Më poshtë paraqiten parashikimi i shpenzimeve në të dy fazat e PBA 2020-2022.

Parashikimi i Shpenzimeve për t'u buxhetuar nga Ministria e Mbrojtjes

FAZA I

Tabela. 3.1 **000/lekë**

Zërat	**PBA 2020-2022**		
Parashikimet sipas Artikujve	***2020***	***2021***	***2022***
600 - Paga	*351,230*	*351,230*	*351,230*
601 - Sigurime Shoqërore	*63,945*	*63,945*	*63,945*
602 - Mallra dhe Shërbime të Tjera	*428,375*	*438,625*	*438,625*
606 - Transferta për Buxh. Fam. & Individ	*2,000*	*2,200*	*2,200*

231 - Kapitale të Trupëzuara	-	*200,000*	*200,000*
Totali Buxhetor	***845,550***	***1,056,000***	***1,056,000***

Burimi i të dhënave: Spitali Universitar i Traumës

Faza e dytë

Parashikimi i Shpenzimeve për t'u buxhetuar nga Ministria e Mbrojtjes

FAZA II

Tabela. 3.2 **000/lekë**

Zërat	**PBA 2020-2022**		
Parashikimet sipas Artikujve	***2020***	***2021***	***2022***
600 - Paga	*351,230*	*351,230*	*351,230*
601 - Sigurime Shoqërore	*63,945*	*63,945*	*63,945*
602 - Mallra dhe Shërbime të Tjera	*428,375*	*438,625*	*438,625*
606 - Transferta për Buxh. Fam. & Individ	*2,000*	*2,200*	*2,200*
231 - Kapitale të Trupëzuara	*50,000*	*200.000*	*200,000*
Totali Buxhetor	***895,550***	***1,056,000***	***1,056,000***

Burimi i të dhënave: Spitali Universitar i Traumës

Parashikimi i Shpenzimeve për t'u buxhetuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

FAZA II

Tabela. 3.3000/lekë

Zërat	**PBA 2020-2022**		
Parashikimet sipas Artikujve	***2020***	***2021***	***2022***
600	-	-	-
601	-	-	-
602	*167,500*	*174,100*	*180,964*
606	-	-	-
231	-	-	-
Totali Buxhetor	***167,500***	***174,100***	***180,964***

Burimi i të dhënave: Spitali Universitar i Traumës

2/3. Zbatimi i kritereve në planifikimin e buxhetit të shtetit, në përputhje me dispozitat ligjore. Realizimi i treguesve të buxhetit, analizimi dhe krahasimi me vitet e kaluara.

2.3.1 Realizimi i treguesve të buxhetit 2018

Sikurse nga dokumentacioni i shqyrtuar dhe veçanërisht ñAnaliza e vitit 2018 e Sektorit të Financësò përcjellë me shkresën nr. 92, datë 11.01.2019, gjatë vitit financiar 2018, Spitalit Universitar i Traumës, i është alokuar një buxhet total të miratuar nga Ministria e Mbrojtjes prej **906,943,840 lekë**, për paga, sigurime dhe shpenzime dhe një buxhet total të alokuar nga Ministria e Shëndetësisë prej **256,530,000 lekë**. Gjithsej buxheti SUT për vitin 2018 ishte **1 132**

599 000 lekë. Realizimi i shpenzimeve për 12 mujorin e vitit 2018 për këtë program sipas artikujve buxhetorë paraqitet sipas tabelave së mëposhtme:

Raporti i shpenzimeve faktike sipas artikujve (000/lekë) –Formulari nr. 6 (MM 2018)

Tabela. 4.1

Formulari Nr.6: Raporti i shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve (000/leke)

Ministria	**Mbrojtjes**	**Kodi**	**13**
Programi	**Mbeshtetja Shendetesore**	**Titulli**	**07340**

Totali i Shpenzimeve

Artikulli Kodi	Emertimi i artikullit	Fakti i vitit paraardhes Viti 2017	PBA 2018	Plan 2018 (1)	Ndryshimet 2018 (2)	Buxheti i rishikuar 2018 (3)	Fakti 2018 (4)	Diferenca 2018 (5)=(3)-(4)	Ne %
600	Paga	350,568	347,000	351,230	10,487	361,717	357,989	3,728	99.0
601	Sigurime Shoqerore	60,000	51,500	63,945	(5,093)	58,852	58,224	628	98.9
602	Mallra she Sherbime te tjera	486,881	400,500	425,500	28,360	453,860	451,526	2,334	99.5
603	Subvencione			-		-	-	-	
604	Transferta Korente te Brendshme			-		-	-	-	
605	Transferta Korente te Huaja			-		-	-	-	
606	Trans. Per Bash.Fam.&Individ	2,655		-	3515	3,515	2,644	871	75.2
Nen.Totali	**Shpenzime korrente**	**900,104**	**799,000**	**840,675**	**37,269**	**877,944**	**870,383**	**7,561**	**99.1**
230	Kapitale te Patrupezuara	0	0	-		-	0	-	
231	Kapitale te Trupezuara	4,905	0	29,000	0	29,000	0	29,000	0.0
Nen.Totali	**Shpenzime kapitale**			**29,000**	**-**	**29,000**	**-**	**29,000**	
Totali	**Korrente dhe Kapitale**	**905,009**	**799,000**	**869,675**	**37,269**	**906,944**	**870,383**	**36,561**	96.0
Jashte Buxhetore				**0**	**0**	**-**	**0**	**-**	
Totali (korrente+kapitale+jashte buxhetore)		**905,009**	**799,000**	**869,675**	**37,269**	**906,944**	**870,383**	**36,561**	96.0

Burimi i të dhënave: Spitali Universitar i Traumës

Raporti i shpenzimeve faktike sipas artikujve (000/lekë) –Formulari nr. 6 (MSHMS 2018)

Tabela. 4.2

Formulari Nr.6: Raporti i shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve (000/leke)

Ministria	SHENDETSISE	Kodi	13
Programi	Spitali Universitar i Traumes	Titulli	07330

Totali i Shpenzimeve

Artikulli Kodi	Emertimi i artikullit	Fakti i vitit paraardhes Viti 2017	PBA 2018	(1) Plan 2018	(2) Ndryshimet 2018	(3) Buxheti i shikuar 2018	(4) Fakti 2018	(5)=(3)-(4) Diferenca 2018	Ne %
600	Paga	92,500	105,900	105,900	6,500	112,400	111,795	605	**99.5**
601	Sigurime Shoqerore	14,802	16,950	16,950	1,280	18,230	17,929	301	**98.3**
602	Mallra she Sherbime te tjera	122,191	120,000	120,000	5,900	125,900	121,663	4,237	**96.6**
603	Subvencione			-		-	-	-	
604	Transferta Korente te Brendshme			-		-	-	-	
605	Transferta Korente te Huaja			-		-	-	-	
606	Trans. Per Bash.Fam.&Individ	35		-	0	-	-	-	
Nen.Totali	**Shpenzime korrente**	**229,528**	**242,850**	**242,850**	**13,680**	**256,530**	**251,387**	**5,143**	**98.0**
230	Kapitale te Patrupezuara	0		-		-	0	-	
231	Kapitale te Trupezuara	0		-		-	0	-	
Nen.Totali	**Shpenzime kapitale**			**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	
Totali	**Korrente dhe Kapitale**	**229,528**	**242,850**	**242,850**	**13,680**	**256,530**	**251,387**	**5,143**	**98.0**
Jashte Buxhetore				**0**	**0**	**-**	**0**	**-**	
Totali (korrente+kapitale+jashte buxhetore)		**229,528**	**242,850**	**242,850**	**13,680**	**256,530**	**251,387**	**5,143**	**98.0**

Burimi i të dhënave: Spitali Universitar i Traumës

Realizimi i buxhetit në artikullin 602 viti 2018

Tabela. 4.3

Nr.	Emërtimi	Realizimi art. 602	Artikull 602 në %	Buxhetit total në %
1	**Barna dhe materiale mjekësore ortopedike dhe neurokirurgjike**	246,695,775	42%	22%
2	**Oksigjeni dhe kitet**	19,855,132	3%	2%
3	**Shërbime ndaj pacienteve, lavanteri, ushqim**	119,422,115	21%	11%
4	**Shpenzime mirëmbajtje paisje mjekësore dhe të tjera**	26,903,358	5%	2%
5	**Shërbime nga të tretë (ujë, drita, pastrim, roje etj)**	157,755,148	27%	14%
6	**Shpenzime të tjera (vendime gjyqi, taksa, etj)**	9,651,298	2%	1%
7	**TOTALI 602**	**580,282,826**	**100%**	**51%**
Nr.	**Emërtimi**	**Realizimi**	**Vlera në përqindje ndaj buxhetit total**	
1	**Paga**	469,784,090	41%	
2	**Sigurime shoqërore dhe shëndetësore**	76,152,836	7%	
	TOTALI 600+601	**545,936,926**	**48%**	
	TOTALI BUXHETI (600+601+602)	**1,126,219,752**	**99%**	

Burimi i të dhënave: Spitali Universitar i Traumës

Gjatë vitit 2018, me kërkesat e vazhdueshme për fonde nga SUT, drejtuar Institucioneve të mësipërme, janë miratuar disa shtesa buxheti, përkatësisht:

- ✓ nga MM për art. 600+601, një shtesë në vlerën 5,394,000 lekë, për art. 602, një shtesë në vlerën 28,360,000 lekë dhe për art. 606, një shtesë në vlerën 3,515,000 lekë;
- ✓ nga MSHMS për art. 600+601 një shtesë në vlerën 7,780,000 lekë dhe për art.602 një shtesë në vlerën 5,900,000 lekë.

Buxheti i SUT gjatë vitit 2018, sikurse rezulton edhe nga tabela pak më poshtë,është realizuar si vijon:

- në art. 600, për **"Paga"**,në vlerën **99%;**
- në art. 601, për **"Sigurime shoqërore"**,në vlerën **99%;**
- në art. 602 për **"Shpenzime operative",** në vlerën **99%;**
- në art. 606 për **"Transferta për Buxh. Fam. & Individ"**, *në vlerën 75%.*
  Ky konstatim i realizimit të dobët i këtij zëri buxhetor, justifikohet nga SUT me arsyen se çelja e fondeve bëhet mbi bazën e një parashikimi të përafërt të kërkesave të pritshme për ndihma ekonomike gjatë vitit.
- në art. 231, **"Kapitale të Trupëzuara",***konstatohet se fondi është i parealizuar.*

Realizimi i buxhetit në artikullin 231(/000lekë)

Tabela. 4.4

Kodi	Emërtimi i artikullit	Buxheti 2018	Buxheti i rishikuar 2018	Fakti 2018	Diferenca 2018	Në %
M1 70520	Ndërtimi i sallave të operacionit të Këmbës Diabetike	12,000	12,000	0	12,000	**0**
M1 70519	Rikonstruksion "Këmba ñDiabetike" dhe pajisja e sallave sipas standarteve	17,000	17,000	0	17,000	**0**
	Totali	**29,000**	**29,000**	**0**	**29,000**	**0**

Burimi i të dhënave: Spitali Universitar i Traumës

Mosrealizimi i këtij fondi investimesh justifikohet nga subjekti me arsyen të vonesave në përfundimin e procedurës në kohë, pasi ka pasur ankesa nga operatorët në KPP. Ky fond për investim ka qenë i shtirë në dy vite buxhetore 2018-2019.

Realizimi i treguesve të buxhetit 2018 (MM + MSHMS)

Tabela. 4.5

Buxheti 2018	Ministria e Mbrojtjes		Ministria e Shëndetësisë		MM+MSHMS		Realizimi
Artikujt Buxhetorë	PLAN	FAKT	PLAN	FAKT	PLAN	FAKT	%
600	361,717,000	357,988,907	112,400,000	111,795,183	474,117,000	469,784,090	**99%**
601	58,852,000	58,224,003	18,230,000	17,928,833	77,082,000	76,152,836	**99%**
602	453,860,100	451,525,686	125,900,000	121,662,908	579,760,100	573,188,594	**99%**
606	3,514,740	2,643,844	-	-	3,514,740	2,643,844	**75%**
231	29,000,000		-	-	29,000,000	-	**0%**
TOTALI	**906,943,840**	**870,382,440**	**256,530,000**	**251,386,924**	**1,163,473,840**	**1,121,769,364**	**96%**

Burimi i të dhënave: Spitali Universitar i Traumës

Në total realizimi i buxhetit për vitin 2018 arrin në nivelin prej 96%.

2.3.2 Realizimi i treguesve të buxhetit 2019

Sikurse nga dokumentacioni i shqyrtuar dhe veçanërisht ñAnaliza e vitit 2019 e Sektorit të Financësò përcjellë me shkresën nr. 87, datë 05.02.2019, gjatë vitit financiar 2019, Spitalit Universitar të Traumës i është alokuar një buxhet nga Ministria e Mbrojtjes, prej **982,694,762 leke**, për paga, sigurime, shpenzime, investime dhe një buxhet i alokuar nga Ministria e Shëndetësisë, prej **275,650,000 lekë**.

Në total, gjatë vitit 2019 SUT ka lëvruar një buxhet prej **1,258,344,762 lekë.**

Realizimi i shpenzimeve për 12 mujorin e vitit 2019 për këtë program sipas artikujve buxhetorë paraqitet sipas tabelave së mëposhtme:

Raporti i shpenzimeve të Programit sipas artikujve buxhetorë (000/lekë) –Aneksi nr. 6 (MM 2019)

Tabela. 5.1

Aneksi nr. 2: Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Artikujve Buxhetorë

ne 000 leke

Ministria e Mbrojtjes									
Programi	07340						Kodi	1017138	
		Totali Shpenzimeve							
Artikulli Kodi	Emri	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2018	(2) PBA viti 2019	(3) Buxheti Vjetor Plani fillestar	(4) Buxheti Vjetor Plani i Rishikuar Viti 2019	(5) Buxheti/ Plani i Rishikuar Periudhes 12-mujor V. 2019	(6) Fakti i Periudhës 12-mujor V. 2019	(7)=(5)-(6) Diferenca	Në %
600	Paga	357,989	351,230	351,230	375,230	375,230	371,490	3,740	99
601	Sigurime Shoqërore	58,224	63,945	63,945	63,945	63,945	60,993	2,952	95
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	451,526	428,375	428,375	468,375	468,375	466,015	2,360	99,5
603	Subvencione								
604	Transferta Korente të Brendshme								
605	Transferta Korente të Huaja								
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	2,644	2,000	2,000	4,645	4,645	3,250	1,395	70
Nen-Totali	*Shpenzime Korrente*	*870,383*	*845,550*	*845,550*	*912,195*	*912,195*	*901,748*	*10,447*	99
230	Kapitale të Patrupëzuara								
231	Kapitale të Trupëzuara	0	130,000	130,000	70,500	70,500	66,881	3,619	95
Nen -Totali	*Shpenz. Kap. me financ. Brendshem*	*0*	*130,000*	*130,000*	*70,500*	*70,500*	*66,881*	*3,619*	95
230	Kapitale të Patrupëzuara								
231	Kapitale të Trupëzuara								
Nen -Totali	*Shpenz. Kap. me financ. të huaj*	*0*	*0*	*0*	*0*	*0*	*0*	*0*	
Nen-Totali	*Shpenzime Kapitale Brend+Huaja*	*0*	*130,000*	*130,000*	*70,500*	*70,500*	*66,881*	*3,619*	95
Nen-Totali	*Shpenzime Korrente+Kapitale*	*870,383*	*975,550*	*975,550*	*982,695*	*982,695*	*968,629*	*14,066*	98,5
Shpenzime nga te ardhurat jashte limitit									
Totali (korrente + kapitale + shp.nga te ardh. Jashte lim.)		870,383	975,550	975,550	982,695	982,695	968,629	14,066	98,5

Burimi i të dhënave: Spitali Universitar i Traumës

Raporti i shpenzimeve faktike të programit sipas artikujve (000/lekë) –Formulari nr. 6 (MSHMS 2019)

Tabela. 5.2

Formulari Nr.6: Raporti i shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve (000/leke)									
Ministria		Shendetsise dhe Mbrojtjes Sociale					Kodi	13	
Programi		Spitali Universitar i Traumes					Titulli	07330	
Totali i Shpenzimeve									
				(1)	(2)	(3)	(4)	(5)=(3)-(4)	
Artikulli Kodi	Emertimi i artikullit	Fakti i vitit paraardhes Viti 2018	PBA 2019	Plan 2019	Ndryshimet 2019	Buxheti i rishikuar 2019	Fakti 12 Mujor 2019	Diferenca 2019	Ne %
600	Paga	111,795	112,800	112,800	2,150	**114,950**	113,215	1,735	**98.5**
601	Sigurime Shoqerore	17,929	18,800	18,800	100	**18,700**	18,327	373	**98.0**
602	Mallra she Sherbime te tjera	121,663	130,000	130,000	12,000	**142,000**	140,325	1,675	**98.8**
603	Subvencione			-		-	-	-	
604	Transferta Korente te Brendshme			-		-	-	-	
605	Transferta Korente te Huaja			-		-	-	-	
606	Trans. Per Bash.Fam.&Individ			-	0	-	-	-	
Nen.Totali	**Shpenzime korrente**	**251,387**	**261,600**	**261,600**	**14,250**	**275,650**	**271,867**	**3,783**	**98.6**
230	Kapitale te Patrupezuara		0	-		-	0	-	
231	Kapitale te Trupezuara		0	-		-	0	-	
Nen.Totali	**Shpenzime kapitale**			**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	
Totali	**Korrente dhe Kapitale**	**251,387**		**261,600**	**14,250**	**275,650**	**271,867**	**3,783**	98.6
Jashte Buxhetore				**0**	**0**	-	**0**	-	
Totali (korrente+kapitale+jashte buxhetore)		**251,387**	**-**	**261,600**	**14,250**	**275,650**	**271,867**	**3,783**	**98.6**

Burimi i të dhënave: Spitali Universitar i Traumës

Gjatë vitit 2019, në përgjigje të kërkesave nga ana e SUT, janë miratuar disa shtesa buxheti të alokuara, përkatësisht:

- ✓ nga MM, për art. 600+601 një shtesë në vlerën 24,000,000 lekë dhe për art. 602 një shtesë në vlerën 40,000,000 lekë;
- ✓ nga MSHMS, për art. 600+601 një shtesë në vlerën 2,050,000 lekë dhe për art. 602 një shtesë në vlerën 12,000,000 lekë.

Buxheti i SUT gjatë vitit 2019, sikurse rezulton edhe nga tabela pak më poshtë, është realizuar si vijon:

- në art. 600, për **"Paga"**,në vlerën **99%;**
- në art. 601,për **"Sigurime shoqërore"**,në vlerën **96%;**
- në art. 602, për **"Shpenzime operative",** në vlerën **98%;**
- në art. 606, për **"Transferta për Buxh. Fam. & Individ"**, *në vlerën 70%.*

Ky konstatim i realizimit të dobët i këtij zëri buxhetor, justifikohet nga SUT me arsyen se çelja e fondeve bëhet mbi bazën e një parashikimi të përafërt të kërkesave të pritshme për ndihma ekonomike gjatë vitit.

- në art. 231, **"Kapitale të Trupëzuara**ò,***konstatohet se fondi është realizuar në vlerën 95%.***

Në total realizimi i buxhetit për vitin 2018 arrin në nivelin **prej 96%.**

Realizimi i treguesve të buxhetit 2019 (MM + MSHMS)

Tabela. 5.3

Buxheti 2019	*Ministria e Mbrojtjes*		*Ministrie e Shendetesise*		*MM+MSHMS*		Realizimi
Artikujt Buxhetorë	*PLAN*	*FAKT*	*PLAN*	*%*	*PLAN*	*FAKT*	*%*
600	*375,230,000*	*371,489,522*	*114,950,000*	*113,214,848*	*490,180,000*	*484,704,370*	***99%***
601	*63,945,000*	*60,992,787*	*18,700,000*	*18,327,314*	*82,645,000*	*79,320,101*	***96%***
602	*468,375,000*	*466,0015,000*	*142,000,000*	*136,777,082*	*610,375,000*	*599,779,968*	***98%***
606	*4,644,762*	*3,250,235*	-	-	*4,644,762*	*3,250,235*	***70%***
231	*70,500,000*	*66,881,302*	-	-	*70,500,000*	*66,881,302*	***95%***
TOTALI	***982,694,762***	***965,616,732***	***275,650,000***	***268,319,244***	***1,258,344,762***	***1,233,935,976***	***98%***

Burimi i të dhënave: Spitali Universitar i Traumës

Buxheti i vitit 2019 duke e krahasuar me vitin 2018, është rritur në total 7 % dhe në zërin shpenzime art. 602 është rritur me 5 %. Më poshtë po japim realizimin e buxhetit për vitet 2018-2019, në art. 602:

Realizimi i artikullit 602 Vitet 2018- 2019 (MM+MSH)

Tabela. 5.4

Nr.	Emertimi	Realizimi 2018	Realizimi në % në art. 602	Realizimi 2019	Realizimi në % në art. 602
1	**Barna dhe materiale mjekësore ortopedike dhe neurokirurgjike**	246,695,775	42%	248,851,631	41%
2	**Oksigjeni dhe kitet**	19,855,132	3%	24,535,085	4%
3	**Shërbime ndaj pacienteve, lavanteri, ushqim**	119,422,115	21%	127,063,387	21%
4	**Shpenzime mirëmbajtje pajisje mjekësore dhe të tjera**	26,903,358	5%	65,396,120	11%
5	**Shërbime nga të tretë (ujë, drita, pastrim, roje etj)**	157,755,148	27%	135,349,277	22%
6	**Shpenzime të tjera (vendime gjyqi, taksa, etj)**	9,651,298	2%	9,179,500	2%
	TOTALI 602	**580,282,826**	**100%**	**610,375,000**	**100%**

Burimi i të dhënave: Spitali Universitar i Traumës

Grafiku i realizimit të buxhetit 2018-2019 në artikullin 602

Diagrama 1



Burimi i të dhënave: Spitali Universitar i Traumës

2.33. Realizimi i treguesve të buxhetit 2020

Sikurse nga dokumentacioni i shqyrtuar dhe veçanërisht ñAnaliza e vitit 2020 e Sektorit të Financësò gjatë vitit financiar 2020, Spitalit Universitar të Traumësi është alokuar një buxhet total nga Ministria e Mbrojtjes: për paga, sigurime, shpenzime operative dhe investime, prej **1,159,224,000 lekësh** dhe një buxhet total nga Ministria e Shëndetësisë, prej **419,408,000 lekësh**. Në total vlera e buxhetit të lëvruar gjatë vitit 2020 për këtë njësi shpenzuese, është**1,578,632,000 lekë**.

Më poshtë paraqesim raportet e shpenzime vetë programeve sipas artikujve buxhetorë të mbuluara nga dy ministritë e linjës.

Raporti i shpenzimeve të Programit sipas artikujve buxhetorë (000/lekë) –Aneksi nr. 2(MM 2020)

Tabela. 6.1

Aneksi nr. 2: Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Artikujve Buxhetorë									
								ne 000 leke	
Ministria e Mbrojtjes									
Programi	07340						Kodi	1017138	
		Totali Shpenzimeve							
Artikulli Kodi	Emri	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2019	(2) PBA Viti 2020	(3) Buxheti Vjetor Plani fillestar Viti 2020	(4) Buxheti Vjetor Plani i Rishikuar Viti 2020	(5) Buxheti/ Plani i Rishikuar Periudhes 12 mujori Viti 2020	(6) Fakti i Periudhës12 Mujori V. 2020	(7)=(4)-(6) Diferenca (Gjendja)	(8=(6)/(4)*100 Perqindje)
600	Paga	371,490	400,000	400,000	382,000	382,000	381,998	2	99.99947644
601	Sigurime Shoqërore	60,993	66,000	66,000	64,000	64,000	61,299	2,701	95.7796875
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	466,015	377,550	377,550	**658,864**	**658,864**	**635,066**	23,798	96.38802545
603	Subvencione							0	
604	Transferta Korente të Brendshme							0	
605	Transferta Korente të Huaja							0	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	3,250	2,000	2,000	4,360	4,360	2,394	1,966	54.90825688
Nen-Totali	*Shpenzime Korrente*	*901,748*	*845,550*	*845,550*	*1,109,224*	*1,109,224*	*1,080,757*	*28,467*	97.43361125
230	Kapitale të Patrupëzuara				22,600	22,600	17,095	5,505	75.64159292
231	Kapitale të Trupëzuara	66,881	50,000	50,000	27,400	**27,400**	20,274	7,126	73.99270073
Nen -Totali	*Shpenz. Kap. me financ. Brendshem*	*66,881*	*50,000*	*50,000*	*50,000*	*50,000*	*37,369*	*12,631*	74.738
230	Kapitale të Patrupëzuara								
231	Kapitale të Trupëzuara								
Nen -Totali	*Shpenz. Kap. me financ. të huaj*	*0*	*0*	*0*	*0*	*0*	*0*	*0*	
Nen-Totali	*Shpenzime Kapitale Brend+Huaja*	*66,881*	*50,000*	*50,000*	*50,000*	*50,000*	*37,369*	*12,631*	74.738
Nen-Totali	*Shpenzime Korrente+Kapitale*	*968,629*	*895,550*	*895,550*	*1,159,224*	*1,159,224*	*1,118,126*	*41,098*	96.45469728
Shpenzime nga te ardhurat jashte limitit									
Totali (korrente + kapitale + shp.nga te ardh. j. lim.)		**968,629**	**895,550**	**895,550**	**1,159,224**	**1,159,224**	**1,118,126**	**41,098**	**96.45469728**

Burimi i të dhënave: Spitali Universitar i Traumës

Raporti i shpenzimeve faktike të programit sipas artikujve (000/lekë) –Formulari nr. 6 (MSHMS 2020)

Tabela. 6.2

Formulari Nr.6: Raporti i shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve (000/leke)									
Ministria		Shendetsisw dhe Mbrojtjes Sociale					Kodi	13	
Programi		Spitali Universitar i Traumes					Titulli	07330	
Totali i Shpenzimeve									
				(1)	(2)	(3)	(4)	(5)=(3)-(4)	
Artikulli Kodi	Emertimi i Artikullit	Fakti i vitit paraardhes Viti 2019	PBA 2019	Plan 2020	Ndryshimet 2020	Buxheti i shikuar 2020	Fakti 2020	Diferenca 2020	Ne %
600	Paga	113,215	115,000	115,000	35,358	150,358	149,569	789	100.0
601	Sigurime Shoqerore	18,327	19,200	19,200	(150)	19,050	19,018	32	100.0
602	Mallra dhe Sherbime te tjera	140,325	140,000	140,000	110,000	250,000	244,907	5,093	98.0
603	Subvencione			-		-	-	-	
604	Transferta Korente te Brendshme			-		-	-	-	
605	Transferta Korente te Huaja			-		-	-	-	
606	Trans. Per Bash.Fam.&Individ			-	0	-	-	-	
Nen.Totali	Shpenzime korrente	271,867	274,200	274,200	145,208	419,408	413,494	5,914	98.6
230	Kapitale te Patrupezuara	0		-		-	0	-	
231	Kapitale te Trupezuara	0		-		-	0	-	
Nen.Totali	Shpenzime kapitale			-	-	-	-	-	
Totali	Korrente dhe Kapitale	271,867	274,200	274,200	145,208	419,408	413,494	5,914	98.6
Jashte Buxhetore				0	0	-	0	-	
Totali (korrente+kapitale+jashte buxhetore)		271,867	274,200	274,200	145,208	419,408	413,494	5,914	98.6

Burimi i të dhënave: Spitali Universitar i Traumës

Realizimi i treguesve të buxhetit 2020 (MM + MSHMS)

Tabela. 6.3

Buxheti 2020	*Ministria e Mbrojtjes*		*Ministria e Shëndetësisë*		*MM+MSHMS*		Realizimi
Artikujt Buxhetorë	*PLAN*	*FAKT*	*PLAN*	*%*	*PLAN*	*FAKT*	*%*
600	*382,000,000*	*381,998,404*	*150,358,000*	*149,569,304*	*532,358,000*	*531,567,708*	***100%***
601	*64,000,000*	*61,299,184*	*19,050,000*	*19,017,629*	*83,050,000*	*80,316,813*	***97%***
602	*658,864,000*	*635,066,270*	*250,000,000*	*244,732,516*	*908,864,000*	*879,798,786*	***97%***
606	*4,360,000*	*2,393,759*	*-*	*-*	*4,360,000*	*2,393,759*	***55%***
230	*22,600,000*	*17,095,054*	*-*	*-*	*22,600,000*	*17,095,054*	***76%***
231	*27,400,000*	*20,274,000*	*-*	*-*	*27,400,000*	*20,274,000*	***74%***
TOTALI	***1,159,224,000***	***1,118,126,671***	***419,408,000***	***413,319,449***	***1,578,632,000***	***1,531,446,120***	***97%***

Burimi i të dhënave: Spitali Universitar i Traumës

Buxheti i mësipërm për periudhën **janar-dhjetor 2020**është realizuar në vlerë totale,për artikullin 600+601 në masën 98 %, dhe në artikullin 602, në masën 97 %.

Ndryshe nga sa reflektuar në tabelën e mësipërme, në fillim të vitit 2020 është çelur një buxhet total (MSHMS + MM), prej **1,287,750,000 lekë,** përkatësisht:

- në art. 600, për **"Paga"**: 115,000,000lekë + 400,000,000 lekë;
- në art. 601, **"Sigurime shoqërore"**: 19,200,000lekë+ 66,000,000 lekë;
- në art. 602, **"Shpenzime operative"**: 210,000,000lekë + 377,550,000 lekë;

- në art. 231,**“Kapitale të Trupëzuara”**: 0 + 50,000,000 lekë.

Gjatë vitit me kërkesat e vazhdueshme për fonde të SUT - së, drejtuar institucioneve të mësipërme, janë miratuar disa shtesa buxheti, sikurse më poshtë:

- Sa i përket art. 600 - **“Paga dhe shpërblime”**, buxheti fillestar ka qenë i pamjaftueshëm për të përfunduar vitin me sukses, pasi muaji dhjetor ishte i pambuluar me fonde. Në bazë të VKM nr. 207, datë 10.03.2020 ñPër dhënie shpërblimi mjek, infermier dhe personel të tjerëò dhe fillimit të Gjendjes së Pandemisë, u hartuan nga SUT, disa kërkesa për fonde për shpërblime të personelit mjekësor dhe mbështetës.
  FSDKSH ï ja miratoi shtesa buxhetore në vlerë totale **35.358.000** lekë, gjatë vitit 2020. Nga ana tjetër Ministria e Mbrojtjes në lidhje me VKM-në e mësipërme nuk ka miratuar shtesë fondi për këtë artikull buxhetor dhe ka urdhëruar SUT-në vetëm në muajin dhjetor, për të shpërblyer personelin mjekësor ushtarak për periudhën mars ï dhjetor 2020.
- Sa i përket art. 602ï **“Shpenzime operative”**, buxheti fillestar për SUT, i cili për natyrën e veçantë të problemeve shëndetësore që trajton, nuk mjaftonte për të përballuar rastet e traumave, aksidenteve, urgjencave të ndryshme. Për këtë arsye SUT, gjatë vitit 2020 hartoi vazhdimisht kërkesa për fonde në funksion të misionit të spitalit, plotësimit me medikamente dhe materiale mjekësore dhe një shërbimi më të mirë spitalor. Gjatë vitit 2020 **FSDKSH ka miratuar 2 shtesa**, në vlerë totale prej **40.000.000 lekë** dhe **Ministria e Mbrojtjes** ka miratuar dy shtesa buxhetore, në vlerën **281,314,000 lekë**.
- Sa i përket art. 231 ï **“Kapitale të Trupëzuara -** Investime**”**, fondet për këtë zë buxhetor miratohen vetëm nga Ministria e Mbrojtjes, dhe nuk kanë ndryshuar gjatë vitit 2020, ndërkohë që kërkesat për investime janë të larta për arsye të rritjes së kërkesave për rikonstruksione të disa godinave të Spitalit, si dhe blerjes së pajisjeve spitalore bashkëkohore për një shërbim më të mirë ndaj pacientit.

Buxheti i SUT gjatë vitit 2020, sikurse rezulton edhe nga tabelat e mësipërme,është realizuar si vijon:

- në art. 600,për **“Paga”,**në vlerën **100%;**
- në art. 601, për **“Sigurime shoqërore”**, në vlerën **97%;**
- në art. 602, për **“Shpenzime operative”,** në vlerën **97%;**
- në art. 606, për **“Transferta për Buxh. Fam. & Individ”**, *në vlerën 55%,*
  Realizimi i dobët i këtij zëri buxhetor, justifikohet nga SUT me arsyen se çelja e fondeve bëhet mbi bazën e një parashikimi të përafërt të kërkesave të pritshme për ndihma ekonomike gjatë vitit. Por është fakt se për të tre vitet në fokus të auditimit ky artikull buxhetor rezulton i parealizuar në nivel të kënaqshëm, dhe kjo për një parashikim të pa përshtatshëm të fondit të programuar për tâı alokuar. Vlera e vogël e këtij zëri buxhetor ndikon pak në realizimin global të buxhetit.
- në art. 230, **“Kapitale të Patrupëzuara”**, fondi është realizuar në vlerën **76%.**
- në art. 231, **“Kapitale të Trupëzuara”**, fondi është realizuar në vlerën **74%.**
  Në të dy këto zëra buxhetorë, realizimi i buxhetit ka rezultuar problematik

2.4.1. Analiza e buxhetit kundrejt PBA për vitin 2018

Referuar shpenzimeve, Spitali Universitar i Traumës për vitin 2018 ka bërë një parashikim në planifikimin e Buxhetit afatmesëm 2018-2020, për vitin 2018, në vlerën **1,041,850,000 lekë**. Sipas Ligjit nr. 109, date 30.11.2017 ñPër buxhetin e vitit 2018ò, i ndryshuar,është miratuar buxheti në vlerën **1,163,473,000**lekë. Referuar aktit normativ, shpenzimet e miratuara kanë patur një rritje të ndjeshme në vlerën **121,618,000** lekë.

Fakti i realizimit të shpenzimeve në fund të vitit ushtrimor rezulton **1,121,769,364** lekë. Ndërkohë, realizimet e shpenzimeve për vitin 2018 janë afërsisht **96,4%.**

2.4.2 Analiza e buxhetit kundrejt PBA për vitin 2019

Referuar shpenzimeve, Spitali Universitar i Traumës për vitin 2019 ka bërë një parashikim në planifikimin e Buxhetit afatmesëm 2019-2021, për vitin 2019, në vlerën **1,237,150,000 lekë**. Sipas Ligjit 99/2018, datë 03.12.2018 ñPër buxhetin e vitit 2019ò i ndryshuar, është miratuar buxheti në vlerën **1,258,344,762lekë**. Referuar aktit normativ, shpenzimet e miratuara kanë patur një rritje jo shumë të lartë në krahasim me PBA, në vlerën **21,194,762 lekë**,

Fakti i realizimit të shpenzimeve në fund të vitit ushtrimor 2019, rezulton **1,233,935,976 lekë**. Ndërkohë, realizimet e shpenzimeve për vitin 2019 janë afërsisht **98%.**

2.4.3. Analiza e buxhetit kundrejt PBA për vitin 2020

Referuar shpenzimeve, SUT për vitin 2020 ka bërë një parashikim në planifikimin e Buxhetit afatmesëm 2020-2022, për vitin 2020, në vlerën**1,169,750,000 lekë**. Sipas Ligjit nr. 88, datë 18.12.2019 ñPër buxhetin e vitit 2020ò, i ndryshuar, është miratuar buxheti në vlerën **1,578,632,000 lekë**.

Referuar aktit normativ, *shpenzimet e miratuara kanë patur një rritje shumë të lartë në krahasim me PBA, në vlerën **408,882,000 lekë**.*

Fakti i realizimit të shpenzimeve për periudhën vitit ushtrimor 2020, rezulton 1,531,466,120 lekë. Ndërkohë, realizimet e shpenzimeve për periudhën 2020 janë afërsisht **97%.**

2.5.1. Analiza e buxhetit 2018

SUT në zbatim të Udhëzimi nr. 22, datë 17.11.2016 ñPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendroreò, ka përcjellë konforme afateve të parashikuara në këtë akt normativ, raportin e monitorimit të buxhetit çdo katër muaj.

Nga ana e SUT këto raporte u përcillen me këtë periodicitet Ministrisë së Mbrojtjes (Drejtorisë së Buxhetimit dhe Menaxhimit Financiar) dhe FSDKSH ï së, meqenëse çdo vit marrëdhënia buxhetore e SUT me MSHMS finalizohet nëpërmjet kontratës, që lidh SUT me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm Kombëtar Shëndetësor (FSDKSH), bazuar në vendimet që Këshilli i Ministrave, miraton çdo vit ñPër financimin e shërbimeve spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin é .ñ.

Gjatë vitit 2018 u miratua VKM Nr. 17, datë 12.01.2018 ñPër financimin e shërbimeve spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2018ñ dhe nga SUT u lidh kontrata me Drejtorinë e Shërbimeve Spitalore Universitare dhe Kontrollit Spitalor të FSDKSH, nr. 126 (prot. i FSDKSH), më datë 12.02.2018.

Raportet e monitorimit të buxhetit 2018, sikurse lehtësisht konstatohet nga shkresat:nr. 1911 prot., datë 27.09.2018, nr. 1954 prot., datë 02.10.2018,nr. 834 prot., datë 25.03.2019, nr. 833 prot., datë 25.03.2019, përcjellin tek MM dhe FSDKSH, një relacion të shkurtër dhe formatet e evidencave buxhetore të cilat sikurse ***konstatohet,shfaqin mangësi,*** *meqë nuk respektojnë përpikmërisht kriteret e Udhëzimit Nr. 22, datë 17.11.2016 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore" dhe parashikimet e përcaktuara në paragrafin 49, të këtij udhëzimi.*

1. Titulli i gjetjes: Për vitin buxhetor 2018, relacionet e monitorimit të buxhetit kanë mangësi.

Situata: Raportet e monitorimit të buxhetit 2018, sikurse lehtësisht konstatohet nga shkresat: nr. 1911 prot., datë 27.09.2018, nr. 1954 prot., datë 02.10.2018, nr. 834 prot., datë 25.03.2019, nr. 833 prot., datë 25.03.2019, përcjellin tek MM dhe FSDKSH, një relacion të shkurtër dhe formatet e evidencave buxhetore të cilat sikurse konstatohet shfaqin mangësi,meqë nuk

respektojnë përpikmërisht kriteret e Udhëzimit Nr. 22, datë 17.11.2016 ñPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendroreò dhe parashikimet e përcaktuara në paragrafin 49, të këtij udhëzimi.
Konstatohet se paraqitja e informacionit: ñRelacion për monitorimin e buxhetit të SUT të 4 mujorit....ò bëhet pa plotësimin e një liste përmbajtjeje të raportit të monitorimit.
Po ashtu mungon ñHyrjaò ku jepet një përshkrim i përgjithshëm mbi procesin e monitorimit.
Të dhënat e raportuara në raportin e monitorimit nuk janë në përputhje me formatet e përcaktuara në paragrafin 49, të këtij udhëzimi.
Të dhënat e raportuara në raportin e monitorimit jo vetëm nga ana e programit ñMbështetja për Shëndetësinëò por dhe të programeve të tjera që monitorohen nga Ministria e Linjës, Ministria e Mbrojtjes, nuk janë sipas formateve të përcaktuara në këtë udhëzim në anekset përkatëse, për sa më poshtë

- Aneksi nr. 1, ñRaporti i shpenzimeve sipas Programeveò mungon, dhe paraqitet versioni i vjetër, Formati nr. 7.
- Aneksi nr. 2. ñRaporti i shpenzimeve të Programit sipas Artikujve buxhetorëò mungon, por paraqitet versioni i vjetër, Formati nr. 6.
- Aneksi nr. 3, "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës /produkteve të programit" mungon, etj.

Relacionet e monitorimit dhe zbatimit të buxhetit për vitin 2018 për programin nuk ka analizë të produkteve, shumë nga produktet identifikohen me projektet e investimeve dhe raportohen këto të fundit si produkte, me arsyen se PBA për programin ñMbështetja për Shëndetësinë ñ nuk është trajtuar në nivel objektivi, treguesish performance dhe produkteve të tyre, në mënyrë që të interpretohet në relacion mbi bazën e këtij standardi.
Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditmit, nga subjekti i audituar SUT është paraqitur observacioni me shkresën nr. 989/1 prot., të datës 14.05.2021, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë, cituar në ligjëratë të drejtë:
Kriteri: Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 22, datë 17.11.2016 ñPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendroreò, Kreu IV, paragrafi 49, sipas të cilit:
"Raporti i monitorimit i përgatitur nga ministritë dhe institucionet konsiston në:
Paraqitjen e informacionit sipas kërkesave të përcaktuara në udhëzim duke;
Plotësuar një listë të përmbajtjes së raportit të monitorimit;
Paraqitur një "Hyrje", ku të jepet një përshkrim i përgjithshëm mbi procesin e monitorimit:
Plotësuar formatet e përcaktuara në këtë udhëzim (Anekset bashkëlidhur), ku të dhënat janë të rakorduara me planin e buxhetit dhe realizimin në fakt të thesarit sipas SIQF:
.... Realizimin e produkteve në krahasim me planin si në terma sasiorë, ashtu dhe në vlerë..."
dhe Kreu V, paragrafi 51, sipas të cilit: *"Pjesë integrale e këtij udhëzimi dhe të detyrueshme për t'u zbatuar janë edhe anekset e monitorimit bashkëlidhur, si më poshtë:*
Aneksi nr. 1.....
Aneksi nr. 2....Aneksi nr. 5....".
Ndikimi: Hartimi i raporteve të monitorimit me mangësi të tilla e bën të paqartë vlerësimin e ecurisë financiare të institucionit, në raport me objektivat dhe politikat e SUT.
Shkaku: Mungesa e përvojës në përgatitjen e raporteve të monitorimit sipas standarteve të reja, të parashikuara në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 22, datë 17.11.2016 ñPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendroreò.
Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Menaxhmenti i Spitalit Universitar të Traumës duhet të sigurojë administrim të mirë dhe të forcojë kontrollet në monitorimin e buxhetit, si dhe të marrë masa që raportet e monitorimit të buxhetit të jenë të përpiluara me përfshirjen e të gjitha standarteve, si ato të formës, ashtu dhe ato të përmbajtjes, duke synuar mos përsëritjen e rasteve të tilla në të ardhmen.

Gjatë procesit të auditimit, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga SUT, konstatohet dërgimi me vonesë i raportit vjetor të monitorimit të buxhetit për vitin 2018 (më datë 25.03.2019).

2. Titulli i gjetjes: Vonesë në dërgimin e raportit vjetor të monitorimit të buxhetit për vitin 2018.

Situata: Raportet vjetorë të monitorimit të buxhetit për 2018, sikurse lehtësisht konstatohet nga shkresat: nr. 834 prot. dhe nr. 833 prot., janë përcjellë pranë Ministrisë së Mbrojtjes dhe Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm Kombëtar Shëndetësor me vonesë, më datë 25.03.2019.

Kriteri: Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 9, datë 20.03.2018, ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, Kreu VI, paragrafi 270, i cili parashikon:*"**Nëpunësit autorizues të njësive të qeverisjes qendrore, duhet të paraqesin raportet e monitorimit tek Nëpunësi i Parë Autorizues, deri në fund të javës së katërt mbas përfundimit të katër mujorit dhe konkretisht deri në 30 Maj, 30 Shtator, ndërsa raporti vjetor deri në fund të muajit Shkurt tëvitit të ardhshëm, sipas të dhënave përfundimtare, pas rakordimeve me Ministrinë përgjegjëse për Financat".***

Ndikimi: Vonesa e dërgimit të raportit të monitorimit të buxhetit ndikon në proceset e vlerësimin e ecurisë financiare të institucionit dhe zbatimit të buxheteve të akorduara nga dy institucionet, ndaj të cilave SUT ka varësi buxhetore.

Shkaku: Neglizhenca mbetet shkaku për të cilën janë vonuar raportet vjetore të monitorimit të buxhetit, meqë SUT nuk ka identifikuar qartësisht një arsye tjetër.

Rëndësia:E mesme

Rekomandimi: Spitali Universitar i Traumës të marrë masa që raportet e monitorimit të buxhetit të jenë të përpiluara dhe dërguara në kohë tek dy institucionet ndaj të cilave SUT ka varësi buxhetore.

Për mangësitë e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi z. A. Z. , me detyrë Drejtor i SUT, në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj. E. O. , me detyrë Shefe e Sektorit të Planifikimit të Buxhetit.

Gjate vlerësimit të realizimit të treguesve të buxhetit, sikurse në paragrafët më lart, pjesërisht janë referuar edhe të dhëna të cilat janë përfshira në raportet e monitorimit, ndaj në vijim po trajtojmë pak të dhëna që meritojnë vëmendje.

Realizimi i shpenzimeve për 12 mujorin e vitit 2018 për ñ**PROGRAMI 07340 – Mbështetja për Shëndetësinë**ò sipas artikujve buxhetorë paraqitet në Tabelën 4.1 (faqe 8):

Realizimi i fondeve buxhetore sipas grup artikujve, për 12 /mujorin e vitit 2018, në këtë program buxhetor rezulton, si më poshtë:

Realizimi i fondeve buxhetore për grupin e shpenzimeve korente: 99 %

Realizimi i fondeve buxhetore për grupin e shpenzimeve kapitale: 0 %

Gjithsej:**49.5 %**

Nga ana tjetër,gjatë vitit buxhetor 2018 personeli i planifikuar në strukturën e SUT, i mbuluar nga fonde buxhetore të MM, ishte prej 473 punonjësish, ndërsa të punësuar gjatë këtij viti ishin 459 veta, pra me një mungese pre 14 punonjësish në raport me planin, duke e çuar realizimin në 97%.

Personel SUT 2018, i buxhetuar nga MM

Tabela. 7.1

Sektori I Planifikimit							
	Ministria e Mbrojtjes				Kodi	17	
Programi	Mbeshtetja Shendetesore				Titulli	07340	
			1	2			
Kodi I			Sasia e planifikuar per vitin 2018	Sasia e relaizuar deri sot	Analiza		
Produktit	Emri i Produktit	Njesia matjes			Mbetja (1-2)	% realizimi	Komente
1	Personel SUT	Nr.fiz.	473	459	14	97.0	Nuk eshte siguruar nr I plote I punonjesve buxhetore

Drejtori SUT	Emri	Arben Zenelaj	P/Sektori Planifikimit	Emri	Edlira Osmenllari
	Nënshkrimi			Nënshkrimi	
	Data	25.02.2019		Data	25.02.2019

Burimi i të dhënave: Spitali Universitar i Traumës

Për vitin 2018, sipas programimit buxhetor afatmesëm 2018-2020, për ketë program buxhetor ishin parashikuar dy produkte në nivel investimi (me financim të brendshëm): ñNdërtimi i sallave të operacionit të Këmbës Diabetikeò dhe ñRikonstruksionin "Këmba ñDiabetike" dhe pajisja e sallave sipas standarteveò.

Lidhur me *transferimet, shtesat, pakësimet* në alokimet tek zërat buxhetorë për vitin 2018, ndryshime te planit të buxhetit,kanë qenë si më poshtë:

Ka patur një alokim shtesë në art. 600, prej 15,487,000 lekë, për plotësimin e fondit të pagave për mbylljen e vitit 2018.

Në përgjigje të kërkesës dërguar nga SUT, për një fond shtese prej 76,344,177 lekë për blerje materialesh mjekimi, barna, kite, shërbim lavanteri, kompesime legale, faturave të furnizimit me ujë dhe me energji elektrike, etj., është mundësuar një alokim shtesë prej 30,000,000 lekë, në art. 602.

Ndërkaq ka patur pakësim në artikullin buxhetor 601, në vlerën prej 5,093,000 lekë, me arsyen se alokimi fillestar i këtij artikulli rezultonte, më shumë nga sa nevojitej për pagesën e kontributeve të sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore, referuar numrit të punonjësve, deri në fund të vitit 2018. Paralelisht janë bërë transferime nga një artikull tek një tjetër:

është shtuar fondi për art 606 me 239,900 leke dhe është pakësuar alokimi në art 602 për të njëjtë vlerë është shtuar fondi për art 606 me 1,400,000 leke dhe është pakësuar alokimi në art 602 për të njëjtë vlerë.

Paralelisht monitorimi i raportohet edhe FSDKSH ï së, ku vihet në dukje se fondet e akorduara për vitin 2018 ndaj SUT, me burim financimi nga FSDKSH përbëjnë rreth 28 % të buxhetit, me ndryshime të miratuara,në raport me buxhetin e akorduar nga Ministria e Mbrojtjes, për vitin 2018.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas grup artikujve për vitin 2018, përñProgramin 07330 SUT (Urgjenca e Tiranës & Ortopedi ish QSUT)ò rezulton, me realizim të fondeve buxhetore për grupin e shpenzimeve korrente, në 98 %, sikurse në Tabelën 4.2 (faqe 10).

Nga ana tjetër, gjatë vitit buxhetor 2018 personeli i planifikuar në strukturën e SUT, i mbuluar me fonde buxhetore nga MSHMS, ishte prej 141 punonjësish, ndërsa të punësuar gjatë këtij viti ishin 134 veta, pra me një mungese prej 7 punonjësish, në raport me planin, duke e çuar realizimin në 95%.

Personel SUT 2018, i buxhetuar nga MSHMS

Tabela. 7.2

Sektori I Planifikimit							
	Ministri e Shendetesise				Kodi	13	
	Spitali Universitar i Traumes				Titulli	07330	
			1	2			
Kodi I			Sasia e planifikuar per vitin 2018	Sasia e ree realizuar deri sot -2018	Analiza		
Produktit	Emri i Produktit	Njesia matjes			Mbetja (1-2)	% realizimit	Komente
1	Personel SUT	Nr.fiz.	141	134	7	95.0	Ne proçes

Burimi i të dhënave: Spitali Universitar i Traumës

Gjatë vitit buxhetor 2018, buxheti i akorduar nga MSHMS, ka pësuar disa ndryshime, të pasqyruara si më poshtë;
-alokim shtesë në art. 600, prej 6,500,000 lekë;
-alokim shtesë në art. 601, prej 1,280,000 lekë;
-alokim shtesë në art. 602, prej 5,900,000 lekë;

2.5.2. Analiza e buxhetit 2019

Gjatë vitit 2019 u miratua VKM Nr. 46 datë 30.01.2019ñPër financimin e shërbimeve spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2019ò dhe nga SUT u lidh kontrata me Drejtorinë e Shërbimeve Spitalore Universitare dhe Kontrollit Spitalor të FSDKSH, nr. 170 (prot. i SUT), më datë 18.01.2019.
U shqyrtuan raportet katër mujore të monitorimit të buxhetit të vitit 2019, dhe veçanërisht ato nr. 308 prot., datë 03.02.2020, nr. 309 prot., datë 03.02.2020, përcjell MM - së dhe FSDKSH ï së.
Referuar raportit dërguar MM, lidhur me ñProgramin 07340 ï Mbështetja për Shëndetësinëò, identifikohen objektivat kryesore të këtij programi, të cilat janë:

1. **Pritja dhe trajtimi i pacientëve të poli traumatizuar në kohë reale pranë Urgjencës së SUT.**

Treguesit e performancës për këtë objektiv:

- Numri Urgjencave të Kirurgjisë dhe Terapisë;
- Numri i pacientëve të shtruar të planifikuar dhe urgjentë në SUT;
- Nr. i operacioneve të planifikuara dhe urgjente;
- % e Mortalitetit.

2. **Trajtimi shëndetësor dhe spitalor ndaj pacientëve, i ofruar nga Specialitetet Mjekësore pranë SUT.**

Treguesit e performancës për këtë objektiv:

- Numri i shtrimeve reanimatore;
- Numri total i operacioneve sipas specialiteteve;
- Numri i ekzaminimeve imazherike;
- Numri i vizitave ambulatore në poliklinikë;
- Ditë qëndrimi mesatar në spital;
- Numri i shtrimeve reanimatore.

Fondet e akorduara për Programin ñMbështetje për Shëndetësinëò përbëjnë rreth 4.6 %të buxhetit, me ndryshime të miratuara, për MM-në

Për programin **" Mbështetje për Shëndetësinë"**, janë planifikuar dy objektiva, të shprehur dhe të realizuar me 4 produkte në zërat ñShpenzime Korrente ñ dhe 1 (një)ñProjekte Investimiò, në zërin ñShpenzime Kapitaleò.

Vlera totale e buxhetit të realizuar me këtë program shëndetësor, arrin në 968,629 mijë lekë, ose në nivelin 99%, të buxhetit të alokuar, prej 982,695,000 lekësh.

Realizimi i fondeve buxhetore për grupin e shpenzimeve korrente 99 %

Realizimi i fondeve buxhetore për grupin e shpenzimeve kapitale 95 %

Në këtë program shpërndarja e burimeve financiare është bërë në përputhje me politikat ekonomike dhe prioritetet e SUT ï së, duke pasur si synim një përdorim sa më efiçent të këtyre burimeve, përgjegjësi të qarta për menaxhimin e shpenzimeve për çdo produkt, në funksion të realizimit të objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara nga SUT për vitin 2019.

Realizimi i produkteve të parashikuar në program paraqitet si vijon:

Realizimi i treguesve të performancës

Tabela. 8.1

000 /lekë

Kodi i Produktit	Emërtimi i Treguesit të Performancës	Buxheti 2019	Fakti Viti 2019
91.04 AA	Paciente të Trajtuar Ambulator dhe të shtruar për shërbimin e Urgjencës pranë SUT.	116,041	115,729
91.04AB	Infrastrukture dhe logjistike funksionale për pacientët e shërbimit të Urgjencës.	46,153	45,649
917.4AC	Pacientë të trajtuar ambulator dhe të shtruar sipas specialiteteve mjekësore.	545,851	542,054
91.04 AD	Mirëmbajtje Infrastrukture dhe Logjistike sipas specialiteteve mjekësore të SUT	204,150	198,316
M10.0519	Rikonstruksion i pavionit dhe ndërtimi i sallave të operacionit të Këmbës Diabetike në SUT	70,500	66,881

Burimi i të dhënave: Spitali Universitar i Traumës

Gjatë vitit buxhetor 2019,buxheti i akorduar SUTï së, nga MM ka pësuar disa ndryshime nëpërmjet akteve normative apo edhe kërkesave për rialokim fondi për nevojat e SUT, të cilat kanë rezultuar si më poshtë:

për art. 601nuk ka patur ndryshime në planin fillestar të buxhetit 2019;
-alokim shtesë në art. 600, prej 24,000,000 lekë;
-alokim shtesë në art. 602, prej 40,000,000 lekë;
pakësim në art. 231, prej 70,500,000 lekë;
Në bazë të kërkesës dërguar nga SUT, fillimisht është kërkuar transferim të fondit 100.000.000 lekë të investimit, me produkt ñ*Proteza të blera për Pacientët",* me kodin e miratuar I8AZ812 në artikuj buxhetorë përkatës, si më poshtë:

1. 36.882.214 lekë, në art. 231, për plotësimin e vlerës së kontratës të ñ*Rikonstruksion i Pavijonit dhe Ndërtimi i Sallave të Operacionit të Këmbës Diabetike* ñ;
2. 3.600.000 lekë, në art. 231, për furnizim/vendosje të një ashensori po të këtij pavijoni;
3. 59,517,786 lekë (si diferencë e mbetur nga 100,000,000 lekët), u transferuan tek art. 602 me përshkrimin ñ*Furnizim me pajisje mjekimi* (materiale konsumi) për shërbimin e Ortopedisë, të SUT.

Përfundimi rezultoi me realizimin si në punim dhe në likuidim të rikonstruksionit të Këmbës Diabetike (dy kate), por jo me realizim të furnizim/vendosje të ashensorit po në këtë godinë, për arsye të zhvillimit të procedurës së prokurimit në muajt e fundit të vitit 2019.
Përsa i takon produktit që ka të bëjë me **Shpenzimet kapitale,** kemi realizim në masën 95%.

Përmbledhëse e projekteve të investimeve me financim të brendshëm 2019, nga MM

Tabela. 8.2 000 /lekë

Mbështetje për Shëndetësinë						
			Në			
Kodi i		**Ins.Buxh.**	Buxheti i Rishikuar		Realizimi ne	Komente
Produktit	**Emërtimi i Projektit**	**01**	2019	Fakti	%	(Problematika)
18AZ812	Proteza te blera për pacientet	01	0	-	-	
M170519	Rikonstruksion" Këmba Diabetike", dhe pajisja e sallave sipas standardeve	**01**	70,500	66,881	**95**	**U realizua**
	Totali		**70,500**	66,881	-	**Realizuar**

Burimi i të dhënave: Spitali Universitar i Traumës

Realizimi i buxhetit të financuar nga MM, për vitin 2020, nga SUT është në masën 99%.
Fondet e akorduara për vitin 2019 SUT - së, me burim financimi nga FSDKSH, përbëjnë rreth 28 % të buxhetit, me ndryshime të miratuara,në raport me buxhetin e akorduar nga Ministria e Mbrojtjes, për vitin 2019.
Realizimi i fondeve buxhetore sipas grup artikujve për 12 /mujorin e vitit 2019 në këtë program buxhetor rezulton 98,6%.
Formati nr. 6,në vijim, përmban organikën e punonjësve në nivelin limit, sikurse përcaktuar në pikën 18, të VKM nr. 46, datë 30.01.2019 ñPër financimin e shërbimeve spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor, për vitin 2019ò.

Personel SUT 2019, i buxhetuar nga MSHMS

Tabela. 8.3

Nr							
Ministria	Shendetsise dhe Mbrojtjes Sociale				Kodi	13	
	Spitali Universitar i Traumes				Titulli	07330	
			1	2			
Kodi I			Sasia e planifikuar per vitin 2019	Sasia e realizuar per vitin 2019	Analiza		
Produktit	Emri i Produktit	Njesia matjes			Mbetja (1-2)	% realizimit	Komente
1	Personel SUT	Nr.fiz.	141	136	5	96.5	

Burimi i të dhënave: Spitali Universitar i Traumës

Gjatë vitit buxhetor 2019 personeli i planifikuar në strukturën e SUT, i mbuluar me fonde buxhetore nga MSHMS, ishte prej 141 punonjësish, ndërsa të punësuar gjatë këtij viti ishin 136 veta, pra me një mungese prej 5 punonjësish, në raport me planin, duke e çuar realizimin në 96,5%.

Gjatë vitit buxhetor 2019, buxheti i akorduar nga MSHMS, ka pësuar disa ndryshime, të pasqyruara si më poshtë;

-alokim shtesë në art. 602, prej 12,000,000 lekë;

-pakësim në art. 600, prej 2,150,000 lekë;

-pakësim në art. 601, prej 100,000 lekë.

Për këta të tre artikuj buxhetorë FSDKSH, zakonisht në fund të çdo viti rialokon shtesa apo pakësim fondesh, me qëllim plotësimin e nevojave për shpenzime të personelit për paga, pagesa të kontributeve shoqërore dhe sigurimeve shëndetësore, sipas nr. faktik të punonjësve të SUT, si dhe blerje të materialeve ortopedike, për art. 602, si një nga shërbimet spitalore që financohen nga FSDKSH.

2.5.3 Analiza e buxhetit 2020

Gjatë vitit 2020 u miratua Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 22.01.2020ñPër financimin e shërbimeve spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2020ò dhe nga SUT u lidh kontrata me Drejtorinë e Shërbimeve Spitalore Universitare dhe Kontrollit Spitalor të FSDKSH, nr. 492 (prot. i SUT), më datë 25.02.2020.

U shqyrtuan raportet katër mujore të monitorimit të buxhetit të vitit 2020, dhe veçanërisht ato nr. 335 prot., datë 12.02.2021 dhe nr. 335/1 prot., datë 12.02.2021, përcjell MM - së dhe FSDKSH ï së.

Referuar raportit dërguar MM, fondet e akorduara për Programin ñMbështetje për Shëndetësinëò përbëjnë rreth 4.5 % të buxhetit, me ndryshime të miratuara, për MM-në dhe ky program synon óAfrimin e një Shërbimi sa më të Specializuar Mjekësor dhe Spitalor në nivel Universitar, në trajtim në rang kombëtar të Politraumaveò.

Treguesi i performancës për këtë qëllim janë:

- Numri Urgjencave të Kirurgjisë dhe Terapisë;
- Numri i pacientëve të shtruar të planifikuar dhe urgjentë në SUT;
- Nr. i operacioneve të planifikuara dhe urgjente;
- % e Mortalitetit.

Qëllimi i ñProgramit 07340 ï Mbështetja për Shëndetësinëò, shprehet me dy objektiva themelorë të SUT, të cilat janë:

I. Pritja dhe trajtimi i pacientëve të politraumatizuar në kohë reale pranë Urgjencës së SUT.

Treguesit e performancës për këtë objektiv:

- Numri i shtrimeve nga Urgjenca;
- Numri i Urgjencave të shërbimit të Kirurgjisë;
- Numri i operacioneve në Sallat Operatore të Urgjencës;
- Numri i manipulimeve të ndryshme kirurgjikale;
- % e Mortalitetit në Urgjencë.

II. Trajtimi shëndetësor dhe spitalor ndaj pacientëve, i ofruar nga Specialitetet Mjekësore pranë SUT.

Treguesit e performancës për këtë objektiv:

- Numri i shtrimeve reanimatore;
- Numri total i operacioneve sipas specialiteteve në bllokun operator të SUT;
- Numri i ekzaminimeve imazherike;
- Numri i ekzaminimeve laboratorike;
- Ditë qëndrimi në spital;
- Koificenti i shfrytëzimit të shtratit,

Për programin ò Mbështetje për Shëndetësinëò, u planifikuan fillimisht 3 (tre) produkte në zërat ñShpenzime Korrenteñ, me buxhet fillestar 845,550,000 lekë, i ndryshuar më pas me shpalljen e pandemisë globale, në vlerën 1,079,224,000 lekë dhe me rindryshim buxhetor përfundimtar në vlerën 1,109,224 lekë, ndërkohë që realizimi i shpenzimeve korrente për periudhën e 12 mujorit të vitit 2020, rezulton në vlerën 1,080,757.000 lekë, në nivel 97.43 %.

Në kushtet e pandemisë nga Covid-19 gjatë vitit buxhetor 2020 u shtua edhe një produkt, i paparashikuar në PBA 2020-2022:

91704AF - Emergjence Mjekësore Covid -19.

Ecuria e realizimit te produkteve krahasuar me planin paraqitet si vijon:

Realizimi i treguesve të performancës 2020
Programin "Mbështetje për Shëndetësinë"

Tabela. 9.1 000/lekë

Kodi i Produktit	Emërtimi i Treguesit të Performancës	Buxheti 2020	Fakti Viti 2020
917.4 AA	Infrastrukture shëndetësore , logjistike funksionale për trajtimin e pacienteve ambulator dhe te shtruar për shërbimin e Urgjencës pranë SUT	263,960	258,552
917.4AC	Paciente te trajtuar ambulator dhe te shtruar sipas specialiteteve mjekësore.	511,550	505,233
917.4 AD	Mirëmbajtje Infrastrukturore dhe Logjistike sipas specialiteteve mjekësore te SUT	152,400	148,582
I8.Z811	Furnizim ï Vendosje Ashensori	7,400	3,582

I8AZ.15	Blerje Aparat Radiografi , krah C	11,808	11,808
M170.25	Studime Projektime	22,600	17,095
I8A.817	Blerje Pajisje Mjekësore	8,192	4,884

Burimi i të dhënave: Spitali Universitar i Traumës

Realizimi 12 mujor i buxhetit total të programit ñMbështetje për Shëndetësinëò (në vlerë 1,118.126,000 lekë) kundrejt buxhetit total të akorduar, për vitin 2020 (në vlerë 1,159,224,000 lekë),rezulton në nivelin 96.4% (sikurse shihet qartë edhe nga Tabela 6.1).
Për investimet, zëri ñShpenzime Kapitaleò, me financim të brendshëm, fillimisht u planifikuan tre produkte, në vlerën **50,000,000** lekë. Më pas, në periudhën e fundvitit 2020, u krijua dhe një produkt shtesë,por pa ndryshuar fondin në total (nga 3 u krijuan 4 produkte). Ky zë buxhetor realizua në vlerën **37,367,000,** në nivelin**75 %**.
Pasqyrimi analitik i shpenzimeve për investime paraqitet në aneksin nr.5 nga tabela e mëposhtme.

Përmbledhëse e projekteve të investimeve, me financim të brendshëm, nga MM për 2020

Tabela. 9.2 000/lekë

Aneksi nr. 5: Përmbledhëse e Projekteve të Investimeve me Financim të Brendshem

me 000 / leke

Kodi i projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plote e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i perfundimit të projektit	Buxheti i kontraktuar	Plani i buxhetit viti 2020	Realizimi progresiv nga fillimi i vitit deri fund te 12 mujorit . Viti 2020	Realizimi per periudhen e raportimit (12mujore/vjetore)	Mbetja	Komente
I8AZ815	Furnizim Vendosje Ashensoresh	7,400	2020	2020	7,400	7,400	3,580	3,580	3,820	perfunduar blerja me lidhje kontrate me nr 130/18 date 24.12.2019 me afat dy mujor nga lidhja e kontrates duke perfshire vitin 2020 per furnizim vendosje 1 (cope) ashensor , ne procedure prokurimi ka deshtuar ne sistem me mosdalje fituesve per kete qellim
I8AZ814	Blerje Aparat radiografie , krah C (edhe me program vazhdues)	20,000	2020	2020	11,808	11,808	11,808	11,808	0	realizim 100%
I8AZ813	Studime Projektime	22,600	2020	2020	22,600	22,600	17,095	17,095	5,505	Realizim I disa projekte preventivi me lidhje kontratash nr total 3 pertej 75 % te planizimit per kete qellim
I8AZ817	Blerje Pajisje Mjekesore			2020	8,192	8,192	4,884	4,884	3,308	realizim te blerjes se pajisjeve mjekesore sherbime dermatologji , nkirurgji , dhe per urgjencen mjekesore pajisje EKG
		50,000			50,000	50,000	37,367	37,367	12,633	
						Riplanizim 230+231 viti 2020	realizimi progresiv 12 mujor		Mbetja	

Burimi i të dhënave: Spitali Universitar i Traumës

Gjatë vitit buxhetor 2020, buxheti i akorduar nga MM, ka pësuar disa ndryshime, të pasqyruara si më poshtë;
-alokim shtesë në art. 602, prej 431,400,000 lekë;
-alokim shtesë në art. 602, prej 100,00,000 lekë;

-alokim shtesë në art. 606, prej 2,360,000 lekë;
-pakësim në art. 602, prej 250,000,000 lekë;
-pakësim në art. 600, prej 8,000,000 lekë;
-pakësim në art. 601, prej 2,000,000 lekë;
-dy transferime në vlerat, prej 22,600,000 lekë dhe 8,192,000 lekë.
Fondet e akorduara për vitin 2020 SUT - së, me burim financimi nga FSDKSH, përbëjnë rreth 37,5%të buxhetit, me ndryshime të miratuara,në raport me buxhetin e akorduar nga Ministria e Mbrojtjes, për vitin 2020.
Siç vërehet fondet buxhetore për vitin 2020 kanë qenë më të mëdha në krahasim me vitet e tjera, për shkak të situatës të pandemisë globale dhe masave të marr për përballimin e gjendjes.
Shtesat e buxhetit më shumë kanë prekur art. 600, si rezultat i pagesave dhe shpërblimeve për personelin mjekësor e urgjencës.
Po ashtu në art. 602 janë rialokuar dy herë fonde shtesë, përkatësisht për 90,000,000 lekë dhe 20,000,000 lekë, për mbulimin e shërbimeve të ortopedisë, të paketave të katarakteve të syrit, për shërbimin e okulistikës, si dhe për blerje të materialeve mbrojtëse personale anticovid -19.
Pakësimet në artikujt buxhetor 600 dhe 601 realizohen nga vetë FSDKSH, zakonisht në fund të çdo viti, pasi është konstatuar plotësimi i shpenzimeve të personelit për paga, kontribute shoqërore dhe sigurime shëndetësore, sipas numrit faktik të punonjësve të SUT.
Sikurse vihej re qartë, edhe nga Tabela 6.2, realizimi i fondeve buxhetore për grupin e shpenzimeve korrente, arrin në nivelin99 %.
Formati nr .6, në vijim, përmban organikën e punonjësve në nivelin limit, sikurse përcaktuar në pikën 18, të VKM nr. 42, datë 22.01.2020ñPër financimin e shërbimeve spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor, për vitin 2020ò.

Personel SUT 2020, i buxhetuar nga MSHMS

Tabela. 9.3

Sektori I Planifikimit							
	SHENDETESISE				**Kodi**	**13**	
	Spitali Universitar i Traumes				**Titulli**	**07330**	
			1	**2**			
Kodi I			**Sasia e planifikuar per vitin 2020**	**Sasia e realizuar vjetore 2020**	**Analiza**		**Komente**
Produktit	**Emri i Produktit**	**Njesia matjes**			**Mbetja (1-2)**	**% realizimit**	
1	**Personel SUT**	Nr.fiz.	**141**	**139**	**2**	**98.6**	nivel optimal

Burimi i të dhënave: Spitali Universitar i Traumës

Gjatë vitit buxhetor 2020 personeli i planifikuar në strukturën e SUT, i mbuluar me fonde buxhetore nga MSHMS, ishte prej 141 punonjësish, ndërsa të punësuar gjatë këtij viti rezultojnë 139 veta, pra me një mungese prej 2 punonjësish, në raport me planin, duke e çuar realizimin në 98,6%.
Gjatë vitit buxhetor 2020, buxheti i akorduar nga MSHMS, ka pësuar disa ndryshime, të pasqyruara si më poshtë;
-alokim shtesë në art. 602, prej 90,000,000 lekë;

-alokim shtesë në art. 600, prej 9,753,000 lekë;
-alokim shtesë në art. 602, prej 20,000,000 lekë;
-alokim shtesë në art. 600, prej 20,000,000 lekë:
-alokim shtesë në art. 600, prej 4,800,000 lekë;
-alokim shtesë në art. 601, prej 150,000 lekë;
-alokim shtesë në art. 600, prej 805,000 lekë.

Konstatohet se gjatë gjithë procesit të monitorimit të buxhetit nga njësia shpenzuese SUT, përkatësisht: të vitit 2018, të vitit 2019, të vitit 2020, paraqitja e informacionit,si dhe të dhënat e raportuara në raportin e monitorimit të buxhetit për këto vite, me burim financimi nga FSDKSH, nuk ka qenë në përputhje me përcaktimet e bëra në Udhëzimin Nr. 22, datë 17.11.2016 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore", meqë tabelat financiare nuk janë ato të formateve të përcaktuara në paragrafin 49, të këtij udhëzimi.

1. Titulli i gjetjes: Raportet e monitorimit të buxhetit për vitet 2018, 2019, 2020, me burim financimi nga FSDKSH, nuk kanë qenë në përputhje me përcaktimet e bëra në Udhëzimin Nr. 22, datë 17.11.2016 ñPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendroreò, meqë tabelat financiare nuk janë ato të formateve të përcaktuara në paragrafin 49, të këtij udhëzimi.

Situata: Gjatë gjithë procesit të monitorimit të buxhetit nga njësia shpenzuese SUT, përkatësisht: të vitit 2018, të vitit 2019, të vitit 2020, paraqitja e informacionit,si dhe të dhënat e raportuara në raportin e monitorimit të buxhetit për këto vite, me burim financimi nga FSDKSH, nuk ka qenë në përputhje me përcaktimet e bëra në Udhëzimin Nr. 22, datë 17.11.2016 ñPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendroreò, meqë tabelat financiare nuk janë ato të formateve të përcaktuara në paragrafin 49, të këtij udhëzimi.

Arsyet që kushtëzojnë një raportim jo të plotë, lidhur me zbatimin dhe monitorimin e buxhetit, me burim financimi nga FSDKSH, sipas SUT ï së, lidhen me këto argumente:

-Në rastin e marrëdhënies buxhetore mes SUT ï së dhe FSDKSH, nuk mund të flitet për një zbatim të mirëfilltë të një PBA ï je, me dy faza, sikurse realizohet në marrëdhënien buxhetore me Ministrinë e Mbrojtjes. Në marrëdhënien me FSDKSH realizohet zbatimi vetëm i Fazës së II i PBA ï së, i cili bazohet në Shtojcën 7 A, që përmban në formatet e saj treguesit aktual të çdo viti, sipas artikujve buxhetorë përkatës dhe parashikim në një format të kërkesave për artikullin buxhetor 602. Nga FSDKSH, në lidhje me udhëzimet e PBA, shkresat vijnë për fazën e dytë, me kërkesën për plotësimin e Shtojcës 7A);

-Nga ana e FSDKSH ï së, njësisë shpenzuese SUT, nuk i dërgohen tavane buxhetore;

-Nga ana tjetër, Shtojca 7-A nuk përmban formate në respektim të tavaneve në nivel qëllimi, objektivash, treguesish performance, produktesh, në mënyrë që të analizohet dhe raportohet çdo 4 muaj ecuria e treguesve, për buxhetin që i akordohet SUT ï së, nga FSDKSH ï ja, ndryshe nga si raportohet me raportet e zbatimit dhe monitorimit të buxhetit, me burim financimi nga MM;

Njëkohësisht, sikurse vihet re, Vendimet e Këshillit të Ministrave me objekt:ñPër financimin e shërbimeve spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin ...ñ, si dhe kontratat e lidhura çdo vit, mes SUT dhe Drejtorisë së Shërbimeve Spitalore Universitare dhe Kontrollit Spitalor të FSDKSH, nuk referojnë në asnjë pikë apo paragraf, të dhëna mbi zbatimin dhe monitorimin e një PBA të mirëfilltë, në rastin e buxhetimit nga FSDKSH, pavarësisht se SUT financohet nga MSHMS, me afro një vlerë fondesh që arrin në 30%, të fondeve të alokuara nga Buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

Kriteri: Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 22, datë 17.11.2016 ñPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendroreò, Kreu IV, paragrafi 49, i cili parashikon: *"Raporti i monitorimit i përgatitur nga ministritë dhe institucionet konsiston në:*
Paraqitjen e informacionit sipas kërkesave të përcaktuara në udhëzim duke:....
Plotësuar formatet e përcaktuara në këtë udhëzim (Anekset bashkëlidhur)...".
Ndikimi: Mosplotësimi i të dhënave financiare, sipas formateve të përcaktuara në Udhëzimin i Ministrisë së Financave nr. 22, datë 17.11.2016,në raportet e monitorimit të buxhetit për vitet 2018, 2019, 2020, dërguar FSDKSH, me burim financimi nga ky institucion, e bën procesin e vlerësimit të ecurisë financiare të SUT, një proces larg standartit të konsoliduar rëndom në të gjitha proceset e raportimit të monitorimit të buxhetit.
Shkaku: Vështirësitë objektive të cilat kushtëzojnë raportimin e monitorimit në përputhje me formatet e parashikuara në anekset bashkëlidhur Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 22, datë 17.11.2016 dhe mos kërkimi i zgjidhjes së problemit nga ana e SUT, në bashkëpunim me FSDKSH dhe MFE.
Rëndësia:E lartë.
Rekomandimi: Spitali Universitar i Traumës të marrë masa dhe të bashkërendojë veprimet me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm Kombëtar Shëndetësor dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në kërkim të një zgjidhjeje për plotësimin e formateve, për të parandaluar në të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.
Për mangësitë e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi z. A. Z., me detyrë Drejtor i SUT, në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj. E. O., me detyrë Shefe e Sektorit të Planifikimit të Buxhetit.
***Gjatë procesit të auditimit u konstatohet po ashtu, se raportet e monitorimit të buxhetit, gjatë periudhës objekt auditimi, nuk janë publikuar në faqen web të SUT*(wwww.sut.gov.al).**
2. Titulli i gjetjes: Mospublikim i raporteve të monitorimit të buxhetit në faqen zyrtare të SUT.
Situata: Gjatë procesit të auditimit u konstatua, se raportet e monitorimit të buxhetit, gjatë periudhës objekt auditimi, janë afishuar, apo publikuar pjesërisht (vetëm si Programi ñMbështetje për Shëndetësinëò), në raportin financiar të MM ï së, por nuk janë publikuar as në faqen web të SUT, as integralisht në ndonjërën faqe të të dy ministrive, ndaj të cilave SUT ka varësi buxhetore.
Si i tillë këto raporte monitorimi janë të panjohur për të interesuarit dhe mospublikimi është në shkelje të parimit të transparencës publike.
Kriteri: Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 22, datë 17.11.2016 ñPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendroreò, Kreu IV, neni 49, i cili parashikon:**"***Raporti i monitorimit i përgatitur nga ministritë dhe institucionet konsiston në:.....*
Publikimin e raporteve të monitorimit në faqen zyrtare të çdo ministrie/institucioni..".
Ndikimi: Mospublikimi i raporteve të monitorimit të buxhetit pamundëson informimin e të interesuarve dhe shmang transparencën publike.
Shkaku: Mos vlerësim i detyrimit ligjor.
Rëndësia: E lartë.
Rekomandimi: Drejtori i Spitalit Universitar të Traumës të marrë masa që raportet e monitorimit të paraqiten në faqen zyrtare të institucionit, duke rritur kështu nivelin e transparencës dhe të llogaridhënies, si dhe duke nxitur debatin publik mbi menaxhimin e Istitucionit. Kjo do të kontribuojë që grupet e interesit të monitorojnë më mirë zbatimin e planeve të Buxhetimit Afatmesëm me Bazë Performancën, apo orientimin e politikave të përgjithshme në drejtim të objektivave strategjikë të Sistemit Shëndetësor.

Për mangësinë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi A. Z., me detyrë Drejtor i SUT, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues.
Për sa trajtuar më sipër, arrihet **në konkluzionet se:**
Buxhetet vjetore janë hartuar dhe realizuar me mjaftueshmëri financiare, duke i siguruar Spitalit Universitar të Traumës zhvillim normal të aktivitetit të SUT.
Destinacioni i përdorimit të fondeve buxhetore në përgjithësi është ruajtur.
Limiti i përdorimit (kufiri vleror) rezulton i respektuar.
Afatet e çeljes së fondeve referuar udhëzimeve të buxhetit janë ruajtur

2.3. Zbatimi i strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
Bazuar në pikën 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1001, datë 02.12.2015 ñ*për integrimin e Spitalit Universitar te Traumës dhe Spitalit Ushtarak të Forcave të Armatosura në një strukturë të bashkuar*ò, është bërë miratimi i strukturës dhe organikës së SUT-S për vitin 2016, nga Kryeministri me urdhrin nr**.** 95, date 07.06.2016, financimi i pagave kryhet nga dy Ministritë, nga Ministria e Mbrojtjes dhe nga Ministria e Shëndetësisë (FSDKSH).
- Me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë nr. 38, datë 01.02.2016 ñ*Për transferimin e personelit të Shërbimit të Urgjencës Mjekësore*ò i është shtuar organika me 20 punonjës, të profesioneve mjek, infermier dhe shoferë.
-Me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë nr. 573, datë 27.12.2016 sërish Organikës së SUT ñ*Për kalimin e shërbimit të Traumatologji-Ortopedisë, nga Qendra spitalore Universitare Nënë Tereza, në Spitalin e Traumës",* i është shtuar organika me 85 punonjës, shoqëruar me transferimin e fondin përkatës të pagave, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe fondin në zërin ñ*Mallra-shërbime*ò të nevojshëm për funksionimin e shërbimit të Ortopedi Traumatologjisë.
Nga auditimi konstatohet se janë dhënë ndihma dhe shpërblime për dalje në pension dhe për raste fatkeqësie, konformë kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 929, datë 17.11.2010 ñ*Për krijimin dhe përdorimin e Fondit të veçantë*ò, i ndryshuar, ku për çdo rast janë është marrë miratimi nga Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Shëndetësisë dhe nuk u konstatuan shkelje të procedurave nga SUT.
Nga auditimi i kryer, rezulton rregullshmëri në derdhjet bankare, krahasimin e shumave të paguara me kartelat, borderotë dhe pasqyrat përmbledhëse. Siglimi i borderove është bërë sipas rregullave nga Titullari i SUT, shefja e sektorit të financës, specialistja e financës për pagat dhe janë të vulosura nga Dega e Thesarit Tiranë.
Listë pagesat janë plotësuar me të gjitha rubrikat e saj për çdo punonjës duke filluar si nga emërtesa sipas strukturës, paga bazë, ditë pune etj. edhe në rubrikën e ñ*shtesave"* apo ñ*ndalesave*ò.
Është mbajtur libri i pagave dhe është plotësuar për të gjithë punonjësit në marrëdhënie pune, duke pasqyruar të gjitha të dhënat e kërkuara. Tatimi mbi pagë është llogaritur konform ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ñ*Për tatimin mbi të ardhurat"*, i ndryshuar, ndërsa kontributi i sigurimeve shoqërore është llogaritur në zbatim të Ligjit nr. 10070, datë 05.02.2009 ñ*Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë"*, me ndryshimet përkatëse, si dhe janë kryer ndalesat e janë derdhur në Degën Rajonale të Tatimeve.

2.4. Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dita brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj).

Auditimi u ushtrua me zgjedhje[1], konkretisht u audituan urdhër shpenzimet (Shpenzimet me anë të bankës), të kaluara nëpërmjet Degës së Thesarit Tiranë, të kryera për llogari të Ministrisë së Mbrojtjes (Në vijim MB) dhe të Ministrisë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (ISKSH) (Në vijim MSHMS), për muajin dhjetor 2018, dhjetor 2019 dhe dhjetor 2020, **në total 655 transaksione** (urdhër shpenzime) **me vlerë 597,318 mijë lekë**. Sipas viteve: Për muajin dhjetor 2018, u audituan 186 transaksione (urdhër shpenzime) **me vlerë 115,560 mijë lekë**, përkatësisht 106 transaksione (urdhër shpenzime) me vlerë 78,139 mijë lekë MB dhe 80 transaksione me vlerë 37,421 mijë lekë MSHMS.

Për muajin dhjetor 2019, u audituan 171 transaksione (urdhër shpenzime) **me vlerë 157,586 mijë lekë,** përkatësisht 140 transaksione (urdhër shpenzime) me vlerë 114,974 mijë lekë MB dhe 31 transaksione me vlerë 42,612 mijë lekë MSHMS.

Për muajin dhjetor 2020, u audituan 298 transaksione (urdhër shpenzime) **me vlerë 324,172 mijë lekë**, përkatësisht 147 transaksione (urdhër shpenzime) me vlerë 210,499 mijë lekë MB dhe 151 transaksione me vlerë 113,723 mijë lekë MSHMS.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se transaksionet janë kryer konformë Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, me ndryshimet vijuese të tij, Ligjit nr. 25/2018, ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, me ndryshimet vijuese të tij, Ligjit 83/2019 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publikò, me ndryshimet vijuese të tij.

Veprimet financiare janë regjistruar në regjistrat e kontabilitetit, bazuar në dokumente vërtetues. Dokumentacioni është i sistemuar në mënyrë kronologjike.

*Pavarësisht nga sa u citua më sipër u konstatuan dhe shkelje dhe parregullsi ligjore ose rregullatore **në 22 transaksione (urdhër shpenzime) me vlerë 27,306 mijë lekë**, ku në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë:*

Me urdhër shpenzimin nr. 854, datë 06.12.2018 **për vlerën 489,422 lekë**, është likuiduar Shoqëria ñKa.ò Shpk. Ky shpenzim (likuidim) ka të bëjë me shërbim gjelbërimi për muajin nëntor 2018. Dokumentet vërtetues të kryerjes së këtij shpenzimi, fatura tatimore nr. 52, datë 30.11.2018 për vlerën 489,422 lekë. Situacion nr. 2, datë 30.11.2018 në vlerën 481,422 lekë, për periudhën 01.11.-30.11.2018 (kontrata nr. 179 prot., datë 01.10.2018, i firmosur nga M. P. me detyrë specialiste planifikimi, E. T. me detyrë juriste, V. S. me detyrë përgjegjës i sektorit të shërbimeve të brendshme dhe zv/drejtor ekonomik A. H., dhe për shoqërinë ñK.ò Shpk nga administratorja M. K. Në këtë situacion në zërin 4 ñMbjellje pemë dekorative të reja 14 copë x 17,000 = 238,000 lekë dhe në zërin 6 ñMbjellje shkurre dekorativeò copë 12 x 2,000 lekë/copë = 24,000 lekë. Shuma e të dy zërave është 262,000 lekë x 1.2 TVSH = 314,400 lekë me TVSH, shpenzimi është kryer pa dokumentacion të plotë vërtetues. Konkretisht nuk ka plan vendosje se ku do të mbillet me distancat respektive, speciet përkatëse, preventiv, çerfitikata fito-sanitare që

[1] *Auditimi me zgjedhje zhvillohet sipas ISA 530 (i rishikuar) "Kampioni i auditimit",i cili tregon tipet e ndryshme të testeve që audituesi kryen.*
Përkufizimi i një kampioni të zgjedhur për auditim sipas ISA 530 është: "Aplikimi i procedurave të auditimit në më pak se 100% të artikujve brenda një grupi të caktuar të transaksioneve ose llogarive kontabël etj, në atë mënyrë që të gjithë kampinonët të kenë të njëjtin shans për tu zgjedhur" .

do ti shoqërojnë. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 6, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35, Ligjin nr. 8732, datë 24.01.2001 ñPër materialin mbjellës bimorò, me ndryshimet vijuese të tijô, neni 7/b,c,ç, neni 20 pika 1 dhe 2, neni 23, VKM nr. 157, date 25.4.2002 ñPër kriteret dhe rregulla të përpunimit, ambalazhimit, ruajtjes, etiketimit dhe përmbajtjes se etiketës për materialin mbjellës, bimorò, neni 6, Udhëzimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit nr. 107 datë 2.12.2002 ñPër krijimin, shumëzimin, përpunimin, tregtimin, kontrollin, vlerësimin e farave dhe fidanëve dhe ruajtjen e trajtimin e materialit gjenetik bimorò, neni 11, b,c,d, neni 21/a,d, neni 39/a,b,c.

Për mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi V. S. me detyrë përgjegjës i sektorit të shërbimeve të brendshme.

Me urdhër shpenzimin nr. 900, datë 18.12.2018 **për vlerën 448,000 lekë**, është likuiduar Instituti i Modelimeve në Biznes. Ky shpenzim ka të bëjë me azhurnim softi WEB Buxhetor (Program financiar që përdoret në kontabilitetin e këtij institucioni). Dokumentet vërtetues të kryerjes së këtij shpenzimi, faturë shitje nr. 1420, datë 05.12.2018 në vlerën 448,000 lekë. Akt rakordimi për kryerjen e shërbimit me nr. 434 prot., datë 13.12.2018, është firmosur nga E. R. me detyre përgjegjëse e sektorit të financës, F. T. specialiste e sektorit të financës, Z. H. specialiste e sektorit të financës, L.T. specialiste e sektorit të financës dhe M. Ç. në emër të operatorit ekonomik Instituti i Modelimeve në Biznes. Urdhër prokurimi për blerjet me vlera të vogla nr. 208/7 prot., datë 30.10.2018. Ftesën për ofertë nr. 208/8 datë 30.10.2018. Specifikimet teknike me nr. 208/1 prot., datë 26.10.2018 të firmosura nga E. R. , F. T. dhe Zh. H. . Procesverbal i datës 05.11.2018 i komisionit të vlerësimit të ofertave i firmosur nga G. H. me detyrë përgjegjësi i sektorit të prokurimeve me profesion ekonomist, M. S. specialist prokurimi me profesion jurist si dhe Dh. M. specialist prokurimi me profesion ekonomiste.

Grupi i përgatitjes së specifikimeve teknike, akt rakordimi për kryerjen e shërbimit, dhe komisioni i blerjes me vlera të vogla, nuk kanë në përbërjen e tyre specialist të IT. Veprim në kundërshtim me Udhëzimin MF nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, pika 43.

Për mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi G. H. me detyrë përgjegjësi i sektorit të prokurimeve.

Me urdhër shpenzimin nr. 177, datë 13.12.2018 **për vlerën 23,000 lekë** nëpërmjet Bankës C. , është likuiduar përmbaruesi A. G. me NIPT K51717021H. Nuk ka faturë të lëshuar prej tij, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 10.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, neni 46, 47, 48, 49, 50. Ky shpenzim është klasifikuar në strukturën e llogarisë (artikullin) 6001001. Në këtë analizë përfshihen shpenzimet për pagën bazë sipas kategorisë, për të punësuarit. Referuar objektit të shpenzimit, ky shpenzim duhet të ishte përfshirë në analizën (artikullin) 6027400, që ka të bëjë me shpenzime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për largimet nga puna. Pra ky shpenzim nuk është paraqitur në llogarinë e duhur kontabël të klasifikimit buxhetor në nivel 7-shifror, po ashtu është kapitalizuar në mbyllje të vitit ushtrimor.

Veprime në kundërshtim me klasifikimin ekonomik të shpenzimeve, kodifikimi i të cilit është i njëjtë me llogaritë e planit kontabël publik, Ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 6, Udhëzimin MF nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publikò, me ndryshimet vijuese

të tij, pika 35 dhe me klasifikimin ekonomik të shpenzimeve, kodifikimi i të cilit është i njëjtë me llogaritë e planit kontabël publik.
Me urdhër shpenzimin nr. 187, datë 17.12.2018 **për vlerën 50,000 lekë** nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria ñGe.ò Shpk. Dokumentet vërtetues të kryerjes së këtij shpenzimi janë;
-fletëhyrje nr. 495, date 31.12.2018, e firmosur vetëm nga magazinieri.
-fatura tatimore shitje kompjuterike nr. 7063, datë 13.12.2018.
-procesverbali datë 07.12.2018 për pritjen, administrimin dhe dokumentimin e kiteve, i firmosur nga A. H. , A. B. dhe N. V. , duke cilësuar se materialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standarteve të kërkuara dhe specifikimeve teknike të kërkuara. Ky artikull të administrohet dhe të behët hyrje me fletëhyrjen nr. 495, datë 13.12.2018. Në procesverbalin e marrjes në dorëzim nuk është përcaktuar si janë realizuar specifikimet teknike një për një që duhet të plotësonte malli, por theksohet në përgjithësi.
Me urdhër shpenzimin nr. 188, datë 07.12.2018 për vlerën 28,800 lekë nëpërmjet R. Bank , është likuiduar Shoqëria ñB.A.ò Shpk. Dokumentet vërtetues të kryerjes së këtij shpenzimi janë:
-fletëhyrje nr. 478, date 31.12.2018, e firmosur vetëm nga magazinieri.
-fatura tatimore nr. 356, datë 07.12.2018.
-procesverbali datë 13.12.2018 për pritjen, administrimin dhe dokumentimin e kiteve, i firmosur nga I. H. , A. B. dhe V. B. , duke cilësuar se materialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standarteve të kërkuara dhe specifikimeve teknike të kërkuara. Ky artikull të administrohet dhe të behët hyrje me fletëhyrjen nr. 495, datë 13.12.2018. Në procesverbalin e marrjes në dorëzim nuk është përcaktuar si janë realizuar specifikimet teknike një për një që duhet të plotësonte malli, por theksohet në përgjithësi.
Me urdhër shpenzimin nr. 239, datë 27.12.2018 **për vlerën 443,861 lekë** nëpërmjet Bankës Soc. Ge. Alb. , është likuiduar BNT E. me NIPT J618...7D. Ky shpenzim ka të bëjë shërbimin e skanerit. Ky shpenzim është klasifikuar në strukturën e llogarisë (artikullin) 6025500. Në këtë analizë përfshihen shpenzimet e kryera për të gjitha llojet e mjeteve të transportit të përdorura nga ana e institucionit si psh: Riparime të ndryshme që ju bëhen këtyre mjeteve dhe nuk përbëjnë shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme. Referuar objektit të shpenzimit ky shpenzim duhet të ishte përfshirë në analizën (artikullin) 6029099, që ka të bëjë me shpenzime te tjera materiale dhe shërbime operative. Pra ky shpenzim nuk është paraqitur në llogarinë e duhur kontabël të klasifikimit buxhetor në nivel 7-shifror, po ashtu është kapitalizuar në mbyllje të vitit ushtrimor. Veprime në kundërshtim me klasifikimin ekonomik të shpenzimeve, kodifikimi i të cilit është i njëjtë me llogaritë e planit kontabël publik.
Me urdhër shpenzimin nr. 1058, datë 13.12.2019 **për vlerën 1,826,850 lekë** nëpërmjet Cre. Bankë, është likuiduar Shoqëria D. Shpk. Ky shpenzim ka të bëjë pagë shërbim lavanterie për periudhën 01-12.12.2019. Ky shpenzim është klasifikuar në strukturën e llogarisë (artikullin) 6021001. Në këtë analizë përfshihen shpenzimet për uniforma dhe veshje te tjera speciale. Konkretisht shpenzimet për blerjen e uniformave dhe veshjeve që përdoren nga ana e punonjësve civil dhe strukturave te specializuara. Këtu përmendim veshjet e strukturave të mbrojtjes, rendit SHISH etj, si dhe ato të punonjësve të shërbimit civil, të personelit mjekësor, rojet, pastruesit e tjerë , ose kundra vlera e tyre..... Referuar objektit të shpenzimit ky shpenzim duhet të ishte përfshirë në analizën (artikullin) 6029099 që ka të bëjë me shpenzime për te tjera materiale dhe shërbime operative. Pra ky shpenzim nuk është paraqitur në llogarinë e duhur kontabël të klasifikimit buxhetor në nivel 7-shifror, po ashtu është kapitalizuar në mbyllje të vitit ushtrimor. Veprime në kundërshtim me klasifikimin ekonomik të shpenzimeve, kodifikimi i të cilit është i njëjtë me llogaritë e planit kontabël publik.

Me urdhër shpenzimin nr. 1065, datë 13.12.2019 **për vlerën 1,090,800 lekë**, nëpërmjet Raiffeisen Bankë, është likuiduar Shoqëria ñF.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëjë shërbim mirëmbajtje aparaturave mjekësore. Dokumentet vërtetues të kryerjes së këtij shpenzimi, fatura tatimore shitje nr. 389, datë 12.12.2019 në vlerën 1,090,800 lekë. Akt rakordimi me nr. 783 prot, datë 12.12.2019 me objekt shërbimi i mbajtjes së aparaturave mjekësore. Në këtë aktrakordim citohet se ñKomisioni i ngritur me urdhrin nr. 12/21, datë 20.09.2019, pasi kontrolloi të gjithë kërkesat për riparimin e pajisjeve, të firmosur nga personat që kanë në përdorim këto pajisje, vendosi akt-rakordimin sipas situacionit bashkëngjitur. Akt rakordimi është firmosur nga L.H. me detyrë përgjegjës i sektorit të menaxhimit të teknologjisë, T. Xh. me detyrë kryelaborant i rëntgeni i shërbimit të imazherisë dhe G. P. me detyre inxhinier bio medikal. Situacion punimesh i kompanisë ñF.ò Shpk, për mirëmbajtjen e aparaturave mjekësore në SUT për vitin 2019, i cili është firmosur nga përfaqësuesi i shoqërisë ñFe.ò O. S. dhe L. H. .

Me urdhër shpenzimin nr. 1086, datë 31.12.2019 **për vlerën 1,709,985 lekë** nëpërmjet Cre.Bankë, është likuiduar Shoqërie D. Shpk. Dokumentet vërtetues të kryerjes së këtij shpenzimi, fatura nr. 491, datë 31.12.2019 kg 7160 për vlerën 3,072,200 lekë. Akt rakordimi për likuidim datë 31.12.2019, mbi bazën e kontratës nr. 132/14, datë 07.12.2016. Ky shpenzim ka të bëjë shërbim lavanterie për periudhën 13-31.12.2019. Akt rakordimi është firmosur nga E. Xh. me detyrë specialiste plani, N. M. me profesion infermiere me detyrë përgjegjëse recepsioni i shërbimit të konsultave të specializuar ambulatore, A. Rr. me detyrë magazinier, V. S. me detyrë përgjegjësi i sektorit të shërbimeve të brendshme.

Ky shpenzim është klasifikuar në strukturën e llogarisë (artikullin) 6021001. Në këtë analizë përfshihen shpenzimet për uniforma dhe veshje te tjera speciale. Konkretisht shpenzimet për blerjen e uniformave dhe veshjeve që përdoren nga ana e punonjësve civil dhe strukturave te specializuara. Këtu përmendim veshjet e strukturave të mbrojtjes, rendit SHISH etj, si dhe ato të punonjësve të shërbimit civil, të personelit mjekësor, rojet, pastruesit e tjerë , ose kundra vlera e tyre..... Referuar objektit të shpenzimit ky shpenzim duhet të ishte përfshirë në analizën (artikullin) 6029099 që ka të bëjë me shpenzime te tjera materiale dhe shërbime operative. Pra ky shpenzim nuk është paraqitur në llogarinë e duhur kontabël të klasifikimit buxhetor në nivel 7-shifror, po ashtu është kapitalizuar në mbyllje të vitit ushtrimor. Veprime në kundërshtim me klasifikimin ekonomik të shpenzimeve, kodifikimi i të cilit është i njëjtë me llogaritë e planit kontabël publik.

Me urdhër shpenzimin nr. 1006, datë 11.12.2019 **për vlerën 322,222 lekë**, është likuiduar shoqëria ñK.ò Shpk. Ky shpenzim (likuidim) ka të bëjë me shërbim gjelbërimi për muajin nëntor 2019. Dokumentet vërtetues të kryerjes së këtij shpenzimi, fatura tatimore nr. 5, datë 02.12.2019 për vlerën 322,222 lekë. Situacion nr. 14, datë 02.12.2019 në vlerën 322,222 lekë, për periudhën 1-30 nëntor 2019 (Akt rakordimi për likuidim i firmosur nga M. P. me detyrë specialiste planifikimi, E. T. me detyrë juriste, V. S. me detyrë përgjegjës i sektorit të shërbimeve të brendshme dhe zv/drejtor ekonomik A. H. , dhe për shoqërinë ñK.ò Shpk nga administratorja M.K. Në këtë situacion në zërin 4 ñMbjellje pemë dekorative të reja 7 copë x 17,000 = 119,000 lekë dhe në zërin 6 ñMbjellje shkurre dekorativeò copë 6 x 2,000 lekë/copë = 12,000 lekë. Shuma e të dy zërave është 131,000 lekë x 1.2 TVSH = 157,200 lekë me TVSH, shpenzimi është kryer pa dokumentacion të plotë vërtetues. Konkretisht nuk ka plan vendosje se ku do të mbillet me distancat respektive, speciet përkatëse, preventiv, çerfitikata fito-sanitare qe do ti shoqërojnë. Po ashtu në situacion nuk janë përcaktuar speciet. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, me

ndryshimet vijuese të tij, neni 6, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35, Ligjin nr. 8732, datë 24.01.2001 ñPër materialin mbjellës bimorò, me ndryshimet vijuese të tijô, neni 7/b,c,ç, neni 20 pika 1 dhe 2, neni 23, VKM nr. 157, date 25.4.2002 ñPër kriteret dhe rregulla të përpunimit, ambalazhimit, ruajtjes, etiketimit dhe përmbajtjes se etiketës për materialin mbjellës, bimorò, neni 6, Udhëzimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit nr. 107 datë 2.12.2002 ñPër krijimin, shumëzimin, përpunimin, tregtimin, kontrollin, vlerësimin e farave dhe fidanëve dhe ruajtjen e trajtimin e materialit gjenetik bimorò, neni 11, b,c,d, neni 21/a,d, neni 39/a,b,c.

Për mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi V. S. me detyrë përgjegjës i sektorit të shërbimeve të brendshme.

Me urdhër shpenzimin nr. 237, datë 04.12.2019 **për vlerën 21,891 lekë** nëpërmjet Bankës C. është likuiduar përmbaruesi N. B. me NIPT L0...004B. Ky shpenzim është klasifikuar në strukturën e llogarisë (artikullin) 6001001. Në këtë analizë përfshihen shpenzimet për pagën bazë sipas kategorisë, për të punësuarit. Referuar objektit të shpenzimit ky shpenzim duhet të ishte përfshirë në analizën (artikullin) 6027400 që ka të bëjë me shpenzime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për largimet nga puna. Pra ky shpenzim nuk është paraqitur në llogarinë e duhur kontabël të klasifikimit buxhetor në nivel 7-shifror, po ashtu është kapitalizuar në mbyllje të vitit ushtrimor.

Veprime në kundërshtim me klasifikimin ekonomik të shpenzimeve, kodifikimi i të cilit është i njëjtë me llogaritë e planit kontabël publik, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligjin nr. 25/2018, ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 7, Ligjin 83/2019 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò neni 2, 3 dhe 6, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35.

Me urdhër shpenzimin nr. 238, datë 04.12.2019 **për vlerën 23,000 lekë** nëpërmjet Bankës CRE. , është likuiduar përmbaruesi A. G. me NIP K51...21H. Nuk ka faturë të lëshuar prej tij . Ky shpenzim është klasifikuar në strukturën e llogarisë (artikullin) 6001001. Në këtë analizë përfshihen shpenzimet për pagën bazë sipas kategorisë, për të punësuarit. Referuar objektit të shpenzimit, ky shpenzim duhet të ishte përfshirë në analizën (artikullin) 6027400, që ka të bëjë me shpenzime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për largimet nga puna. Pra ky shpenzim nuk është paraqitur në llogarinë e duhur kontabël të klasifikimit buxhetor në nivel 7-shifror, po ashtu është kapitalizuar në mbyllje të vitit ushtrimor.

Veprime në kundërshtim me klasifikimin ekonomik të shpenzimeve, kodifikimi i të cilit është i njëjtë me llogaritë e planit kontabël publik, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligjin nr. 25/2018, ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 7, Ligjin 83/2019 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëòneni 2, 3 dhe 6, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35.

Me urdhër shpenzimin nr. 287, datë 03.12.2010 **për vlerën 23,000 lekë** nëpërmjet Bankës CRE. , është likuiduar përmbaruesi A. G. me NIP K51...21H. Nuk ka faturë të lëshuar prej tij . Ky shpenzim është klasifikuar në strukturën e llogarisë (artikullin) 6001001. Në këtë analizë përfshihen shpenzimet për pagën bazë sipas kategorisë, për të punësuarit. Referuar objektit të shpenzimit ky shpenzim duhet të ishte përfshirë në analizën (artikullin) 6027400, që ka të bëjë me shpenzime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për largimet nga puna. Pra ky shpenzim

nuk është paraqitur në llogarinë e duhur kontabël të klasifikimit buxhetor në nivel 7-shifror, po ashtu është kapitalizuar në mbyllje të vitit ushtrimor. Veprime në kundërshtim me klasifikimin ekonomik të shpenzimeve, kodifikimi i të cilit është i njëjtë me llogaritë e planit kontabël publik, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligjin nr. 25/2018, ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 7, Ligjin 83/2019 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, neni 2, 3 dhe 6, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35, dhe me klasifikimin ekonomik të shpenzimeve, kodifikimi i të cilit është i njëjtë me llogaritë e planit kontabël publik.

Me urdhër shpenzimin nr. 823, datë 28.12.2020 **për vlerën 778,560 lekë** nëpërmjet Cre. Bankë, është likuiduar personi fizik tregtar E. Sh. . Ky shpenzim ka të bëjë me blerje aksesor për dyert e pavionëve të SUT. Ky shpenzim është klasifikuar në strukturën e llogarisë (artikullin) 231000. Referuar objektit të shpenzimit ky shpenzim duhet të ishte përfshirë në analizën (artikullin) 2312105, që ka të bëjë me shpenzime për ndërtesa shëndetësore. Pra ky shpenzim nuk është paraqitur në llogarinë e duhur kontabël të klasifikimit buxhetor në nivel 7-shifror, po ashtu është kapitalizuar në mbyllje të vitit ushtrimor. Veprime në kundërshtim me klasifikimin ekonomik të shpenzimeve, kodifikimi i të cilit është i njëjtë me llogaritë e planit kontabël publik.

Me urdhër shpenzimin nr. 830, datë 28.12.2020 për vlerën 857,042 lekë nëpërmjet C. Bankë, është likuiduar Shoqëria ñG. C. ò. Ky shpenzim ka të bëjë me Furnizim vendosje kondicioner, inverter ftohës dhe aspirator për SUT. Ky shpenzim është klasifikuar në strukturën e llogarisë (artikullin) 2314150 shpenzime për pajisje mjekësore. Referuar objektit të shpenzimit, ky shpenzim duhet të ishte përfshirë në analizën (artikullin) 2314170 që ka të bëjë me shpenzime për pajisje dhe instalim kondicioneri. Pra ky shpenzim nuk është paraqitur në llogarinë e duhur kontabël të klasifikimit buxhetor në nivel 7-shifror, po ashtu është kapitalizuar në mbyllje të vitit ushtrimor. Veprime në kundërshtim me klasifikimin ekonomik të shpenzimeve, kodifikimi i të cilit është i njëjtë me llogaritë e planit kontabël publik.

Me urdhër shpenzimin nr. 858, datë 31.12.2020 **për vlerën 13,497,500 lekë** nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria Ti. . Ky shpenzim ka të bëjë me blerje materiale për ortopedinë. Ky shpenzim është klasifikuar në strukturën e llogarisë (artikullin) 6021003 shpenzime për blerje materiale ortopedike, në fakt kjo analizë i përket blerjes së medikamenteve mjekësore. Referuar objektit të shpenzimit ky shpenzim duhet të ishte përfshirë në analizën (artikullin) 6020400 që ka të bëjë me shpenzime për materiale për funksionimin e pajisjeve speciale. Pra ky shpenzim nuk është paraqitur në llogarinë e duhur kontabël të klasifikimit buxhetor në nivel 7-shifror, po ashtu është kapitalizuar në mbyllje të vitit ushtrimor.

Veprime në kundërshtim me klasifikimin ekonomik të shpenzimeve, kodifikimi i të cilit është i njëjtë me llogaritë e planit kontabël publik.

Me urdhër shpenzimin nr. 860, datë 31.12.2020 **për vlerën 1,665,900 lekë** nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria ñT. ò. Ky shpenzim ka të bëjë me blerje materiale për ortopedinë. Ky shpenzim është klasifikuar në strukturën e llogarisë (artikullin) 6021003 shpenzime për blerje materiale ortopedike, në fakt kjo analizë i përket blerjes së medikamenteve mjekësore. Referuar objektit të shpenzimit ky shpenzim duhet të ishte përfshirë në analizën (artikullin) 6020400, që ka të bëjë me shpenzime për materiale për funksionimin e pajisjeve speciale. Pra ky shpenzim nuk është paraqitur në llogarinë e duhur kontabël të klasifikimit buxhetor në nivel 7-shifror, po ashtu është kapitalizuar në mbyllje të vitit ushtrimor.

Veprime në kundërshtim me klasifikimin ekonomik të shpenzimeve, kodifikimi i të cilit është i njëjtë me llogaritë e planit kontabël publik.
Me urdhër shpenzimin nr. 862, datë 31.12.2020 **për vlerën 4,006,600 lekë**, nëpërmjet BKT është likuiduar Shoqëria ñT. ò. Ky shpenzim ka të bëjë me blerje materiale për ortopedinë. Ky shpenzim është klasifikuar në strukturën e llogarisë (artikullin) 6021003 shpenzime për blerje materiale ortopedike, në fakt kjo analizë i përket blerjes së medikamenteve mjekësore. Referuar objektit të shpenzimit ky shpenzim duhet të ishte përfshirë në analizën (artikullin) 6020400, që ka të bëjë me shpenzime për materiale për funksionimin e pajisjeve speciale. Pra ky shpenzim nuk është paraqitur në llogarinë e duhur kontabël të klasifikimit buxhetor në nivel 7-shifror, po ashtu është kapitalizuar në mbyllje të vitit ushtrimor. Veprime në kundërshtim me klasifikimin ekonomik të shpenzimeve, kodifikimi i të cilit është i njëjtë me llogaritë e planit kontabël publik.
Klasifikimi jo i saktë i shpenzimeve shkakton, mbivlerësim dhe nënvlerësim të kategorive përkatëse dhe një prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në Pasqyrat Financiare Vjetore.
Nga kontrolli me zgjedhje i ushtruar në dokumentacionin e arkës, për rregullshmërinë e plotësimit, përpunimit e ligjshmërisë së likuidimeve u konstatua se:
Veprimet e arkës mbahen në llogari kontabile të arkës nga sektori i financës dhe libër arke nga punonjësi i caktuar me përgjegjësinë e lëvizjes së vlerave monetare. Dokumentacioni i arkës është i plotë dhe i sistemuar. Nuk janë kryer pagesa (likuidime) me para në dorë nëpërmjet arkës. Nëpërmjet arkës, janë bërë hyrje arkëtimet nga të ardhurat dytësore të spitalit sipas tarifave përkatëse për vizitat, analizat laboratorike etj, të cilat derdhen në bankë dhe përdorimi i tyre është i thesarizuar, pra shpenzimet kryen nëpërmjet skemës së thesarit. U krye kontroll me zgjedhje për aplikimin e tarifave në zbatim të urdhrit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 493, datë 20.07.2019 ñPër sistemin e referimit dhe tarifat e shërbimit shëndetësor publikò, urdhër i protokolluar ne SUT me nr. 403, datë 22.02.2021.
U krye verifikim me zgjedhje për zbatimin e tarifave dhe u konstatua se ato janë zbatuar konformë urdhrit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 28, datë 26.01.2016 ñPër sistemin e referimit dhe tarifat e shërbimit shëndetësor publikò, i ndryshuar. Konkretisht u verifikua mandatë arkëtimi me nr. serie 00033725 datë 05.11.2020,me nr. referimi nr. 377 me kod pacienti I9...040 A, mandat arkëtimi me nr. serie 00...727, datë 05.11.2020, pa numër referimi me kod pacienti K56...53D, mandat arkëtimi me nr. serie 00033673, datë 03.11.2020, pa numër referimi me kod pacienti G308...45V, mandat arkëtimi me nr. serie 00033705, datë 04.11.2020, pa numër referimi me kod pacienti G801...42R, dhe nuk u konstatua diferenca.
Theksojmë faktin pavarësisht mos konstatimit të diferencave urdhri nr. 493, datë 20.07.2019, është dërguar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me afërsisht 18 muaj vonesë.
-Nga kontrolli me zgjedhje i ushtruar në dokumentacionin të magazinës, për rregullshmërinë e plotësimit, përpunimit e ligjshmërisë së likuidimeve u konstatua:
Dokumentacioni i magazinës është i sistemuar dhe regjistruar në ditarët përkatës.
Për vitin 2018, nuk ka barna të skaduara dhe të asgjësuara, në vitin 2019 barna të skaduara dhe të dhe të asgjësuara në vlerën 334,573 lekë, ndërsa në vitin 2020 nuk ka barna të skaduara dhe të asgjësuara. Barnat e skaduara kanë dalë jashtë përdorimit me:
- fletëdaljen nr. 4, datë 26.06.2019, dhe janë asgjësuar me procesverbalin nr. 337/29 prot., datë 26.06.2019 dhe nr. 337/33 datë 26.06.2019, firmosur nga komisioni i përbërë A. S. , E. Sh. , P. S. , K. L. , E. H. dhe S. Gj. .
-fletëdaljen nr. 1, datë 26.06.2019, dhe janë asgjësuar me procesverbalin nr. 337/31 prot., datë 26.06.2019, firmosur nga komisioni i përbërë A. S. , E. Sh. , P. S. , K. L. , E. H. dhe S. Gj. .

-fletëdaljen nr. 28, datë 19.09.2019, dhe janë asgjësuar me procesverbalin nr. 337/31 prot., datë 26.06.2019, firmosur nga komisioni i përbërë A. S. , E. Sh. , P. S. , K. L. , E. H. dhe S. Gj. .
-fletëdaljen nr. 19, datë 26.06.2019, dhe janë asgjësuar me procesverbalin nr. 337/32 prot., datë 26.06.2019, firmosur nga komisioni i përbërë A. S. , E. Sh. , P. S. , K. L. , E. H. dhe S. Gj. .
Në zbatim të Urdhrit të Ministritë të Shëndetësisë nr. 290, datë 21.06.2006 ñPër një përdorim sa më efiçent të medikamenteve dhe materialeve mjekësoreò, kanë qarkulluar në Spitale të tjera barnat për vitin 2018 në vlerën 10,440,607 lekë, për vitin 2019 në vlerën 51,122 lekë dhe për vitin 2020 në vlerën 3,571,112 lekë. Konkretisht transferimet janë bërë spitaleve K. G. , Spitali Lushnjë, Spitali Shkodër, Spitali Shefqet Ndroqi, Spitali QSUT, Spitali Mirditë, Siptali Durrës, Spitali Vlorë, Spitali Kavajë, Spitali Mbretëresha Geraldin, Spitali Lezhë, Spitali Elbasan, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë dhe Operatori Qendror OSHKSH.
Për periudhën objekt auditimi janë zhvilluar 98 procedura blerje me vlera te vogla me vlerë 38,807 mijë lekë.
-Nga 44 proçedura të audituara me blerje me vlera të vogla me vlerë 22,869 mijë lekë, me përjashtim të shkeljes që në vitin 2018, Titullarit të Autoritetit Kontraktor, nuk ka ngritur në fillim të vitit kalendarik 2018 komisionin për prokurimet me vlerë të vogël, por ky komision është ngritur rast pas rasti për çdo procedurë specifike të prokurimi me vlerë të vogël. Mos ngritja në fillim të vitit kalendarik 2018, e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël ka lënë pa informacion APP - në për personat e ngarkuar fillimisht, me administrimin e procedurave të prokurimeve me vlerë të vogël, veprim në kundërshtim me Udhëzimin APP, nr. 3 datë 08.01.2018 ñMbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeò, i ndryshuar. Nuk është konstatuar shkelje tjetër.
1. Titulli i Gjetjes : Shpenzime të mos paraqitura në llogarinë e duhur kontabël të klasifikimit buxhetor në nivel 7-shifror.
Situata: Në 10 raste për **vlerën 24,831 mijë lekë** shpenzimet për blerje materiale, për shërbime etj, nuk janë paraqitur në llogarinë e duhur kontabël të klasifikimit buxhetor në nivel 7-shifror, po ashtu janë kapitalizuar në mbyllje të vitit ushtrimor.
Kriteri: Veprime në kundërshtim me klasifikimin ekonomik të shpenzimeve, kodifikimi i të cilit është i njëjtë me llogaritë e planit kontabël publik.
Shkaku: Keq interpretim i klasifikimit buxhetor në nivel 7-shifror, në mungesë të një udhëzuesi përkatës.
Rëndësia: E mesme
Ndikimi/Efekti: Klasifikimi jo i saktë i shpenzimeve shkakton, mbivlerësim dhe nënvlerësim të kategorive përkatëse dhe një prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në pasqyrat financiare vjetore.
Rekomandimi: Menaxhmenti, duhet të siguroj menaxhim të mirë dhe të forcoj kontrollet në realizimin e shpenzimeve, të siguroj klasifikimin e duhur të tyre për një pasqyrim të drejt dhe të saktë financiar.
2. Titulli i Gjetjes : Shpenzimi të kryera pa dokumentacion të plotë vërtetues.
Situata: Në 2 raste për **vlerën 471,600 lekë** janë kryer shpenzime për shërbim gjelbërimi pa dokumentacion të plotë vërtetues. Konkretisht nuk ka plan vendosje se ku do të mbillen pemët dekorative me distancat respektive, speciet përkatëse, preventiv, çerfitikata fito-sanitare qe do ti shoqërojnë.
Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligji nr. 25/2018, ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 7, Udhëzimi MF nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër

menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35, Ligji nr. 8732, datë 24.01.2001 ñPër materialin mbjellës bimorò, me ndryshimet vijuese të tijô, neni 7/b,c,ç, neni 20 pika 1 dhe 2, neni 23, VKM nr. 157, date 25.4.2002 ñPër kriteret dhe rregulla të përpunimit, ambalazhimit, ruajtjes, etiketimit dhe përmbajtjes se etiketës për materialin mbjellës, bimorò, neni 6, Udhëzimii i Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit nr. 107 datë 2.12.2002 ñPër krijimin, shumëzimin, përpunimin, tregtimin, kontrollin, vlerësimin e farave dhe fidanëve dhe ruajtjen e trajtimin e materialit gjenetik bimorò, neni 11, b,c,d, neni 21/a,d, neni 39/a,b,c.

Shkaku: Neglizhencë nga struktura e sektorit të shërbimeve të brendshme.

Rëndësia: E mesme

Ndikimi/Efekti: Nuk vërtetohet plotësisht shpenzimi i kryer.

Rekomandimi: Nga sektori i shërbimeve të brendshme të merren masa që shpenzimet e shërbim gjelbërimit të kryhen me dokumentacion specifik që i përkasin këtij shërbimi.

3. Titulli i Gjetjes: Shpenzime përmbarimore të kryera pa dokumentacion të plotë vërtetues (faturë) dhe mos paraqitje në llogarinë e duhur kontabël të klasifikimit buxhetor në nivel 7-shifror.

Situata: Në 2 raste **për vlerën 69,000 lekë** janë kryer shpenzime përmbarimore pa dokumentacion të plotë vërtetues (faturë) dhe nuk janë paraqitur në llogarinë e duhur kontabël të klasifikimit buxhetor në nivel 7-shifror, po ashtu janë kapitalizuar në mbyllje të vitit ushtrimor.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligji nr. 25/2018, ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 7, Ligjin 83/2019 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò neni 2, 3 dhe 6, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35, klasifikimi ekonomik të shpenzimeve, kodifikimi i të cilit është i njëjtë me llogaritë e planit kontabël publik.

Shkaku: Keq interpretim i klasifikimit buxhetor në nivel 7-shifror, në mungesë të një udhëzuesi përkatës.

Rëndësia: E mesme

Ndikimi/Efekti: Risk për evazion fiskal dhe klasifikimi jo i saktë i shpenzimeve shkakton, mbivlerësim dhe nënvlerësim të kategorive përkatëse dhe një prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në Pasqyrat Financiare Vjetore.

Rekomandimi: Nga sektori i financës të merren masa që shpenzimet përmbarimore të kryhen me dokumentacion të plotë vërtetues (faturë) dhe të paraqiten në llogarinë e duhur kontabël të klasifikimit buxhetor në nivel 7-shifror.

4. Titulli i Gjetjes: Shpenzim i kryer për shërbimin e azhurnimit softi WEB Buxhetor (Program financiar që përdoret në kontabilitetin), me grup pune ku në përbërjen e tij nuk ka specialist IT.

Situata: Me urdhër shpenzimin nr. 900, datë 18.12.2018 për vlerën 448,000 lekë, është likuiduar Instituti i Modelimeve në Biznes. Ky shpenzim ka të bëjë me azhurnim softi WEB Buxhetor (Program financiar që përdoret në kontabilitetin e këtij institucioni). Dokumentet vërtetues të kryerjes së këtij shpenzimi, faturë shitje nr. 1420, datë 05.12.2018 në vlerën 448,000 lekë. Akt rakordimi për kryerjen e shërbimit me nr. 434 prot., datë 13.12.2018, është firmosur nga E. R. me detyre përgjegjëse e sektorit të financës, F. T. specialiste e sektorit të financës, Zh. H. specialiste e sektorit të financës, L. T. specialiste e sektorit të financës dhe M. Ç. në emër të operatorit ekonomik Instituti i Modelimeve në Biznes. Urdhër prokurimi për blerjet me vlera të vogla nr. 208/7 prot., datë 30.10.2018. Ftesën për ofertë nr. 208/8 datë 30.10.2018. Specifikimet

teknike me nr. 208/1 prot., datë 26.10.2018 të firmosura nga E. R. , F. T. dhe Zh. H. . Procesverbal i datës 05.11.2018 i komisionit të vlerësimit të ofertave i firmosur nga G. H. me detyrë përgjegjësi i sektorit të prokurimeve me profesion ekonomist, M. S. specialist prokurimi me profesion jurist si dhe Dh. M. specialist prokurimi me profesion ekonomiste. Grupi i përgatitjes së specifikimeve teknike, akt rakordimi për kryerjen e shërbimit dhe komisioni i blerjes me vlera të vogla, nuk kanë në përbërjen e tyre specialist të IT.

Për mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi G. H. me detyrë përgjegjësi i sektorit të prokurimeve.

Kriteri: Udhëzimi MF nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, pika 43.

Shkaku: Keq interpretim i dispozitave ligjore.

Rëndësia: E mesme

Ndikimi/Efekti: Risk i lart për mos efektivitet të shpenzimeve.

Rekomandimi: Nga sektori i prokurimeve të merren masa që grupet e përgatitjes së specifikimeve teknike, komisionet e blerjes me vlera të vogla për procedurat e shërbimit të teknologjisë së informacionit të kenë në përbërjen e tyre specialist IT

5. Titulli i Gjetjes: Mosngritja në fillim të vitit kalendarik 2018 e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël.

Situata:Për vitin 2018 Titullarit të Autoritetit Kontraktor, nuk ka ngritur në fillim të vitit kalendarik 2018 komisionin për prokurimet me vlerë të vogël, por ky komision është ngritur rast pas rasti për çdo procedurë specifike të prokurimi me vlerë të vogël. Mos ngritja në fillim të vitit kalendarik 2018, e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël ka lënë pa informacion APP - në për personat e ngarkuar fillimisht, me administrimin e procedurave të prokurimeve me vlerë të vogël, veprim në kundërshtim me Udhëzimin APP, nr. 3 datë 08.01.2018 ñMbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeò, i ndryshuar.

Kriteri: Udhëzimi i APP nr. 3, datë 08.01.2018 ñMbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeò, i ndryshuar, pika 2.

Shkaku: Mungesë informacioni mbi ndryshimet e kuadrit normativ.

Rëndësia: E mesme

Ndikimi/Efekti: Mosngritja në fillim të vitit kalendarik 2018, e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël ka lënë pa informacion APP-në për personat e ngarkuar fillimisht, me administrimin e procedurave të prokurimeve me vlerë të vogël.

Rekomandimi: Për shkeljet dhe parregullsitë e konstatuara në prokurimet me vlerë të vogël në vitin 2018 lidhur ngritjen e komisionit në fillim të vitit kalendarik, edhe pse kjo praktikë është korrigjuar për vitin 2019 dhe 2020, duhet ti kushtohet vëmendja e duhur institucionale mos përsëritja e rasteve të tilla në të ardhmen.

2.5. Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit, plotësimi i pasqyrave financiare në afat, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë.

Auditimi u ushtrua me zgjedhje[2], konkretisht u audituan mbajtja e kontabilitetit, plotësimi i pasqyrave financiare viti 2019.

[2] *Auditimi me zgjedhje zhvillohet sipas ISA 530 (i rishikuar) "Kampioni i auditimit",i cili tregon tipet e ndryshme të testeve që audituesi kryen.*

Nga SUT hartohen dy pasqyra financiare vjetore për buxhetin qe çelet:
-Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me kod buxheti ñ13ò.
-Nga Ministria e Mbrojtjes me kod buxheti ñ17ò.
Për vitin 2018.
Në zbatim të nenit 16, pika 3, të Ligjit nr. 154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, u konstatua se pasqyrat financiare të vitit 2018 janë audituar nga Njësia e Auditit të Brendshëm. Nga teste e bëra rrezultoj se standardet e përdorura për këtë auditim janë në përputhje me standardet e KLSH dhe ato ndërkombëtare[3], për pasojë merret i mirëqenë auditimi i pasqyrave financiare vjetore të vitit 2018.
Për vitin 2019
Nga auditimi u konstatua se pasqyrat financiare për vitin 2019, janë hartuar dhe dërguar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me shkresën nr. 663 prot., datë 12.03.2020, si dhe në Ministrinë së Mbrojtjes me shkresën nr. 664 prot., datë 12.03.2020. Pasqyrat financiare për vitin 2019, janë dërguar dhe në Degën e Thesarit Tiranë, degë e cila i ka protokolluar me nr. 1953 prot., datë 12.03.2020. Pasqyrat financiare janë hartuar dhe dorëzuar brenda afatit të përcaktuar të vitit buxhetor (31.03.2020).
Në SUT sektori i financës punon me sistemin e programit ñAlpha buxhetorò, i cili është azhurnuar dhe mirëmbahet nga I.M.B. Shpk sipas kontratës nr. 208/10 date 09/11/2018 ñPër kryerjen e shërbimit ñAzhornim softweri dhe mirëmbajtje te programit Alpha Buxhetorò ne SUT.
Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit është bërë në zbatim te Planit Kontabël te miratuar nga institucioni, Ligjin nr. 25/2018, ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò.
Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas kontabilitetit me bazë të modifikuar rrjedhëse në bazë të ndryshimeve për trajtimin kontabël të materialeve dhe shpenzimit vjetor në lidhje me to, që paraqesin veçori sipas trajtimit në sektorin publik.
Konkretisht:
-Është plotësuar dhe përpunuar dokumentacioni i kontabilitetit, konformë dispozitave ligjore që rregullojnë mbajtjen dhe regjistrimin e veprimeve kontabile. Janë azhornuar ditarët e kontabilitetit dhe libri i madh i përmbledhjes së llogarive .
-Në librin përmbledhës të llogarive, janë pasqyruar përmbledhëset e kontabilizimeve të ditarëve të kontabilitetit, për çdo muaj dhe në mënyrë progresive .
Bilancet kontabël kanë të pasqyruar tepricat e llogarive, sipas të dhënave të librit përmbledhës të llogarive.
-Në verifikimin e kryer për rakordimin e inventarëve kontabël të llogarive inventariale e financiare me inventarin, ka rakordim midis llogarive analitike me ato sintetike.
-Është azhornuar libri i llogarisë (libri i madh), sipas kërkesave të Ligjit nr. 25/2018, ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, si dhe udhëzimeve të Ministrisë të financave në zbatim të tij.

Përkufizimi i një kampinoni të zgjedhur për auditim sipas ISA 530 është: "Aplikimi i procedurave të auditimit në më pak se 100% të artikujve brenda një grupi të caktuar të transaksioneve ose llogarive kontabël etj, në atë mënyrë që të gjithë kampinonët të kenë të njëjtin shans për tu zgjedhur" .

3. *Mbështetur në* ***ISSAI 1610*** "Përdorimi i punës së Audituesve të Brendshëmò

Pavarësisht nga sa u citua më sipër u konstatuan dhe shkelje dhe parregullsi ligjore ose rregullatore si më poshtë:

-Pasqyrat financiare vjetore nuk janë miratuar nga Bordi i Spitalit Universitar i Traumës (miratimi i raportit vjetor të veprimtarisë financiare), veprim në kundërshtim Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 66, datë 03.02.2017 ñPër përcaktimin e kritereve e të procedurave për ngritjen e organizimin e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitareò, pika 10/c.

Për mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Bordi i Spitalit Universitar i Traumës.

-Nuk janë përgatitur pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara sipas udhëzimeve të MF-së. Pra pasqyrat financiare të Ministrisë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me kod buxheti ñ13ò dhe Ministrisë e Mbrojtjes me kod buxheti ñ17ò, janë hartuar secila më vehte, pra nuk janë konsoliduar ose gjendja e tyre financiare nuk është paraqitur në aneksin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit SUT, përpjesëtimisht me pjesën takuese, veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, kapitulli IV, pika 98-111.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi Sektori i Financës, si dhe pasqyron mangësi të Degës së Thesarit të Rrethit Tiranë.

-Pasqyrat financiare vjetore, edhe pse janë depozituara në Degën e Thesarit të Rrethit Tiranë, nuk provohet nga ana shkresore të jetë bërë konfirmimi nga kjo e fundit, pastaj të dërgoheshin në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe në Ministrinë e Mbrojtjes (vetëm provohet protokollimi në Degën e Thesarit), veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, kapitulli IV, pika 117.

Për sa trajtuar si më sipër pasqyron mangësi të Degës së Thesarit të Rrethit Tiranë.

-Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se Formati 12 ñ*Pyetësor dhe shënime shpjegueseò*dhe relacioni shpjegues për pasqyrat financiare, në të dy bilancet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me kod buxheti ñ13ò dhe Ministrisë se Mbrojtjes me kod buxheti ñ17ò, është plotësuar pjesërisht dhe nuk janë përfshirë të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen, në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar ku të japin informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë dhe te qarte te pasqyrave financiare. Veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme**”,** pika 3.7 ñRregullat për dhënien e shënimeve shpjeguese për pasqyrat financiare individualeò.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi Sektori i Financës, si dhe pasqyron mangësi të Degës së Thesarit të Rrethit Tiranë.

-Në pasivin e bilancit kontabël të Spitalit Universitar të Traumës për Ministrinë e Mbrojtjes nuk pasqyrohet në llogarinë 12, rezultat i mbartur nga viti i kaluar. Në këtë zë të pasqyrës së pasivit nuk është pasqyruar rezultat i mbartur për të bërë krahasimin ndërmjet gjendjes në çelje të tij, shtesën përgjatë vitit dhe përdorimin e tij në rezultat për të financuar shpenzimet korente apo kapitale, në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò. Në pasiv është pasqyruar vetëm Llogaria 85 ñRezultati i ushtrimit sipas të cilës pasqyrohet në vlerën ï 1,402,928 lekë për Bilancin Kontabël të Spitalit Universitar të Traumës për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe në vlerën 10,865,810 lekë

për Bilancin Kontabël të Spitalit Universitar të Traumës për Ministrinë e Mbrojtjes, si pasojë e diferencës ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve korente. Nga lëvizja e pasqyruar në pasqyrën e lëvizjes së fondeve, veprimet e rregullimit të kësaj llogarie janë ato të mbylljes së rezultatit të ushtrimit të vitit të kaluar dhe ato të njohjes së rezultatit të këtij viti. Veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme**",** Aneksi 1 ñAnaliza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publikò.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi Sektori i Financës, si dhe pasqyron mangësi të Degës së Thesarit të Rrethit Tiranë.

- Në pasivin e bilancit kontabël të Spitalit Universitar të Traumës për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nuk është evidentuar shuma e ndalesave të tjera të mbajtura nga paga në shumën 23 000 lekë, si të pagueshme nga të tretët dhe që janë mbajtur nga paga, që për efekt raportimi duhet të dalin si llogari më vete të detyrimit në fund të periudhës. Veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò, Aneksi 1, Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik ñLlogaritë e personelit, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe llogaritë e tatimeve e taksave me shtetin (42 e 43)ò.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi Sektori i Financës.

Detyrimet e prapambetura

Në kontabilitetit llogaria 486 ñdetyrimet e prapambeturaò në pasqyrat financiare te MSHMS të vitit 2019 nuk ka detyrime të prapambetura. Kurse në pasqyrat financiare MM te vitit 2019 SUT, si detyrim i prapambetur është vlera 646,731 lekë në të cilën përfshihen:

Llogaria 4864601 detyrime gjoba dhe inetersa për sigurimet shoqërore 1.026 lekë

Llogaria 4864602 detyrime gjoba dhe interesa për sigurimet shëndetësore 605.633 lekë

-Llogaria 4864603 detyrime për gjoba dhe interesa për tatimin mbi te ardhurat 40.072 lekë.

1. Titulli i Gjetjes: Pasqyrat financiare vjetore nuk janë miratuar nga Bordi i Spitalit Universitar i Traumës.

Situata: Pasqyrat financiare vjetore nuk janë miratuar nga Bordi i Spitalit Universitar i Traumës (miratimi i raportit vjetor të veprimtarisë financiare), veprim në kundërshtim Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 66, datë 03.02.2017 ñPër përcaktimin e kritereve e të procedurave për ngritjen e organizimin e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitareò, pika 10/c.

Për sa trajtuar si më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Bordi i Spitalit Universitar i Traumës.

Shkaku: Bordi i Spitalit Universitar i Traumës nuk është mbledhur asnjë herë.

Kriteri: Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 66, datë 03.02.2017 ñPër përcaktimin e kritereve e të procedurave për ngritjen e organizimin e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitareò, pika 10/c.

Ndikimi/Efekti: Mos kontroll nga organet drejtuese të raportit vjetor të veprimtarisë financiare.

Rëndësia: E lart

Rekomandimi: Nga Bordi i Spitalit Universitar i Traumës të merren masa për miratimin i e përvitshëm të pasqyrave financiare vjetore .

2. Titulli i Gjetjes: Nuk janë përgatitur pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara sipas udhëzimeve të MF-së.

Situata: Nuk janë përgatitur pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara sipas udhëzimeve të MF-së. Pra pasqyrat financiare të Ministrisë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me kod

buxheti ñ13ò dhe Ministrisë e Mbrojtjes me kod buxheti ñ17ò, janë hartuar secila më vehte, pra nuk janë konsoliduar ose gjendja e tyre financiare nuk është paraqitur në aneksin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit SUT, përpjesëtimisht me pjesën takuese, veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, kapitulli IV, pika 98-111.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi Sektori i Financës, si dhe pasqyron mangësi të Degës së Thesarit të Rrethit Tiranë.

Shkaku: Neglizhencë e sektorit të financës dhe e Degës së Thesarit Tiranë**.**

Kriteri: Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, kapitulli IV, pika 98-111.

Ndikimi/Efekti: Gjendja financiare e të dy Ministrive respektivisht kod buxheti ñ13ò dhe kod buxheti ñ17ònuk është paraqitur në aneksin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit SUT.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Nga sektori i financës të merren masa për përgatitur pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara të përvitshme dhe të paraqiten në përputhje me standardet kontabël kombëtare, duke pasqyruar gjendjen e tyre financiare në aneksin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit SUT.

3. Titulli i Gjetjes: Pasqyrat financiare vjetore, nuk janë konfirmuar nga Dega e Thesarit të Rrethit Tiranë.

Situata: Pasqyrat financiare vjetore, edhe pse janë depozituara në Degën e Thesarit të Rrethit Tiranë, nuk provohet nga ana shkresore të jetë bërë konfirmimi nga kjo e fundit, pastaj të dërgoheshin në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe në Ministrinë e Mbrojtjes (vetëm provohet protokollimi në Degën e Thesarit), veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, kapitulli IV, pika 117.

Për sa trajtuar si më sipër pasqyron mangësi të Degës së Thesarit të Rrethit Tiranë.

Shkaku: Mos vlerësim dhe neglizhencë nga Dega e Thesarit të Rrethit Tiranë.

Kriteri: Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, kapitulli IV, pika 117.

Ndikimi/Efekti: Rist tek besueshmëria e të dhënave të pasqyruara në bilanc.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Nga Drejtoria e SUT, sektori i financës të merren masa që pasqyrat financiare vjetore të dërgohen në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe në Ministrinë e Mbrojtjes, pasi të jenë konfirmuar paraprakisht nga Dega e Thesarit të Rrethit Tiranë.

4. Titulli i Gjetjes: Relacioni shpjegues për pasqyrat financiare nuk përfshinë të gjitha informacionet shpjeguese.

Situata: Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se Formati 12 ñPyetësor dhe shënime shpjegueseòdhe relacioni shpjegues për pasqyrat financiare, në të dy bilancet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me kod buxheti ñ13ò dhe Ministrisë se Mbrojtjes me kod buxheti ñ17ò, është plotësuar pjesërisht dhe nuk janë përfshirë të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen, në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar ku të japin

informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë dhe te qarte te pasqyrave financiare.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi Sektori i Financës, si dhe pasqyron mangësi të Degës së Thesarit të Rrethit Tiranë.

Shkaku: Mos vlerësim nga sektori i financës**.**

Kriteri: Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme**",** pika 3.7 ñRregullat për dhënien e shënimeve shpjeguese për pasqyrat financiare individualeò.

Ndikimi/Efekti: Mos prezantim me analizë të detajuar llogarive përkatëse.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Nga Sektori i Financës të merren masat që në vijimësi, pyetësori dhe shënimet shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore (formati nr. 12), të përgatiten dhe paraqiten në përputhje me standardet kontabël kombëtare dhe ky seksion të plotësohet me të dhëna të sakta për elementë të ndryshme të raportimit financiar të njësisë.

5. Titulli i Gjetjes: Në pasivin e bilancit kontabël nuk pasqyrohet në llogarinë 12, rezultat i mbartur nga viti i kaluar.

Situata: Në pasivin e bilancit kontabël të Spitalit Universitar të Traumës për Ministrinë e Mbrojtjes nuk pasqyrohet në llogarinë 12, rezultat i mbartur nga viti i kaluar. Në këtë zë të pasqyrës së pasivit nuk është pasqyruar rezultat i mbartur për të bërë krahasimin ndërmjet gjendjes në çelje të tij, shtesën përgjatë vitit dhe përdorimin e tij në rezultat për të financuar shpenzimet korente apo kapitale, në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, Aneksi 1, analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik. Në pasiv është pasqyruar vetëm Llogaria 85 ñRezultati i ushtrimit sipas të cilës pasqyrohet në vlerën ï 1,402,928 lekë për Bilancin Kontabël të Spitalit Universitar të Traumës për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe në vlerën 10,865,810 lekë për Bilancin Kontabël të Spitalit Universitar të Traumës për Ministrinë e Mbrojtjes, si pasojë e diferencës ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve korente. Nga lëvizja e pasqyruar në pasqyrën e lëvizjes së fondeve, veprimet e rregullimit të kësaj llogarie janë ato të mbylljes së rezultatit të ushtrimit të vitit të kaluar dhe ato të njohjes së rezultatit të këtij viti.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi Sektori i Financës, si dhe pasqyron mangësi të Degës së Thesarit të Rrethit Tiranë.

Shkaku: Mos vlerësim nga sektori i financës.

Kriteri: Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme**",** Aneksi 1 ñAnaliza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publikò.

Ndikimi/Efekti: Nuk bëhet i mundur krahasimi ndërmjet gjendjes në çelje të bilancit, shtesën përgjatë vitit dhe përdorimin e tij në rezultat për të financuar shpenzimet korente apo kapitale.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Nga Sektori i Financës të merren masat që në vijimësi, pasqyrat financiare të përgatiten dhe paraqiten në përputhje me standardet kontabël kombëtare duke pasqyruar në pasivin e bilancit rezultat i mbartur nga viti i kaluar ñLlogaria 12ò, për të bërë krahasimin ndërmjet gjendjes në çelje të tij, shtesën përgjatë vitit dhe përdorimin e tij në rezultat për të financuar shpenzimet korente apo kapitale.

6. Titulli i Gjetjes: Në pasivin e bilancit kontabël, nuk është evidentuar shuma e ndalesave të tjera të mbajtura nga paga.
Situata: Në pasivin e bilancit kontabël të Spitalit Universitar të Traumës për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nuk është evidentuar shuma e ndalesave të tjera të mbajtura nga paga në shumën 23 000 lekë, si të pagueshme nga të tretët dhe që janë mbajtur nga paga, që për efekt raportimi duhet të dalin si llogari më vete të detyrimit në fund të periudhës.
Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi Sektori i Financës.
Shkaku: Mos vlerësim nga Sektori i Financës.
Kriteri: Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò, Aneksi 1, Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik ñLlogaritë e personelit, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe llogaritë e tatimeve e taksave me shtetin (42 e 43)ò.
Ndikimi/Efekti: Mos pasqyrim në llogarinë e duhur të shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore.
Rëndësia: E mesme
Rekomandimi: Nga Sektori i Financës të merren masat që në vijimësi, bilancen të përgatiten dhe paraqiten në përputhje me standardet kontabël kombëtare, duke evidentuar shuma e mbajtura nga paga si të pagueshme nga të tretët, dhe të dalin si llogari më vete të detyrimit në fund të periudhës, për efekt raportimi.

2.6. Përputhshmëria ligjore dhe rregullshmëria financiare në planifikim dhe në realizimin e prokurimit të fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime.
Auditimi u krye me zgjedhje[4].
Informacion i përgjithshëm:
Për vitin 2018, nga Spitali Universitar i Traumës janë zhvilluar 88 procedura prokurimi me vlerë 218,298 mijë lekë, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale & Agjencia e Blerjeve te Përqendruara janë zhvilluar 22 procedura me vlerë 370,761 mijë lekë.
Për vitin 2019, nga Spitali Universitar i Traumës janë zhvilluar 54 procedura prokurimi me vlerë 499,120 mijë lekë, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale & nga Agjencia e Blerjeve te Përqendruara & Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit janë zhvilluar 23 procedura me vlerë 339,005 mijë.
Për vitin 2020, nga Spitali Universitar i Traumës janë zhvilluar 55 procedura prokurimi me vlerë 397,264 mijë lekë, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale & nga Agjencia e Blerjeve te Përqendruara & Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit janë zhvilluar 6 procedura me vlerë 111.232 mijë lekë.
Ne total nga Spitali Universitar i Traumës për vitet 2018, 2019 dhe 2020 janë zhvilluar 197 procedura me vlerë 1,114,682 mijë lekë. Janë audituar 44 proçeura për vlerën 22,869 mijë lekë, ose 59 % e vlerës së prokurimeve të realizuara.

---

[4] *Auditimi me zgjedhje zhvillohet sipas ISA 530 (i rishikuar) "Kampioni i auditimit",i cili tregon tipet e ndryshme të testeve që audituesi kryen.*
Përkufizimi i një kampinoni të zgjedhur për auditim sipas ISA 530 është: "Aplikimi i procedurave të auditimit në më pak se 100% të artikujve brenda një grupi të caktuar të transaksioneve ose llogarive kontabël etj, në atë mënyrë që të gjithë kampinonët të kenë të njëjtin shans për tu zgjedhur" .

Theksojmë se 10 nga procedurat e audituara janë marrëveshje kuadër, të cilat kanë minimalisht nga 5 miniproçedura (minikontrata) sejcila, të cilat janë audituar.

Në proçedurat e audituara, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se përgjithësisht është zbatuar Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, me ndryshimet vijuese të tij, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñRregullat e Prokurimitò, me ndryshimet vijuese të tij, si dhe aktet nënligjore në funksion të tyre, në lidhje me përzgjedhjen e proçdurëve të prokurimit, llogaritjen e fondit limit, argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kërkesave për kualifikim, kualifikimin, shpalljen fitues të operatorëve ekonomik, si dhe lidhjen dhe zbatimin e kontratave.

Pavarësisht nga sa u citua më sipër u konstatuan dhe shkelje dhe parregullsi ligjore ose rregullatore, të cilat në mënyrë të detajuar për çdo proçedeurë prokurimi paraqiten si më poshtë vijon:

Procedurat e prokurimit të audituara për pajisjet mjekësore, materiale mjekimi dhe shërbime.

1. Proçedura e prokurimit me objekt "blerje aparat radiografie me krah C", viti 2020.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt blerje aparat radiografie me krah Cò		
1. Urdhër Prokurimi Nr Nr.29/6 dt.10.06.2020 2. Lloji i Procedurës së Prokurimit ñProcedurë e hapurò	3. Njësia e prokurimit Urdhër Nr.29/6 dt.10.06.2020 -G. H. me detyrë Shef i Sektorit Prokurimeve. - G. P. inxhinier biomedikal. M. S. , specialist i sektorit te prokurimeve.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 29/7 datë 10.06.2020 -M. Xh. mjek angiolog (specialist i fushës) -Th. Xh. specialist imazherie - S. K. me Specialist IT
5. Fondi Limit (pa tvsh) 16,666,667 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 9,840,000 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 6,826,667
8. Data e hapjes së tenderit 13.07.2020	9. Burimi Financimit Fond nga Buxheti i Shtetit (Ministria e Mbrojtjes)	10. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër _8___OE b) Sõkualifikuar __6___OE, c) Kualifikuar___2__ OE
11. Ankimime ñLin.ò Shpk dhe ñMo.ò Shpk APPï sõka; KPP-K Mo. Shpk	12. Përgjigje Ankesës nga AK -Ka	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik Ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës nr. 29/26 prot., datë 27.10.2020	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 11,808,000 lekë	

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Fondi i këtij i këtij investimi është akorduar nga Buxheti i Shtetit me vlerë 20,000,000 lekë.

Kjo procedurë është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike të SUT.

Me kërkesën nr. 218 prot, datë 23.04.2020 drejtuar Drejtorit të Spitali, për dijeni A. B. me detyrë Zv/drejtore ekonomike dhe E. O. me detyrë përgjegjëse e sektorit të planifikimit, M. Xh. me detyrë mjek aniolog në shërbimin e kirurgjisë, ka bërë kërkesë për blerje aparat radiografie me krah C, me program vaskular.

-Me kërkesën nr. 218/1 prot, datë 24.04.2020, drejtuar G.H. me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimeve, E. O. me detyrë përgjegjëse e sektorit të planifikimit, ka bërë kërkesë për blerje aparat radiografie me krah C, me program vaskular, për shërbimin mjekësor të kirurgjisë, fond i

cili është planifikuar në investimet e vitit 2020, me financim nga fondet e buxhetit të shtetit (Ministria e Mbrojtjes), në zërin shpenzime kapitale (artikulli 231).
Me urdhër të Drejtorit të Spitalit nr. 29, datë 27.04.2020, është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike i përbërë nga M. Xh. me detyrë mjek aniolog në shërbimin e kirurgjisë, Th. Xh. me detyrë kryelaborant i rotgenit i shërbimit të imazherisë , G. P. me profesion inxhinier biomedikal.
Me protokoll nr. 29/1 datë 22.05.2020, grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike i përbërë nga M. Xh. , Th. Xh. , G. P. ka hartuar specifikimet teknike.
Me urdhër të Drejtorit të Spitalit nr. 29/2, datë 22.05.2020, është ngritur grupi i punës për argumentin e fondit limit i përbërë nga Zh. H. me profesion ekonomiste, A. D. me profesion ekonomiste, R. J. me profesion ekonomiste.
Me dokument të protokolluar nr. 29/5 datës 04.06.2020, grupi i përllogaritjes së vlerës së kontratës, i ngritur me urdhrin e drejtorit të spitalit 29/2, datë 22.05.2020, i përbërë nga Zh. H. , A. D. R. J. , është përcaktuar vlera 16,666,667 lekë pa TVSH dhe 20,000,000 lekë me TVSH, aq sa është dhe fondi i planifikuar nga Ministria e Mbrojtjes.
Pra, përllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në vlerën 16,666,667 lekë, pas ofertës të ofruar nga operatorët ñF.ò Shpk në vlerën 16,900,000 lekë, ñM. Sò Shpk në vlerën 15,900,000 lekë, ñG.-Al.f.ò Shpk në vlerën 17,200,000 lekë
Vlera 16,900,000 lekë, është llogaritur si çmim mesatar i vlerës së paraqitur nga të tre operatorët.
Nga grupi për llogaritjen e vlerës limit të kontratës,***nuk është dhënë asnjë argumentim*** *përse nuk është marrë për bazë edhe vlera e kontratave të mëparshme të ngjashme, të realizuara po nga vetë Institucioni nqs ka, ose i spitaleve te tjera (QSUT, Shefqet Ndroqi etj).*
Veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 59, pika 2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se ñNë përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet tõ referohet një ose më shumë alternativave të renditura si mëposhtë: Çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe
a) çmimet e tregut;ose/dhe
b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga
autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe
ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.
Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohetò.
Për mangësitë e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Zh. H. , A. D. R. J. .
Si konkluzion, përllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, i spitaleve te tjera (QSUT, Shefqet Ndroqi etj), veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 59, pika 2.
Me urdhër të Drejtorit të Spitalit me nr. 29/6 datë 10.06.2020, është ngritur njësia e prokurimit e përbërë nga G. H. me profesion administrim publik, me detyrë përgjegjës i sektorit juridik dhe

prokurimeve, G. P. me profesion ing. elektronik, me detyrë inxhinier biomedikal, M. S. me profesion ekonomist, me detyrë shefe e sektorit tregtar.
- *Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim/specifikimet teknike.*
Kërkesat për kualifikim janë miratuar me proçesverbalin e datës 10.06.2020 të firmosura nga njësia e prokurimit e përbërë nga G. H. , G. P. dhe M. S. . Në këto kërkesa nuk janë dhënë arsye konkrete në argumentimin e kritereve të vlerësuara për objektin e prokurimit, në raport me natyrën dhe përmasat e këtij objekti
Konkretisht, në nenin 61, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, parashikohet se: "Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit".
Nuk ka një dokument shkresor (procesverbal etj) të njësisë së , ku të jenë miratuar dokumentet e tenderimit (D.T.), dhe në veçanti nuk ka një dokument shkresor ku të jenë përcaktuar kriteret e vlerësimit, edhe pse në SPE është përcaktuar çmimi më i ulët. Konkretisht, në nenin 61, pika 1, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, parashikohet se: Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje më këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi, ndërsa në pikën 2 të këtij neni parashikohet se: Seti i dokumenteve të tenderit firmoset në çdo faqe nga njësia e prokurimit.
Autoriteti Kontraktor duhet të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim/specifikimet teknike, që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mos diskriminim dhe konkurrencë. Kërkesat/specifikimet teknike duhet të jenë të shkruara në mënyrë të tillë, që të argumentohet nevoja që dikton vendosjen e këtyre kritereve, duke parandaluar në këtë mënyrë para përzgjedhjen paraprake të kandidatit fitues, në zbatim me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik.
Për mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit e përbërë nga G.H. , G. P. dhe M. S. .
Me urdhër nr. 29/9, datë 17.06.2020 të V. H. me detyrë zv/drejtor i spitalit, është bërë pezullimi i procedurës së prokurimit, për arsye të ankesës së operatorit ekonomik ñMSEò me nr. 1130 prot., datë 17.06.2020 dhe operatorit ekonomik ñS.M.ò Shpk me nr. 1154 prot., datë 17.06.2020, ankesë që ka të bëjë me përcaktimin e specifikimeve teknike.
Me urdhër nr. 29/10, datë 17.06.2020 të V. H. me detyrë zv/drejtor i spitalit, është ngritur komisioni i shqyrtimit të ankesës, të operatorit ekonomik ñMSEò me nr. 1130 prot.,, datë 17.06.2020 dhe operatorit ekonomik ñS. Me.ò Shpk me nr. 1154 prot., datë 17.06.2020, ankesë që ka të bëjë me përcaktimin e specifikimeve teknike, i përbërë nga M. Xh. , Th. Xh. dhe S. K. .
Me shkresën nr. 29/11 prot, datë 23.06.2020 komisioni i rekomandon V. H. me detyrë zv/drejtor i spitalit, ndryshimin e specifikimeve teknike, të cilat miratohen prej tij.
Me shkresën nr. 29/12 prot, datë 23.06.2020, hartohet shtojca e specifikimeve teknike, si dhe njoftohen me shkresën nr. 1145/1 prot., datë 23.06.2020 operatori ekonomik ñM.ò Shpk, me shkresën nr. 1134/1 prot., datë 23.06.2020 operatori ekonomik ñS. M.ò Shpk dhe me nr. 1130/1 prot., datë 23.06.2020 operatori ekonomik ñMSEò Shpk.
Autoriteti Kontraktor nuk ka kërkuar tek ñKapaciteti teknikò që ofertuesi te paraqesë Çertifikatë Konformiteti CE ose FDA, dhe ose ekuivalent për materialet e ofertuara, konformë Ligjit nr.

89/2014 ñPër pajisjet mjekësore, neni 17 ci cili në mënyrë eksplicite shprehet ñKonformiteti i pajisjes mjekësore me kërkesat thelbësore konfirmohet nga lëshimi i dokumentit të certifikimit FDAò.

Për mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit e përbërë nga G. H. , G. P. dhe M. S. .

Me urdhër nr. 29/13, datë 23.06.2020 të zëvendës drejtor i spitali V. H. , hiqet pezullimi i procedurës së prokurimit.

Me shkresën nr. 372 prot, datë 14.07.2020, komisioni i vlerësimit të ofertave i drejtohet G. H. , në cilësinë e përgjegjësit të sektorit të prokurimeve, për verifikim në sistemin e drejtësisë të subjekteve pjesëmarrës në këtë proçedurë prokurimi.

Me shkresën nr. 29/14 prot, datë 14.07.2020, G. H. në cilësinë e përgjegjësit të sektorit të prokurimeve i kthen përgjigje komisionit të vlerësimit të ofertave, për rezultatin në regjistrin gjyqësorë të Ministrisë së Drejtësisë të subjekteve pjesëmarrës në këtë proçedurë prokurimi, duke bashkëlidhur dhe çertifikata elektronike respektove për çdo subjekt të kërkuar.

Zhvillimi i procedurë së prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marr pjesë operatorët operatorë ekonomike.

-Shoqëria ñLI.ò Shpk, me ofertë në vlerën 88,000,000 lekë.

-Shoqëria ñM.ò Shpk, me ofertë në vlerën 9,840,000 lekë.

-Shoqëria ñB. E.ò Shpk, me ofertë në vlerën 13,118,605 lekë.

-Shoqëria ñH. & L. ò Shpk, me ofertë në vlerën 14,600,000 lekë.

-Shoqëria ñA.P.ò Shpk, me ofertë në vlerën 14, 990,000 lekë.

-Shoqëria ñM. ò Shpk, me ofertë në vlerën 15,400,000 lekë.

-Shoqëria ñL. ï M.ò Shpk, me ofertë në vlerën 15,640, 000 lekë.

-Shoqëria ñB. A.ò Shpk, pa ofertë.

Pas vlerësimit të KVO u kualifikua dhe shpall fitues Shoqëria ñME.ò Shpk, me ofertë në vlerën 15,400,000 lekë, duke u sôkualifikuar operatorët e tjerë, të përmendur si më sipër.

Me ankesën nr. 1507 prot, datë 30.07.2020, ka kryer ankimin operatori ekonomik ñL.ò Shpk drejtuar titullarit të autoriteti kontraktor për sôkualifikim të padrejtë.

Me ankesën nr. 1500 prot, datë 29.07.2020, ka kryer ankimin operatori ekonomik ñM.ò Shpk drejtuar titullarit të autoriteti kontraktor për sôkualifikim të padrejtë.

Me urdhër nr. 29/15, datë 29.07.2020 të zëvendës drejtor i i spitali V. H. , është bërë pezullimi i procedurës së prokurimit, për arsye të ankesës së operatorit ekonomik operatori ekonomik ñL.ò Shpk dhe ñM.ò Shpk.

Me urdhër nr. 29/16, datë 30.07.2020 të zëvendës drejtor i i spitali V. H. , është ngritur komisioni i shqyrtimit të ankesës operatori ekonomik ñL.ò Shpk dhe ñM. ò Shpk i përbërë nga V. D. me detyrë shef i shërbimit të imazherisë, G. P. me detyrë specialist pajisjesh dhe R. J. me detyrë specialiste prokurimi.

Me shkresën nr. 29/17 prot, dhe nr. 29/18 prot datë 05.08.2020, komisioni i shqyrtimit të ankesës i rekomandon zëvendës drejtor i i spitalit në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor me delegim kompetence me urdhrin nr. 315, datë 17.06.2020 për periudhën 17.06.2020-01.07.2020, mos pranimin e ankesave si të pa bazuara në ligj.

Me shkresën nr. 29/19 prot., dhe nr. 29/20 prot datë 05.08.2020, titullari i autoritetit kontraktor njofton operatorët ekonomik ñL.ò Shpk dhe ñM.ò Shpk, për mos marrje në konsideratë të ankesave të tyre.

Me ankesën nr. 1577 prot, datë 11.08.2020, ka kryer ankimim operatori ekonomik ñM.ò Shpk i është drejtuar komisionit të prokurimit publik për sôkualifikim të padrejtë.

Komisionit i prokurimit publik me vendim nr. 903/1 prot., datë 17.08.2020, ka bërë pezullimin e procedurës së prokurimit.
Me urdhër nr. 29/21, datë 20.08.2020 të titullarit të autoritetit kontraktor, është bërë pezullimi i procedurës së prokurimit, për arsye të ankesës së operatorit ekonomik ñM.ò Shpk.
Theksojmë se veprimet e V. H. në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, janë bërë me delegim kompetence me urdhrin nr. 315, datë 17.06.2020 për periudhën 17.06.2020-01.07.2020, urdhrin nr. 429, datë 23.07.2020 për periudhën 27.07.2020-02.08.2020 dhe urdhrin nr. 498, datë 24.08.2020 për periudhën 25.08.2020-01.09.2020.
Me shkresën nr. 1656 prot, datë 24.08.2020 nga Autoriteti Kontraktor, i është dhënë informacion Komisionit të Prokurimit Publik.
Komisionit i prokurimit publik me shkresën nr. 903/3 prot, datë 08.09.2020, protokolluar në SUT me nr. 1798 prot., datë 14.09.2020 shprehet se ñ .... Ju bënë me dije të gjitha palëve se për shkaqe të ligjshme për fluks të madh të ankesave dhe ngarkesës si rrjedhojë e problematikave të tyre, kapacitete të pamjaftueshme të burimeve njerëzore në raport me numrin e ankesave, nuk është e mundur në daljen e një vendimi përfundimtar, brenda afatit 15 ditor nga ardhja e informacionit të autoritetit kontraktorò.
Komisionit i prokurimit publik me vendim nr. 439/1 prot., datë 09.10.2020, ka bërë pranimin e ankesës së operatorit ekonomik ñM.ò. Duke urdhëruar autoritetin kontraktor të anulloj vendimin e KVO.
Me urdhër nr. 29/22, datë 13.10.2020 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, është bërë heqje e pezullimit dhe kërkohet rivlerësimi i procedurës së prokurimit, referuar vendimit të komisionit të prokurimit publik.
Me shkresën nr. 2005/1 prot, datë 16.10.2020 të Autoritetit Kontraktor, i është dhënë informacion Komisionit të Prokurimit Publik për rivlerësimin, duke kualifikuar dhe shpallur në vend të par shoqërinë ñM.ò për vlerën 9,840,000 lekë.
Me vendim të KPP nr. 439/4 datë 28.10.2020, është kryer heqja e pezullimit të procedurës së prokurimit.
Me kërkesë nr. 2003 prot., datë 13.10.2020 operatori ekonomik ñM.ò, i ka kërkuar Autoritetit Kontraktor informacion mbi arsyet e sôkualifikimit të operatorit ekonomik ñM.ò Shpk, për të bërë ankesë në gjykatën administrative, kundër vendimit KPP.
KVO mbas rivlerësimit në zbatim vendimit te KPP me nr. 439/2020 prot., datë 09.10.2020, ka kualifikuar operatorët si më poshtë;
-Shoqëria ñM.ò Shpk, me ofertë në vlerën 9,840,000 lekë.
-Shoqëria ñMED.ò Shpk, me ofertë në vlerën 15,400,000 lekë.
Duke shpallur fitues operatorin ekonomik ñM.ò Shpk, me ofertë në vlerën 9,840,000 lekë.
Raporti përmbledhës nga komisioni i vlerësimit, është hartuar me nr. 29/23 prot., datë 23.10.2020, raport i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor.
Në datën në S.P.E. e A.P.P, është kryer njoftimi i fituesit, nga ku A.P.P e ka bërë aktive publikimin e njoftimit të fituesit në datën 23.10.2020.
Me urdhër nr. 29/25, datë 23.10.2020,Titullari i Autoritetit Kontraktor, ka ngarkuar njësinë e prokurimit për administrimin e dokumenteve të tenderit të dorëzuar nga operatori ekonomik fitues.
Komisioni i vlerësimit të ofertave, gjithashtu ka hartuar inventarin pa datë për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ñM.ò Shpk i shpallur fitues.
Kontrata është lidhur me nr. 29/26 prot., datë 27.10.2020 ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës të përfaqësuar nga A. Z. në cilësinë e Drejtorit të Spitalit dhe operatorit/e shoqërisë

ñM.ò Shpk në vlerën 11,808,000 lekë pa TVSh, kontrata duhet të fillojë zbatimin me nënshkrimin e palëve me afat 2- mujor.
Në datën 23.10.2020 në S.P.E. e A.P.P, është kryer publikimi i njoftimit të lidhjes së kontratës, nga ku A.P.P. e ka bërë aktive këtë publikim në datën 28.10.2020.
Me urdhër nr. 29/28 datë 28.10.2020 të Drejtorit të Spitalit është ngritur grupi i punës për monitorimin dhe zbatimin e kontratës dhe të marrjes në dorëzim të pajisjes i përbërë nga M.Xh. me detyrë shef i kirurgjisë rikonstruktime, B. H. me detyrë mjeke kirurge dhe G.P.me detyrë specialist pajisjesh.
Nga operatori i kontraktuar ñM.ò Shpk me nr. 29/29 prot.,datë 24.12.2020, është kërkuar shtyrje e afatit të zbatimit të kontratës, duke kërkuar që malli për shkak të situata të Covid-19, do të lëvrohet rreth datë 5-10 janar 2021.
Kontrata është amenduar me nr. 29/30 prot., datë 24.12.2020, duke ndryshuar afatin e zbatimit të saj me dy muaj nga data e nënshkrimit ose 61 ditë në 81 ditë. Amendimi bie ndesh me autorizimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 10/173, datë 17.06.2020 për tregtimin me shumicë të pajisjeve mjekësore nga data 01.07.2020 deri më 31.12.2020, pasi e kalon datë 31.12.202, dhe kontraktuesi duhet të kishte sjell autorizim tjetër.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të prokurimit operatori ekonomik fitues, duhej të ishte sõkualifikuar me arsyetimin si më poshtë vijon:
Në pikën 2.3/e ñKapaciteti teknikò është përcaktuar òOfertuesi duhet te paraqesë certifikate ISO 9001:2015 (ose ekuivalent) të cilësisë për ofertuesin/distributor i mallrave objekt i kontratës. Çertifikatat duhet të jene lëshuar nga nje organ i vlerësimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, te njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikatat kërkohen të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderitò. Ky operator nuk e ka përmbushur këtë kërkesë, pasi Kompania ñEU. C.ò, nuk provohet që është e njohur nga Republika e Shqipërisë, për pasojë çertifikata ISO 9001:2015 e lëshuar prej saj me nr. 172ALQS date 09.08.2019 me vlefshmëri 08.08.2020, nuk është dokument i vlefshëm për tu marr në konsideratë për kualifikim.
Për sa trajtuar mësipërm, kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik ñM.ò Shpk, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 46 pika neni 53 pika 3, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñRregullat e Prokurimitò, i ndryshuar, neni 66 pika 3, Ligjin nr. 44/2015 ñKodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisëò nenet 108-118, çka ngarkon me përgjegjësi Komisioni i Prokurimit Publik.
Pavarësisht shkeljeve dhe parregullsive ligjore ose rregullatore të përmendur si më sipër, veprimet e mësipërme nga KVO janë kryer nga mos njohja/ose keqinterpretimi i legjislacionit specifik të procedurave të prokurimit dhe në veçanti atij të mallrave, dhe nuk kanë krijuar asnjë pasojë financiare në dëm Institucionit, sepse operatori ekonomik ñM.ò Shpk është me vlerë më të vogël se operatori ñMED.ò Shpk i kualifikuar, pasi oferta e tij është në vlerën 15,400,000 lekë.
Procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban nr. 19 rendor, datë 11.01 2021, i firmosur nga M. Xh. , B. H. dhe G. P. , ku është cilësuar se ñMalli u kontrolluar nga komisioni dhe konstaton që është sipas standardeve dhe specifikimeve teknike brenda afatit të kërkuar. Ky artikull do të bëhet hyrje me nr. 18, datë 31.12.2020.
Likuidimi është kryer me urdhër shpenzimin nr. 890, datë 31.12.2020 për vlerën 11,808,000 lekë nëpërmjet R. Bank, është likuiduar Shoqëria M. Ky shpenzim ka të bëj me Blerje Aparat Radiografie, krah C (program vaskular). Fatura nr. 14807, date 31.12.2020. procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit i firmosur nga M. Xh. me profesion mjek, B.H. me profesion mjek dhe G. P. inxhinier biomedikal. Fletë hyrja nr. 18, datë 31.12.2020.

Pajisja nuk shoqërohet me etiketën e përkthyer në gjuhën shqipe, veprim në kundërshtim me neni 20 të Ligjit nr. 89/2014 ñPër pajisjet mjekësoreò i ndryshuar, **ku është shprehur në mënyrë eksplicite se "**Çdo pajisje mjekësore, që vendoset në treg dhe vihet në shërbim, duhet të përmbajë etiketën në gjuhën shqipe, e cila duhet të paraqitet në një formë të dukshme dhe të lexueshme**", theksojmë se etiketa është** vetëm në gjuhën angleze.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi M. Xh. me profesion mjek, B.H. me profesion mjek dhe G. P. inxhinier biomedikal.

2. Proçedura e prokurimit me objekt "Furnizim me pajisje mjekimi (materiale konsumi) për shërbimin e Ortopedisë ne SUT", viti 2019.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: " Furnizim me pajisje mjekimi (materiale konsumi) per shërbimin e Ortopedisë ne SUTò		
1. Urdhër Prokurimi Nr Nr. 86/13 Datë 25.04.2019 2. Lloji i Procedurës së Prokurimit ñProcedurë e hapurò	3. Njësia e prokurimit Urdhër 123/4 Datë 06.09.2019 - Prof. Asc. V. R. Zv/Drejtor Teknik - G. H.-përgjegjës për prokurim me - M. P. -Specialiste Planifikimi	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 123/5 datë 06.09.2019 - Dr. B. G. -Shef i shërbimit te Ortcovpedisë - M. S. -Specialist Prokurimi - B. V. , Jurist
5. Fondi Limit (pa tvsh) 195,018,733 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) - BOE ñOR.ò Shpk, ñLò Shpk, ñLAB.ò Shpk me 194,506,670 Leke pa TVSH - OE 2 ñTRI.ò Shpk me 193,911,750 Leke pa TVSH	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) OE. 1- 512,063 OE. 2 ï 1,106,983
8. Data e hapjes së tenderit 02.10.2019 ora 10:00	9. Burimi Financimit Fond nga Buxheti i Shtetit (Ministria e Mbrojtjes)	10. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër _2___OE b) Sôkualifikuar __0___OE, c) Kualifikuar___2__ OE
11. Ankimime Nuk ka APPï sôka; KPP- nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK -jo	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik Nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14 .Lidhja e kontratës nr.1/2019 nr. 123/21 Prot ., datë 22.11.2019	15. Vlera e kontratës (me tvsh) Tri. Shpk=15,995,070 Leke pa TVSH dhe 15,995,070 Leke me TVSH	
16. Lidhja e kontratës nr.2/2019 nr. 123/26 prot., datë 27.12.2019	17. Vlera e kontratës (me tvsh) BOE ñOR. 360ò Shpk, ñLò Shpk, ñLA.PH.ò Shpk=2,979,935 Leke pa TVSH dhe me TVSH e njejta shume	
18. Lidhja e kontratës nr.3/2020 nr. 123/30 prot., datë 06.03.2020	19. Vlera e kontratës (me tvsh) BOE ñOR. 360ò Shpk, ñLò Shpk, ñLA.PH.ò Shpk= 20,090,900 Leke pa TVSH dhe me TVSH e njëjta shume	
20. Lidhja e kontratës nr.4/2020 nr. 123/36 prot., datë 06.05.2020	21. Vlera e kontratës (me tvsh) BOE ñOR. 360ò Shpk, ñLò Shpk, ñLA.PH.ò Shpk=22,090,220 Leke pa TVSH dhe me TVSH e njejta shume	
22. Lidhja e kontratës nr.5/2020 nr. 123/40 prot., datë 08.07.2020	23. Vlera e kontratës (me tvsh) Tri. Shpk=25,550,000 Leke pa TVSH dhe me TVSH e njejta shume	
24. Lidhja e kontratës nr.6/2020 nr. 123/44 prot., datë 15.09.2020	25. Vlera e kontratës (me tvsh) BOE ñOR. 360ò Shpk, ñLò Shpk, ñLA.PH.ò Shpk=49,900,160 Leke pa TVSH dhe me TVSH e njejta shume	
26. Lidhja e kontratës nr.7/2020	27. Vlera e kontratës (me tvsh) Tri.Shpk=39,960,000	

nr. 123/48 prot., datë 15.12.2020	Leke pa TVSH dhe me TVSH e njejta shume	
28. Lidhja e kontratës nr.8/2021` nr. 123/52 prot., datë 18.03.2021	25. Vlera e kontratës (me tvsh) BOE ñOR. 360ò Shpk, ñLò Shpk, ñLA.PH.ò Shpk=18,446,750 Leke pa TVSH dhe me TVSH e njëjta shume	

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:
Fondi i këtij i këtij investimi është akorduar nga Buxheti i Shtetit (sipas PBA) me vlerë 195,018,733 lekë
për dy vite.
Kjo procedurë është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike.
Kjo procedure është vazhdim i procedurës se anulluar herën e parë me Nr. REF-...-24-2019 dhe te procedurës se anulluar herën e dytë me Nr. REF-...07-26-2019.
Me urdhër të Titullarit të Autoritet Kontraktor nr. 123 Prot., datë 06.09.2019, është krijuar njësia e prokurimit e përbëre nga: Doktor V. R. me detyrë zv/drejtor teknik, G. H. me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimit dhe M. P. me detyre specialiste planifikimi.
Me shkresën nr. 123/1, date 06.09.2019, njësia e prokurimit i është drejtuar me relacion Titullarit të Autoritet Kontraktor për zgjedhjen e procedurës se prokurimit.
Me urdhër të Titullarit të Autoritet Kontraktor nr. 123/2, datë 06.09.2019, është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike i përbërë nga: V. R. me detyrë zv/drejtor teknik me profesion mjek, A. G. me detyrë mjek ortoped dhe A. D. me detyre mjek ortoped.
Me urdhër të Titullarit të Autoritet Kontraktor nr. 123/3, datë 06.09.2019, është ngritur grupi i punës për argumentin e fondit limit i përbëre nga V. R. me detyre zv/drejtor teknik me profesion kirurg ortoped, G. H. me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimit me profesion administrim publik dhe M. P. me detyrë specialiste planifikimi me profesion ekonomiste.
Pra, përllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në vlerën 195,018,73 lekë, pas çmimit mesatar zë për zë ofruara nga operatorët ekonomik ñT.ò Shpk, ñO.E.S D.ò Shpk, ñL.ò Shpk.
Nga grupi për llogaritjen e vlerës limit të kontratës, ***nuk është dhënë asnjë argumentim*** *përse nuk është marrë për bazë edhe vlera e kontratave të mëparshme të ngjashme, të realizuara po nga vetë Institucioni n.q.s ka, ose i spitaleve te tjera (QSUT, Shefqet Ndroqi etj)., ose pse një numër kaq i kufizuar operatoresh, pse tre dhe jo mbi pesë.*
Veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 59, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se ñNë përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet tëi referohet një ose më shumë alternativave të renditura si mëposhtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe
a) çmimet e tregut;ose/dhe
b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga
autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe
ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.
Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohetò.
Si konkluzion, përllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave

të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, i spitaleve te tjera (QSUT, Shefqet Ndroqi etj), , veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 59, pika 2.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi V. R. , G. H. dhe M. P. .

Njësia e prokurimit me procesverbal të pa datuar ka bërë konfirmimin e specifikimeve teknike dhe ka përcaktuar fondin limit në vlerën 195,018,73 lekë, të cilat janë hartuar me shkresën nr. 257/1 prot, datë 07.01.2019.

Me urdhër Titullarit të Autoritet Kontraktor nr. 123/4, date 06.09.2019, është urdhëruar të kryhet proçedura e prokurimit, procedurë e hapur, me fond limit 195,018,73 lekë, marrëveshje kuadër me afat 24 muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër.

Me urdhër të titullarit nr. 123/5, date 06.09.2019 është krijuar komisioni i vlerësimit te ofertave i përbërë nga: B. G. me detyre Shef i shërbimit te Ortopedisë, M. S. me detyre specialist prokurimi (jurist) dhe B. V. me detyre jurist.

Me shkresën nr. 123/6 prot., datë 06.09.2019, është bërë njoftimi i kontratës i cili është publikuar ne Buletinin e Njoftimeve Publike.

- Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim/specifikimet teknike.

Kërkesat për kualifikim janë miratuar me proçesverbalin nr. 1 të datës 06.09.2019 te firmosur nga njësia e prokurimit te përbëre nga V. R. , G. H. dhe M. P. .

Në këto kërkesa janë dhënë arsye konkrete në argumentimin e kritereve të vlerësuara për objektin e prokurimit, në raport me natyrën dhe përmasat e këtij objekti, por nuk janë dhënë referencat ligjore për çdo kërkesë.

Konkretisht, në nenin 61, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, parashikohet se: "Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht ***dhe ligjërisht***, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit".

Nuk ka një dokument shkresor (procesverbal etj) të njësisë së prokurimit, ku të jenë përcaktuar kriteret e vlerësimit, ***edhe pse në S.P.E është përcaktuar ofertimi nga OE do të behët me çmim për njësi dhe për efekt krahasimi, edhe vlerësimi i ofertave të paraqitura do të behët në bazë të shumatores së çmimeve për njësi të artikujve".***

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi V. R. , G. H. dhe M. P. .

Në datë 02.10.2019 është mbajtur proces-verbal për marrjen ne dorëzim te mostrave nga Operatori Ekonomik ñTri.ò Shpk dhe Bashkimi i Operatorëve Ekonomik ñO. 360ò & ñL.ò Shpk& ñLa.ph.ò Shpk dhe me date 23.12.2019, është bere kthimin e mostrave të dorëzuara nga Operatori Ekonomik ñTri.ò Shpk. Ndërsa procesverbali per kthimin e mostrave të dorëzuara nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik ñO. 360ò Shpk & ñL.ò & ñL.ph.ò Shpk, është mbajtur ne date 02.12.2019.

Zhvillimi i procedurë së prokurimit.

Në këte procedure prokurimi, Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë 24 mujore nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër, kanë marr pjesë operatorët ekonomike.

-Operatori Ekonomik ñTri.ò Shpk me ofertë me shumatore për njësi 2,518,770 me vlerë totale 193,911,750 lekë.
- Bashkimi i Operatorëve Ekonomik ñOrt. 360ò Shpk & ñLA.ò & ñLa.ph.ò Shpk ofertë me shumatore për njësi 2,579,624 me vlerë totale 194,506,670 lekë.
Nga komisioni i vlerësimit të ofertave u kualifikuan të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, duke shpallur fitues shumatore për njësi 2,518,770 lekë pa TVSH.
Komisioni i Vlerësimit te Ofertave me shkresën nr. 123/7 Prot., datë 02.10.2019, i ka bërë kërkesë G. H. me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimeve, për verifikim te certifikatave te gjendjes gjyqësore të administratoreve dhe përfaqësuesit te vet deklaruar nga operatoret ekonomike.
Me shkresën nr. 123/8 prot., date 11.10.2019 G. H. me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimeve, i kthen përgjigje komisionit te vlerësimit te ofertave mbi verifikimin e certifikatave te gjendjes gjyqësore.
Në datën 21.10.2019 me nr. 123/9 prot., nga KVO, është bërë dhe raporti përmbledhës i procedurës së prokurimit duke kualifikuar Operatorin Ekonomik ñTri.ò Shpk dhe Bashkimin e Operatorëve Ekonomik ñO.360ò Shpk & ñLA.ò & ñLa.ph.ò Shpk, duke shpallur fitues shumatore për njësi 2,518,770 lekë pa TVSH, mbi bazën e të cilit do të zhvillohet minikonkurimi për lidhjen e kontratave sipas nevojës për furnizim.
Me shkresën nr. 123/10 prot., datë 21.10.2019, është bërë njoftimi i operatoreve ekonomik te suksesshëm ne marrëveshjen kuadër, Operatorin Ekonomik ñTri.ò Shpk dhe Bashkimin e Operatorëve Ekonomik ñO.360ò Shpk& ñLA.ò Shpk& ñLa.ph.ò Shpk.
Titullari i Autoritetit Kontraktor me shkresën nr. 123/11 Prot., datë 21.10.2019, ka urdhëruar administrimin e dokumentacionit dhe për lidhjen e kontratës me operatorin e shpallur fitues.
Me datë 30.10.2019, me nr. 123/12 prot., datë 30.10.2019, është nënshkruar marrëveshja kuadër ndërmjet SUT dhe Operatorin Ekonomik ñT.ò Shpk dhe Bashkimin e Operatorëve Ekonomik ñO 360ò Shpk & ñL.ò & ñL.ph.ò Shpk, me fond limit 195,018,733 lekë, shumatore për njësi më e ulët e ofruar në procedurën e prokurimit (S.P.E) në vlerën 2,518,770 lekë pa TVSH, duke theksuar se çmimet e ofruara në shumatoren për njësi, do të jenë çmimet referencë për çdo mini-konkurs që do të zhvillohet sipas kërkesave dhe nevojave të SUT. Kohëzgjatja e kontratës 24 muaj nga momenti i nënshkrimit nga palët. Theksojmë se kontrata për operatorin ekonomik ñL.ph.ò Shpk është firmosur nga F. S. me autorizim datë 31.10.2019 të administratorit të shoqërisë K. A. , autorizim i cili është i pavlefshëm jo vetëm, pasi është nje dite me vonë pasi është lidhur marrëveshja, por është në kundërshtim me kodin civil, pasi nuk ka prokurë të posaçme.
Me shkresën nr. 123/13 prot., datë 01.11.2019 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, është bërë njoftimi i kontratës së nënshkruar për publikim në APP.
Operatorët Ekonomik ñO 360ò Shpk &ñL.ò Shpk, & ñLò, në këtë procedurë prokurimi janë paraqitur me kontratën e bashkëpunimit me numër 4139 rep, nr. 1166 kol, datë 25.09.2019, kontratë e cila në:
-Nenin 4 ñNatyra dhe përqindja e pjesëmarrjesò, pika 4.2, ka përcaktuar se ñPalët bien dakort se përqindja e pjesëmarrjes në këtë bashkëpunim është si vijon ñO. 360ò Shpk 28 %, Lab.ò Shpk 22 % dhe ñLA.ò Shpk 50 %ò
-Nenin 5 ñElementët e bashkimitò, pika 5.1 ka përcaktuar se ñPalët bien dakort se në kushte kur malli që do të prokurohet është një lloj i përcaktuar, secila nga anëtarët e bashkimit të operatorëve, do të realizojë furnizime të përcaktuara, në raport me përqindjen respektive të pjesëmarrjes në bashkimin e secilës palë, të cilës do ti korespodojë një përqindje e njëjtë me

shpërndarjen e të ardhuraveò. Pika 5.2 ka përcaktuar se ñKonkretisht palët do të realizojnë sipas përqindjes së përcaktuar në nenin 4.2, elementët e furnizimit sipas shtojcës 12 ñSasia dhe grafiku i lëvrimitò, pjesë e dokumenteve të tenderit të njoftuara nga autoriteti kontraktorò. Në të gjitha kontratat e lidhura Bashkimin e Operatorëve Ekonomik Or. Shpk & ñLA.ò Shpk & ñLab.ò Shpk, nuk ka të përcaktuar konkretisht se cfar materiale mjekësore do të furnizoj secila palë. Pra bashkimi i operatorëve, ka marr pjesë në këtë proçedurë prokurimi më një kontratë bashkëpunimi pa përcaktuar materialet mjekësore që do të furnizoj secili.
I njëjti argument qëndron edhe ISO 90.1:2015 të paraqitur nga ky bashkim operatorësh, ku secili operator duhet të dorëzonte certifikatat ISO, sipas materialeve që do të mirrte përsipër të realizonte sipas aktmarrëveshjes. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e nenit 74 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij pika 1dhe 2.
Referuar sa mësipër, kualifikimi dhe shpallja fitues e shoqërisë operatorit ekonomik ñO.E.S Dis.ò Shpk, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 46 pika neni 53 pika 3, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñRregullat e Prokurimitò, i ndryshuar, neni 66 pika 3, neni 74, pika 1 dhe 2, Ligjin nr. 44/2015 ñKodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisëò nenet 108-118.
Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi komisioni i vlerësimit të ofertave i përbër nga B. G. me detyre Shef i Sherbimit te Ortopedise, M. S. me detyre specialist prokurimi (jurist) dhe Besnik Velia me detyre jurist.
Me urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 123/14 prot., datë 04.11.2019 është ngritur grupi i punës për monitorimin dhe zbatimin e marrëveshjes kuadër me i përbërë nga Artan Distafa me detyre mjek ortoped si kryetar i komisionit, A. G. me detyre mjek ortoped si anëtar i komisionit, A. Ç. me detyre mjek ortoped si kryetar i komisionit, E. O. me detyre përgjegjëse e sektorit te planifikimit dhe E. N. me detyre përgjegjëse e shërbimit te farmacisë.
Me urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 123/15 prot., datë 14.11.2019, është ringritur grupi i punës për monitorimin dhe zbatimin e marrëveshjes kuadër i përbërë nga A. D. me detyre mjek ortoped si kryetar i komisionit, A. Ç. me detyre mjek ortoped si kryetar i komisionit, G. B. me detyre mjek ortoped si anëtar i komisionit, E. O. me detyre përgjegjëse e sektorit te planifikimit dhe E. N. me detyre përgjegjëse e shërbimit te farmacisë.
Me shkresën nr. 123/16 Prot., datë 18.11.2019, është bërë kërkesë për lidhje kontrate për ñFurnizim me pajisje mjekimi (materiale konsumi) për shërbimin e Ortopedisë ne SUTò drejtuar G. H. me detyrë përgjegjës sektori i prokurimeve, nga grupi i monitorimit të Marrëveshjes Kuadër i përbërë nga A. D. , A. Ç. , G. B. , E. O. dhe E. N. .
Me urdhër te Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 123/17 prot., datë 19.11.2019, është krijuar komisioni i zhvillimit te minikonkurseve sipas Marrëveshjes Kuadër i përbërë nga: V. R. , G. H. dhe M. S. .
Me shkresën te Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 123/18 prot., date 19.11.2019 dhe shkresën nr. 123/19 prot., Date 19.11.2019, u është bërë ftesë për oferte respektivisht Operatorit Ekonomik ñT.ò Shpk dhe Bashkimin e Operatorëve Ekonomik ñOrt. 360ò Shpk & ñL.ò Shpk & ñL.ò Shpk.
Operatori Ekonomik ñT.ò Shpk më datë 21.11.2019 ka dorëzuar formularin e ofertës për minikonkurs me shumatore të çmimeve për njësi 1,500,170 lekë, me çmim oferte në vlerën 15,995,070 lekë.

Bashkimin e Operatorëve Ekonomik ñO 360ò Shpk & ñL.ò Shpk & ñLab.ò Shpk, ka dorëzuar formularin e ofertës për minikonkurs me shumatore të çmimeve për njësi 1,502,004 lekë, me çmim oferte në vlerën 15,997,222 lekë.
Komisioni i zhvillimit te minikonkursit, me procesverbal nr.1, datë 21.11.2019 me r. 123/20 prot., ka shpallur fitues Operatori Ekonomik ñT.ò Shpk me oferte totale 15,997,222 lekë pa Tvsh.
Kontrata është lidhur me 123/21 prot., datë 22.11.2019 ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës të përfaqësuar nga A. Z. në cilësinë e Drejtorit të Spitalit dhe operatorit/e shoqërisë ñT.ò Shpk në vlerën 15,995,070 lekë me tvsh, kontrata duhet të fillojë zbatimin me nënshkrimin e palëve me deri më një muaj nga fillimi i saj.
Me shkresën nr. 123/22 prot., datë 23.12.2019 i është bërë kërkesë për lidhje kontrate për G. H. me detyrë përgjegjës sektori i prokurimeve, nga grupi i monitorimit të Marrëveshjes Kuadër i përbërë nga A. D. , A. Ç. , G. B. , E. O. dhe E. N. .
Me shkresën nr. 123/23 Prot., date 26.12.2019 dhe me shkresën nr. 123/24 prot., date 26.12.2019, nga Autoriteti Kontraktor u është bërë ftesë për ofertë operatoreve ekonomik ñTr.ò Shpk dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik O. 360ò Shpk & ñL.ò Shpk & ñL.ò Shpk.
Bashkimi i Operatorëve Ekonomik Ort. 360ò Shpk & ñL.ò Shpk & ñL.ò më datë 27.12.2019, ka dorëzuar formularin e ofertës për minikonkurs me shumatore të çmimeve për njësi 770,814 lekë, me çmim oferte në vlerën 2,979,935 lekë
Operatori Ekonomik ñT.ò Shpk më datë 27.12.2019, ka dorëzuar formularin e ofertës për minikonkurs me shumatore të çmimeve për njësi 774,020 lekë, me çmim oferte në vlerën 2,999,050 lekë.
Komisioni i zhvillimit te minikonkursit, me procesverbal nr. 2, me 123/25 prot., datë 27.12.2019, ka shpallur fitues Bashkimin e Operatorëve Ekonomik ñOrt. 360ò Shpk & ñLA.ò Shpk & ñLab.ò Shpk me oferte totale 2,979,935 lekë pa Tvsh.
Kontrata është lidhur me 123/26 prot., datë 27.12.2019 ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës të përfaqësuar nga A. Z. në cilësinë e Drejtorit të Spitalit dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik Ort. 360ò Shpk & ñLA.ò Shpk & ñLab.ò Shpk në vlerën 2,979,935 lekë me tvsh, kontrata duhet të fillojë zbatimin me nënshkrimin e palëve me deri më një muaj nga fillimi i saj.
Me shkresën nr. 119 prot., datë 24.02.2020 është bërë kërkesë për lidhje kontrate për G. H. me detyrë përgjegjës sektori i prokurimeve, nga grupi i monitorimit të Marrëveshjes Kuadër i përbërë nga A. D. , A. Ç. , G. B. , E. O. dhe E. N. .
Me shkresën nr. 123/27 prot., date 25.02.2020 dhe shkresën nr. 123/28 prot., date 25.02.2020 nga Autoriteti Kontraktor, u është bërë ftesë për oferte operatoreve ekonomik ñT.ò Shpk dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik ñO. 360ò Shpk & ñL.ò Shpk & ñL.ò Shpk.
Operatori Ekonomik ñTri.ò Shpk më datë 27.02.2020, ka dorëzuar formularin e ofertës për minikonkurs me shumatore të çmimeve për njësi 1,475,270 lekë, me çmim oferte në vlerën 20,113,400 lekë.
Bashkimi i Operatorëve Ekonomik ñO. 360ò Shpk & ñLA.ò Shpk & ñLab.ò Shpk më datë 27.02.2020, ka dorëzuar formularin e ofertës për minikonkurs me shumatore të çmimeve për njësi 1,481,720 lekë, me çmim oferte në vlerën 20,090,900 lekë
Komisioni i zhvillimit te minikonkursit, me procesverbal nr. 3, me 123/29 prot., datë 27.02.2020 ka shpallur fitues Bashkimin e Operatorëve Ekonomik ñO 360ò Shpk & ñLò Shpk & ñL.ò Shpk me oferte totale 20,090,900 lekë pa Tvsh.
Kontrata është lidhur me 123/26 prot., datë 27.12.2019 ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës të përfaqësuar nga A. Z. në cilësinë e Drejtorit të Spitalit dhe Bashkimit të Operatorëve

Ekonomik ñO 360ò Shpk & ñL.ò Shpk & ñL.ò Shpk në vlerën 20,090,900 lekë me tvsh, kontrata duhet të fillojë zbatimin me nënshkrimin e palëve me deri më 2 mujore nga fillimi i saj. Në nenin 7 të kësaj kontrate është përcaktuar pagesa do te kryhet nga blerësi brenda 30 ditëve nga marrja e faturës për mallin e pranuar. Pagesa do të kryhet në lekë shqiptare, me çek ose urdhërxhirim në llogarinë e furnizuesit sipas kontratës së bashkëpunimit me numër 4139 rep, nr. 1166 kol, datë 25.09.2019 ñO. 360ò Shpk 28 %, L.ò Shpk 22 % dhe ñL.ò Shpk 50 %.
Me urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor është ringritur grupi i punës për monitorimin dhe zbatimin e marrëveshjes kuadër i përbërë nga: V. R. me detyre zv/drejtor teknik si kryetar i komisionit, A. C. me detyre mjek ortoped si anëtar i komisionit, B. G. me detyre mjek ortoped si anëtar i komisionit, E. O. me detyre përgjegjëse e sektorit te planifikimit si anëtare e komisionit dhe E. N. me detyre përgjegjëse e shërbimit te farmacisë si anëtare e komisionit.
Me urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 123/32 Prot., date 06.03.2020, është krijuar komisioni i zhvillimit te minikonkurseve sipas Marrëveshjes Kuadër i përbërë nga: Z. D. , G. H. dhe M. S. .
Me shkresën nr. 227 Prot., datë 30.04.2020 grupi i punës për monitorimin dhe zbatimin e marrëveshjes kuadër, i ka bërë kërkesë për lidhje kontrate G. H. me detyrë përgjegjës sektori i prokurimeve.
Me shkresën nr. 123/33 prot., date 04.05.2020 dhe shkresën nr. 123/34 prot., date 04.05.2020 nga Autoriteti Kontraktor, u është bërë ftesë për oferte operatoreve ekonomik ñT.ò Shpk dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik ñOrt. 360ò Shpk & ñLA.ò Shpk & ñLab.ò Shpk.
Operatori Ekonomik ñT.ò Shpk më datë 05.05.2020 ka dorëzuar formularin e ofertës për minikonkurs me shumatore të çmimeve për njësi 1,531,870 lekë, me çmim oferte në vlerën 22,111,850 lekë.
Bashkimi i Operatorëve Ekonomik ñO. 360ò Shpk & ñL.ò Shpk & ñL.ò Shpk më datë 05.05.2020, ka dorëzuar formularin e ofertës për minikonkurs me shumatore të çmimeve për njësi 1,560,460 lekë, me çmim oferte në vlerën 22,090,220 lekë
Komisioni i zhvillimit te minikonkursit, me procesverbal nr. 4, me 123/35 prot., datë 05.05.2020 ka shpallur fitues Bashkimin e Operatorëve Ekonomik ñO. 360ò Shpk & ñL.ò Shpk & ñL.ò Shpk me oferte totale 20,090,900 lekë pa Tvsh.
Kontrata është lidhur me 123/36 prot., datë 06.05.2020 ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës të përfaqësuar nga A. Z. në cilësinë e Drejtorit të Spitalit dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik ñO. 360ò Shpk & ñL.ò Shpk & ñL.ò Shpk në vlerën 20,090,900 lekë me tvsh, kontrata duhet të fillojë zbatimin me nënshkrimin e palëve me deri më 2 mujore nga fillimi i saj. Në nenin 7 të kësaj kontrate është përcaktuar Furnizuesi do të filloj lëvrimin e materialeve, menjëherë pas nënshkrimit të kësaj kontrate, sipas kërkesave të SUT, deri në një periudhë dy mujore. Të gjitha materialet që do të lëvrohen me anë të kontratës së furnizimit mund të ndrohen (mallrat/materialet do të qëndrojnë të magazinuara në farmacinë SUT), sipas përmasave dhe llojeve përmasave dhe llojeve të kërkuara rast pas rasti. Çdo material që do të ndrohet, duhet të pasqyrohet me anë të një proçesverbali të cilin e firmosin përfaqësuesit e operatoreve ekonomik dhe grupi i monitorimit të kontratës. Vlera e materialeve nuk do të ndryshoj nga ajo e kontratës së furnizimit. Kjo klauzolë nuk është në dokumentet e procedurës së prokurimit.
Me shkresën nr. 326 Prot., datë 29.06.2020 grupi i punës për monitorimin dhe zbatimin e marrëveshjes kuadër, i ka bërë kërkesë për lidhje kontrate G. H. me detyrë përgjegjës sektori i prokurimeve.

Me shkresën nr. 123/37 prot., datë 30.06.2020 dhe nr. 123/38 prot., datë 30.06.2020 nga Autoriteti Kontraktor, u është bërë ftesë për oferte operatoreve ekonomik ñTri.ò Shpk dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik ñO. 360ò Shpk & ñLA.ò Shpk & ñLab.ò Shpk.
Bashkimi i Operatorëve Ekonomik ñO. 360ò Shpk & ñLA.ò Shpk & ñLab.ò Shpk, më datë 02.07.2020, ka dorëzuar formularin e ofertës për minikonkurs me shumatore të çmimeve për njësi 1,651,204 lekë, me çmim oferte në vlerën 25,551,020 lekë.
Operatori Ekonomik ñTri.ò Shpk më datë 02.07.2020 ka dorëzuar formularin e ofertës për minikonkurs me shumatore të çmimeve për njësi 1,640,320 lekë, me çmim oferte në vlerën 22,550,000 lekë.
Komisioni i zhvillimit te minikonkursit, me procesverbal nr. 5, me 123/39 prot., datë 02.07.2020, ka shpallur fitues Operatori Ekonomik ñTri.ò Shpk me oferte totale 25,555,000 lekë pa Tvsh.
Kontrata është lidhur me 123/40 prot., datë 08.07.2020 ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës të përfaqësuar nga A. Z. në cilësinë e Drejtorit të Spitalit dhe Operatori Ekonomik ñT.ò Shpk në vlerën 25,550,000 lekë.
Në nenin 5 të kësaj kontrate është përcaktuar Furnizuesi do të filloj lëvrimin e materialeve, menjëherë pas nënshkrimit të kësaj kontrate, sipas kërkesave të SUT, deri në një periudhë dy mujore. Të gjitha materialet që do të lëvrohen me anë të kontratës së furnizimit mund të ndrohen (mallrat/materialet do të qëndrojnë të magazinuara në farmacinë SUT), sipas përmasave dhe llojeve përmasave dhe llojeve të kërkuara rast pas rasti. Çdo material që do të ndrohet, duhet të pasqyrohet me anë të një proçesverbali të cilin e firmosin përfaqësuesit e operatoreve ekonomik dhe grupi i monitorimit të kontratës. Vlera e materialeve nuk do të ndryshoj nga ajo e kontratës së furnizimit. Kjo klauzolë nuk është në dokumentet e procedurës së prokurimit.
Me shkresën nr. 476 Prot., datë 10.09.2020 grupi i punës për monitorimin dhe zbatimin e marrëveshjes, i ka bërë kërkesë për lidhje kontrate G. H. me detyrë përgjegjës sektori i prokurimeve.
Me shkresën nr. 123/41 prot., datë 10.09.2020 dhe nr. 123/42 prot., datë 10.09.2020, nga Autoriteti Kontraktor, u është bërë ftesë për oferte operatoreve ekonomik ñTr.ò Shpk dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik O 360ò Shpk & ñLA.ò Shpk & ñLab.ò Shpk.
Operatori Ekonomik ñTri.ò Shpk më datë 14.09.2020 ka dorëzuar formularin e ofertës për minikonkurs me shumatore të çmimeve për njësi 1,805,620 lekë, me çmim oferte në vlerën 49,920,900 lekë.
Bashkimi i Operatorëve Ekonomik ñO. 360ò Shpk & ñLA.ò Shpk & ñLab.ò Shpk, më datë 14.09.2020, ka dorëzuar formularin e ofertës për minikonkurs me shumatore të çmimeve për njësi 1,812,544 lekë, me çmim oferte në vlerën 49,900,160 lekë.
Komisioni i zhvillimit te minikonkursit, me procesverbal nr. 6, me 123/35 prot., datë 14.09.2020, ka shpallur fitues Bashkimin e Operatorëve Ekonomik ñO. 360ò Shpk & ñLA.ò Shpk & ñLab.ò Shpk me oferte totale 49,900,160 lekë pa Tvsh.
Kontrata është lidhur me 123/44 prot., datë 15.09.2020 ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës të përfaqësuar nga A. Z. në cilësinë e Drejtorit të Spitalit dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik ñO 360ò Shpk & ñL.ò Shpk & ñL.ò Shpk në vlerën 49,900,160 lekë me tvsh, kontrata duhet të fillojë zbatimin me nënshkrimin e palëve me deri më 3 mujore nga fillimi i saj. Në nenin 5 të kësaj kontrate është përcaktuar Furnizuesi do të filloj lëvrimin e materialeve, menjëherë pas nënshkrimit të kësaj kontrate, sipas kërkesave të SUT, deri në një periudhë dy mujore. Të gjitha materialet që do të lëvrohen me anë të kontratës së furnizimit mund të ndrrohen (mallrat/materialet do të qëndrojnë të magazinuara në farmacinë SUT), sipas përmasave dhe

llojeve përmasave dhe llojeve të kërkuara rast pas rasti. Çdo material që do të ndrohet, duhet të pasqyrohet me anë të një proçesverbali të cilin e firmosin përfaqësuesit e operatoreve ekonomik dhe grupi i monitorimit të kontratës. Vlera e materialeve nuk do të ndryshoj nga ajo e kontratës së furnizimit. Kjo klauzolë nuk është në dokumentet e procedurës së prokurimit.
Me shkresën nr. 639 Prot., datë 07.12.2020, grupi i punës për monitorimin dhe zbatimin e marrëveshjes kuadër i ka bërë kërkesë për lidhje kontrate G. H. me detyrë përgjegjës sektori i prokurimeve.
Me shkresën nr. 123/45 prot., datë 10.12.2020 dhe nr. 123/46 prot., datë 10.12.2020 nga Autoriteti Kontraktor, u është bërë ftesë për oferte operatoreve ekonomik ñT.ò Shpk dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik ñO. 360ò Shpk & ñLA.ò Shpk & ñLab.ò Shpk.
Operatori Ekonomik ñTri.ò Shpk më datë 11.12.2020, ka dorëzuar formularin e ofertës për minikonkurs me shumatore të çmimeve për njësi 1,779,620 lekë, me çmim oferte në vlerën 39,960,000 lekë.
Bashkimi i Operatorëve Ekonomik ñO. 360ò Shpk & ñLA.ò Shpk & ñLab.ò Shpk, më datë 11.12.2020, ka dorëzuar formularin e ofertës për minikonkurs me shumatore të çmimeve për njësi 1,790,520lekë, me çmim oferte në vlerën 39,962,240 lekë.
Komisioni i zhvillimit te minikonkursit, me procesverbal nr. 7, me 123/47 prot., datë 11.12.2020 ka shpallur fitues Operatorin Ekonomik ñTri.ò Shpk me oferte totale 39,960,000 lekë pa Tvsh.
Kontrata është lidhur me 123/48 prot., datë 15.12.2020 ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës të përfaqësuar nga A. Z. në cilësinë e Drejtorit të Spitalit Operatori Ekonomik ñTr.ò Shpk në vlerën 39,960,000 lekë me tvsh, kontrata duhet të fillojë zbatimin me nënshkrimin e palëve me deri më 2 mujore nga fillimi i saj. Në nenin 5 të kësaj kontrate është përcaktuar Furnizuesi do të filloj lëvrimin e materialeve, menjëherë pas nënshkrimit të kësaj kontrate, sipas kërkesave të SUT, deri në një periudhë dy mujore. Të gjitha materialet që do të lëvrohen me anë të kontratës së furnizimit mund të ndrohen (mallrat/materialet do të qëndrojnë të magazinuara në farmacinë SUT), sipas përmasave dhe llojeve përmasave dhe llojeve të kërkuara rast pas rasti. Çdo material që do të ndrohet, duhet të pasqyrohet me anë të një proçesverbali të cilin e firmosin përfaqësuesit e operatoreve ekonomik dhe grupi i monitorimit të kontratës. Vlera e materialeve nuk do të ndryshoj nga ajo e kontratës së furnizimit. Kjo klauzolë nuk është në dokumentet e procedurës së prokurimit.
Me shkresën nr. 137 prot., datë 10.03.2021, grupi i punës për monitorimin dhe zbatimin e marrëveshjes kuadër, i ka bërë kërkesë për lidhje kontrate G. H. me detyrë përgjegjës sektori i prokurimeve.
Me shkresën nr. 123/49 prot., datë 12.03.2021 dhe nr. 123/50 prot., datë 12.03.2021 nga Autoriteti Kontraktor, u është bërë ftesë për oferte operatoreve ekonomik ñTri.ò Shpk dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik ñO. 360ò Shpk & ñLA.ò Shpk & ñLab.ò Shpk.
Operatori Ekonomik ñTri.ò Shpk më datë 16.03.2021, ka dorëzuar formularin e ofertës për minikonkurs me shumatore të çmimeve për njësi 1,049,620 lekë, me çmim oferte në vlerën 18,448,500 lekë.
Bashkimi i Operatorëve Ekonomik ñO. 360ò Shpk & ñLA.ò Shpk & ñLab.ò Shpk, më datë 16.03.2021, ka dorëzuar formularin e ofertës për minikonkurs me shumatore të çmimeve për njësi 1,057,020 lekë, me çmim oferte në vlerën 18,446,750 lekë.
Komisioni i zhvillimit te minikonkursit, me procesverbal nr. 8, me 123/51 prot., datë 16.03.2021, ka shpallur fitues Bashkimin e Operatorëve Ekonomik Ort. 360ò Shpk & ñLA.ò Shpk & ñLab.ò Shpk me oferte totale 18,446,750 lekë pa Tvsh.

Kontrata është lidhur me 123/52 prot., datë 18.03.2021 ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës të përfaqësuar nga A. Z. në cilësinë e Drejtorit të Spitalit dhe Bashkimi i Operatorëve Ekonomik O. 360ò Shpk & ñL.ò Shpk & ñL.ò Shpk në vlerën 18,446,750 lekë me tvsh, kontrata duhet të fillojë zbatimin me nënshkrimin e palëve me deri më 2 mujore nga fillimi i saj. Në nenin 5 të kësaj kontrate është përcaktuar Furnizuesi do të filloj lëvrimin e materialeve, menjëherë pas nënshkrimit të kësaj kontrate, sipas kërkesave të SUT, deri në një periudhë dy mujore. Të gjitha materialet që do të lëvrohen me anë të kontratës së furnizimit mund të ndrohen (mallrat/materialet do të qëndrojnë të magazinuara në farmacinë SUT), sipas përmasave dhe llojeve përmasave dhe llojeve të kërkuara rast pas rasti. Çdo material që do të ndrohet, duhet të pasqyrohet me anë të një proçesverbali të cilin e firmosin përfaqësuesit e operatoreve ekonomik dhe grupi i monitorimit të kontratës. Vlera e materialeve nuk do të ndryshoj nga ajo e kontratës së furnizimit. Kjo klauzolë nuk është në dokumentet e procedurës së prokurimit.

Likuiduar me:

Urdhër shpenzimi nr. 243 datë 06.12.2019 për vlerën 13,123,200 lekë nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria ñTri.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 324188419 date 27.11.2019,fletë hyrjen nr. 64, datë 27.11.2019, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban 27.11.2019, i firmosur nga A. C. , K. S. dhe L. F. , ku është cilësuar se ñMaterialet u kontrolluar nga komisioni dhe janë sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me nr. 64, datë 27.11.2019.

Urdhër shpenzimin nr. 253 datë 13.12.2019 për vlerën 1,612,050 lekë nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria ñTr.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 324192202 date 12.12.2019,fletë hyrjen nr. 87, datë 12.12.2019, procesverbali i pritjes,kontrollit dhe administrimit të mallit mban 12.12.2019, i firmosur nga A. C. , K. S. dhe L. F. ku është cilësuar se ñMaterialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me hyrja nr. 87, datë 12.12.2019.

Urdhër shpenzimin nr. 257 datë 13.12.2019 për vlerën 1,259,820 lekë nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria ñTri.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 324191342 date 10.12.2019, fletë hyrjen nr. 90, datë 10.12.2019, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban 10.12.2019, i firmosur nga A. C. , K. S. dhe L. F. , ku është cilësuar se ñMaterialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me hyrja nr. 90, datë 10.12.2019.

Urdhër shpenzimin nr. 260 datë 31.12.2019 për vlerën 1,368,975 lekë nëpërmjet CREDINS Bankë, është likuiduar Shoqëria ñO. 360ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 305, date 27.12.2019, fletë hyrjen nr. 98, datë 27.12.2019, procesverbali i pritjes dhe kontrollit dhe administrimit të mallit mban 27.12.2019, i firmosur nga A. C. , K. S. dhe L. F. ku është cilësuar se ñMaterialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me nr. 98, datë 27.12.2019.

Urdhër shpenzimin nr. 261 datë 31.12.2019 për vlerën 1,592,960 lekë nëpërmjet CRE. Ban. , është likuiduar Shoqëria ñO. 360ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore.

Procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban 27.12.2019, i firmosur nga A. C. , K. S. dhe L. F. ku është cilësuar se ñMaterialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me nr. 99, datë 27.12.2019.

Urdhër shpenzimin nr. 117 datë 21.05.2020 për vlerën 13,268,560 lekë nëpërmjet UNION Bankë, është likuiduar Shoqëria ñLA.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 5, date 12.05.2020, fletë hyrjen nr. 282, 283 datë 12.05.2020, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban 12.05.2020, i firmosur nga A. C. , K. S. dhe L. F. ku është cilësuar se ñMaterialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me nr. 282, 283 datë 12.05.2020.
Urdhër shpenzimin nr. 118 datë 21.05.2020 për vlerën 8,818,660 lekë nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria ñLab.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 79 date 13.05.2020, fletë hyrjen nr.288, 287datë 13.05.2020, procesverbali i pritjes dhe kontrollit dhe administrimit të mallit mban 13.05.2020, i firmosur nga A. C. , K. S. dhe L. F. ku është cilësuar se ñMaterialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me hyrja nr. 288, 287datë 13.05.2020.
Urdhër shpenzimin nr. 121 datë 26.05.2020 për vlerën 3,000 lekë nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria ñLab.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 80 date 13.05.2020, fletëhyrja nr. 269 datë 13.05.2020, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban datën 13.05.2020, i firmosur nga A. C. , K. S. dhe L. F. ku është cilësuar se ñMaterialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me hyrja nr. 269 datë 13.05.2020.
Urdhër shpenzimin nr. 171 datë 27.07.2020 për vlerën 6,292,300 lekë nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria ñTr.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 3242.4573 date 13.07.2020, fletë hyrjen nr. 370, datë 13.07.2020, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban 13.07.2020, i firmosur nga A. C. , K. S. dhe L. F. ku është cilësuar se ñMaterialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me hyrja nr. 370, datë 13.07.2020.
Urdhër shpenzimin nr. 185 datë 18.08.2020 për vlerën 1,032,300 lekë nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria ñTri.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 3242555186 date 14.07.2020,fletë hyrjen nr.370, datë 13.07.2020, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban 14.07.2020, i firmosur nga A. C. , K. S. dhe L. F. ku është cilësuar se ñMaterialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me hyrja nr. 388, datë 14.07.2020.
Urdhër shpenzimin nr. 186 datë 18.08.2020 për vlerën 370,000 lekë nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria ñTriò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 3242555155, datë 14.07.2020, fletë hyrjen nr. 387, datë 14.07.2020, procesverbali i pritjes dhe kontrollit dhe administrimit të mallit mban 14.07.2020, i firmosur nga A. C. , K. S. dhe L. F. , ku është cilësuar se ñMaterialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me hyrja nr. 387, datë 14.07.2020.
Urdhër shpenzimin nr. 195 datë 03.09.2020 për vlerën 3,822,200 lekë nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria ñTri.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 3242.9432 date 27.07.2020 fletë hyrjen nr. 424, datë 27.07.2020, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban

27.07.2020, i firmosur nga A. C. , K. S. dhe L. F. ku është cilësuar se ñMaterialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me hyrja nr. 424, datë 27.07.2020.
Urdhër shpenzimin nr. 196 datë 03.09.2020 për vlerën 2,250,580 lekë nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria ñTr.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 324255204 date 14.07.2020, fletë hyrjen nr. 389, datë 14.07.2020, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban 14.07.2020, i firmosur nga A. C. , K. S. dhe L. F. ku është cilësuar se ñMaterialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me hyrja nr. 389, datë 14.07.2020.
Urdhër shpenzimin nr. 202 datë 08.09.2020 për vlerën 3,332,300 lekë nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria ñTr.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 324.64838 date 12.08.2020, fletë hyrjen nr. 446, datë 12.08.2020, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban datën 12.08.2020, i firmosur nga A. C., K. S. dhe L. F. ku është cilësuar se ñMaterialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me hyrja nr. 446, datë 12.08.2020.
Urdhër shpenzimin nr. 203 datë 08.09.2020 për vlerën 2,009,720lekë nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria ñTri.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 390526326 date 27.08.2020. procesverbali i pritjes, fletë hyrjen nr. 464, datë 27.08.2020, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban 27.08.2020, i firmosur nga A. C. , K. S. dhe L. F. ku është cilësuar se ñMaterialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me nr. 464, datë 27.08.2020.
Urdhër shpenzimin nr. 204 datë 08.09.2020 për vlerën 1,250,050 lekë nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria ñTr.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 39052.327 date 27.08.2020. procesverbali i pritjes, fletë hyrjen nr. 485, datë 27.08.2020, procesverbali i pritjes dhe kontrollit dhe administrimit të mallit mban 27.08.2020, i firmosur nga A. C. , K. S. dhe L. F. ku është cilësuar se ñMaterialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me nr. 485, datë 27.08.2020.
Urdhër shpenzimin nr. 205 datë 08.09.2020 për vlerën 130,000 lekë nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria ñTri.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 390526247 date 27.08.2020, fletë hyrjen nr. 463, datë 27.08.2020, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban 27.08.2020, i firmosur nga A. C. , K. S. dhe L. F. ku është cilësuar se ñMaterialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me nr. 463, datë 27.08.2020.
Urdhër shpenzimin nr. 206 datë 08.09.2020 për vlerën 1,426,200 lekë nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria ñTri.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 390264822 date 12.08.2020, fletë hyrjen nr. 445, datë 12.08.2020, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban 12.08.2020, i firmosur nga A. C. , K. S. dhe L. F. ku është cilësuar se ñMaterialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me nr. 445, datë 12.08.2020.

Urdhër shpenzimin nr. 826, datë 28.12.2020 për vlerën 8,033,750 lekë nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria ñTri.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 3905..408 date 28.12.2020, fletë hyrjen nr. 668, datë 28.12.2020, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban datën 28.12.2020, i firmosur nga A. C. , K. S. dhe L. F. ku është cilësuar se ñMaterialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me nr. 445, datë 12.08.2020.
Urdhër shpenzimin nr. 852 datë 31.12.2020 për vlerën 6,135,550 lekë nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria ñTri.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 390563553 date 30.12.2020, fletë hyrjen nr. 772, datë 30.12.2020, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban datën 30.12.2020 i firmosur nga A. C. , K. S. dhe L. F. ku është cilësuar se ñMaterialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me nr. 772, datë 30.12.2020.
Urdhër shpenzimin nr. 854 datë 31.12.2020 për vlerën 715,000 lekë nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria ñTr.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 3905.4554 date 30.12.2020, fletë hyrjen nr. 723, datë 30.12.2020, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban 30.12.2020 i firmosur nga A. C. , K. S. dhe L. F. ku është cilësuar se ñMaterialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me nr. 723, datë 30.12.2020.
Urdhër shpenzimin nr. 856 datë 31.12.2020 për vlerën 5,129,250 lekë nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria ñTri.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 3905.4787 date 30.12.2020, fletë hyrjen nr. 725, datë 30.12.2020, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban 30.12.2020 i firmosur nga A. C. , K. S. dhe L. F. ku është cilësuar se ñMaterialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me nr. 725, datë 30.12.2020.
Urdhër shpenzimin nr. 860 datë 31.12.2020 për vlerën 1,665,900 lekë nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria ñTri.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 390564802 date 30.12.2020, fletë hyrjen nr. 726, datë 30.12.2020, procesverbali i pritjes dhe kontrollit dhe administrimit të mallit mban 30.12.2020 i firmosur nga A. C. , K. S. dhe L. F. ku është cilësuar se ñMaterialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me nr. 726, datë 30.12.2020.
Urdhër shpenzimin nr. 862 datë 31.12.2020 për vlerën 4,006,600 lekë nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria ñTr.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 390564555 date 30.12.2020, fletë hyrjen nr. 724, datë 30.12.2020, procesverbali i pritjes dhe kontrollit dhe administrimit të mallit mban 30.12.2020 i firmosur nga A. C., K. S. dhe L. F. ku është cilësuar se ñMaterialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me . 724, datë 30.12.2020.
Urdhër shpenzimin nr. 53 datë 09.04.2020 për vlerën 9,222,220 lekë nëpërmjet U. Bank, është likuiduar Shoqëria ñLA.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 133, date 26.03.2021, fletë hyrjen nr. 782 datë 26.03.2021, procesverbali i pritjes dhe kontrollit dhe administrimit të mallit mban

26.03.2021, i firmosur nga A. C. , K. S. dhe L. F. ku është cilësuar se ñMaterialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me nr. 782 datë 26.03.2021.
Urdhër shpenzimin nr. 53 datë 09.04.2020 për vlerën 9,222,220 lekë nëpërmjet U. Bank, është likuiduar Shoqëria ñLA.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 133, date 26.03.2021, fletë hyrjennr. 782 datë 26.03.2021, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban 26.03.2021, i firmosur nga A. C. , K. S. dhe L. F. ku është cilësuar se ñMaterialet u kontrolluar nga komisioni dhe janë sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me nr. 782 datë 26.03.2021.
Urdhër shpenzimin nr. 619, datë 25.09.2020 për vlerën 12,978,058 lekë nëpërmjet UNION Bankë, është likuiduar Shoqëria ñL.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 6, date 17.09.2020. procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit, fletë hyrjen nr. 491 datë 17.09.2020, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban 17.09.2020, i firmosur nga A. C. , K. S. dhe L. F. ku është cilësuar se ñMaterialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me nr. 491 datë 17.09.2020.
Urdhër shpenzimin nr. 620 datë 25.09.2020 për vlerën 9,612,552 lekë nëpërmjet U. Bank, është likuiduar Shoqëria ñLA.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 6, date 17.09.2020, fletë hyrjen nr. 491 datë 17.09.2020, procesverbali i pritjes dhe kontrollit dhe administrimit të mallit mban 17.09.2020, i firmosur nga A. C. , K. S. dhe L. F. ku është cilësuar se ñMaterialet u kontrolluar nga komisioni dhe janë sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me nr. 491 datë 17.09.2020.
Urdhër shpenzimin nr. 642 datë 06.10.2020 për vlerën 5,057,400 lekë nëpërmjet U. Bank , është likuiduar Shoqëria ñLA.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 7, date 30.09.2020, fletë hyrjen nr. 514 datë 30.09.2020, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban 30.09.2020, i firmosur nga A. C. , K. S. dhe L. F. ku është cilësuar se ñMaterialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me nr. 514 datë 30.09.2020.
Urdhër shpenzimin nr. 650 datë 12.10.2020 për vlerën 12,096,550 lekë nëpërmjet U. Bank, është likuiduar Shoqëria ñLA.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 179, date 21.09.2020, fletë hyrjen nr. 497 datë 21.09.2020, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban 21.09.2020, i firmosur nga A. C. , K. S. dhe L. F. ku është cilësuar se ñMaterialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me nr. 497 datë 21.09.2020.
Urdhër shpenzimin nr. 673 datë 05.11.2020 për vlerën 9,651,600 lekë nëpërmjet UNION Bankë, është likuiduar Shoqëria ñLA.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 198, date 21.09.2020, fletë hyrjen nr. 496 datë 21.09.2020, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban 21.09.2020, i firmosur nga A. C. , K. S. dhe L. F. ku është cilësuar se ñMaterialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me nr. 496 datë 21.09.2020.

Urdhër shpenzimin nr. 718 datë 16.11.2020 për vlerën 504,000 lekë nëpërmjet U Bank, është likuiduar Shoqëria ñLA.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 8, date 15.10.2020, fletë hyrjen nr. 533 datë 15.10.2020, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban 15.10.2020, i firmosur nga A. C. , K. S. dhe L. F. ku është cilësuar se ñMaterialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me nr. 533 datë 15.10.2020.
Urdhër shpenzimin nr. 858 datë 31.12.2020 për vlerën 13,497,500 lekë nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria ñTri.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 3905.4551 date 30.12.2020, fletë hyrjen nr. 717, datë 30.12.2020, procesverbali i pritjes dhe kontrollit dhe administrimit të mallit mban 30.12.2020 i firmosur nga A. C. , K. S. dhe L. F. ku është cilësuar se ñMaterialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me Fletë hyrjen nr. 717, datë 30.12.2020.
Urdhër shpenzimin nr. 66 datë 23.02.2021 për vlerën 776,450 lekë nëpërmjet BKT, është likuiduar Shoqëria ñTri.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 3905.5741 date 05.02.2021, fletë hyrjennr. 737, datë 05.02.2021, procesverbali i pritjes dhe kontrollit dhe administrimit të mallit mban 08.02.2021 i firmosur nga A. C. , K. S. dhe L. F. ku është cilësuar se ñMaterialet u kontrolluan nga komisioni dhe janë sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me Fletë hyrjen nr. 737, datë 05.02.2021.

3. Proçedura e prokurimit me objekt "Blerje materiale Respiratori dhe Monitori per Reaniminacionin", viti 2020.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt blerje materiale Respiratori dhe Monitori per Reaniminacionin viti 2020		
1. Urdhër Prokurimi nr. 36/6 datë 06.08.2020 2. Lloji i Procedurës së Prokurimit ñProcedurë e hapurò	3. Njësia e prokurimit Urdhër nr. 36/6 datë 06.08.2020 - E. T. me detyrë me detyrë inxhinier biomedikal - E. Xh. me profesion ekonomiste. M. S. , specialist i sektorit te prokurimeve.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 29/7 datë 10.06.2020 - D. M. , mjek shef i shërbimit të reaminacionit - B. V. , me profesion jurist - R. J. me profesion ekonomist
5. Fondi Limit (pa tvsh) 8,066,067 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 7,082,100 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 983,967
8. Data e hapjes së tenderit 31.08.2020	9. Burimi Financimit Fond nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër _2___OE b) Sõkualifikuar ska OE, c) Kualifikuar___2__ OE
11. Ankimime ñFe.ò Shpk APPï sõka; KPP-Ka Mon. Shpk	12. Përgjigje Ankesës nga AK -Ka	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik Ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e marrëveshjes kuadër nr. 36/22 prot., datë 30.10.2020 16. Lidhja e kontratës nr. 36/27 prot., datë 11.11.2020	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 8,066,067 lekë 17. Vlera e kontratës (me tvsh) 4,097,160 leke	

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.)të A.P.P, u konstatua se:

Fondi i këtij i këtij investimi është akorduar nga Buxheti i Shtetit me vlerë 8,066,067 lekë.
Kjo procedurë është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike.
-Me kërkesën nr. 194 prot., datë 06.04.2020 drejtuar G. H. me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimeve, E. O. me detyrë përgjegjëse e sektorit të planifikimit, ka bërë kërkesë për blerje materiale Respiratori dhe Monitori për Reaniminacionin, fond i cili është planifikuar në investimet e vitit 2020, me financim nga fondet e buxhetit të Shtetit (Ministria e Mbrojtjes).
SUT me shkresën nr. 862 prot., datë 08.05.2020 SUT, i kërkon Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, shikimin e mundësisë së zhvillimit të proçedurës së prokurimit me objekt blerje materiale Respiratori dhe Monitori për Reaniminacionin, pasi këto materiale mjekësore specifike janë emergjente për shërbimet e SUT.
SUT me shkresën nr. 1202 prot., datë 26.06.2020 SUT, i kërkon Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kërkesë për prokurim të përqendruar për blerje materiale Respiratori dhe Monitori për Reaminacionin, pasi këto materiale mjekësore specifike janë emergjente për shërbimet e SUT.
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me shkresën nr. 862 prot., datë 08.05.2020, , i delegon të drejtën e kryerjes së procedurës së prokurimit.
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me shkresën nr. 3075/1 prot. datë 07.07.2020, kërkon informacion në lidhje me artikujt, sasitë dhe fondin limit respektivisht për secilën procedurë të prokuruar gjatë vitit 2019, arsyet e përdorimit të testimit të tregut gjatë përllogaritjes së fondit limit, krahasuar me vitin paraardhës, arsyet e dërgimit të testimit të tregut në një numër të kufizuar operatorësh ekonomik, si dhe regjistrin e parashikimeve të viti 2020.
Me shkresën nr. 3075/3 prot., datë 22.07.2020, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në kompetencat deleguara përshin edhe : Përcaktimin e llojit të procedurës së prokurimit, përfshirja në regjistrin e parashikimit të prokurimeve në sistemin e prokurimit elektronik, lidhja dhe ndjekja e zbatimit të kontratës.
Me urdhër të Drejtorit të Spitalit nr. 36, datë 01.06.2020, është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike i përbërë nga D. M. me detyrë shef i shërbimin të reaniminiacionit, E. S. me detyrë mjek anestezis, E. T. specialist pajisjesh.
Me protokoll nr. 36/1 datë 05.06.2020, grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike, ka hartuar specifikimet teknike.
Me urdhër të Drejtorit të Spitalit nr. 36 /2, datë 08.06.2020, është ngritur grupi i punës për argumentin e fondit limit i përbërë nga M. P. me profesion ekonomiste, Zh. H. me profesion ekonomiste, R. J. me profesion ekonomiste.
Me dokument të protokolluar nr. 36/5 datës 22.06.2020 grupi i përllogaritjes së vlerës së kontratës, i ngritur me urdhrin e drejtorit të spitalit 29/2, datë 22.05.2020 ka përcaktuar vlerën 8,066,067 lekë pa TVSH dhe 9,679,280 lekë me TVSH.
Pra, përllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në vlerën 8,066,067 lekë, pas çmimit mesatar zë për zë ofruara nga operatorët ñM.ò Shpk, ñB.ò Shpk, ñA.ò Shpk.
Nga grupi për llogaritjen e vlerës limit të kontratës, ***nuk është dhënë asnjë argumentim*** *përse nuk është marrë për bazë edhe vlera e kontratave të mëparshme të ngjashme, të realizuara po nga vetë Institucioni n.q.s ka, ose i spitaleve te tjera (QSUT, Shefqet Ndroqi etj)., ose pse një numër kaq i kufizuar operatoresh, pra pse tre dhe jo mbi pesë.*
Veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 59, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se ñNë përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet tëi referohet një ose më shumë alternativave të renditura si mëposhtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave

(INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe
a) çmimet e tregut;ose/dhe
b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga
autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe
ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.
Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohetò.
Si konkluzion, përllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, i spitaleve te tjera (QSUT, Shefqet Ndroqi, spitaleve private etj), veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 59, pika 2,
Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi M. P. , Zh. H.j, R. J..
Me urdhër të Drejtorit të Spitalit me nr. 36/6 datë 06.08.2020, është përcaktuar procedura e prokurimit ñProçedurë e hapurò, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushte janë përcaktuar për një periudhë 12-mujore, është ngritur njësia e prokurimit e përbërë nga E. T. me detyrë inxhinier biomedikal, E. Xh. me profesion ekonomiste, M. S. me profesion jurist.
Me urdhër të Drejtorit të Spitalit me nr. 36/7 datë 06.08.2020, është ngritur komisioni i prokurimit i përbërë nga D. M. me detyrë shef i shërbimit të reaminacionit, B. V. me profesion jurist, R. J. me profesion ekonomiste.
- *Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim/specifikimet teknike.*
Kërkesat për kualifikim janë miratuar me proçesverbalin nr. 1, datë 06.08.2020 të nga njësia e prokurimit e përbërë nga E. T. , E. Xh. , M. S. . Në këto kërkesa nuk janë dhënë arsye konkrete në argumentimin e kritereve të vlerësuara për objektin e prokurimit, në raport me natyrën dhe përmasat e këtij objekti
Konkretisht, në nenin 61, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, parashikohet se: "Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit".
Nuk ka një dokument shkresor (procesverbal etj) të njësisë së prokurimit, ku të jenë miratuar dokumentet e tenderimit (D.T.) dhe në veçanti nuk ka një dokument shkresor ku të jenë përcaktuar kriteret e vlerësimit, edhe pse në S.P.E, është përcaktuar çmimi më i ulët. Konkretisht, në nenin 61, pika 1, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, parashikohet se: Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje më këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi, ndërsa në pikën 2 të këtij neni parashikohet se: Seti i dokumenteve të tenderit firmoset në çdo faqe nga njësia e prokurimit.

Për mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit e përbër nga E. T. , E. Xh. , M. S. .
Njoftimi i kontratës është bërë me nr 36/8 prot., datë 06.08.2020.
Me urdhër nr. 36/9, datë 27.08.2020, të V. R. me detyrë zv/ drejtor teknik, është bërë pezullimi i procedurës së prokurimit, për arsye rekomandimeve të ardhura nga koordinimi me APP.
Me shkresën nr. 36/10 prot., datë 27.08.2020, është bërë ndryshimin e specifikimeve teknike, ndryshim i cili është publikuar në S.P.E më datën 27.08.2020.
Me ndryshimin e dokumenteve të tenderit (Specifikimeve teknike), nuk është bërë shtyrja e afatit kohor për dorëzimin e ofertave me 5 ditë, veprim në kundërshtim me neni 42, pika 2/1 e ligjit të prokurimit publik.
Me urdhër nr. 36/11, datë 27.08.2020, të V.R. me detyrë zv/ drejtor teknik është bërë, heqja e pezullimit të procedurës së prokurimit.
Me shkresën nr. 36/12 prot, datë 02.09.2020, komisioni i vlerësimit të ofertave i drejtohet G. H. në cilësinë e përgjegjësit të sektorit të prokurimeve për verifikim në sistemin e drejtësisë të subjekteve pjesëmarrës në këtë proçedurë prokurimi, për operatorët ekonomik ñF.ò Shpk dhe ñM.ò Shpk.
Me shkresën nr. 36/13 prot, datë 02.09.2020, Gen. Hal. në cilësinë e përgjegjësit të sektorit të prokurimeve, i kthen përgjigje komisionit të vlerësimit të ofertave për rezultatin në regjistrin gjyqësorë të Ministrisë së Drejtësisë të subjekteve pjesëmarrës në këtë proçedurë prokurimi, duke bashkëlidhur dhe çertifikata elektronike respektive për çdo subjekt të kërkuar.
Zhvillimi i procedurë së prokurimit.
Në këtë procedurë prokurimi kanë marr pjesë operatorët operatorë ekonomike.
-Operatori ekonomik òFe.ò Shpk, me ofertë në vlerën 7,082,100 lekë.
- Operatori ekonomik òMON. òShpk, me ofertë në vlerën 7,962,400 lekë.
Pas vlerësimit të KVO u kualifikua dhe shpall fitues Operatori ekonomik òFed.ò Shpk, me ofertë në vlerën 7,082,100 lekë.
Me ankesën nr. 1758 prot., datë 09.09.2020, ka kryer ankimim operatori ekonomik ñMon.ò Shpk drejtuar Titullarit të Autoriteti Kontraktor për kualifikim të padrejtë të Operatori ekonomik òF.ò Shpk, me arsyetimin se òProduktet e listuara nga Operatori ekonomik òF.ò Shpk, nuk janë kontabile me pajisjet e instaluara në këtë spital. Mos përputhja e produkteve të ofruara nga ky operator, e bënë ofertën e këtij operatori ekonomik të papërgjegjshme dhe të rrezikshme për jetën e pacientëve.....ò, si dhe kërkon anullimin e procedurës së prokurimit.
Me urdhër nr. 36/14 prot., datë 09.09.2020 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, është bërë pezullimi i procedurës së prokurimit, për arsye të ankesës së operatorit ekonomik ñM.ò Shpk.
Me urdhër nr. 36/14 prot., datë 09.09.2020 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, është ngritur komisioni i shqyrtimit të ankesës të operatorit ekonomik ñM.ò Shpk i përbërë nga G. H. me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimeve, E. T. me detyrë specialist pajisjesh dhe Pelivan Sulovari me detyrë kryeinfermier i shërbimit të reaniminacionit.
Me shkresën nr. 36/16 prot, datë 09.09.2020, komisioni i shqyrtimit të ankesës i rekomandon Titullarit të Autoritetit Kontraktor mos pranimin e ankesës, si të pa bazuara në ligj.
Me shkresën nr. 1758/1 prot, datë 15.09.2020 Titullari i Autoritetit Kontraktor, njofton operatorin ekonomik ñMò Shpk, për mos marrje në konsideratë të ankesës së tij.
Me ankesën nr. 1908 prot., datë 30.09.2020 operatori ekonomik ñM.ò Shpk i është drejtuar komisionit të prokurimit publik për kualifikim të padrejtë operatorit ekonomik ñF.ò Shpk dhe për anullimin e procedurës së prokurimit.

Komisionit i prokurimit publik me vendim nr. 1168/1 prot., datë 29.09.2020, ka bërë pezullimin e procedurës së prokurimit.
Me urdhër nr. 36/17, datë 30.09.2020 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, është bërë pezullimi i procedurës së prokurimit, për arsye të ankesës së operatorit ekonomik ñM.ò Shpk.
Me shkresën nr. 1931/1 prot., datë 05.10.2020 nga Autoriteti Kontraktor, i është dhen informacion Komisionit të Prokurimit Publik.
Komisionit i prokurimit publik me vendim nr. 452/2020, ka bërë mos pranimin e ankesës së operatorit ekonomik ñM.ò . Duke urdhëruar Autoritetin Kontraktor të anulloj vendimin e KVO.
Me urdhër nr. 36/18, datë 20.10.2020 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, është bërë heqje e pezullimit dhe kërkohet rivlerësimi i procedurës së prokurimit, referuar vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik.
Raporti përmbledhës nga komisioni i vlerësimit është hartuar me nr. 29/23 prot.,, datë 23.10.2020, raport i cili është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor, ku ka shpallur fitues operatorin ekonomik òF.ò Shpk, me ofertë në vlerën 7,082,100 lekë.
Në S.P.E. e A.P.P, është kryer njoftimi i fituesit, nga ku A.P.P e ka bërë aktive publikimin e njoftimit të fituesit në datën 20.10.2020.
Titullarit të Autoritetit Kontraktor me urdhrin nr. 36/21, datë 20.10.2020, ka ngarkuar njësinë së prokurimit për administrimin e dokumenteve të tenderit të dorëzuar nga operatori ekonomik fitues.
Komisioni i vlerësimit të ofertave, gjithashtu ka hartuar inventarin pa datë, për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik i shpallur fitues ñFed.ò Shpk.
Marrëveshja kuadër është lidhur me nr. 36/22 prot., datë 30.10.2020, ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës të përfaqësuar nga A. Z. në cilësinë e Drejtorit të Spitalit dhe operatorit/e shoqërisë ñF.ò Shpk në vlerën 8,066,067 lekë pa TVSh, kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër është për periudhën 30.10.2020 deri më 30.10.2021, me datë fillimi nënshkrimin e saj.
Në datën 06.11.2020 në S.P.E. e A.P.P, është kryer publikimi i njoftimit të lidhjes së kontratës, nga ku A.P.P. e ka bërë aktive këtë publikim në datën 06.11.2020 .
Me urdhër nr. 26/23, datë 30.1012020 të Drejtorit të Spitalit, është ngritur grupi i punës për monitorimin dhe zbatimin e kontratës dhe të marrjes në dorëzim të pajisjes i përbërë nga Dritan Muzha me detyrë shef i shërbimit të reaniminacionit, E. O. me detyrë përgjegjëse e sektorit të planifikimit dhe G. P. me detyrë specialist pajisjesh.
Me shkresën nr. 597 prot, datë 10.11.2020, grupi i punës për monitorimin dhe zbatimin e kontratës drejtuar G. H. , i kërkon lidhje kontrate për blerje materiale respiratori dhe monitori për reaniminacion në vlerën 4,097,160 lekë me afat 31.12.2020, duke i kërkuar dhe listën e artikujve.
Me shkresën nr. 36/25prot, datë 11.11. 2020,Titullari i Autoritetit Kontraktor, i kërkon operatorit ekonomik kërkesë për dhënie oferte blerje materiale respiratori dhe monitori për reaniminacion, duke i përcaktuar llojin e artikujve, njësinë dhe sasitë, pa i përcaktuar çmimin për njësi.
Operatori ekonomik ñF.ò paraqet ofertën e cila është protokolluar me nr. 36/26 prot., datë 11.11.2020, ku ka përcaktuar çmimin për secilin artikuj, me vlerë totale 3,414,300 lekë pa TVSH dhe me TVSH 4,097,160 lekë .
Kontrata është lidhur me nr. 36/27 prot., datë 11.11.2020 ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës të përfaqësuar nga A. Z. në cilësinë e Drejtorit të Spitalit dhe operatorit/e shoqërisë ñFed.ò Shpk në vlerën 4,097,160 lekë me TVSh, kontrata duhet të fillojë zbatimin me nënshkrimin e palëve deri më 31.12.2020.

Në neni 17 të kontratës është përcaktuar se ñ Furnizuesi i mallit që është objekt i kësaj kontrate, i paraqet blerësit çertifikatën e origjinës dhe të cilësisë së mallit së bashku me faturën e shitjes.
Zbatimi i kontratës
Me urdhër shpenzimin nr. 394, datë 24.12.2020 për vlerën 182,400, nëpërmjet Raiff. Ban. është likuiduar Shoqëria Fed. . Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale respiratori dhe monitori. Dokumenti vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 532, date 26.11.2020, fletë hyrja nr. 619, datë 27.11.2020, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban datën 26.11.2020, i firmosur nga D. M. , E. O. dhe V. P. , ku është cilësuar se ñMalli u kontrolluar nga komisioni dhe konstaton që është sipas standardeve dhe specifikimeve teknike brenda afatit të kërkuar. Ky artikull do të bëhet hyrje me nr. 619, datë 27.11.2020.
Me urdhër shpenzimin nr. 403, datë 28.12.2020 për vlerën 1,319,400 lekë nëpërmjet Raiff. Bank është likuiduar Shoqëria Fe. . Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale respiratori dhe monitori: Dokumenti vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 585, date 16.12.2020, fletë hyrja nr. 646, datë 18.12.2020, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban datën 16.12.2020, i firmosur nga D. M. , E. O. dhe V. P. , ku është cilësuar se ñMalli u kontrolluar nga komisioni dhe konstaton që është sipas standardeve dhe specifikimeve teknike brenda afatit të kërkuar. Ky artikull do të bëhet hyrje me nr. 646, datë 18.12.2020.
Me urdhër shpenzimin nr. 404, datë 28.12.2020 për vlerën 548,640 lekë nëpërmjet R. Ban. është likuiduar Shoqëria F. . Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale respiratori dhe monitori: Dokumenti vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 584, date 16.12.2020, fletë hyrja nr. 645, datë 18.12.2020, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit datë 16.12.2020, i firmosur nga D. M. , E. O. dhe V. P. , ku është cilësuar se ñMalli u kontrolluar nga komisioni dhe konstaton që është sipas standardeve dhe specifikimeve teknike brenda afatit të kërkuar. Ky artikull do të bëhet hyrje me nr. 645, datë 18.12.2020.
Me urdhër shpenzimin nr. 413, datë 31.12.2020 për vlerën 2,046,720 lekë, nëpërmjet Raiff. Ban. është likuiduar Shoqëria F. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale respiratori dhe monitori: Dokumenti vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 610, date 29.12.2020, fletë hyrja nr. 702, datë 29.12.2020, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban 29.12.2020, i firmosur nga D. M. , E. O. dhe V. P. , ku është cilësuar se ñMalli u kontrolluar nga komisioni dhe konstaton që është sipas standardeve dhe specifikimeve teknike brenda afatit të kërkuar. Ky artikull do të bëhet hyrje me nr. 702, datë 29.12.2020.
Të katër urdhër shpenzimet nuk kanë asnjë dokument vërtetues (shoqërues) në kundërshtim me neni 17 të kontratës është përcaktuar në mënyrë eksplicite se ñ *Furnizuesi i mallit që është objekt i kësaj kontrate, i paraqet blerësit çertifikatën e origjinës dhe të cilësisë së mallit së bashku me faturën e shitjes".*
Veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik, me ndryshimet vijuese të tij, pika 54, ku është shprehur në mënyrë eksplicite "*Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat përgjegjëse për financat duhet të kontrollojnë në se fletëhyrja origjinale ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si proces verbal i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve për investimet, procesverbal i marrjes në dorëzim të mallit, certifikatë origjinale dhe cilësie, fletë analize laboratorike, garanci malli et*j.".
Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi komisioni i kontrollit dhe administrimit të mallit të përbërë nga D. M. , E. O. dhe G. P.

4. Proçedura e prokurimit me objekt "Blerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e Kirurgjisë vaskulare dhe Kirurgjisë maksilofaciale në SUT"ndarë në dy lote (një operator një lot)", viti 2019.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e Kirurgjisë vaskulare dhe Kirurgjisë maksilofaciale në SUT"ndarë në dy lote (një operator një lot)		
1. Urdhër Prokurimi Nr Nr. 86/13 Datë 25.04.2019 2. Lloji i Procedurës së Prokurimit ñProcedurë e hapurò	3. Njësia e prokurimit Urdhër 86/13 Datë 25.04.2019 - G. H. Përgjegjës për prokurim me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimit. - Dr. B. P. , kirurge e përgjithshme. E. T. , Juriste.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 86/14 datë 25.04.2019 - F. B. Përgjegjëse e sektorit të kostos me profesion ekonomiste - Dr. M. Xh. , M. angiolog - Dr. L. B. , Mjeke kirurge maksilofaciale - B. V. me detyre jurist - M. S. me detyre specialist prokurimi
5. Fondi Limit (pa tvsh) 17,248,756 lekë Loti nr. 1- 2,606,744 Loti nr. 2 ï 14,642,012	6. Oferta fituese (pa tvsh) Loti nr. 1- 2,586,000 Loti nr. 2 ï 14,392,995	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) Loti nr. 1- 20,744 Loti nr. 2 ï 249,017
8. Data e hapjes së tenderit 20.05.2019 ora 10:00	9. Burimi Financimit Fond nga Buxheti i Shtetit (Ministria e Mbrojtjes)	10. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër _1___OE b) Sõkualifikuar __0___OE, c) Kualifikuar___1__ OE
11. Ankimime Nuk ka APPï sõka; KPP- nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK -jo2	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik Nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës nr. 1 nr. 86/26 Prot ., datë 05.07.2019	15. Vlera e kontratës (me tvsh) Për lotin nr. 1 ï 1,051,400 lekë pa tvsh dhe 1,082,880 lekë me tvsh Për lotin nr. 2 ï 5,428,990 lekë pa tvsh dhe 6,005,848 lekë me tvsh	
16. Lidhja e kontratës nr.2 nr. 86/29 prot., datë 03.12.2019	17. Vlera e kontratës (me tvsh) 146,500 Leke pa tvsh	
18. Lidhja e kontratës nr. 3 nr. 86/32 prot., datë 17.04.2020	19. Vlera e kontratës (me tvsh) Për lotin nr. 1 ï 1843,000 lekë pa tvsh dhe 1,882,000 lekë me tvsh Për lotin nr. 2 ï 8,777,330 lekë pa tvsh dhe 9,778,158 lekë me tvsh	

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.)të A.P.P, u konstatua se:
Fondi i këtij i këtij investimi është akorduar nga Buxheti i Shtetit (sipas PBA) në vlerën 17,248,756 lekë për dy vite.
Kjo procedurë është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike të SUT.
Me kërkesën nr. 176 prot, datë 25.03.2019 drejtuar G. H. me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimeve, E. O. me detyrë përgjegjëse e sektorit të planifikimit, ka bërë kërkesë për prokurim me objekt: "Blerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e Kirurgjisë vaskulare dhe Kirurgjisë maksilofaciale në SUT", për nevojat e SUT, fond i cili është planifikuar me financim nga fondet e buxhetit të Shtetit (Ministria e Mbrojtjes).
Me urdhër të Drejtorit të Spitalit nr. 86, datë 26.03.2019, është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike i përbërë nga: Dr. M. Xh. me detyrë mjek angiolog, Dr. B. P. me detyrë kirurge e përgjithshme, E. Sh. me detyre kryeinfermiere.

Me urdhër të Drejtorit të Spitalit nr. 86/1, datë 26.03.2019, është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike i përbërë nga: Dr. L. B. me detyrë kirurge maksilofaciale, Dr. M. S. me detyrë kirurg maksilofacial, Dr. A. T. me detyre kirurge maksilofaciale.
Me protokoll nr. 86/2 datë 05.04.2019 grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike i përbërë nga Dr. L. B. . Dr. M. S. , Dr. A. T. kanë hartuar specifikimet teknike.
Me protokoll nr. 86/3 datë 05.04.2019 grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike i përbërë nga Dr. M. Xh. , Dr. B. P. , E. Sh. ka hartuar specifikimet teknike.
Me urdhër të Drejtorit të Spitalit nr. 86/4, datë 05.04.2019, është ngritur grupi i punës për argumentin e fondit limit i përbërë nga E. O. me detyrë përgjegjëse e sektorit të planifikimit me profesion ekonomiste, Zh. H. me detyre specialiste finance me profesion ekonomiste, E. Xh. me detyre specialiste planifikimi me profesion ekonomiste.
Me urdhër të Drejtorit të Spitalit nr. 86/5, datë 05.04.2019 është ngritur grupi i punës për argumentin e fondit limit për ñBlerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e kirurgjisë vaskulareò i përbërë nga E. O. me detyrë Përgjegjëse e sektorit të planifikimit me profesion ekonomiste, Zh. H. me detyre specialiste finance me profesion ekonomiste, E. Xh. me detyre specialiste planifikimi me profesion ekonomiste.
Loti 1. Blerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e Kirurgjisë maksilofaciale.
Me dokument të protokolluar nr. 86/12 datës 18.04.2019 grupi i përllogaritjes së fondit limit, i ngritur me urdhrin e drejtorit të spitalit 86/4, datë 05.04.2019 i përbërë nga E. O. , Zh. H. , E. Xh. , është përcaktuar vlera 2,606,744 lekë pa TVSH dhe 2,691,886 lekë me TVSH.
Loti 2. "Blerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e Kirurgjisë vaskulare".
Me dokument të protokolluar nr. 86/11 datës 18.04.2019 grupi i përllogaritjes së fondit limit, i ngritur me urdhrin e drejtorit të spitalit 86/5, datë 05.04.2019 i përbërë nga E. O. , Zh. H. , E. Xh. , është përcaktuar vlera 14,642,012 lekë pa TVSH dhe 15,949,118 lekë me TVSH.
Përllogaritja është kryer duke marr ofertat e tre operatoreve ekonomik G.-A, E., G., duke nxjerr çmimin mesatar për të 59 artikujt dhe duke i krahasuar me kontratën e mëparshme nr. 44/24, datë 26.04.2017. Në rast se artikulli nuk ka qenë në kontratën vjetër, është marr për bazë çmimi mesatar i tre operatorëve ekonomik. Në rast se ka qenë në kontratën e vjetër, është marr për bazë çmimi më i vogël P.sh artikulli nr. 8 ñkateter embolektomie 5 F, çmimi mesatar 12,566 lekë, çmimi i kontratës nr. 44/24, datë 26.04.2017 në vlerën 12,060 lekë është marr për bazë çmimi 12,060 lekë x sasia 15 copë = 180,900 lekë.
Përllogaritja është kryer duke marr ofertat e tre operatoreve ekonomik G.-A, E., G., duke nxjerr çmimin mesatar për të 23 artikujt dhe duke i krahasuar me kontratën e mëparshme nr. 147/8, datë 05.12.2017. Në rast se artikulli nuk ka qenë në kontratën vjetër, është marr për bazë çmimi mesatar i tre operatorëve ekonomik. Në rast se ka qenë në kontratën e vjetër, është marr për bazë çmimi më i vogël P.sh artikulli nr. 17 ñkokë kaçavide vida 2.0 mm, centraleñ, çmimi mesatar 22,903 lekë/copë , çmimi i kontratës nr. 147/8, datë 05.12.2017 në vlerën 22,260 lekë/copë është marr për bazë çmimi 22,260 lekë/copë x sasia 1 copë = 22,260 lekë.
Pra, përllogaritja e vlerës së kontratës, në total për të dy lotet, është përcaktuar në vlerën 17,248,756 lekë, sipas çmimit të marrë nga testimi i tregut nga operatorët ekonomik G.-A, E., G..
Me urdhër të Drejtorit të Spitalit me nr. 86/13 Prot datë 25.04.2019, është ngritur njësia e prokurimit e përbërë nga G. H. me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimeve, Dr. B. P. mjeke kirurge dhe E. T. juriste.
Nga grupi për llogaritjen e vlerës limit të kontratës,***nuk është dhënë asnjë argumentim*** *përse nuk është marrë për bazë edhe vlera e kontratave të mëparshme të ngjashme, të realizuara nga*

spitalet e tjera (QSUT, Shefqet Ndroqi,etj pse jo dhe spitalet private), ose pse një numër kaq i kufizuar operatoresh, pra pse tre dhe jo mbi pesë.

Veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 59, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se ñNë përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet tõ referohet një ose më shumë alternativave të renditura si mëposhtë: Çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe

a) çmimet e tregut;ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

Si konkluzion, përllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, i spitaleve te tjera (QSUT, Shefqet Ndroqi, spitaleve private etj) dhe pse një numër kaq i kufizuar operatoresh, pra pse tre dhe jo mbi pesë, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 59, pika 2.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi grupi i llogaritjes së vlerës së kontratës i përbërë nga E. O. , Zh. H. , E. Xh. .

Me urdhër të Drejtorit të Spitalit me nr. 7/6 Prot datë 16.04.2020, është ngritur njësia e prokurimit e përbërë nga G. H. Përgjegjës me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimeve, M. S. specialist prokurimi me detyrë jurist dhe M. P. me profesion ekonomiste me detyrë specialiste e planifikimit.

Me urdhër të Drejtorit të Spitalit me nr. 7/7 Prot datë 21.06.2020, është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga E. O. , Zh. H. , E. Xh. .

Me urdhër të Drejtorit të Spitalit me nr. 86/14 Prot datë 25.04.2019, është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave , për lotin nr. 1 dhe nr.2, i përbërë nga F. B. përgjegjëse e kostos, M. Xh. mjek, L. B. mjeke, B. V. jurist dhe M. S. specialist prokurimi. Njëkohësisht është përcaktuar që procedura e prokurimit e hapur.

Me shkresën nr. 86/15, datë 25.04.2019, është bërë njoftimi i kontratës në S.P.E, Loti 1: Blerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e kirurgjisë maksilofaciale në SUT. Shumatorja e çmimeve për njësi është në vlerën 564,511.34 lekë, ndërsa fondi limit/vlera e pritshme e kontratës është 2,606,744 lekë pa Tvsh.

Loti 2: Blerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e kirurgjisë vaskulare në SUT. Shumatorja e çmimeve për njësi është në vlerën 4,539,543 lekë pa tvsh. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës është 14,642,012 lekë pa Tvsh.

Ofertimi nga operatorët ekonomik do të bëhet me çmim për njësi dhe për efekt krahasimi, edhe vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi të zërave të furnizimit, por pa tejkaluar vlerën e përcaktuar të fondit limit për çdo lot të përllogaritur sipas sasive të pritshme për 24 muaj.

Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër "Blerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e kirurgjisë vaskulare dhe kirurgjisë maksilofaciale në SUT", ndarë në dy lote (një operator një lot). Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë 24 mujore nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër.

- *Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim/specifikimet teknike.*

Kërkesat për kualifikim janë miratuar me proçesverbalin e datës 25.04.2019, të firmosura nga njësia e prokurimit e përbërë nga G. H. , B. P. , E. T. .

Në këto kërkesa nuk janë dhënë arsye konkrete në argumentimin e kritereve të vlerësuara për objektin e prokurimit, në raport me natyrën dhe përmasat e këtij objekti

Konkretisht, në nenin 61, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, parashikohet se: "Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit".

Nuk ka një dokument shkresor (procesverbal etj) të njësisë së prokurimit, ku të jenë miratuar dokumentet e tenderimit (D.T.), dhe në veçanti nuk ka një dokument shkresor ku të jenë përcaktuar kriteret e vlerësimit, edhe pse në S.P.E është përcaktuar çmim për njësi. Konkretisht, në nenin 61, pika 1, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, parashikohet se: Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje më këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi, ndërsa në pikën 2 të këtij neni parashikohet se: Seti i dokumenteve të tenderit firmoset në çdo faqe nga njësia e prokurimit.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit e përbërë nga G. H. , B. P. , E. T. .

Me date 20.05.2019 ora 10:00 është hapur procedura për vlerësimin e ofertave dhe është mbajtur proces verbal për marrjen në dorëzim të mostrave nga operatori ekonomik ñO.E.S Dis.ò.

Zhvillimi i procedurë së prokurimit.

Në të procedurë prokurimi, për Lotin nr. 1 dhe të 2 ka marr pjesë operatori ekonomik ñO.E.S Dis.ò Shpk me vlerat respektive 2,586,000 lekë 14,392,995 lekë.

Pas vlerësimit të KVO u kualifikua dhe shpall fitues operatori ekonomik ñO.E.S Dis.ò Shpk me ofertë për lotin nr. 1 në vlerën 2,586,000lekë dhe për lotin nr. 2 në vlerën 14,392,995 lekë.

Nuk ka patur ankesa, pasi ka vetëm një operator dhe vetëm një ofertë për të dyja lotet e sipërpërmendura.

Në datën 05.06.2019 është bërë raporti përmbledhës i procedurës së prokurimit duke shpallur fitues operatori ekonomik ñO.E.S Dis.ò Shpk.

Në datë 05.06.2019 është bërë njoftimi i fituesit për lotin nr. 1 dhe për lotin nr. 2, përkatësish me shkresat me nr. 86/17 prot, dhe 86/18 prot.,

Me shkresën nr. 86/19 prot., datë 05.06.2019, është urdhëruar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor për administrimin e dokumentacionit dhe për lidhjen e kontratës me operatorin e shpallur fitues.

Me datë 21.06.2019, me nr. 86/20 prot., datë 21.06.2019 është nënshkruar marrëveshja kuadër ndërmjet SUT dhe operatorit ekonomik ñO.E.S Dis.ò Shpk në vlerën e fondit limit 17,248,756 lekë për të dy lotet dhe me afat dy vjeçar, edhe pse operatori ekonomik ñO.E.S Dis.ò Shpk me

për lotin nr. 1 ka paraqitur ofertë në vlerën 2,586,000lekë dhe për lotin nr. 2 ka paraqitur ofertë në vlerën në vlerën 14,392,995 lekë, me shumatore për të dy lotet 16,978,995 lekë. Pra diferenca nga fondi limit në ofertën fituese është në vlerën 269,761 lekë (17,248,756 - 16,978,995 = 269,761).
Me urdhër të Titullari i Autoritetit Kontraktor, është ngritur grupi i punës për monitorimin dhe zbatimin e marrëveshjes kuadër me nr. 86/21 prot., datë 21.06.2019 i përbërë nga Medien Xh. K. , L. B. anëtare dhe E. O. anëtare.
Me shkresën nr. 86/22 prot., datë 26.06.2019, është bërë njoftimi i kontratës së nënshkruar për publikim në APP.
Në datë 26.07.2019 është mbajtur proces-verbal për kthimin e mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik ñO.E.S Dis.ò Shpk.
Me shkresën nr. 86/23 prot., datë 01.07.2019, është bërë kërkesë për lidhje kontrate për shërbimin e kirurgjisë vaskulare dhe maksilofaciale në SUT drejtuar G. H. me detyrë përgjegjës sektori i prokurimeve, nga grupi i monitorimit të MK i përbërë nga Dr. M. Xh. , Dr. L. B. , E. O.
Me shkresën nr. 86/24 prot., date 04.07.2019, është bërë kërkesë për dhënie çmimi drejtuar operatori ekonomik ñO.E.S Dis.ò Shpk.
Kontrata është lidhur me 86/26 prot., datë 05.07., ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës të përfaqësuar nga A. Z. në cilësinë e Drejtorit të Spitalit dhe operatorit/e shoqërisë ñO.E.S Dis.ò Shpk, për lotin nr. 1 në vlerën 1,082,880 lekë me tvsh për 13 artikuj, dhe për lotin nr. 2 për 47 artikuj në vlerën 6,005,848 lekë me tvsh, kontrata duhet të fillojë zbatimin me nënshkrimin e palëve me deri më 31.12.2019.
Autorizimi i dhënë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për shoqërisë ñO.E.S Dis.ò Shpk është me nr. 120/54 prot, datë 28.06.2018 me nr. 193, datë 26.06.2018 ñPër tregtim me shumicë pajisje mjekësoreò me afat vlefshmërie të autorizimit deri më datë 30.06.2019. Pra nga grupi i monitorimit të kontratës dhe sektori juridik, nuk është kërkuar rinovim autorizimi nga shoqëria ñO.E.S Dis.ò Shpk, si dhe vet operatori nuk ka paraqitur autorizim pas datës 01.07.2019 dhe deri në përfundim të kontratës.
Me shkresën nr. 757 prot., datë 03.12.2019, është bërë kërkesë për lidhje kontrate për shërbimin e kirurgjisë maksilofac iale në SUT drejtuar G. H. me detyrë përgjegjës sektori i prokurimeve, nga grupi i monitorimit të Marrëveshjes Kuadër i përbërë nga Dr. M. Xh. , Dr. L. B. , E. O. .
Me shkresën nr. 86/27 prot., është bërë kërkesë për dhënie çmimi drejtuar Shoqërisë ñO.E.S Dis.ò Shpk.
Kontrata është lidhur me nr. 86/29 prot., datë 03.12.2019, ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës të përfaqësuar nga A. Z. në cilësinë e Drejtorit të Spitalit dhe operatorit/e shoqërisë ñO.E.S Dis.ò Shpk, për lotin nr. 1 në vlerën 146,500 lekë me tvsh për 3 artikuj, kontrata duhet të fillojë zbatimin me nënshkrimin e palëve me deri më 31.12.2019.
Me shkresën nr. 197 prot., datë 10.04.2020, është bërë kërkesë për lidhje kontrate për shërbimin e kirurgjisë vaskulare dhe maksilofaciale në SUT, drejtuar G. H. me detyrë përgjegjës sektori i prokurimeve, nga grupi i monitorimit të Marrëveshjes Kuadër i përbërë nga Dr. M. Xh. , Dr. L. B. , E. O. .
Me shkresën nr. 86/30 Prot., datë 16.04.2020, është bërë kërkesë për dhënie çmimi drejtuar shoqërisë ñO.E.S Dis.ò Shpk.
Kontrata është lidhur me nr. 86/32 prot., datë 17.04.2020 ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës të përfaqësuar nga A. Z. në cilësinë e Drejtorit të Spitalit dhe operatorit/e shoqërisë ñO.E.S Dis.ò Shpk, për lotin nr. 1 në vlerën 1,882,000 lekë me tvsh për 13 artikuj dhe për lotin 2

në vlerën 9,778,158 lekë me tvsh për 51 artikuj, kontrata duhet të fillojë zbatimin me nënshkrimin e palëve deri më 31.12.2020.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të prokurimit operatori ekonomik fitues duhej të ishte sõkualifikuar me arsyetimin si më poshtë vijon:
Në pikën 2.3/e ñKapaciteti teknikò është përcaktuar ò Ofertuesi duhet te paraqesë certifikate ISO 9001:2015 (ose ekuivalent) te cilësisë për ofertuesin / distributor i mallrave objekt i kontratës, lëshuar nga nje organ i vlerësimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, te njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.
Ky operator nuk e ka përmbushur këtë kërkesë, pasi Kompania ñT. A.ò, nuk provohet që është e njohur nga Republika e Shqipërisë, për pasojë çertifikata ISO 90.1:2015 e lëshuar prej saj me nr. 01011361 date 20.12.2011 me vlefshmëri deri në datën 19.12.2020 , nuk është dokument i vlefshëm për tu marr në konsideratë për kualifikim.

Për sa trajtuar mësipërm, kualifikimi dhe shpallja fitues e shoqërisë operatorit ekonomik ñO.E.S Dis.ò Shpk, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 46 pika neni 53 pika 3, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñRregullat e Prokurimitò, i ndryshuar, neni 66 pika 3, Ligjin nr. 44/2015 ñKodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisëò nenet 108-118.
Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi komisionin e vlerësimit të ofertave të përbërë nga Dr. M. Xh. , Mjek angiolog, Dr. L. B. , Mjeke kirurge maksilofaciale, B. V. me detyre jurist, M. S. me detyre specialist prokurimi.
Pavarësisht shkeljeve dhe parregullsive ligjore ose rregullatore të përmendur si më sipër, veprimet e mësipërme nga KVO janë kryer nga mos njohja/ose keqinterpretimi i legjislacionit specifik të procedurave të prokurimit dhe në veçanti atij të mallrave dhe nuk kanë krijuar asnjë pasojë financiare në dëm Institucionit, pasi operatori ekonomik ñO.E.S Dis.ò Shpk është i vetmi operator në këtë procedurë prokurimi.
Likuiduar me:
-Urdhër shpenzimin nr. 663 datë 17.09.2019 për vlerën 708,880 lekë, nëpërmjet R. Bank është likuiduar Shoqëria ñO.E.S Dis.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 2843.4928, date 22.07.2019, fletë hyrja nr. 321, datë 22.07.2019, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban 22.07.2019, i firmosur nga L. B. , A. T. dhe M. S. ku është cilësuar se ñMalli u kontrolluar nga komisioni dhe konstaton që është sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me nr. 321, datë 22.07.2019.
-Urdhër shpenzimin nr. 665 datë 17.09.2019 për vlerën 3,796,548 lekë, nëpërmjet Raif. Bank është likuiduar Shoqëria ñO.E.S Dis.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 284344891, date 17.07.2019, fletë hyrja nr. 315, datë 17.07.2019 dhe nr. 315/1, datë 17.07.2019, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban 17.07.2019, i firmosur nga M. Xh. , B. P. dhe E. Sh. ku është cilësuar se ñMalli u kontrolluar nga komisioni dhe konstaton që është sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me nr. 315, datë 17.07.2019 dhe nr. 315/1, datë 17.07.2019.
-Urdhër shpenzimin nr. 756 datë 16.09.2019 për vlerën 739,912 lekë, nëpërmjet Raif. Bank është likuiduar Shoqëria ñO.E.S Dis.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 284345111, date 14.08.2019,

fletë hyrja nr. 360, datë 14.08.2019, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban datën 14.08.2019, i firmosur nga M. Xh. , B. P dhe E. Sh. ku është cilësuar se ñMalli u kontrolluar nga komisioni dhe konstaton që është sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje me nr. 360, datë 14.08.2019.
-Urdhër shpenzimin nr. 823 datë 24.10.2019 për vlerën 347,000 lekë, nëpërmjet Raiffeisen Bank është likuiduar Shoqëria ñO.E.S Dis.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 284345511, date 23.09.2019, fletë hyrja nr. 420, datë 23.09.2019, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban datën 23.09.2019, i firmosur nga L. B., A. T. dhe M. S. ku është cilësuar se ñMalli u kontrolluar nga komisioni dhe konstaton që është sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje nr. 420, datë 23.09.2019.
- Urdhër shpenzimin nr. 826 datë 24.10.2019 për vlerën 415,248 lekë, nëpërmjet Raiffeisen Bank është likuiduar Shoqëria ñO.E.S Dis.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 284345514, date 23.09.2019, fletë hyrja nr. 419, datë 23.09.2019, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban datën 23.09.2019, i firmosur M. Xh. , B. P. dhe E. Sh. ku është cilësuar se ñMalli u kontrolluar nga komisioni dhe konstaton që është sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje nr. 419, datë 23.09.2019.
-Urdhër shpenzimin nr. 849 datë 05.11.2019 për vlerën 198,400 lekë, nëpërmjet Raiffeisen Bank është likuiduar Shoqëria ñO.E.S Dis.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 284345691, date 08.10.2019, fletë hyrja nr. 445, datë 08.10.2019, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban datën 08.10.2019, i firmosur M. Xh., B. P. dhe E. S.i ku është cilësuar se ñMalli u kontrolluar nga komisioni dhe konstaton që është sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje nr.445, datë date 08.10.2019.
-Urdhër shpenzimin nr. 913 datë 13.11.2019 për vlerën 855,740 lekë, lekë nëpërmjet Raiffeisen Bank është likuiduar Shoqëria ñO.E.S Dis.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 284345931, date 31.10.2019, fletë hyrja nr. 11, datë 31.10.2019, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban datën 31.10.2019, i firmosur M. Xh. , B. P. dhe E. Sh. ku është cilësuar se ñMalli u kontrolluar nga komisioni dhe konstaton që është sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje nr. 11, datë date 31.10.2019.
-Urdhër shpenzimin nr. 1027 datë 12.12.2019 për vlerën146,500 lekë, nëpërmjet Raiffeisen Bank është likuiduar Shoqëria ñO.E.S Dis.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 284346252, date 04.12.2019, fletë hyrja nr. 70, datë date 04.12.2019, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban 05.12.2019, i firmosur M. Xh. , B. P. dhe E. Sh. ku është cilësuar se ñMalli u kontrolluar nga komisioni dhe konstaton që është sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje nr. 70, datë date 04.12.2019.
-Urdhër shpenzimin nr. 316 datë 21.05.2020 për vlerën 1,779,640 lekë, nëpërmjet Raif. Bank është likuiduar Shoqëria ñO.E.S Dis.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 284347330, date 28.04.2020, fletë hyrja nr. 256, datë date 28.04.2020, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban datën 28.04.2020, i firmosur M. Xh. , B. P. dhe E. Sh. ku është cilësuar se ñMalli u kontrolluar nga komisioni dhe konstaton që është sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje nr. 256, datë date 28.04.2020.

-Urdhër shpenzimin nr. 317 datë 21.05.2020 për vlerën 1,882,000 lekë, nëpërmjet Raiffeisen Bank është likuiduar Shoqëria ñO.E.S Dis.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 284347334, date 30.04.2020, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit, fletë hyrja nr. 264, datë 30.04.2020, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban 30.04.2020, i firmosur M. Xh. , B. P. dhe E. Sh. ku është cilësuar se ñMalli u kontrolluar nga komisioni dhe konstaton që është sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje nr. 264, datë date 30.04.2020.
-Urdhër shpenzimin nr. 389 datë 07.07.2020 për vlerën 2,854,542 lekë, nëpërmjet Raif. Bank është likuiduar Shoqëria ñO.E.S Dis.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 284347630, date 11.06.2020, fletë hyrja nr. 331, datë date 11.06.2020, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban 11.06.2020, i firmosur M. Xh. , B. P. dhe E. Sh. ku është cilësuar se ñMalli u kontrolluar nga komisioni dhe konstaton që është sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje nr. 331, datë date 11.06.2020.
-Urdhër shpenzimin nr. 596 datë 15.09.2020 për vlerën 3,974,491 lekë, nëpërmjet Raiffeisen Bank është likuiduar Shoqëria ñO.E.S Dis.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 360849597, date 11.08.2020, fletë hyrja nr. 439, datë date 11.08.2020, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban 11.08.2020, i firmosur M. Xh., B. P. dhe E. Sh. ku është cilësuar se ñMalli u kontrolluar nga komisioni dhe konstaton që është sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje nr. 439, datë date 11.08.2020.
-Urdhër shpenzimin nr. 732 datë 18.11.2020 për vlerën 771,245 lekë, nëpërmjet Raif. Bank është likuiduar Shoqëria ñO.E.S Dis.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 360850258, date 26.10.2020, fletë hyrja nr. 547, datë date 26.10.2020, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban 26.10.2020, i firmosur M. Xh. , B. P. dhe E. Sh. ku është cilësuar se ñMalli u kontrolluar nga komisioni dhe konstaton që është sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje nr. 547, datë date 26.10.2020.
-Urdhër shpenzimin nr. 750 datë 03.12.2020 për vlerën 398,240 lekë, nëpërmjet Raif. Bank është likuiduar Shoqëria ñO.E.S Dis.ò Shpk. Ky shpenzim ka të bëj me blerje materiale mjekësore. Dokumentacion vërtetues, fatura tatimore shitje nr. 360850485, date 23.11.2020, fletë hyrja nr. 612, datë date 26.10.2020, procesverbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit mban 23.11.2020, i firmosur M. Xh., B. P. dhe E. Sh. ku është cilësuar se ñMalli u kontrolluar nga komisioni dhe konstaton që është sipas standardeve dhe specifikimeve teknike. Ky artikull do të bëhet hyrje nr. 612, datë date 26.10.2020.
Nga kjo kontratë në farmaci më datën 08.04.2021, u krye verifikimi kontabël dhe fizik në tre artikuj, konkretisht: Stend karotide self expanding cope 2 x 179,800 lekë/copë = 359,600 lekë, Graft vascular i drejt 6 mm 1 x 94,000 lekë/copë = 94,000 lekë, Guidewire 0.035ò, i drejt 145-180 cm cope 1 32,000 lekë/copë = 32,000 lekë. Nuk pati diferenca, si dhe specifikimet teknike të tre artikujve u konstatua se janë konformë dokumentacionit të tenderimit.

5. Proçedura e prokurimit me objekt "Kryerje e shërbimit të lavanterisë dhe hotelerisë për një periudhë 48 mujore në SUT", viti 2020.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: ñKryerje e shërbimit të lavanderisë dhe hotelerisë për një periudhë 48 mujore në SUTò - Marrëveshje Kuadër me nje Operator Ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë 48 mujore nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuader

1. Urdhër Prokurimi Nr Nr.7/6 Datë 16.04.2020 2. Lloji i Procedurës së Prokurimit ñProcedurë e hapurò	3. Njësia e prokurimit Urdhër Nr.7/6 dt.16.04.2020 - G. H. Përgjegjës për prokurim me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimit. - M. S. Specialist Prokurimi me detyre jurist. M. P. , specialiste planifikimi me detyre ekonomiste.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 7/7 datë 21.04.2020 - Dr. V. R. Zv/Drejtor teknik me profesion kirurg ortoped - B. V. me detyre jurist - V. S. me detyre përgjegjës i sektorit të shërbimeve
5. Fondi Limit (pa tvsh) 199,290,000 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 149,752,200 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 49,537,800 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 20.05.2020 ora 10:00	9. Burimi Financimit Fond nga Buxheti i Shtetit (Ministria e Mbrojtjes)	10. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër _5___OE b)Sôkualifikuar __0___OE, c) Kualifikuar___1__ OE
11.Ankimime OE ñD .ò Shpk dhe B.OE ñK.I.ò Shpk& ñB. L.ò Shpk APPï sôka; KPP-ka **"D."SHPK**	12. Përgjigje Ankesës nga AK -Ka	13.Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik Ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës nr.1 nr. 7/32 prot., datë 20.07.2020	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 20,308,860 lekë	
16. Lidhja e kontratës nr.2 nr. 7/37 prot., datë 11.12.2020	17. Vlera e kontratës (me tvsh) 3,604,152 lekë	
18. Lidhja e kontratës nr.3 nr. 7/40 prot., datë 30.12.2020	19. Vlera e kontratës (me tvsh) 57,600,156 lekë	

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:
Fondi i këtij i këtij investimi është akorduar nga Buxheti i Shtetit (Ministria e Mbrojtjes) me vlerë 199,290,000 lekë për katër vite.
Kjo procedurë është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike.
Me kërkesën nr. 748 prot, datë 02.12.2019 drejtuar A. B. me detyrë zv/drejtore ekonomike dhe E. O. me detyrë përgjegjëse e sektorit të planifikimit, grupi i punës i përbërë nga V. S. , E. Xh. , A. Rr. , N. M. dhe I. P. , ka njoftuar për përfundimin e kontratës së shërbimit të lavanterisë dhe marrjen e masave për të lidhur kontratën tjetër.
-Me kërkesën nr. 82/ prot, datë 03.02.2020 drejtuar G. H. me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimeve, E. O. me detyrë përgjegjëse e sektorit të planifikimit, ka bërë kërkesë për prokurim me objekt: ñKryerjen e Shërbimit të lavanterisë dhe hotelerisëò, për nevojat e SUT, fond i cili është planifikuar me financim nga fondet e buxhetit të shtetit (Ministria e Mbrojtjes).
Me urdhër të Drejtorit të Spitalit nr. 7, datë 04.02.2020, është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike i përbërë nga: V. S. me detyrë përgjegjës i sektorit të shërbimeve, N. M. me detyrë përgjegjëse e recepsionit, M. P. me detyre specialiste planifikimi, E. Xh. me detyrë specialiste planifikimi dhe I. P. me detyre Kryeinfermier.
Me protokoll nr. 7/1 datë 07.04.2020, grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike ka hartuar specifikimet teknike.
Në specifikimet teknike janë përcaktuar informacionet mbi gjendjen e shtretërve, tabelat e inventarit të butë me peshat përkatëse sipas studimeve (kontratave të mëparshme), tabela me sasitë përkatëse që do të blihen nga kontraktori përgjatë katër viteve, specifikimet e materialeve të buta dhe mënyra e kryerje së shërbimit me punonjësit përkatës.

Me urdhër të Drejtorit të Spitalit nr. 7/2, datë 07.04.2020, është ngritur grupi i punës për argumentin e fondit limit, i përbërë nga G. H. me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimeve me profesion administrim publik, A. D. me detyre specialiste finance me profesion ekonomiste, M. S. me detyre specialist prokurimi me profesion jurist.
Me dokument të protokolluar nr. 7/5 datës 16.04.2020, grupi i përllogaritjes së fondit limit ka përcaktuar vlerën 199,290,000 lekë pa TVSH dhe 239,148,000 lekë me TVSH, aq sa është dhe fondi i planifikuar nga Ministria e Mbrojtjes.
Pra, përllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në vlerën 199,290,000 lekë, sipas çmimit të marrë nga kontrata e fundit pas testimit të tregut ñAG.ò Shpk në 395 lekë/kg, ñDDE.ò Shpk në vlerën 350 lekë/kg, ñW-CEN.ò Shpk në vlerën 402 lekë/kg lekë, testim i cili ka rezultuara me çmim më të lart se kontrata e fundit.
Vlera 199,290,000 lekë, është llogaritur çmimi njësi i kontratës së fundit 350 lekë/kg (569,400 programuar kg x 350 lekë/kg = 199,290,000 lekë).
- Ka një kontradiksion tek përllogaritja e vlerës së kontratës tek shoqëria ñDev.ò Shpk, ne ofertën për procedurën e prokurimit 589,400 kg x 280 lekë/kg = 159,432,000 lekë, ndërsa në ofertën e paraqitur për përllogaritjen e vlerës së kontratës 589,400 kg x 350 lekë/kg = 199,290,000 lekë, me diferenca 39,858,000 lekë.
Nga grupi për llogaritjen e vlerës limit të kontratës, ***nuk është dhënë asnjë argumentim*** *përse nuk është marrë për bazë edhe e realizuara nga spitalet e tjera (QSUT, Shefqet Ndroqi,etj pse jo dhe private), ose pse një numër kaq i kufizuar operatoresh, pra pse tre dhe jo mbi pesë.*
Veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 59, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se ñNë përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet tõ referohet një ose më shumë alternativave të renditura si mëposhtë: Çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe
a) çmimet e tregut;ose/dhe
b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga
autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe
ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.
Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.
Si konkluzion, përllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, i spitaleve te tjera (QSUT, Shefqet Ndroqi, spitaleve private etj), veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 59, pika 2.
Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi grupi i llogaritjes së vlerës së kontratës i përbërë nga G. H. , A. D. , M. S. .
Me urdhër të Drejtorit të Spitalit me nr. 7/6 Prot datë 16.04.2020, është ngritur njësia e prokurimit e përbërë nga G. H. me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimeve, M. S. me detyrë specialist prokurimi me profesion jurist dhe M. P. me detyrë specialiste planifikimi me profesion ekonomiste.

Me urdhër të Drejtorit të Spitalit me nr. 7/7 Prot datë 21.06.2020, është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga V. R. me detyrë zv/ drejtor teknik, V. S. me detyrë përgjegjës i sektorit të shërbimeve dhe B.V. me detyrë jurist.

- Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim/specifikimet teknike.

Kërkesat për kualifikim janë miratuar me proçesverbalin e datës 21.04.2020, të firmosur nga njësia e prokurimit e përbërë nga G. H. , M. S. dhe M. P. .

Kërkesat për kualifikim janë miratuar me proçesverbalin e datës 21.04.2020 të firmosura nga njësia e prokurimit. Në këto kërkesa nuk janë dhënë arsye konkrete në argumentimin e kritereve të vlerësuara për objektin e prokurimit, në raport me natyrën dhe përmasat e këtij objekti.

Konkretisht, në nenin 61, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, parashikohet se: "Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit".

Nuk ka një dokument shkresor (procesverbal etj) të njësisë së prokurimit, ku të jenë miratuar dokumentet e tenderimit (D.T.) dhe në veçanti nuk ka një dokument shkresor ku të jenë përcaktuar kriteret e vlerësimit, edhe pse në S.P.E është përcaktuar çmimi më i ulët. Konkretisht, në nenin 61, pika 1, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, parashikohet se: Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje më këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi, ndërsa në pikën 2 të këtij neni parashikohet se: Seti i dokumenteve të tenderit firmoset në çdo faqe nga njësia e prokurimit.

Në pikën 2.3.7 (shtojca 1) të kritereve të kualifikimit ñKapaciteti ekonomikò, është përcaktuar se, operatorët duhet të paraqesin, për sa i përket përvojës së mëparshme, furnizime te mëparshme të ngjashme me një vlere prej 40% të fondit limit të objektit te prokurimit, të realizuar gjate tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit, vërtetuar me dokumentacionin vërtetues.

Veprim në kundërshtim me shkresën Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), nr. 3341/1 prot, date 20.03.2018, pasi nuk duhesh ñKërkuar që kontrata të ngjashme me një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit të veprimtarisë së operatorit , ***por të tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të tenderit".***

Për mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit e përbër nga G. H. , M. S. dhe M. P. .

Me urdhër nr. 7/10, datë 28.04.2020 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, është bërë pezullimi i procedurës së prokurimit, për arsye të ankesës së operatorit ekonomik ñS. C.ò me nr. 824 prot., datë 28.04.2020, ankesë që ka të bëjë me dokumentet e tenderit dhe kriteret e kualifikimit.

Me urdhër nr. 7/9, datë 28.04.2020 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, është ngritur komisioni i shqyrtimit të ankesës, të operatorit ekonomik ñS. C.ò me nr. 824, datë 28.042020, ankesë që ka të bëjë me përcaktimin e dokumentave të tenderit dhe kriteret e kualifikimit, i përbërë nga V.R. , V. S. dhe B. V. .

Me shkresën nr. 824/1 prot., datë 30.04.2020, komisioni i rekomandon Titullarit të Autoritetit Kontraktor, ndryshimin e dokumenteve të tenderit dhe kritereve të kualifikimit sipas ankesës të operatorit ekonomik ñS. C. ò.

Me urdhër nr. 7/12, datë 30.04.2020 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, hiqet pezullimi i procedurës së prokurimit.
Me shkresën nr. 7/11 prot., datë 30.04.2020, hartohet shtojca me ndryshimet e dokumenteve të tenderit, si dhe njoftohet me shkresën nr. 824/2 prot., datë 05.05.2020 operatori ekonomik ñS. C.ò Shpk.
APP në datë 04.05.2020, ka dërguar rekomandime mbi arsyetimin ose ndryshimin e kritereve të kualifikimit.
Njësia e prokurimit e përbërë nga G. H., M. S. dhe M. P. , ka rekomanduar ndryshimet e kritereve të kualifikimit, sipas rekomandimeve të APP-së dhe ka bërë arsyetimet e vendosjes së kritereve.
Me shkresën nr. 7/13 prot., datë 05.05.2020, njësia e prokurimit i rekomandon Titullarit të Autoritetit Kontraktor ndryshimin e dokumenteve të tenderit referuar rekomandimit të APP.
Me shkresën nr. 7/14 prot., datë 05.05.2020 është hartuar shtojca me ndryshimet e dokumenteve të tenderit dhe është bërë dhe ndryshimi i hapjes së datave të procedurës për vlerësim.
Me ndryshimin e dokumenteve të tenderit (Specifikimeve teknike), shtojca e publikuar më datë 05.05.2020, nuk është bërë shtyrja e afatit kohor për dorëzimin e ofertave me 5 ditë, por është lënë i njëjti afat i dorëzimit të ofertave data 20.05.2020 ora 10.00, veprim në kundërshtim me neni 42, pika 2/1 e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, me ndryshimet vijuese të tij.
Me shkresën nr. 7/15 prot., datë 22.05.2020, komisioni i vlerësimit të ofertave i drejtohet G. H. në cilësinë e përgjegjësit të sektorit të prokurimeve, për verifikim në sistemin e drejtësisë të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në këtë proçedurë prokurimi.
Me shkresën nr. 7/16 prot., datë 22.05.2020, G. H. në cilësinë e përgjegjësit të sektorit të prokurimeve i kthen përgjigje komisionit të vlerësimit të ofertave, për rezultatin në regjistrin gjyqësor të Ministrisë së Drejtësisë të subjekteve pjesëmarrës në këtë proçedurë prokurimi, duke bashkëlidhur dhe çertifikata elektronike respektive për çdo subjekt të kërkuar.
Titullari i Autoritetit Kontraktor ka lëshuar autorizimin nr. 977 prot., datë 26.05.2020 për verifikimin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës në tender, të cilët kanë paraqitur ofertë si më poshtë:
1. Operatori ekonomik ñS. C. ò Shpk.
2. Operatori ekonomik ñDE.ò Shpk.
3. Bashkimi i operatorëve ekonomik ñB. L.ò Shpk & ñK. I.ò Shpk.
Komisioni i vlerësimit të ofertave me procesverbal datë 29.05.2020, ka bërë vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomik, si dhe me procesverbal datë 27.05.2020 ka verifikuar në vendin e kryerjes së aktivitetit, makineritë dhe pajisjet si më poshtë:
-a. Makineri larëse profesionale me kapacitet larje minimal 40 kg. Në pikën 2.3/4.1 ñKapaciteti ekonomikò është përcaktuar: Makineri larëse profesionale me sistem dozimi elektronik dhe ose manual te detergjenteve qe përdoren gjate procesit te larjes me kapacitet larje minimal 40 kg.
b. Makineri me barriera larëse profesionale me kapacitet minimal 50 kg. Në pikën 2.3/4.1 ñKapaciteti ekonomikò është përcaktuar: Makineri me barriera larëse profesionale (barriera te cilat bëjnë dezinfektimin e materialeve me infeksione) me sistem dozimi elektronik dhe/ose manual te detergjenteve qe përdoren gjate procesit te larjes, me kapacitet minimal 50 kg.
c. Makineri larëse me dhoma kapacitet larje minimal 300 kg/dite. Në pikën 2.3/4.1 ñKapaciteti ekonomikò është përcaktuar: Makineri larëse me disa dhoma larjeje, të cilat duhet të jenë te lidhura me sistem dozimi elektronik dhe ose manual te detergjenteve qe përdoren gjate procesit te larjes. Makineria duhet te ketë nje kapacitet larje minimal 300 kg/dite.

d. Makineri tharëse profesionale me kapacitet minimal 390 kg/dite. Në pikën 2.3/4.1 ñKapaciteti ekonomikò është përcaktuar: Makineri tharëse profesionale me kapacitet minimal 390 kg/dite
e. Makineri hekurosëse me rul profesional me kapacitet minimal 390 kg/dite. Në pikën 2.3/4.1 ñKapaciteti ekonomikò është përcaktuar: Makineri hekurosëse profesionale me kapacitet minimal 390 kg/dite.
f. Makineri për dizifektimin e karrelave të shërbimit. Në pikën 2.3/4.1 ñKapaciteti ekonomikò është përcaktuar: Duhet të disponojë minimumi nje makineri me sistem dozimi elektronik te detergjenteve qe përdoren gjate procesit te larjes për larjen dhe dizinfektimin e karrocave qe do te përdoren gjate shërbimit ne SUT (karrocat janë përcaktuar sipas pikës 4).
Referuar sa më sipër: Ky operator nuk provohet ta përmbushur këtë kërkesë, pasi nga verifikimi fizik nuk është marr si provë asnjë e dhënë teknike ñEtiketa e makinerisë e përkthyer në gjuhën shqipeò që të provohen kapacitetet e tyre teknike, për më tepër nuk provohet makineria me sistem dozimi elektronik te detergjenteve.
Zhvillimi i procedurë së prokurimit.
Në këtë procedurë prokurimi kanë marr pjesë operatorët operatorë ekonomik.
-S.C.. me ofertë në vlerën 149,752,200 lekë.
-D. Shpk në vlerën 159,432,100 lekë.
-Bashkimi i operatorëve ñK. I.ò Shpk & ñB. L. ò me vlerë 164,556,600 lekë
-KPL, pa ofertë
-W. Cen., pa ofertë
Pas vlerësimit të KVO u kualifikua dhe shpall fitues operatori ekonomik òS. C..ò Shpk, me ofertë në vlerën 149,752,200 lekë, duke u sôkualifikuar operatorët e tjerë, të përmendur si më sipër.
Me ankesën nr. 1054 prot, datë 03.06.2020, ka kryer ankimimin operatori ekonomik ñD.ò Shpk, drejtuar Titullarit të Autoriteti Kontraktor për sôkualifikim të padrejtë.
Me ankesën nr. 1063 prot, datë 04.06.2020, ka kryer ankimim bashkimi i operatorëve ekonomik ñB. L.ò Shpk & ñK. I.ò Shpk, drejtuar Titullarit të Autoriteti Kontraktor për sôkualifikim të padrejtë.
Me urdhër nr. 7/17, datë 03.06.2020 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, është ngritur komisioni i shqyrtimit të ankesës të operatorit ekonomik ñD.ò Shpk dhe me urdhër nr. 7/19, datë 04.06.2020, është ngritur komisioni i shqyrtimit të ankesës bashkimit të operatorëve ekonomik ñB. L.ò Shpk & ñK. I.ò Shpk, i përbër nga A. B. me detyrë zv/drejtor ekonomik, I. K. me detyrë përgjegjëse e sektorit juridik dhe R. J. me detyrë specialiste prokurimi.
Me urdhër nr. 7/18, datë 03.06.2020 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, është bërë pezullimi i procedurës së prokurimit, për arsye të ankesës së operatorit ekonomik ñDe.ò Shpk dhe me urdhër nr. 7/19, datë 04.06.2020, është ngritur komisioni i shqyrtimit të ankesës të bashkimit të operatorëve ekonomik ñB. L.ò Shpk & ñK. I.ò Shpk, i përbërë nga A. B. me detyrë zv/drejtor ekonomik, I. K. me detyrë përgjegjëse e sektorit juridik dhe R. J. me detyrë specialiste prokurimi.
Me shkresën nr. 1054/1 prot, datë 10.06.2020 komisioni i shqyrtimit të ankesës i rekomandon Titullarit të Autoritetit Kontraktor, pranimin pjesërisht të ankesë të operatorit ekonomik ñD.ò Shpk.
Me shkresën nr. 1054/2 prot, dhe nr. 1063/2 prot datë 10.06.2020, Titullari i Autoritetit Kontraktor njofton trajtimin e ankesës, duke sôkualifiuar të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës në tender.

Me shkresën nr. 1099 prot., datë 11.06.2020 operatori ekonomik ñS. C.ò Shpk, kërkon informacion mbi proçedurën e prokurimit..
Me ankesën nr. 1099/1 prot, datë 12.06.2020, i është kthyer përgjigje operatorit ekonomik ñS.C.ò Shpk.
Me shkresën nr. 1126 prot., datë 17.06.2020, është bërë ankesë nga operatori ekonomik ñS. C.ò Shpk, për sõkualifikim të padrejtë dhe rivlerësim të procedurës së prokurimit.
Me urdhër nr. 7/20, datë 17.06.2020 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, është ngritur komisioni i shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ñS.C.ò Shpk, i përbërë nga G. H. , M. S. dhe I. P. .
Me shkresën nr. 7/21 prot, datë 17.06.2020, komisioni i shqyrtimit të ankesës i rekomandon Titullarit të Autoritetit Kontraktor, për pranimin e ankesës së operatorit ekonomik ñS.C.ò Shpk dhe rekomandon rivlerësimin e procedurës.
Nga rivlerësimi i procedurës u vendos rikualifikimi i operatori ekonomik ñS.C.ò dhe sõkualifikimi i operatorët të tjerë.
Me shkresën nr. 1126 prot., datë 18.06.2020, i është kthyer përgjigje operatorit ekonomik ñS. C. ò, mbi vendimin e marrë nga ana e Autoritetit Kontraktor.
Me shkresën nr. 1177 prot., datë 22.06.2020, është bërë ankesë nga operatori ekonomik ñD.ò Shpk, për rivlerësimin e procedurës së prokurimit.
Me shkresën nr. 1178 prot., datë 22.06.2020, është vënë në dijeni Autoritetit Kontraktor, për ankesën e operatori ekonomik ñD.ò Shpk, drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik (KPP).
Me shkresën 1177/1 prot, datë 26.06.2020, i është kthyer përgjigje operatori ekonomik ñD.ò Shpk, ku i refuzohet ankesa.
Komisionit i prokurimit publik me vendim nr. 218/1 prot, datë 25.06.2020, ka lejuar Autoritetin Kontraktor për zhvillimin e mëtejshëm të procedurës dhe ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik ñD.ò Shpk.
Me shkresën nr. 7/22 datë 06.07.2020, është bërë heqja e pezullimit të procedurës së prokurimit në zbatim vendimit të K.P.P.
Në datë 07.07.2020, është ribërë ankesë pranë KPP-së nga operatorit ekonomik ñD. ò Shpk dhe për dijeni dhe të SUT.
Me vendimin nr. 248/1 prot, datë 09.07.2020, Komisioni i Prokurimit Publik, ka refuzuar edhe njëherë ankesën e operatorit ekonomik ñD. ò Shpk.
Raporti përmbledhës nga komisioni i vlerësimit është hartuar me nr. 7/24 prot., datë 14.07.2020, raport i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, ku ka shpallur fitues operatorin ekonomik ñS.C.ò Shpk, me ofertë ekonomike 149,752,200 pa TVSH dhe me fond limit të Marrëveshjes Kuadër 199,290,000 lekë pa TVSH. Në datën 14.07.2020 në S.P.E. e A.P.P, është kryer njoftimi i fituesit, nga ku A.P.P e ka bërë aktive publikimin e njoftimit të fituesit në datën 16.07.2020.
Titullari i Autoritetit Kontraktor me urdhrin nr. 7/25, datë 14.07.2020, ka ngarkuar njësinë e prokurimit për administrimin e dokumenteve të tenderit të dorëzuar nga operatori ekonomik fitues.
Komisioni i vlerësimit të ofertave, gjithashtu ka hartuar inventarin pa datë për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik i shpallur fitues ñS.C.ò Shpk.
Marrëveshja kuadër është lidhur me nr. 7/26 prot., datë 17.07.2020, ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës të përfaqësuar nga A. Z. në cilësinë e Drejtorit të Spitalit dhe operatorit/e shoqërisë ñS.C.ò Shpk në vlerën 199,290,000 lekë pa TVSh, kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër

është për një periudhë 48-mujore, nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshje (periudha 17.07.2020-17.07.2024).
Me urdhër nr. 7/27 datë 17.07.2020 të Drejtorit të Spitalit, është ngritur grupi i punës për monitorimin dhe zbatimin e kontratës i përbërë nga E. O. me detyrë përgjegjëse e sektorit të planifikimit, V. S. me detyrë përgjegjësi i shërbimeve mbështetëse, E. Xh. me detyrë specialiste planifikimi, A. Rr. me detyrë magazinier dhe I. P. me detyrë kryeinfermier
Formulari i njoftimit të kontratës është bërë me nr. 7/28 prot, datë 20.07.2020, publikuar në S.P.E datë 20.07.2020.
Me shkresën nr. 7/29 prot, datë 20.07.2020, grupi i punës për monitorimin dhe zbatimin e kontratës drejtuar G. H. , i kërkon lidhje kontrate për shërbim të lavanterisë dhe hotelerisë në vlerën 20,308,860 lekë me afat 20.07.2020-31.12.2020 (165 ditë x 390 kg/ditë= 64,350 kg x 263 lekë/kg = 16,924,050 lekë x 20 % tvsh (3,384,810) = 20,308,860 lekë.
Me shkresën nr. 7/30 prot., datë 20.07. 2020, Titullari i Autoritetit Kontraktor, i kërkon operatorit ekonomik ñS.C.ò Shpk kërkesë për dhënie oferte blerje për sasinë 64,350 kg, pa çmim/kg për periudhën 20.07.2020-31.12.2020, duke i cilësuar ñÇmimi duhet të jepet për njësi në monedhën lekë, në vlerën pa TVShò.
Operatori ekonomik ñS.C.ò Shpk, paraqet ofertën e cila është protokolluar me nr. 7/31 prot., datë 20.07.2020, ku ka përcaktuar çmimin 263 lekë/kg, me vlerë totale 16,924,050 lekë pa TVSH dhe me TVSH 20,308,860 lekë .
Kontrata është lidhur me nr. 7/32 prot., datë 20.07.2020 ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës të përfaqësuar nga A. Z. në cilësinë e Drejtorit të Spitalit dhe operatorit/e shoqërisë ñS.C.ò Shpk në vlerën 20,308,860 lekë me TVSh, kontrata duhet të fillojë zbatimin me nënshkrimin e palëve me deri më 31.12.2020.
Me urdhër nr. 7/33 datë 10.09.2020 të Drejtorit të Spitalit është ngritur grupi i punës për monitorimin dhe zbatimin e kontratës, i përbërë nga V. S. me detyrë përgjegjësi i shërbimeve mbështetëse, M. P. mer detyrë specialiste planifikimi, E. Xh. me detyrë specialiste planifikimi, A. Rr. me detyrë magazinier dhe I. P. me detyrë kryeinfermier.
Me urdhër nr. 7/34 datë 16.10.2020 të Drejtorit të Spitalit, është ngritur grupi i punës për monitorimin dhe zbatimin e kontratës i përbërë nga V. S. me detyrë përgjegjësi i shërbimeve mbështetëse, M. P. me detyrë specialiste planifikimi, M. S. me detyrë jurist, A. Rr. me detyrë magazinier dhe I. P. me detyrë kryeinfermier.
Me shkresën nr. 7/35 prot, datë 11.12. 2020, Titullari i Autoritetit Kontraktor, i kërkon operatorit ekonomik ñS.C.ò Shpk, kërkesë për dhënie oferte blerje për sasinë 11,420 kg, pa çmim/kg për periudhën 12.12-31.12.2020, duke i cilësuar ñÇmimi duhet të jepet për njësi në monedhën lekë, në vlerën pa TVShò. Në një kohë që për periudhën 20.07.2020-31.12.2020 është lidhur kontratë, për sasinë sasinë 64,350 kg.
Operatori ekonomik ñS.C.ò Shpk, paraqet ofertën e cila është protokolluar me nr. 7/36 prot., datë 11.12.2020, ku ka përcaktuar çmimin 263 lekë/kg me vlerë totale 3,003,460 lekë pa TVSH dhe me TVSH 3,604,152 lekë.
Kontrata është lidhur me nr. 7/37 prot., datë 11.12.2020 ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës të përfaqësuar nga A. Z. në cilësinë e Drejtorit të Spitalit dhe operatorit/e shoqërisë ñS.C.ò Shpk në vlerën 3,604,152 lekë me TVSh, kontrata duhet të fillojë zbatimin me nënshkrimin nga 12.12.2020 e me deri më 31.12.2020. Në një kohë që për periudhën 20.07.2020-31.12.2020 është lidhur kontratë, për sasinë sasinë 64,350 kg.
Me shkresën nr. 643 prot, datë 07.12.2020, komisioni i monitorimit të kontratës i përbërë V. S. , M. P. , E. Xh. , A. Rr. , M. S. dhe I. P. i drejtohen A. H. me detyrë zv/drejtor ekonomik dhe

për dijeni E. O. me detyrë përgjegjëse e sektorit të planifikimit, i kërkon marrjen e masave për lidhjen e kontratës nr. 2/2020 për shërbimin e lavanterisë dhe hotelerisë për periudhën 12.12.2020-31.12.2020 për vlerën 3,003,460 lekë, 11,420 kg x 263 lekë/kg =3,003,460 lekë dhe për lidhjen e kontratës 3/2021 për periudhën 01.01.2021 deri më datën 31.12.2021 me vlerë 54,813,145 lekë.
Në këtë shkresë përveç të tjerave citohet se : Nga data 12.12.2020 deri më 31.12.2020 mbetemi të pa mbuluar me kontratë, pasi vlera e kontratës 1/2020 me nr. 7/32 prot, datë 20.07.2020 ka përfunduara para afatit ta parashikuar me arsyet:
-Materiali i butë bazuar në specifikimet teknike të përcaktuara dhe miratuara në këtë procedurë prokurimi, rezulton të ketë një peshë më të madhe se ajo e parashikuar në artikujt (çarçaf i poshtëm, çarçaf i sipërm, çarçaf zarf, si rrjedhojë pesha ditore ka pasur ndryshime të konsiderueshme. Artikujt e përmendur sa më sipër kanë përdorim të shpeshtë në këtë shërbim.
-Çarçaf i poshtëm pesha e parashikuar në specifikimet teknike 0.77 kg, në fakt ka rezultuar 1.1 kg.
-Çarçaf i sipërm pesha e parashikuar në specifikimet teknike 0.77 kg, në fakt ka rezultuar 1.1 kg.
-Çarçaf i zarf pesha e parashikuar në specifikimet teknike 1.1 kg, në fakt ka rezultuar 1.3 kg.
Diferenca nga pesha e parashikuar në peshën faktike ka sjellë përfundimin e parakohshëm të kontratës së lartpërmendur.
-Pandemi e COVID-19 është faktor tjetër në rritjen e peshës ditore, pasi frekuenca e ndërrimit të çarçafëve është shumë e shpeshtë, si pasojë e paraqitjes së pacientëve të infektuar me COVID-19, dhe pse ata nuk shtrohen në këtë spital, por përdorimi i shtretërve të urgjencës deri në momentin që transferohen në spitalet e COVID-19. Në këto kushte kërkojmë lidhjen e kontratës nr. 2/2020 për të përmbushur nevojat 12.12-31.12.2020 me vlerë 3,003,460 pra 571 kg/ditë x 20 ditë = 11,420 kg x 263 = 3,003,460 lekë.
Kërkesa është e pa argumentuar me argumentet si më poshtë:
-Diferencat në peshë në rastet e sipër cituara bien ndesh me specifikimet teknike që janë pjesë e kontratave me nr. 7/37 prot., datë 11.12.2020 dhe kontrata me nr. 7/40 prot., datë 30.12.2020 të lidhura për këtë shërbim.
- Shtimi i shtrimeve në urgjencë si pasojë e COVI-19, nuk është e shoqëruar me numrin e shtrimeve të ndodhura, dhe mbi të gjitha kontrata është lidhur në mes të pandemisë, dhe nuk është në fillimin e saj.
Me shkresën nr. 677 prot, datë 28.12.2020 E. O. me detyrë përgjegjëse e sektorit të planifikimit i kërkon G. H. me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimeve lidhje kontrate për shërbimin e lavanterisë dhe hotelerisë në vlerën 57,600,000 lekë me afat deri më 31.12.2021.
Me shkresën nr. 7/38 prot, datë 30.12. 2020,Titullari i Autoritetit Kontraktor, i kërkon operatorit ekonomik ñS.C.ò Shpk kërkesë për dhënie oferte blerje për sasinë 182,510 kg, pa çmim/kg për periudhën 12.12-31.12.2021, duke i cilësuar ñÇmimi duhet të jepet për njësi në monedhën lekë, në vlerën pa TVShò.
Operatori ekonomik S. C.ò Shpk, paraqet ofertën e cila është protokolluar me nr. 7/39 prot., datë 30.12.2020 ku ka përcaktuar 182,510 kg x 263 lekë/kg, me vlerë totale 48,000,130 lekë pa TVSH dhe me 57,600,156 TVSH lekë.
Kontrata është lidhur me nr. 7/40 prot., datë 30.12.2020 ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës të përfaqësuar nga A. Z. në cilësinë e Drejtorit të Spitalit dhe operatorit/e shoqërisë S. C.ò Shpk në vlerën 57,600,156 lekë me TVSh (182,510 kg x 263 lekë/kg = 48,000,130 lekë x 20 % TVSH = 57,600, 156 lekë, kontrata duhet të fillojë zbatimin me nënshkrimin nga 01.01.2021 e me deri më 31.12.2021.

Veprime në kundërshtim me:
- Marrëveshjen kuadër të lidhur me nr. 7/26 prot, datë 17.07.2020 ndërmjet SUT dhe operatori ekonomik S. C. ò Shpk, ku është përcaktuar ñkontraktori , me an të ofertës së tij, bie dakort të furnizoj mallra, ashtu siç janë specifikuar në kushtet e përcaktuara në këtë kontratë, formularin e deklarimit të ofertës, specifikimet teknike, formulari i çmimit të ofertës dhe dokumentet standard të tenderitò.
- Kontratën të lidhur me nr. 7/32 prot., datë 20.07.2020 në vlerën 20,308,860 lekë me TVSh, kontrata duhet të fillojë zbatimin me nënshkrimin e palëve me deri më 31.12.2020, nenet 8,12 dhe 14.
-Kontratën e lidhur me nr. 7/37 prot., datë 11.12.2020 ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës dhe operatorit/e shoqërisë ñS. C.ò Shpk në vlerën 3,604,152 lekë me TVSh, nenet 8,12 dhe 14.
- Kontratën e lidhur me nr. 7/40 prot., datë 30.12.2020 ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës dhe operatorit/e shoqërisë S. C. ò Shpk në vlerën 57,600,156 lekë me TVSh, nenet 8,12 dhe 14.
- Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 60, pika 1, e cila përcakton se: ñ1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fitueseò.
- Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 ñKodi Civil i Republikës së Shqipërisëò, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690 në të cilin është shprehur ñ.....Mos përmbushja e detyrimeve përkatëse sjell lindjen e përgjegjësisë juridiko-civile për palën mos përmbushëse, përgjegjësi e cila konkretizohet në detyrimin për ti shpërblyer palës/palëve të tjera shpërblimin e dëmit të pësuar në formën dëmit efektiv dhe fitimit të munguarò.
- Shtojca 5. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike dhe të Termave të Referencës nga operatori ekonomik S. C. ò Shpk.
Si pasojë e mos zbatimit të specifikimeve teknike për periudhën tetor 2020 deri më mars 2021, Shoqëria ñS.C.ò Shpk ka përfituar padrejtësisht vlerën ***3,536,421 lekë, duke krijuar në këtë mënyrë dëm ekonomik në të njëjtën vlerë.***
Për mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi V. S. me detyrë përgjegjës i sektorit të shërbimeve, i cili njëkohësisht, referuar urdhrit të Drejtorit të Spitalit nr. 7/27 datë 17.07.2020, jo vetëm është pjesëtar i grupit te monitorimit të kontratës, por njëkohësisht referuar urdhrit të Drejtorit të Spitalit nr. 7, datë 04.02.2020, është anëtar i grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike, si dhe referuar urdhrit të Drejtorit të Spitalit nr. 7/7 Prot datë 21.06.2020, është anëtar i komisionit të vlerësimit të ofertave. Pra në funksion të detyrës së Tij, ka pasur dijeni të plotë për specifikimet teknike të materialeve të buta të përshkruara si më sipër që janë pjesë e kontratave që duhet të zbatonte operatori ekonomik ñS.C.ò Shpk, specifikime të cilat nuk i ka zbatuar.
Leje mjedisore dhënë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë ñQendra Kombëtare e Biznesitò me numër serial PN-6843-07-2018, Kodi III.1.A, lëshuar datë 22.01.2019, me afat vlefshmërie ñPa afatò, me vend të kryerjes ë veprimtarisë; Qarku Tiranë, B/K Kashar, Q/F: MEZEZ.
Akt-Miratimi i lejes mjedisit Tipi C, nr. 43, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit ñAgjencia Rajonale e Mjedisit, Qarku Tiranëò me nr. 43 prot, datë 11.01.2019.
Në pikën 2.3/7 ñKapaciteti ekonomikò është përcaktuar operatorët ekonomik duhet te paraqesë: a) vërtetim pronësie ose kontrate qiraje për objektin ku do te ushtrohet aktiviteti (vendi ku është instaluar lavanteria). Kontrata e qerase duhet te jete e vlefshme për gjithë periudhën e parashikuar për kryerjen e shërbimit dhe duhet te ketë bashkangjitur te gjithë dokumentacionin ligjor, ***kopje te aktit te pronësisë te qiradhënësit dhe dokumentet e tjerë qe vërtetojnë marrëveshjen kontraktuale mes palëve***.

Ky operator nuk e ka përmbushur këtë kërkesë, pasi ka paraqitur:
-Me kontratën nën qiraje (noteriale) me Nr. 1642 Rep, Nr. 471/2 Ko, datë 08.08.2018, lidhur para noterit D. Gj. mes shoqërisë ñS. C.òShpk, si nënqiramarrës dhe shoqërisë ñVi.òShpk si nën qiradhënës, ku kjo e dyta, gëzon të drejtën të jetë nën qiradhënës sipas nenit 6.8 të kontratës së qirasë (noteriale) Nr. 1307 Rep, Nr. 377 Kol, datë 28.06.2018 para noterit D. Gj. , **plotësohet pjesërisht kriteri** 2.3.7/a) vërtetim pronësie ose kontratë qiraje për objektin ku do të ushtrohet aktiviteti, por nuk plotëson pjesën tjetër ku është shprehur në ligjëratë të drejtë ñKontrata e qirasë duhet të jetë e vlefshme për gjithë periudhën e parashikuar për kryerjen e shërbimit **dhe duhet të ketë bashkangjitur të gjithë dokumentacionin ligjor, kopje të aktit të pronësisë të qiradhënësit".**

-Vërtetimi i lëshuar nga Drejtoria e Aluizmit Tiranë me nr. 1388/1 prot, datë 21.02.2019 ku shprehet në mënyrë eksplicite se: ñPasi u njohëm me kërkesën tuaj, vërtetojmë si më poshtë: Në përfundim të verifikimeve të kryera në bazën e të dhënave të administruara nga Drejtoria e Aluizmit Tiranë Rurale, rezulton se, I. K. **ka aplikuar për legalizim** objekti pa leje me vetë deklarim **nr. 459 prot, viti 2006** me funksion __ të ndodhur Kashar, si dhe fakti që **nga viti 2006 deri më datë 14.05.2021 (data e observacionit) që nuk është bërë ky legalizim (nuk është paraqitur asnjë dokument legalizues),** provon që jo vetëm është aplikim i cili mund të miratohet/ ose jo, pra nuk është dokument pronësie, por mund të jetë risk i ushtrimit të dispozitave ligjore për ndërtim të paligjshëm, referuar dhe faktit që marrëveshja kuadër është lidhur me nr. 7/26 prot., datë 17.07.2020, me kohëzgjatje për një periudhë 48-mujore, nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshje (periudha 17.07.2020-17.07.2024), e bënë më të lart riskun e përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

-Vendimi i KRRT nr. 7, datë 07.07.2003 për miratimin e destinacionit të sheshit të ndërtimi jo vetë bën fjalë për **Repart Mobilierie** për llogari të Ilir Kafazi dhe Përparim Kepa **dhe jo për ambient pastrim kimik (lavanteri), nuk është leje ndërtimi referuar** Ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998, me ndryshimet vijuese të tij, rregulloren e urbanistikës të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 722, datë 19.11.1998, e ndryshuar, pavarësisht kontratës së qirasë dhe nën qirasë që është konsideruar leje ndërtimi nr. 7 datë 07.07.2003 lëshuar nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Bashkisë Vorë, por është formulari nr. 2, destinacioni i sheshit të ndërtimit. Leja ndërtimi referuar dispozitës së cituar është formulari nr. 4.

-Çertifikatë për vërtetim hipotekor në zonën kadastrale nr. 2679, numri i pasurisë 40/41 vol 18, faqe 116, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 1576 m^2, **nga kjo asnjë m^2 ndërtesë në pronësi Ilir Karafili**, po ashtu dhe kartela e pronësisë.

Kontratë nën qiraje (noteriale) me Nr. 1642 Rep, Nr. 471/2 Kol, datë 08.08.2018 lidhur para noterit D.Gj. ndërmjet shoqërisë ñS.C.ò Shpk si nën qiramarrës dhe shoqërisë ñVi. ò Shpk si nën qiradhënës, ku kjo e dyta, gëzon të drejtën të jetë nën qiradhënës sipas nenit 6.8 të kontratës së qirasë (noteriale) Nr. 1307 Rep, Nr. 377 Kol datë 28.06.2018 para noterit D.Gj. dhe vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Aluizmit Tiranë me nr. 1388/1 prot, datë 21.02.2019, ka një kontradiksion (kundërshtojnë njëra tjetrën). Në kontratën e qirasë dhe nën qirasë bëhet fjalë për një ndërtim të kryer me leje ndërtimi, **pra ndërtim i ligjshëm, ndërsa në** vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Aluizmit Tiranë **bëhet fjalë për objekt pa leje** me vet deklarim nr. 459 prot, viti 2006.

Dokumenti i pronësisë jepet në ato raste kur ka përfunduar objekti, është kolauduar, është dhënë leja e shfrytëzimit, është nxjerr çertifikata e pronësisë ose vërtetim dokumenti hipotekor, dhe jo formulari 2 Destinacionin e sheshit të ndërtimi as dhe formulari nr. 4 leja e ndërtimit, apo një vërtetim legalizimi që ka vetë deklaruar, që mund të jetë një objekt çfarëdo. Vërtetimi hipotekor i

pronësisë apo çertifikata e pronësisë janë i vetmi dokumentacion që lëshohen nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore e Kadastrës në zbatim të Ligjit nr. 111/2018 ñPër kadastrënò.
Kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik ñS.C.ò Shpk është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 46, neni 53 pika 3, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñRregullat e Prokurimitò, i ndryshuar, neni 66 pika 3, Ligjin nr. 44/2015 ñKodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisëò nenet 108-118.
Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi KVO e përbër nga V. R. me detyrë zv/ drejtor teknik, V. S. me detyrë përgjegjës i sektorit të shërbimeve dhe B. Ve.me detyrë jurist, komisioni i shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik "S.C." Shpk, i përbërë nga G. H., M. S.j dhe I. P., si dhe pasqyron mangësi të Komisionit të Prokurimit Publik.
Pavarësisht shkeljeve dhe parregullsive ligjore ose rregullatore të përmendur si më sipër, veprimet e mësipërme nga KVO janë kryer nga mos njohja/ose keqinterpretimi i legjislacionit specifik të procedurave të prokurimit dhe në veçanti atij të mallrave dhe nuk kanë krijuar asnjë pasojë financiare në dëm Institucionit, pasi operatori ekonomik ñS.C.ò Shpk është me vlerë më të vogël, nga operatorët ñDE.ò Shpk dhe Bashkimit i operatorëve ñKo. Inv.ò Shpk & ñBa. Lau. ò të cilët janë sôkualifikuar, pasi ofertat respektive të tyre edhe sikur të kualifikoheshin, janë në vlerën 159,432,100 lekë dhe në vlerën 164,556,600 lekë (më të mëdha se oferta fituese). Gjithsesi për shkeljet dhe parregullsitë e përmendura më lart, del më se e domosdoshme marrja e masave urgjente për të korrigjuar këtë praktikë në zhvillimin e proceduarve të prokurimit. Qëllimi i këtyre masave është jo vetëm ndreqja e gjendjes së shkeljeve dhe parregullsive, por edhe ndikimi me anë të efektit parandalues mbi punonjësit e tjerë të administratës, për të parandaluar për të ardhmen shkeljet e ligjeve.
Likuiduar me:
-Urdhër shpenzimin nr. 478 datë 18.08.2020 për vlerën 947,614 lekë, për periudhën 21-31 korrik 2020. Dokument vërtetues, fatura nr. 16 datë 31.07.2020 me objekt ñ Furnizim të shërbimit të lavanterisëò kg 3002.58 kg x 263 lekë/kg n= 947,614 lekë. Akt-rakordim për likuidim datë 31.07.2020 firmosur nga E. O., V. S., E. Xh. , A. Rr., I. P., zv/drejtori ekonomik A. H.dhe O. Z. administrator i shoqërisë ñS.C.ò Shpk. Tabela për datat 21-31.07.2020 për secilin material, firmosur nga E. O. dhe O. Z. administrator i shoqërisë ñS.C.ò Shpk.
-Urdhër shpenzimin nr. 604 datë 15.09.2020 për vlerën 2,922,661 lekë, për muajin gusht 2020. Dokument vërtetues fatura nr. 27 datë 31.08.2020 me objekt ñ Furnizim të shërbimit të lavanterisëò kg 9260.25 kg x 263 lekë/kg n= 2,922,661 lekë. Akt-rakordim për likuidim datë 31.08.2020 firmosur nga E. O. , V. S. , E. Xh. , A. Rr. , I. P. , zv/drejtori ekonomik A. H. dhe O. Z. administrator i shoqërisë S. C.ò Shpk. Tabela për datat 01-31.08.2020 për secilin material, firmosur nga E. O. dhe O. Z. administrator i shoqërisë ñS.C.ò Shpk.
Urdhër shpenzimin nr. 665 datë 14.10.2020 për vlerën 3,892,610 lekë, për muajin shtator 2020. Dokument vërtetues fatura nr. 44 datë 30.09.2020 me objekt ñFurnizim të shërbimit të lavanterisëò kg 12,334 kg x 263 lekë/kg n= 3,892,610 lekë. Akt-rakordim për likuidim datë 30.09.2020 firmosur nga V. S. , E. Xh. , M. P. , A. Rr. , I. P. , zv/drejtori ekonomik A. H. dhe O. Z. administrator i shoqërisë S. C. ò Shpk. Tabela për datat 01-30.09.2020 për secilin material, firmosur nga E. Xh. dhe O. Z. administrator i shoqërisë ñS.C.ò Shpk.
Urdhër shpenzimin nr. 696 datë 10.11.2020 për vlerën 4,999,104 lekë, për muajin tetor 2020. Dokument vërtetues fatura nr. 3111 datë 31.10.2020 me objekt ñFurnizim të shërbimit të lavanterisëò kg 15,840 kg x 263 lekë/kg n= 4,999,104 lekë. Akt-rakordim për likuidim datë 31.10.2020 firmosur nga V. S., M. P. , M . S. , A. Rr. , I. P. , dhe O. Z. administrator i shoqërisë

ñS.C.ò Shpk. Tabela për datat 01-30.10.2020 për secilin material, firmosur nga M. P. dhe O. Z. administrator i shoqërisë S. C.ò Shpk.
Urdhër shpenzimin nr. 769 datë 09.12.2020 për vlerën 5,414,118 lekë, për muajin nëntor 2020. Dokument vërtetues fatura nr. 50 datë 30.11.2020 me objekt ñFurnizim të shërbimit të lavanterisëò kg 17,155 kg x 263 lekë/kg n= 5,414,118 lekë. Akt-rakordim për likuidim datë 30.11.2020 firmosur nga V. S. , M. P. , M. S. , A. Rr. , I. P. , dhe O. Z. administrator i shoqërisë ñS.C.ò Shpk. Tabela për datat 01-30.11.2020 për secilin material, firmosur nga M. P. dhe O. Z. administrator i shoqërisë S .C.ò Shpk.
-Urdhër shpenzimin nr. 792 datë 21.12.2020 për vlerën 2,132,935 lekë, për muajin 01-11.12.2020. Dokument vërtetues fatura nr. 52 datë 11.12.2020 me objekt ñFurnizim të shërbimit të lavanterisëò kg 6,758.35 kg x 263 lekë/kg n= 2,132,935 lekë. Akt-rakordim për likuidim datë 11.12.2020 firmosur nga V. S. , M. P. , M. S. , A. Rr. , I. P. , dhe O. Z. administrator i shoqërisë ñS.C.ò Shpk. Tabela për datat 01-11.12.2020 për secilin material, firmosur nga M. P. dhe O. Z.administrator i shoqërisë S. C. ò Shpk.
Urdhër shpenzimin nr. 795 datë 21.12.2020 për vlerën 778,857 lekë, për muajin 12-15.12.2020. Dokument vërtetues fatura nr. 53 datë 15.10.2020 me objekt ñFurnizim të shërbimit të lavanterisëò kg 2,467.86 kg x 263 lekë/kg n= 778,857 lekë. Akt-rakordim për likuidim datë 11.12.2020 firmosur nga V. S. , M. P. , M. S. , A. Rr. , I. P. , dhe O. Z. administrator i Shoqërisë ñS.C.ò Shpk. Tabela për datat 12-15.12.2020 për secilin material, firmosur nga M. P. dhe O. Z. administrator i shoqërisë ñS.C.ò Shpk.
Urdhër shpenzimin nr. 422 datë 31.12.2020 për vlerën 2,825,295 lekë, për muajin 16-31.12.2020. Dokument vërtetues fatura nr. 65 datë 31.12.2020 me objekt ñFurnizim të shërbimit të lavanterisëò kg 2,467.86 kg x 263 lekë/kg n= 778,857 lekë. Akt-rakordim për likuidim datë 31.12.2020 firmosur nga V. S. , M. P. , M. S. , A. Rr. , I . P. , dhe O. Z. administrator i Shoqërisë ñS.C.ò Shpk. Tabela për datat 16-31.12.2020 për secilin material, firmosur nga M. P. dhe O. Z.administrator i shoqërisë S. C. ò Shpk.
Referuar dhe trendit të zbatimit të kontratës, pavarësisht proçedurës së prokurimit, po shkohet në nivelin e shpenzimit të fondit limit dhe jo atij të prokuruar.

6. Proçedura e prokurimit me objekt "Trajtimin e mbetjeve spitalore për SUT", viti 2020.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: ñTrajtimin e mbetjeve spitalore për SUTò Marrëveshje Kuadër me nje Operator Ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë 24 mujore nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuader		
1. Urdhër Prokurimi nr. 141/5 datë 13.01.2020 2. Lloji i Procedurës së Prokurimit ñProcedurë e hapurò	3. Njësia e prokurimit Urdhër nr. 141/5 datë 13.01.2020 - G. H. me detyrë me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimit - G. P. me detyrë specialist pajisjesh. A. G. me detyrë kryeinfermier i kirurgjisë	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 141/6 datë 13.01.2020 - V. S. me detyrë përgjegjës i sektorit të shërbimeve të brendshme - L. H. me me detyrë përgjegjës i sektorit teknik - M. S. me detyrë specialist prokurimi
5. Fondi Limit (pa tvsh) 57,164,200 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 57,086,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 78,200
8. Data e hapjes së tenderit 06.02.2020	9.Burimi Financimit Fond nga Buxheti i Shtetit	10.Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër _2___OE b)Sôkualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar___1__OE
11. Ankimime Nuk ka APPï sôka; KPP-Ka Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK -nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik Nuk ka
B .Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		

14. Lidhja e marrëveshjes kuadër nr. 141/19 prot., datë 02.03.2020 15. Vlera e marrëveshjes kuadër (me tvsh) 68,597,040 lekë	16. Lidhja e kontratës nr. 141/25 prot., datë 27.03.2020 17. Vlera e kontratës (me tvsh) 14,826,720 leke 18. Lidhja e kontratës nr. 141/29 prot., datë 25.08.2020 19. Vlera e kontratës (me tvsh) 12,105,360 leke	20. Lidhja e kontratës nr. 141/32 prot., datë 05.01.2021 21. Vlera e kontratës (me tvsh) 25,149,120 leke

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.)të A.P.P, u konstatua se:
Fondi i këtij i këtij investimi është akorduar nga Buxheti i Shtetit me vlerë 57,164,200 lekë.
Kjo procedurë është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike.
-Me kërkesën nr. 797 prot., datë 23.12.2019 drejtuar G. H. me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimeve, E. O. me detyrë përgjegjëse e sektorit të planifikimit, ka bërë kërkesë për ñTrajtimin e mbetjeve spitaloreò për një periudhë 24-mujore, fond i cili është planifikuar në investimet e vitit 2020, me financim nga fondet e buxhetit të Shtetit (Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale).
Me urdhër të Drejtorit të Spitalit nr. 141, datë 26.12.2019, është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike i përbërë nga L. H. me detyrë përgjegjës i sektorit teknik, G. P. me detyrë specialist pajisjesh, A. G. me detyrë kryeinfermier.
Me protokoll nr. 141/1 datë 31.12.2019, grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike, ka hartuar specifikimet teknike.
Me urdhër të Drejtorit të Spitalit nr. 141 /2, datë 06.01.2020, është ngritur grupi i punës për argumentin e fondit limit i përbërë nga G. H. me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimeve, M. P. me profesion ekonomiste, A. D. me profesion ekonomiste.
Me dokument të protokolluar nr. 141/3 datës 10.01.2020 grupi i përllogaritjes së vlerës së kontratës, i ngritur me urdhrin e drejtorit të spitalit 141 /2, datë 06.01.2020 ka përcaktuar vlerën 57,164,200 lekë pa TVSH dhe 68,597,040 lekë me TVSH.
Pra, përllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në vlerën 57,164,200 lekë, sipas çmimit për njësi të marrë bazuar në çmimin e kontratës të vitit 2019 me Nr. 11/29 prot. Date 15.04.2019 dhe Marrëveshjes kuadër me Nr. 11/24 prot., date 12.04.2019.
Nga grupi për llogaritjen e vlerës limit të kontratës, ***nuk është dhënë asnjë argumentim*** *përse nuk është marrë për bazë edhe* çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, si QSUT, Shefqet Ndroqi, private, etj.
Veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 59, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se ñNë përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet tõ referohet një ose më shumë alternativave të renditura si mëposhtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe
a) çmimet e tregut;ose/dhe
b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe
ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.
Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

Si konkluzion, përllogaritja e vlerës së kontratës, është bërë duke u mbështetur në çmimet e kontratave të mëparshme, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, i spitaleve te tjera (QSUT, Shefqet Ndroqi, spitaleve private etj), veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 59, pika 2.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi grupi i përllogaritjes së vlerës së kontratës i përbërë nga G. H. , M. P. dhe A. D. .

Me urdhër të Drejtorit të Spitalit me nr. 141/4 datë 13.01.2020, është përcaktuar procedura e prokurimit ñProçedurë e hapurò, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushte janë përcaktuar për një periudhë 24-mujore, është ngritur njësia e prokurimit e përbërë nga G. H. me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimit, G. P. me profesion specialist pajisjesh, A. G. me profesion kryeinfermier i kirurgjisë.

Me urdhër të Drejtorit të Spitalit me nr. 141/5 datë 13.01.2020, është ngritur urdhri i prokurimit për kryerjen e prokurimit me procedurë të hapur, marrëveshje kuadër ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me periudhë 24-mujore., duke ngarkuar për zbatimin e kësaj proçdurë njësinë e prokurimit e përbërë nga G. H. me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimit, G. P. me profesion specialist pajisjesh, A. G. me profesion kryeinfermier i kirurgjisë.

Me urdhër te Drejtorit te Spitalit me nr. 141/6 date 13.01.2020 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave nga V. S. me detyrë përgjegjës i sektorit të shërbimeve, L. H. me detyrë përgjegjës i sektorit teknik dhe M. S. me detyre specialist prokurimi.

Njoftimi i kontratës është bërë me nr 141/7 prot., datë 13.01.2020

- Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim/specifikimet teknike.

Kërkesat për kualifikim janë miratuar me proçesverbalin nr. 1, datë 13.01.2020 nga njësia e prokurimit e përbërë nga G. H. , G. P. , A. G. . Në këto kërkesa nuk janë dhënë arsye konkrete në argumentimin e kritereve të vlerësuara për objektin e prokurimit, në raport me natyrën dhe përmasat e këtij objekti

Konkretisht, në nenin 61, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, parashikohet se: "Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit".

Nuk ka një dokument shkresor (procesverbal etj) të njësisë së prokurimit, ku të jenë miratuar dokumentet e tenderimit (D.T.) dhe në veçanti nuk ka një dokument shkresor ku të jenë përcaktuar kriteret e vlerësimit, edhe pse në S.P.E, është përcaktuar çmimi më i ulët. Konkretisht, në nenin 61, pika 1, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, parashikohet se: Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje më këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi, ndërsa në pikën 2 të këtij neni parashikohet se: Seti i dokumenteve të tenderit firmoset në çdo faqe nga njësia e prokurimit.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi G. , G. P. , A. G. .

Me urdhër nr. 141/8, datë 31.01.2020, të Drejtorit te Spitalit, është bërë pezullimi i procedurës së prokurimit, për arsye rekomandimeve të ardhura nga koordinimi me APP.
Me shkresën nr. 141/9 prot., datë 31.01.2020, i është drejtuar Drejtorit të Spitalit nga njësia e prokurimit e përbërë nga G. H. , G. P. , A. G. një rekomandim pas shqyrtimit të rekomandimeve të zyrës së koordinimit të APP-së.
Me shkresën Nr. 141/10 prot., datë 31.01.2020, bazuar në rekomandimet e APP-së, njësia prokurimit hartoi shtojcë DST Nr. 1 duke bërë sqarimet përkatëse mbi specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta të kualifikimit.
Me ndryshimin e dokumenteve të tenderit (Specifikimeve teknike), nuk është bërë shtyrja e afatit kohor për dorëzimin e ofertave me 5 ditë, veprim në kundërshtim me neni 42, pika 2/1 Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, me ndryshimet vijuese të tij,
Me urdhër nr. 141/11, datë 31.01.2020, të Drejtorit të Spitalit është bërë, heqja e pezullimit të procedurës së prokurimit.
Me datë 06.02.2020 është mbajtur një procesverbal nga Komisioni i vlerësimit të ofertave i përbëre nga V. S. , L. H. , M. S. për dorëzimin e mostrave.
Me shkresën nr. 141/12 prot, datë 10.02.2020, komisioni i vlerësimit të ofertave i drejtohet G. H. në cilësinë e përgjegjësit të sektorit të prokurimeve për verifikim në sistemin e drejtësisë të subjekteve pjesëmarrës në këtë proçedurë prokurimi, për operatorët ekonomik ñM. ï T.ò Shpk dhe ñE. R.ò Shpk.
Me shkresën nr. 141/13 prot, datë 11.02.2020, G. H. në cilësinë e përgjegjësit të sektorit të prokurimeve, i kthen përgjigje komisionit të vlerësimit të ofertave për rezultatin në regjistrin gjyqësorë të Ministrisë së Drejtësisë të subjekteve pjesëmarrës në këtë proçedurë prokurimi, duke bashkëlidhur dhe çertifikata elektronike respektive për çdo subjekt të kërkuar.
Zhvillimi i procedurë së prokurimit.
Në këtë procedurë prokurimi kanë marr pjesë operatorët ekonomike.
-Operatori ekonomik ñM. - T.ò Shpk, me ofertë në vlerën 47,222,600 lekë.
- Operatori ekonomik ñE. R.ò Shpk, me ofertë në vlerën 57,086,000 lekë.
Me shkresën Nr. 141/15 prot., datë 13.02.2020 dhe me shkresën 141/14 prot., datë 13.02.2020 është hartuar nga Komisioni i Vlerësimit të ofertave nje procesverbal konstatimi për verifikimin e impiantit te përpunimit te mbetjeve për OE ñME. - T.ò Shpk dhe ñEC. RIC.ò Shpk.
Pas vlerësimit të KVO u kualifikua dhe shpall fitues Operatori ekonomik ò EC. RIC.ò Shpk, me ofertë në vlerën 57,086,000 lekë.
Raporti përmbledhës nga komisioni i vlerësimit është hartuar me nr. 141/16 prot., datë 25.02.2020, raport i cili është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor, ku ka shpallur fitues operatorin ekonomik ò E. R.ò Shpk, me ofertë në vlerën 57,086,000 lekë.
Në S.P.E. e A.P.P, është kryer njoftimi i fituesit, nga ku A.P.P e ka bërë aktive publikimin e njoftimit të fituesit në datën 26.02.2020.
Titullarit të Autoritetit Kontraktor me urdhrin nr. 141/18, datë 25.02.2020, ka ngarkuar njësinë së prokurimit për administrimin e dokumenteve të tenderit të dorëzuar nga operatori ekonomik fitues dhe lidhjen e kontratës.
Marrëveshja kuadër është lidhur me nr. 141/19 prot., datë 02.03.2020, ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës të përfaqësuar nga A. Z.në cilësinë e Drejtorit të Spitalit dhe operatorit/e shoqërisë ñE. R. ò Shpk në vlerën 57,086,000 lekë pa TVSh, kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër është për periudhën 02.03.2020 deri më 02.03.2022, me datë fillimi nënshkrimin e saj.
Në datën 25.02.2020 në S.P.E. e A.P.P, është kryer publikimi i njoftimit të lidhjes së kontratës, nga ku A.P.P. e ka bërë aktive këtë publikim në datën 26.02.2020 .

Me urdhër nr. 141/20, datë 02.03.2020 të Drejtorit të Spitalit, është ngritur grupi i punës për monitorimin dhe zbatimin e marrëveshjes kuadër i përbërë nga L. H. me detyre përgjegjës i sektorit teknik, G. P. me detyrë specialist pajisjesh, A. G. me detyrë kryeinfermier, M. Dh. me detyrë elektricist, R. M. me detyrë elektricist.
Me shkresën Nr. 141/21 prot., datë 05.03.2020 është formulari i publikimit të njoftimit të kontratës së nënshkruar.
Me shkresën nr. 171 prot, datë 27.03.2020, grupi i punës për monitorimin dhe zbatimin e kontratës drejtuar G. H. , i kërkon lidhje kontrate për Trajtimin e mbetjeve spitalore për SUT në vlerën 12,355,600 lekë
Me shkresën nr. 141/23 prot, datë 27.03.2020,Titullari i Autoritetit Kontraktor, i kërkon operatorit ekonomik kërkesë për dhënie oferte për trajtimin e mbetjeve spitalore për SUT.
Operatori ekonomik ñEC. RIC.ò paraqet ofertën e cila është protokolluar me nr. 141/24 prot., datë 27.03.2020, ku ka përcaktuar çmimin për shërbimin, me vlerë totale 12,355,600 lekë pa TVSH dhe me TVSH 14,826,720 lekë .
Kontrata është lidhur me nr. 141/25 prot., datë 27.03.2020 ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës të përfaqësuar nga A. Z. në cilësinë e Drejtorit të Spitalit dhe operatorit/e shoqërisë ñEC. RIC. ò Shpk në vlerën 14,826,720 lekë me TVSh, kontrata duhet të fillojë zbatimin me nënshkrimin e palëve deri më 31.08.2020.
Me shkresën Nr. 28 prot., date 07.05.2020 OE ñ M. ï T. ò Shpk i drejtohet SUT me kërkesën për tërheqjen e mostrave.
Komisionit i Vlerësimit të ofertave harton 2 procesverbale me datë 12.05.2020 për dorëzimin e mostrave tek OE ñM. - T.ò Shpk dhe E. R.ò Shpk.
Me shkresën Nr. 141/26 prot., date 02.06.2020, Titullari i Autoritetit Kontraktor urdhëron grupi i punës për monitorimin dhe zbatimin e marrëveshjes kuadër të monitorojë dhe zbatojë Marrëveshjen Kuadër.
Me shkresën nr. 443/1 prot, datë 24.08.2020, grupi i punës për monitorimin dhe zbatimin e kontratës drejtuar G. H. , i kërkon lidhje kontrate për Trajtimin e mbetjeve spitalore për SUT në vlerën 10,505,000 lekë.
Me shkresën nr. 141/27 prot, datë 25.08.2020,Titullari i Autoritetit Kontraktor, i kërkon operatorit ekonomik kërkesë për dhënie oferte për trajtimin e mbetjeve spitalore për SUT.
Operatori ekonomik ñE. R. ò paraqet ofertën e cila është protokolluar me nr. 141/28 prot., datë 25.08.2020, ku ka përcaktuar çmimin për shërbimin, me vlerë totale 10,087,800 lekë pa TVSH dhe me TVSH 12,105,360 lekë .
Kontrata është lidhur me nr. 141/29 prot., datë 25.08.2020 ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës të përfaqësuar nga A. Z. në cilësinë e Drejtorit të Spitalit dhe operatorit/e shoqërisë ñE.R.ò Shpk në vlerën 12,105,360 lekë me TVSh, kontrata duhet të fillojë zbatimin me nënshkrimin e palëve deri më 31.12.2020.
Titullari i Autoritetit Kontraktor me urdhrin nr. 1795, datë 14.09.2020 ngrihet komisioni per funksionimin e shërbimit të mbetjeve të rrezikshme spitalore dhe monitorimin e marrëveshjes kuadër nga V. S. me detyrë përgjegjës i sektorit të shërbimeve të brendshme, G. P. me detyrë specialist pajisjesh dhe A. L. me detyrë oksigjenist.
Me shkresën nr. 692 prot, datë 31.12.2020, grupi i punës për monitorimin dhe zbatimin e kontratës drejtuar G. H. , i kërkon lidhje kontrate për Trajtimin e mbetjeve spitalore për SUT në vlerën 20,957,600 lekë pa TVSH.
Me shkresën nr. 141/30 prot, datë 05.01.2020,Titullari i Autoritetit Kontraktor, i kërkon operatorit ekonomik kërkesë për dhënie oferte për trajtimin e mbetjeve spitalore për SUT.

Operatori ekonomik ñE. R.ò paraqet ofertën e cila është protokolluar me nr. 141/31 prot., datë 05.01.2020, ku ka përcaktuar çmimin për shërbimin, me vlerë totale 20,957,600 lekë pa TVSH dhe me TVSH 25,149,120 lekë .
Kontrata është lidhur me nr. 141/32 prot., datë 05.01.2020 ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës të përfaqësuar nga A. Z. në cilësinë e Drejtorit të Spitalit dhe operatorit/e shoqërisë ñEC. RIC.ò Shpk në vlerën 25,149,120 lekë me TVSh, kontrata duhet të fillojë zbatimin me nënshkrimin e palëve deri më 29.09.2020.
Titullari i Autoritetit Kontraktor me urdhrin nr. 141/33, datë 01.02.2020 ngrihet komisioni per funksionimin e shërbimit të mbetjeve të rrezikshme spitalore dhe monitorimin e marrëveshjes kuadër nga V. S. me detyrë përgjegjës i sektorit të shërbimeve të brendshme, G. P. me detyrë specialist paisjesh dhe L. Ll.me detyrë infermier.

7. Proçedura e prokurimit me objekt "Trajtimin e mbetjeve spitalore për SUT", viti 2018.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: ñTrajtimin e mbetjeve spitalore për SUTò Marrëveshje Kuadër me nje Operator Ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë 12 mujore nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër		
1. Urdhër Prokurimi nr. 63/6 datë 30.04.2018 2. Lloji i Procedurës së Prokurimit ñProcedurë e hapurò	3. Njësia e prokurimit Urdhër nr. 63/6 datë 30.04.2018 - G. H. me detyrë me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimit - E. T. me detyrë specialist pajisjesh. B. V. me detyrë jurist	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 63/7 datë 30.04.2018 - L. N. me detyrë përgjegjës i sektorit të statistikës (Mjek epidemiolog) - E. T. me detyrë juriste - M. S. me detyrë specialist prokurimi
5. Fondi Limit (pa tvsh) 27,010,000 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 27,010,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 0
8. Data e hapjes së tenderit 25.05.2018	9. Burimi Financimit Fond nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër _2___OE b) Sõkualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar___1__ OE
11. Ankimime Nuk ka APPï sõka; KPP-Ka Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK -nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik Nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14 .Lidhja e marrëveshjes kuadër nr. 63/12 prot., datë 27.06.2018 15. Vlera e marrëveshjes kuadër (me tvsh) 27,010,000 lekë	16 .Lidhja e kontratës nr. 63/17 prot., datë 28.06.2018 17. Vlera e kontratës (me tvsh) 16,605,600 leke 18. Lidhja e kontratës nr. 63/21 prot., datë 15.10.2018 19. Vlera e kontratës (me tvsh) 8,658,000 leke	20. Lidhja e kontratës nr. 255/2 prot., datë 31.12.2018 21. Vlera e kontratës (me tvsh) 7,148,400 leke

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.)të A.P.P, u konstatua se:
Fondi i këtij i këtij investimi është akorduar nga Buxheti i Shtetit me vlerë 27,010,000 lekë.
Kjo procedurë është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike.
-Me kërkesën nr. 102 prot., datë 02.03.2018 drejtuar G. H. me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimeve, E. O. me detyrë përgjegjëse e sektorit të planifikimit, ka bërë kërkesë për ñTrajtimin e mbetjeve spitaloreò për një periudhë 12-mujore, fond i cili është planifikuar në investimet e vitit 2018, me financim nga fondet e buxhetit të Shtetit (Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale).
Me urdhër të Drejtorit të Spitalit nr. 63, datë 09.03.2018, është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike i përbërë nga L. N. me detyrë përgjegjës i sektorit të statistikës (Mjek

epidemiolog), L. S. me detyrë kryeinfermiere e përgjithshme, E. T. me detyrë specialist pajisjesh.
Me protokoll nr. 118 datë 16.03.2018, grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike, ka hartuar specifikimet teknike.
Me urdhër të Drejtorit të Spitalit nr. 63 /1, datë 30.03.2018, është ngritur grupi i punës për argumentin e fondit limit i përbërë nga V. S. me detyrë përgjegjës i sektorit të shërbimeve, S. Gj. me detyrë kryeinfermiere e urgjencës, Dh. M. me detyrë specialiste prokurimi (me profesion ekonomiste).
Me dokument të protokolluar nr. 63/5 datës 27.04.2018 grupi i përllogaritjes së vlerës së kontratës, i ngritur me urdhrin e drejtorit të spitalit 63 /1, datë 30.03.2018 ka përcaktuar vlerën 27,010,000 lekë pa TVSH dhe 32,412,000 lekë me TVSH.
Pra, përllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në vlerën 27,010,000 lekë, sipas një mesatareje të çmimit ndërmjet Institucioneve (të marrë bazuar në çmimin e kontratave të ngjashme nga Spitali i Elbasanit dhe nga Spitali Koco Glozheni) dhe dy operatorëve ekonomikë, E. R. Shpk dhe Me. Shpk.
Me urdhër të Drejtorit të Spitalit me nr. 63/6 datë 30.04.2018, është përcaktuar procedura e prokurimit ñProçedurë e hapurò, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushte janë përcaktuar për një periudhë 12-mujore, është ngritur njësia e prokurimit e përbërë nga G. H. me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimit, E. T. me profesion specialist pajisjesh, B. V. me profesion jurist.
Me urdhër te Drejtorit te Spitalit me nr. 63/7 date 30.04.2018, është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave nga L. N. me detyrë përgjegjës i sektorit të statistikës (Mjek epidemiolog), E. T. me detyrë juriste dhe M. S. me detyre specialist prokurimi.
Njoftimi i kontratës është bërë me nr 63/8 prot., datë 30.04.2018
- *Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim/specifikimet teknike.*
Kërkesat për kualifikim janë miratuar me proçesverbalin nr. 1, datë 30.04.2018 nga njësia e prokurimit e përbërë nga G. H. me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimit, E. T. me profesion specialist pajisjesh, B. V. me profesion jurist. Në këto kërkesa nuk janë dhënë arsye konkrete në argumentimin e kritereve të vlerësuara për objektin e prokurimit, në raport me natyrën dhe përmasat e këtij objekti
Konkretisht, në nenin 61, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, parashikohet se: "Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit".
Nuk ka një dokument shkresor (procesverbal etj) të njësisë së prokurimit, ku të jenë miratuar dokumentet e tenderimit (D.T.) dhe në veçanti nuk ka një dokument shkresor ku të jenë përcaktuar kriteret e vlerësimit, edhe pse në S.P.E, është përcaktuar çmimi më i ulët. Konkretisht, në nenin 61, pika 1, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, parashikohet se: Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje më këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi, ndërsa në pikën 2 të këtij neni parashikohet se: Seti i dokumenteve të tenderit firmoset në çdo faqe nga njësia e prokurimit.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi G. H., E. T., B. V.
Zhvillimi i procedurë së prokurimit.
Në këtë procedurë prokurimi kanë marr pjesë operatorët ekonomike.
- Operatori ekonomik ñM. - T.ò Shpk, me ofertë në vlerën 28,032,000 lekë.
- Operatori ekonomik òE. R.ò Shpk, me ofertë në vlerën 27,010,000 lekë.
- Operatori ekonomik ñ E. S.ò Shpk, pa ofertë ekonomike
- Operatori ekonomik ñ B Pò Shpk, pa ofertë ekonomike

Janë sõkualifikuar operatorët ekonomikë:
-Operatori ekonomik ñM. T.ò Shpk, me ofertë në vlerën 28,032,000 lekë me arsyetimin se nuk plotëson kriteret e kualifikimit dhe oferta është mbi fondin limit të parashikuar.
- Operatori ekonomik ñE Sò Shpk, pa ofertë ekonomike
me arsyetimin se nuk ka paraqitur dokumentacion.
- Operatori ekonomik ñB Pò Shpk, pa ofertë ekonomike me arsyetimin se nuk ka paraqitur dokumentacion.

Pas vlerësimit të KVO u kualifikua dhe shpall fitues Operatori ekonomik ñE. R.ò Shpk, me ofertë në vlerën 27,010,000 lekë.
Raporti përmbledhës nga komisioni i vlerësimit është hartuar me nr. 63/9 prot., datë 26.06.2018, raport i cili është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor, ku ka shpallur fitues operatorin ekonomik ò E. R.ò Shpk, me ofertë në vlerën 27,010,000 lekë.
Në S.P.E. e A.P.P, është kryer njoftimi i fituesit, nga ku A.P.P e ka bërë aktive publikimin e njoftimit të fituesit në datën 26.06.2018.
Titullarit të Autoritetit Kontraktor me urdhrin nr. 63/11, datë 26.06.2018, ka ngarkuar njësinë së prokurimit për administrimin e dokumenteve të tenderit të dorëzuar nga operatori ekonomik fitues dhe lidhjen e kontratës.
Marrëveshja kuadër është lidhur me nr. 63/12 prot., datë 27.06.2018, ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës të përfaqësuar nga A. Z. në cilësinë e Drejtorit të Spitalit dhe operatorit/e shoqërisë ñE. R.ò Shpk në vlerën 27,010,000 lekë pa TVSh, kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër është për periudhën 27.06.2018 deri më 27.06.2019, me datë fillimi nënshkrimin e saj.
Në datën 02.07.2018 në S.P.E. e A.P.P, është kryer publikimi i njoftimit të lidhjes së kontratës, nga ku A.P.P. e ka bërë aktive këtë publikim në datën 03.07.2018 .
Me urdhër nr. 63/13, datë 27.06.2018 të Drejtorit të Spitalit, është ngritur grupi i punës për monitorimin dhe zbatimin e marrëveshjes kuadër i përbërë nga A. T. me detyre përgjegjës i sektorit teknik, G. P. me detyrë specialist pajisjesh, L. Ll. me detyrë kryeinfermier, M. Dh. me detyrë elektricist, R. M. me detyrë elektricist.
Me shkresën nr. 63/14 prot, datë 27.06.2018, grupi i punës për monitorimin dhe zbatimin e kontratës drejtuar G. H., i kërkon lidhje kontrate për trajtimin e mbetjeve spitalore për SUT në vlerën 13,838,000 lekë
Me shkresën nr. 63/15 prot., datë 27.06.2018, Titullari i Autoritetit Kontraktor, i kërkon operatorit ekonomik kërkesë për dhënie oferte për trajtimin e mbetjeve spitalore për SUT.
Operatori ekonomik ñE. R.ò paraqet ofertën e cila është protokolluar me nr. 63/16 prot., datë 28.06.2018, ku ka përcaktuar çmimin për shërbimin, me vlerë totale 13,838,000 lekë pa TVSH dhe me TVSH 16,605,600 lekë .
Kontrata është lidhur me nr. 63/14 prot., datë 27.06.2018 ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës të përfaqësuar nga A. Z. në cilësinë e Drejtorit të Spitalit dhe operatorit/e shoqërisë ñE.R.ò Shpk në vlerën 16,605,600 leke me TVSh, kontrata duhet të fillojë zbatimin me nënshkrimin e palëve deri më 31.12.2018.

Me shkresën nr. 2155 prot, datë 15.10.2018, grupi i punës për monitorimin dhe zbatimin e kontratës drejtuar G. H., i kërkon lidhje kontrate për trajtimin e mbetjeve spitalore për SUT në vlerën 7,215,000 lekë.
Me shkresën nr. 63/19 prot., datë 15.10.2018,Titullari i Autoritetit Kontraktor, i kërkon operatorit ekonomik kërkesë për dhënie oferte për trajtimin e mbetjeve spitalore për SUT.
Operatori ekonomik ñE. R.ò paraqet ofertën e cila është protokolluar me nr. 63/20 prot., datë 15.10.2018, ku ka përcaktuar çmimin për shërbimin, me vlerë totale 7,215,000 lekë pa TVSH dhe me TVSH 8,658,000 lekë .
Kontrata është lidhur me nr. 63/21 prot., datë 15.10.2018 ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës të përfaqësuar nga A. Z. në cilësinë e Drejtorit të Spitalit dhe operatorit/e shoqërisë ñE.R.ò Shpk në vlerën 8,658,000 lekë me TVSh, kontrata duhet të fillojë zbatimin me nënshkrimin e palëve deri më 31.12.2020.
Me shkresën nr. 255 prot., datë 31.12.2018,Titullari i Autoritetit Kontraktor, i kërkon operatorit ekonomik kërkesë për dhënie oferte për trajtimin e mbetjeve spitalore për SUT.
Operatori ekonomik ñE. R.ò paraqet ofertën e cila është protokolluar me nr. 255/1 prot., datë 31.12.2018, ku ka përcaktuar çmimin për shërbimin, me vlerë totale 462.5 lekë për kg.
Kontrata është lidhur me nr. 255/2 prot., datë 31.12.2018 ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës të përfaqësuar nga A. Z. në cilësinë e Drejtorit të Spitalit dhe operatorit/e shoqërisë ñE.R.ò Shpk në vlerën 7,148,400 lekë me TVSh, kontrata duhet të fillojë zbatimin me nënshkrimin e palëve deri më 27.06.2019.

8. Proçedura e prokurimit me objekt "Trajtimin e mbetjeve spitalore për SUT", viti 2019.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: ñTrajtimin e mbetjeve spitalore për SUTò Marrëveshje Kuadër me nje Operator Ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë 12 mujore nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër		
1. Urdhër Prokurimi nr. 11/4 datë 08.02.2019 2. Lloji i Procedurës së Prokurimit ñProcedurë e hapurò	3. Njësia e prokurimit Urdhër nr. 11/4 datë 08.02.2019 - G. H. me detyrë me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimit - G. P. me detyrë specialist paisjesh. - B. V. me detyre Jurist	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 11/5 datë 08.02.2019 - A. T. me detyrë përgjegjës i sektorit teknik - M. S. me detyrë specialist prokurimi - Dh. M. me me detyrë specialiste prokurimi
5. Fondi Limit (pa tvsh) 28,698,125 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 17,288,640 lekë (460 leke/njesi)	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 11,409,485
8. Data e hapjes së tenderit 15.03.2019	9. Burimi Financimit Fond nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër _3___OE b) Sõkualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar___1__ OE
11. Ankimime Ka APPï sõka; KPP-Ka Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK -Ka	13. Përgjigje ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik Nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e marrëveshjes kuadër nr. 11/24 prot., datë 12.04.2019 15. Vlera e marrëveshjes kuadër (me tvsh) 552,00 lekë/njësi	16. Lidhja e kontratës nr. 11/29 prot., datë 15.04.2019 17. Vlera e kontratës (me tvsh) 20,746,368 leke 18. Lidhja e kontratës nr. 11/35 prot., datë 31.10.2019 19. Vlera e kontratës (me tvsh) 4,080,000 leke	

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:
Fondi i këtij i këtij investimi është akorduar nga Buxheti i Shtetit me vlerë 28,698,125 lekë.

Kjo procedurë është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike.
-Me kërkesën nr. 84 prot., datë 30.01.2019 drejtuar G. H. me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimeve, E. O. me detyrë përgjegjëse e sektorit të planifikimit, ka bërë kërkesë për ñTrajtimin e mbetjeve spitaloreò për një periudhë 12-mujore, fond i cili është planifikuar në investimet e vitit 2019, me financim nga fondet e buxhetit të Shtetit (Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale).
Me urdhër të Drejtorit të Spitalit nr. 11, datë 30.01.2019, është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike i përbërë nga A. T. me detyrë përgjegjës i sektorit teknik, G. P. me detyrë inxhinier pajisjesh, L. Ll. me detyrë kryeinfermier i Ortopedisë Nr.1.
Me protokoll nr. 11/1 datë 31.01.2019, grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike, ka hartuar specifikimet teknike.
Me urdhër të Drejtorit të Spitalit nr. 11 /2, datë 06.02.2019, është ngritur grupi i punës për argumentin e fondit limit i përbërë nga M. S. me detyrë specialist prokurimi, M. P. me profesion ekonomiste, Dh. M. me detyre specialiste prokurimi.
Me dokument të protokolluar nr. 11/3 datës 08.02.2019, grupi i përllogaritjes së vlerës së kontratës, i ngritur me urdhrin e drejtorit të spitalit 11 /2, datë 06.02.2019 ka përcaktuar vlerën 28,698,125 lekë pa TVSH dhe 34,437,750 lekë me TVSH.
Pra, përllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në vlerën 57,164,200 lekë, sipas çmimit për njësi të marrë bazuar në çmimin e kontratës të vitit 2018 me nr. 255/2 prot., datë 31.12.2018.
Nga grupi për llogaritjen e vlerës limit të kontratës, ***nuk është dhënë asnjë argumentim*** *përse nuk është* marrë për bazë edhe çmimet e realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, si QSUT, Shefqet Ndroqi, spitalet private, etj.
Veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 59, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se ñNë përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet tõ referohet një ose më shumë alternativave të renditura si mëposhtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe
a) çmimet e tregut;ose/dhe
b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga
autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe
ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.
Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.
Si konkluzion, përllogaritja e vlerës së kontratës, është bërë duke u mbështetur në çmimet e kontratave të mëparshme, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, i spitaleve te tjera (QSUT, Shefqet Ndroqi, Spitaleve private etj), veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 59, pika 2.
Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi grupi i përllogaritjes së vlerës së kontratës i përbërë nga M. S. me detyrë specialist prokurimi, M. P. me profesion ekonomiste, Dh. M. me detyre specialiste prokurimi.

Me urdhër të Drejtorit të Spitalit me nr. 11/4 datë 08.02.2019, është ngritur urdhri i prokurimit për kryerjen e prokurimit me procedurë të hapur, marrëveshje kuadër ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me periudhë 12-mujore., duke ngarkuar për zbatimin e kësaj proçedurë njësinë e prokurimit e përbërë nga G. H. me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimit, G. P. me profesion specialist pajisjesh, B. V. me detyre Jurist.
Me urdhër te Drejtorit te Spitalit me nr. 11/5 date 08.02.2019 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave nga A. T. me detyrë përgjegjës i sektorit teknik, M. S. me detyrë specialist prokurimi, Dh. M. me detyrë specialiste prokurimi.
Njoftimi i kontratës është bërë me nr 11/6 prot., datë 08.02.2019
- *Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim/specifikimet teknike.*
Kërkesat për kualifikim janë miratuar me proçesverbalin nr. 1, datë 08.02.2019, nga njësia e prokurimit e përbërë nga G. H., G. P., B. V. Në këto kërkesa nuk janë dhënë arsye konkrete në argumentimin e kritereve të vlerësuara për objektin e prokurimit, në raport me natyrën dhe përmasat e këtij objekti.
Konkretisht, në nenin 61, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, parashikohet se: "Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit".
Nuk ka një dokument shkresor (procesverbal etj) të njësisë së prokurimit, ku të jenë miratuar dokumentet e tenderimit (D.T.) dhe në veçanti nuk ka një dokument shkresor ku të jenë përcaktuar kriteret e vlerësimit, edhe pse në S.P.E, është përcaktuar çmimi më i ulët. Konkretisht, në nenin 61, pika 1, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, parashikohet se: Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje më këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi, ndërsa në pikën 2 të këtij neni parashikohet se: Seti i dokumenteve të tenderit firmoset në çdo faqe nga njësia e prokurimit.
Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi G. H., G. P., B. V.
Me urdhër nr. 11/7, datë 18.02.2019, të Drejtorit te Spitalit, është bërë pezullimi i procedurës së prokurimit, për arsye te ankesës me nr. 525 prot., date 18.02.2019 pranë Autoritetit Kontraktor nga Operatori Ekonomik ñE. R.ò Shpk.
Me urdhër nr. 11/8, datë 18.02.2019, të Drejtorit te Spitalit, është ngritur grupi i shqyrtimit te ankesave i përbërë nga A. T. me detyre përgjegjës i sektorit teknik, M. S. me detyre specialist prokurimi, Dh. M. me detyre specialiste prokurimi.
Komisioni i shqyrtimit ankesës me shkresën nr. 11/9 prot., datë 21.02.2019, i është drejtuar Drejtorit të Spitalit, duke bërë rekomandimin përkatës pas shqyrtimit të ankesës se Operatorit Ekonomik ñE. R.ò Shpk.
Me shkresën nr. 11/10 prot., datë 21.02.2019, bazuar në ankesën e Operatorit Ekonomik, komisioni i shqyrtimit te ankesave hartoi shtojcë DST, duke bërë sqarimet përkatëse mbi specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta të kualifikimit.
Me urdhër nr. 11/11, datë 21.02.2019, të Drejtorit të Spitalit është bërë, heqja e pezullimit të procedurës së prokurimit.

Me shkresën nr. 525/1 prot., date 22.02.2019, SUT i kthen përgjigje Operatorit Ekonomik ñE.R.ò Shpk në lidhje me ankesën e bërë.
Me urdhër nr. 11/12, datë 27.02.2019, të Drejtorit te Spitalit, është bërë pezullimi i procedurës së prokurimit, për arsye te ankesës me nr. 586 prot., date 26.02.2019 pranë Autoritetit Kontraktor nga Operatori Ekonomik ñM.Tò Shpk.
Me urdhër nr. 11/13, datë 27.02.2019, të Drejtorit te Spitalit, është ngritur grupi i shqyrtimit te ankesave i përbërë nga A. T. me detyre përgjegjës i sektorit teknik, M. S. me detyre specialist prokurimi, Dh. M. me detyre specialiste prokurimi.
Komisioni i shqyrtimit te ankesave me shkresën nr. 11/14 prot., datë 01.03.2019, i është drejtuar Drejtorit të Spitalit me rekomandimin përkatës, pas shqyrtimit të ankesës se Operatorit Ekonomik ñM.Tò Shpk.
Me shkresën Nr. 586/1 Prot., date 01.03.2019 SUT i kthen përgjigje Operatorit Ekonomik ñM.Tò Shpk mbi ankesën e tyre.
Me shkresën nr. 11/18, date 18.03.2019, SUT i ka bërë sqarim oferte Operatorit Ekonomik ñE.R.ò Shpk.
Operatori Ekonomik ñP.-Mò Shpk i drejtohet SUT me shkresën e kthimit te përgjigjes për ofertën anomalish te ulet me nr. 11/19 prot., date 19.03.2019
Operatori Ekonomik ñE. R.ò Shpk dorëzoi formularin e ofertës me shkresën nr. 11/20 prot., date 19.03.2019.
Zhvillimi i procedurë së prokurimit.
Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomike.
-Operatori ekonomik ñM. - T.ò Shpk, me ofertë në vlerën 0 lekë/njësi (nuk ka paraqitur ofertë ekonomike).
- Operatori ekonomik òE. R.ò Shpk, me ofertë në vlerën 460 lekë/njësi.
- Operatori ekonomik ñP. ï Mò Shpk me ofertë ekonomike 322.32 lekë/njësi
Komisioni i Vlerësimit të ofertave me shkresën nr. 11/21 prot., datë 21.03.2019 ka hartuar procesverbal konstatimi për verifikimin e impiantit te përpunimit te mbetjeve për Operatorit Ekonomik ñP.-Mò Shpk dhe ñE. R.ò Shpk.
Pas vlerësimit të KVO u kualifikua dhe shpall fitues Operatori ekonomik ñE. R.ò Shpk, me ofertë në vlerën 460 lekë/njësi.
Raporti përmbledhës nga komisioni i vlerësimit është hartuar me nr. 11/22 prot., datë 05.04.2019, raport i cili është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor, ku ka shpallur fitues operatorin ekonomik ñE. R.ò Shpk, me ofertë në vlerën 460 lekë/njësi.
Në S.P.E dhe A.P.P, është kryer njoftimi i fituesit, nga ku A.P.P e ka bërë aktive publikimin e njoftimit të fituesit në datën 08.04.2019.
Titullarit të Autoritetit Kontraktor me urdhrin nr. 11/23, datë 05.04.2019, ka ngarkuar njësinë së prokurimit për administrimin e dokumenteve të tenderit të dorëzuar nga operatori ekonomik fitues dhe lidhjen e kontratës.
Marrëveshja kuadër është lidhur me nr. 11/24 prot., datë 12.04.2019, ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës të përfaqësuar nga A. Z.në cilësinë e Drejtorit të Spitalit dhe operatorit/e shoqërisë ñE. R.ò Shpk në vlerën 460 lekë/njësi pa TVSh, kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër është për periudhën 12.04.2019 deri më 12.04.2020, me datë fillimi nënshkrimin e saj.
Me urdhër nr. 11/25, datë 12.04.2019 të Drejtorit të Spitalit, është ngritur grupi i punës për monitorimin dhe zbatimin e marrëveshjes kuadër i përbërë nga A. T. me detyrë përgjegjës i sektorit teknik, G. P. me detyrë specialist pajisjesh, L. Ll. me detyrë kryeinfermier i ortopedisë nr. 1, M. Dh. me detyrë elektricist, R. M. me detyrë elektricist.

Me shkresën nr. 11/27 prot, datë 12.04.2019, Titullari i Autoritetit Kontraktor, i kërkon operatorit ekonomik kërkesë për dhënie oferte për trajtimin e mbetjeve spitalore për SUT.
Operatori ekonomik ñE. R.ò paraqet ofertën e cila është protokolluar me nr. 11/28 prot., datë 15.04.2019, ku ka përcaktuar çmimin për shërbimin, me vlerë totale 17,288,640 lekë pa TVSH dhe me TVSH 20,746,368 lekë.
Kontrata është lidhur me nr. 11/29 prot., datë 15.04.2019 ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës të përfaqësuar nga A. Z.në cilësinë e Drejtorit të Spitalit dhe operatorit/e shoqërisë ñE.R.ò Shpk në vlerën 20,746,368 lekë me TVSh, kontrata duhet të fillojë zbatimin me nënshkrimin e palëve deri më 31.12.2019.
Me shkresën nr. 11/30 prot., datë 18.04.2019 është bërë publikimit të njoftimit të kontratës së nënshkruar.
Me urdhër nr. 11/31, datë 29.08.2019 të Drejtorit të Spitalit, është ngritur grupi i punës për monitorimin dhe zbatimin e marrëveshjes kuadër i përbërë nga I. K. me detyrë përgjegjës i sektorit teknik, G. P. me detyrë specialist pajisjesh, L. Ll. me detyrë kryeinfermier i ortopedisë nr. 1, M. Dh. me detyrë elektricist, R. M. me detyrë elektricist.
Me nr. 2406 prot., date 11.09.2019 Drejtori i Spitalit, i drejtohet sektorit te Burimeve Njerëzore, Financës dhe Menaxhimit te Teknologjisë, me vendimin për ndërprerjen e kontratës provizore te I. K. me detyrë përgjegjës i Sektori Menaxhimit te Teknologjisë.
Me shkresën nr. 583 prot., date 02.10.2019 grupi i punës për monitorimin dhe zbatimin e marrëveshjes kuadër i drejton kërkesë për lidhje kontrate A. H., Sektorit të Planifikimit dhe Sektorit të prokurimeve.
Me urdhër nr. 11/32, datë 23.09.2019 të Drejtorit të Spitalit, është ngritur grupi i punës për monitorimin dhe zbatimin e marrëveshjes kuadër i përbërë nga L. H. me detyrë përgjegjës i sektorit teknik, G. P. me detyrë specialist pajisjesh, L. Ll. me detyre kryeinfermier i ortopedisë nr. 1, M. Dh. me detyrë elektricist, R. M. me detyrë elektricist.
Me urdhër nr. 11/33, datë 14.10.2019 të Drejtorit të Spitalit, është ngritur grupi i punës për monitorimin dhe zbatimin e marrëveshjes kuadër i përbërë nga L. H. me detyrë përgjegjës i sektorit teknik, G. P. me detyrë specialist pajisjesh, A. G. me detyre kryeinfermier, M. Dh. me detyrë elektricist, R. M. me detyrë elektricist.
Me shkresën nr. 668 prot., datë 31.10.2019, Sektori i planifikimit i është drejtuar G. H., dhe i kërkon lidhje kontrate për trajtimin e mbetjeve spitalore për SUT në vlerën 3,400,000 lekë
Kontrata është lidhur me nr. 11/35 prot., datë 31.10.2019 ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës të përfaqësuar nga A. Z. në cilësinë e Drejtorit të Spitalit dhe operatorit/e shoqërisë ñE.R.ò Shpk në vlerën 4,080,000 lekë me TVSh, kontrata duhet të fillojë zbatimin me nënshkrimin e palëve deri më 31.12.2019.
Me shkresën nr. 793/1 prot., datë 19.12.2019, Sektori i Planifikimit i drejtohet G. H., dhe i kërkon lidhje kontrate për trajtimin e mbetjeve spitalore për SUT në vlerën 8,009,485 lekë
Me shkresën nr. 11/36 prot. datë 23.12.2019,Titullari i Autoritetit Kontraktor, i kërkon operatorit ekonomik kërkesë për dhënie oferte për trajtimin e mbetjeve spitalore për SUT.
Operatori ekonomik ñE. R.ò paraqet ofertën e cila është protokolluar me nr. 11/37 prot., datë 23.12.2019, ku ka përcaktuar çmimin për shërbimin me vlerë totale 460 lekë njësi pa TVSH dhe me TVSH 552 lekë/njësi .
Kontrata është lidhur me nr. 11/38 prot., datë 23.12.2019 ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës të përfaqësuar nga A. Z. në cilësinë e Drejtorit të Spitalit dhe operatorit/e shoqërisë ñE.R.ò Shpk në vlerën 9,611,382 lekë me TVSh, kontrata duhet të fillojë zbatimin me nënshkrimin e palëve deri më 12.04.2020.

9. Në procedurat e prokurimit si më poshtë nuk u konstatuan shkelje ligjore ose parregullsi.
-a. Shërbimi i ruajtjes së objekteve me roje private me vlerë limit dhe të prokuruar 24,929 mijë lekë, viti 2018.
-b. Blerje materiale mjekimi neurokirurgjie, viti 2019 me vlerë limit 96,936 mijë lekë, me vlerë të prokuruar 94,420 mijë lekë.
Për procedurën e prokurimit ñShërbimi i ruajtjes së objekteve me roje privateò, është mbajtur aktkonstatimi nr. 22 datë 07.05.2021, ndërsa për procedurës së prokurimit me objekt ñBlerje materiale mjekimi neurokirurgjieò, viti 2019, materiali auditues është paraqitur tek letra e punës.
Titulli i gjetjes: Procedura prokurimi të kryera me shkelje dhe parregullsi ligjore ose rregullatore.
Situata:
Në 7 procedura prokurimi për vlerën 522,153 mijë lekë, përllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, i spitaleve te tjera (QSUT, Shefqet Ndroqi etj), veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 59, pika 2.
-Për 8 procedura prokurimi për vlerën 548,163 mijë lekë në hartimin e dokumenteve të tenderit, për kriteret e veçanta për kualifikimit nuk është dhënë asnjë argument për përcaktimin e tyre dhe nuk është dokumentuar me procesverbal ky përcaktim, veprim në kundërshtim me me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 61, pika 2.
-Në 4 procedura prokurimi për vlerën 428,225 mijë lekë, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë,veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 46, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñRregullat e Prokurimitò, i ndryshuar, neni 63 pika 3, neni 67.
Për sa trajtuar si më sipër ngarkohen me përgjegjësi komisionet e vlerësimit të ofertave.
-Nga mos zbatimi i specifikime teknike të kontratave në marrëveshjen kuadër ñPër kryerjen e shërbimit të lavanterisë dhe hotelerisë për një periudhë 48 mujoreò në vlerën 199,290 mijë lekë pa TVSH, viti 2020, për periudhën tetor 2020 deri më mars 2021 operatori ekonomik ñS. C.ò Shpk, ka përfituar padrejtësisht vlerën ***3,536,421 lekë, duke krijuar në këtë mënyrë dëm ekonomik në të njëjtën vlerë.*** Mos zbatimi i specifikimeve teknike lidhet me materialin e butë; çarçaf i poshtëm, çarçaf i sipërm dhe çarçaf zarf, ku peshat përkatësisht nga 0.77 kg, 0.77 kg dhe 1.1 kg gjatë zbatimit të kontratës (likuidimeve) kanë rezultuar në 1.1 kg, 1.1 kg dhe 1.3 kg. Veprim në kundërshtim me:
-Marrëveshjen kuadër të lidhur me nr. 7/26 prot, datë 17.07.2020, ndërmjet SUT dhe operatori ekonomik ñS. C.ò Shpk, ku është përcaktuar ñkontraktori me an të ofertës së tij, bie dakort të furnizoj mallra, ashtu siç janë specifikuar në kushtet e përcaktuara në këtë kontratë, formularin e deklarimit të ofertës, specifikimet teknike, formulari i çmimit të ofertës dhe dokumentet standard të tenderitò.
- Kontratat e lidhur me nr. 7/32 prot., datë 20.07.2020, nr. 7/37 prot., datë 11.12.2020 nr. 7/40 prot., datë 30.12.2020, ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës dhe operatorit/e shoqërisë ñS.C.ò Shpk, nenet 8,12 dhe 14.

- Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 60, pika 1, e cila përcakton se: ñ1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fitueseò.
- Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 ñKodi Civil i Republikës së Shqipërisëò, nenet 419, 420, nenet 659, 698 dhe neni 690 në të cilin është shprehur ñ.....*Mos përmbushja e detyrimeve përkatëse sjell lindjen e përgjegjësisë juridiko-civile për palën mos përmbushëse, përgjegjësi e cila konkretizohet në detyrimin për ti shpërblyer palës/palëve të tjera shpërblimin e dëmit të pësuar në formën dëmit efektiv dhe fitimit të munguar"*.
- Shtojca 5. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike dhe të Termave të Referencës nga operatori ekonomik ñS. C.ò Shpk. Në zbatimin e kontratës ñBlerje aparat radiografie me krah C në vlerën 16,667 mijë lekë, viti 2020, pajisja nuk shoqërohet me etiketën e përkthyer në gjuhën shqipe, veprim në kundërshtim me neni 20 të Ligjit nr. 89/2014 ñPër pajisjet mjekësoreò, i ndryshuar.
-Për 8 proçedura prokurimi për vlerën 557,425 mijë lekë lidhja e kontratave është realizuar mbi bazën e marrëveshjeve kuadër, e cila pavarësisht ka ndikuar në uljen e çmimit për njësi, por si shpenzim ka shkuar tek fondi limit, duke rritur numrin e pjesëve/njësive dhe në rastet e audituara asnjëherë uljen e numrit të pjesëve/njësive si dhe pakësimin jo vetëm të fondit limit por edhe as të vlerës së prokuruar, dhe mbart në të ardhmen riskun e lart të përzgjedhjes së pjesëve/njësive me vlerë më të lart, duke mos arritur në këtë mënyrë uljen kostove të blerjeve/shërbimeve, veprim në kundërshtim me Udhëzim e APP nr. 6, datë 16.01.2018 ñPër përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeò, me ndryshimet vijuese të tij.
-Në zbatimin e kontratës ñBlerje aparat radiografie me krah Cò në vlerën 16,667 mijë lekë, viti 2020, pajisja nuk shoqërohet me etiketën e përkthyer në gjuhën shqipe, veprim në kundërshtim me nenin 20 të Ligjit nr. 89/2014 ñPër pajisjet mjekësoreò, i ndryshuar.
Kriteri: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 46, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñRregullat e Prokurimitò, i ndryshuar, neni 63 pika 3, neni 67, Ligji nr. 44/2015 ñKodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisëò nenet 108-118, Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 ñKodi Civil i Republikës së Shqipërisëò, nenet 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690.
Ndikimi/efekti: Dëm ekonomik për Institucionin në vlerën 3,536,421 lekë.
Shkaku: Keq interpretime të akteve ligjore dhe rregullatore të procedurave të prokurimit publik, si dhe të zbatimit të kontratave të mallrave (pajisjeve) dhe shërbimeve.
Rëndësia: I lartë.
Rekomandimi: Për mbrojtur interesat publike, duke siguruar se fondet publike shpenzohen në mënyrën e duhur, të besueshme dhe efikase, me konkurrencë dhe transparencë në prokurimet publike, si dhe për të siguruar, që të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar në kontratat publike të trajtohen në mënyrë të drejtë, nga zyra, ose personat e ngarkuar nga Administratori i Shoqërisë:
- Përllogaritja e vlerës së kontratave të prokurimit publik, të vlerësohet si një operacion mjaftë i vështirë dhe në të njëjtën kohë mjaftë i rëndësishëm, për shkak se zbatimi i procedurave të përzgjedhjes të prokurimit publik, do të varet përkatësisht nga përcaktimi i kësaj vlere, por dhe efektiviteti maksimal i shpenzimeve publike. Pikërisht për këtë arsye, duhet zbatuar me rigorozitet legjislacioni i posaçëm për këtë procedurë specifike, kjo edhe për të mënjanuar shmangien nga rregullat e prokurimit nëpërmjet ndarjes apo pjesëtimit të vlerës së kontratave të prokurimit publik.

-Nga Shoqëria t`i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi rëndësia e procesit të shqyrtimit, kualifikimit dhe shpallja fitues të operatorëve është me rëndësi kapitale.
-Lidhja e kontratave mbi bazën e marrëveshjeve kuadër, duhet konsideruar si rast i veçantë dhe Autoriteti Kontraktor nuk duhet në asnjë rast të abuzojë me përdorimin e këtij instrumenti, me qëllim shtrembërimin e konkurrencës. Përdorimi i kësaj forme prokurimi detyrimisht duhet të arrij reduktimin e kostove transaksionale, përmirësimin e vazhdueshëm në harkun e marrëdhënieve afat-gjatë ndërmjet Autoriteti Kontraktor dhe Operatorëve Ekonomik, në interes të konsumatorit, në rastin konkret përmirësimin e shërbimit të pacientit në spital.
-Titullari i Autoritetit Kontraktor duhet të nxjerri urdhër/urdhra me qëllim ndjekjen me përpikëmëri të zbatimit të kontratave, duke përfshirë dhe marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara, për sasinë, cilësinë, llojin si dhe dokumentacionin shoqërues të tyre.
- SUT të marrë masa dhe të ndjekë të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës së 3,536,421 lekë nga shoqëria ñS. C.ò Shpk. Kjo vlerë ka të bëjë me mos zbatimin e specifikime teknike, pjesë e kontratave në marrëveshjen kuadër të lidhur me nr. 7/26 prot., datë 17.07.2020 ñPër kryerjen e shërbimit të lavanterisë dhe hotelerisë për një periudhë 48 mujoreò.
Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1924/7 prot, datë 01.10.2021(protokoll SUT) për Projektraportin, nga Shoqëria "S. C."ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:
Pretendimi i subjektit
Për disponimin e ambjenteve, ky konstatim i grupit të auditimit është tërësisht i fotokopjuar nga pretendimet e ngritura nga OE "D." shpk në ankesat e tij, ankesa që nuk janë pranuar nga KPP me vendime përfundimtare. Referuar këtij kriteri të veçant kualifikimi, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetopjnë se disponojnë në pronësi apo me qira një ambjent (vendin) ku është instaluar lavanteria. Kontrata e qiraë duhet të jetë e vlefshme për gjithë periudhën e parashikuar për kryerjen e shërbimit dhe duhet të ketë bashkëngjitur të gjithë dokumentacionin ligjor, kopje të aktit të pronësisë të qiradhëniësit dhe dokumentet e tjerë që vërtetojnë marrëveshjen kontraktuale mes palëve. Në kemi dorëzuar për përbushjen e këtij kriteri:
-Kontratë nën qiraje (noteriale) me Nr. 1642 Rep, Nr. 471/2 Kol, datë 08.08.2018.
- Vërtetim të lëshuar nga Drejtoria e Aluizimit Tiranë me nr. 1388/1 prot, datë 21.02.2019.
Grupi i auditimit në mënyrë tërësisht të kundraligjshme, tejkalon në mënyrë abuzive kompetencat e veta, kur merr përsipër të vlerësoj vlefshmërinë e aktit noterial. Ky tejkalim kompetencash është haptazi i kundraligjshëm referuar nenit 67,68 dhe 69 të Ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për noterinë".
Për të gjitha sa mësipër ne shpresojmë që grupi i auditimit të mos jetë nxituar nga motive të dyshimta, për të insistuar me çdo kusht që të nxjerr probleme inegzistence në procedurën e kualifikimit tonë. Rikujtojmë, se nga ana e jonë është depozituar kallëzim penal në SPAK, e cila ka regjistruar procedimin penal përkatës për shkeljet e disa zyrtarëve të KSHA të SUT, që favorizon shoqërinë Dev. dhe nuk ngurojmë të dërgojmë informacion të ri për këtë procedim, nëse vërejmë insistim me injorimin ligjit nga ekipi i auditimit edhe pas sqarime tona.
-Disa nga observacionet tona janë marr në konsideratë (pikat I.1 dhe I.2), sepse gjetjet ishin tërësisht dhe në mënyrë flagrante të pa bazuara, mandje tendecioze, por disa prej tyre, sërisht këta auditues kanë vijuar duke i lën në ProjektRaport, mandje pa sqaruar dhe argumentuar qëndrimin e tyre.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Së pari. Grupi auditimit në faqen 103 të projektraportit për këtë procedurë është shprehur në ligjëratë të drejtë ***"****Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:.....", ndërsa në faqe 111 është shprehur "Në pikën 2.3/7 "Kapaciteti ekonomik" është përcaktuar operatori ekonomik duhet te paraqesë: a) vërtetim pronësie ose kontrate qiraje për objektin ku do te ushtrohet aktiviteti (vendi ku është instaluar lavanteria). Kontrata e qerase duhet te jete e vlefshme për gjithë periudhën e parashikuar për kryerjen e shërbimit dhe duhet te ketë bashkangjitur te gjithë dokumentacionin ligjor,* ***kopje te aktit te pronësisë te qiradhënësit dhe dokumentet e tjerë qe vërtetojnë marrëveshjen kontraktuale mes palëve****", pra grupi i auditimit i është referuar dokumentacionit zyrtar (të shkrojtur dhe elektronik) që disponon SUT dhe APP, referuar legjislacionit të prokurimit publik.*

Së dyti. Me kontratën nën qiraje (noteriale) me Nr. 1642 Rep, Nr. 471/2 Kol , datë 08.08.2018 lidhur para noterit D.Gj. mes shoqërisë "S. C." Shpk si nënqiramarrës dhe shoqërisë "V" Shpk si nën qiradhënës, ku kjo e dyta, gëzon të drejtën të jetë nën qiradhënës sipas nenit 6.8 të kontratës së qirasë (noteriale) Nr. 1307 Rep, Nr. 377 Kol datë 28.06.2018 para noterit D.Gj., ***plotësohet pjesërisht kriteri*** *2.3.7/a) vërtetim pronësie ose kontratë qiraje për objektin ku do të ushtrohet aktiviteti, por nuk plotëson pjesën tjetër ku është shprehur në ligjëratë të drejtë "Kontrata e qirasë duhet të jetë e vlefshme për gjithë periudhën e parashikuar për kryerjen e shërbimit* ***dhe duhet të ketë bashkangjitur të gjithë dokumentacionin ligjor, kopje të aktit të pronësisë të qiradhënësit".***

- Vërtetimi i lëshuar nga Drejtoria e Aluizmit Tiranë me nr. 1388/1 prot, datë 21.02.2019 ku shprehet në mënyrë eksplicite se "Pasi u njohëm me kërkesën tuaj, vërtetojmë si më poshtë: Në përfundim të verifikimeve të kryera në bazën e të dhënave të administruara nga Drejtoria e Aluizmit Tiranë Rurale, rezulton se I. K. ***ka aplikuar për legalizim*** *objekti pa leje me vetdeklarim* ***nr. 459 prot, viti 2006*** *me funksion __ të ndodhur Kashar, si dhe fakti që* ***nga viti 2006 deri më datë 01.10.2021 (data e observacionit) që nuk është bërë ky legalizim (nuk është paraqitur asnjë dokument legalizues),*** *provon që jo vetëm është aplikim i cili mund të miratohe/ osejo, pra nuk është dokument pronësie, por mund të jetë risk i ushtrimit të dispozitave ligjore për ndërtim të paligjshëm, referuar dhe faktit që marrëveshja kuadër është lidhur me nr. 7/26 prot., datë 17.07.2020, me kohëzgjatje për një periudhë 48-mujore, nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshje (periudha 17.07.2020-17.07.2024), e bënë më të lartë riskun e përmbushjes së detyrimeve kontraktore.*

- Vendimi i KRRT nr. 7, datë 07.07.2003 për miratimin e destinacionit të sheshit të ndërtimi, jo vetë bën fjalë për ***Repart Mobilierie*** *për llogari të I. K. dhe P. K.* ***dhe jo për ambient pastrim kimik (lavanteri), si dhe nuk është leje ndërtimi referuar*** *Ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998, me ndryshimet vijuese të tij, rregulloren e urbanistikës të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 722, datë 19.11.1998, e ndryshuar, pavarësisht kontratës së qirasë dhe nën qirasë është konsideruar Leje Ndërtimi Nr. 7 datë 07.07.2003 lëshuar nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Bashkisë Vorë, por është formulari nr. 2, destinacioni i sheshit të ndërtimit. Referuar legjislacionit si më sipër Leja ndërtimi është formulari nr. 4.*

- Çertifikatë për vërtetim hipotekor në zonën kadastrale nr. 2679, numri i pasurisë 40/41 vol 18, faqe 116, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 1576 ^{m2}, ***nga kjo asnjë m^2 ndërtesë në pronësi Ilir Karafili****, po ashtu dhe kartela e pronësisë.*

Dokumenti i pronësisë, jepet në ato raste kur ka përfunduar objekti, është kolauduar, është dhënë leja e shfrytëzimit, është nxjerrë çertifikata e pronësisë ose vërtetim dokumenti hipotekor,

dhe jo formulari 2 "destinacionin e sheshit të ndërtimi as dhe formulari nr. 4 leja e ndërtimit, apo një vërtetim legalizimi që ka vetdeklaruar, që mund të jetë një objekt çfarëdo. Vërtetimi hipotekor i pronësisë apo çertifikata e pronësisë janë i vetmi dokumentacion që lëshohen nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës në zbatim të Ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën".
*- Në dokumentacionin e paraqitur në observacion: Kontratë nën qiraje (noteriale) me Nr1642 Rep, Nr. 471/2 Kol, datë 08.08.2018 lidhur para noterit D.Gj. mes shoqërisë "S. C." Shpk si nënqiramarrës dhe shoqërisë "V." Shpk si nën qiradhënës, ku kjo e dyta, gëzon të drejtën të jetë nën qiradhënës sipas nenit 6.8 të kontratës së qirasë (noteriale) Nr. 1307 Rep Nr. 377 Kol, datë 28.06.2018 para noterit D.Gj. dhe vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Aluizmit Tiranë me nr. 1388/1 prot, datë 21.02.2019**, ka një kontradiksion (kundërshtojnë njëra tjetrën).** Në kontratën e qirasë dhe nën qirasë bëhet fjalë për një ndërtim të kryer me leje ndërtimi, **pra ndërtim i ligjshëm në** vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Aluizmit Tiranë **bëhet fjalë për objekt pa leje** me vet deklarim nr. 459 prot, viti 2006.*

Në lidhje me pretendimin Tuaj, që grupi i auditimit ka tejkaluar në mënyrë abuzive kompetencat e veta, kur merr përsipër të vlerësoj vlefshmërinë e aktit noterial. Ky tejkalim kompetencash është haptazi i kundraligjshëm referuar nenit 67,68 dhe 69 të Ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për noterinë". ....Për të gjitha sa mësipër ne shpresojmë që grupi i auditimit të mos jetë nxituar nga motive të dyshimta, për të insistuar me çdo kusht që të nxjerr probleme inegzistence në procedurën e kualifikimit tonë. Rikujtojmë, se nga ana jonë është depozituar kallëzim penal në SPAK, e cila ka regjistruar procedimin penal përkatës për shkeljet e disa zyrtarëve të KSHA të SUT, që favorizon shoqërinë Dev. dhe nuk ngurojmë të dërgojmë informacion të ri për këtë procedim, nëse vërejmë insistim me injorimin ligjit nga ekipi i auditimit edhe pas sqarime tona.
Së pari. Për dijeni tuaj, në zbatim të Ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionim e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Rregulloren e procedurave të auditimit të miratuar me vendim të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 107 datë 08.08.2017 e ndryshuar me vendim nr. 63, datë 22.06.2020, grupi auditimit referuar manualit të përputhmërisë, për çdo shkelje të konstatuar ka dhënë opinionin e tij, brenda sigurisë së arsyeshme[5].
Së dyti. Problemet që ju kini me DEV. për shkak të konkurrencës me ankimime dhe kundër ankimime për njëri tjetrin, siç ka ndodhur dhe në këtë procedurë, nuk mund të bëni palë grupin e auditimit dhe as instrument për të realizuar qëllimet tuaja , duke shpifur dhe santazhuar. Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.
Së treti. Pretendimi i juaj se "Disa nga observacionet tona janë marr në konsideratë (pikat I.1 dhe I.2), sepse gjetjet ishin tërësisht dhe në mënyrë flagrante të pa bazuara, mandje tendecioze, por disa prej tyre, sërisht këta auditues kanë vijuar duke i lën në ProjektRaport, mandje pa sqaruar dhe argumentuar qëndrimin e tyre, është kundërshtim me faqen 129-133 të Projekt Raportit të Auditimit ku janë prezantuar pretendimet operatorit ekonomik "S.C." Shpk dhe qëndrimi grupit të audtimit, ku është dhënë argumentimi tekniko-ligjor për çdo pretendim.
Pretendimi i subjektit
Së pari theksojmë, se jemi shokuar nga mënyra dhe tendenca se si ka parashkruar situatën ekipi i auditimit, duke qartë që se ka lexuar fare me vëmendje marrëveshjen kuadër, specifikimet teknike në dokumentet e tenderit dhe kontratat e lidhura mes nesh dhe SUT.....

[5] ISSAI 300. *Siguria e arsyeshme është siguri e lartë, por jo absolute. Për shkak të kufizimeve të vetvetishme të një auditimi, ai normalisht nuk jep siguri maksimale ne shkallen 100%.*

Kryerja e shërbimit të lavanterisë dhe zëvendësimi i materialit të përdorur, janë detajuar qartë në Shtojca 9 "Specifikimet teknike" dhe në nenin 8 të kontratave të lidhura, ku në lidhje me larjen e materialit të but ekzistues do të bëhet sipas të dhënave të studimit nr. 132/2 datë 08.08.2016 dhe kontratës nr. 132/14 datë 07.12.2016 "Për kryerjen e shërbimit të lavanterisë dhe hotelerisë në SUT për periudhën 4-vjeçare.

Qëndrimi i grupit të audtimit

Së pari. Për dijeninë Tuaj, referenca është e gabuar, pasi nuk i përket marrëveshjes kuadër të lidhur me nr. 7/26 prot, datë 17.07.2020 ndërmjet SUT dhe operatorit ekonomik "S.C." Shpk, por i përket Kontratës nr. 40/18 datë 19.06.2020 për vlerën 3,294,720 lekë me afat 88 ditë, neni 8 paragrafi tretë. Pra të një procedurë tjetër (para kësaj procedure), dhe jo të procedurës objekt auditimi.

Së dyti. Për hartimin e specifikimeve teknike me urdhër të Drejtorit të Spitalit nr. 7, datë 04.02.2020, është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike, po me protokoll nr. 7/1 datë 07.04.2020, grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike ka hartuar specifikimet teknike, të cilat janë publikuar në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, nuk kanë asnjë lidhje me studimin nr. 132/2 datë 08.08.2016 dhe kontratën nr. 132/14 datë 07.12.2016.

Së treti. Referuar shpjegime të bëra në pikat 1 dhe 2, shpresojmë të jetë kuptuar nga ana e Juaj se grupi i auditimit e ka lexuar me vëmendje/ose jo marrëveshjen kuadër, specifikimet teknike në dokumentet e tenderit dhe kontratat e lidhura.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit

Siç vërehet qartësisht, siç tregojnë edhe tabelat 2,3,4,5 të specifikimeve teknike, pesha më e ulët të cilës i referohet grupi i auditimit i përket materialit të but që supozohej duhet të ishte trashëguar nga 132/14 datë 07.12.2016 me operatorin ekonomik "Dev.". Në fakt kjo nuk ka ndodhur, dhe ekipi nuk ka zbuluar se ne kemi filluar shërbimin me mungesë inventari fizik që në fakt duhet të ishte gjendje nga kontrata e mëparshme, pasi Devis nuk ka bërë zëvendësimin e materialit të but. Grupi i auditimit nuk ka verifikuar mungesat në inventar në shkelje të kontratës nga Dev., po ka pasur tendencën të bëjë keqinterpretime të kontratës që ne po zbatojmë me korrektësi maksimale. Madje, për ne zbatimi i kontratës ka pasur kosto të shtuar, pasi kemi qenë të detyruar të fillojmë më shpejt me furnizimin e materialit të ri të butë. Me sa duhet ekipi i auditimit nuk ka pasur vullnetin të shikoj shkeljet e operatorin ekonomik "Dev.".

Qëndrimi i grupit të audtimit

Së pari. Referenca e juaja është për kontratën nr. 40/18 datë 19.06.2020 për vlerën 3,294,720 lekë dhe jo për marrëveshjen kuadër.

Së dyti. Problematikat e zbatimit të kontratës 132/14 datë 07.12.2016 me operatorin ekonomik "Dev.", janë audituar nga Njësia e Auditit të Brendshëm me program nr.567/1 date, 29.10.2020. Në zbatim të nenit 16, pika 2 dhe 3, të Ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", nga teste e bëra rrezultoj se standardet e përdorura për këtë auditim janë në përputhje me standardet e KLSH dhe ato ndërkombëtare[6]", për pasojë është merr i mirëqenë auditimi i kësaj kontrate. Në këtë auditim për pos të tjerave është shprehur:

"Materiale te pa dorëzuara nga shoqëria "D." Shpk pranë SUT-se rezultojnë mangët dhe përbëjnë dëm ekonomik të shkaktuar nga shoqëria "D." Shpk për SUT-në në vlerën 5,819,357 lekë.

---

[6] *Mbështetur në **ISSAI 1610** "Përdorimi i punës së Audituesve të Brendshëm"*

Kontrata e re me shoqërinë "S." Shpk ka filluar më datën 19.06.2020 me inventarin me diferenca të shkaktuara nga mos dorëzimi i material nga shoqëria"D."Shpk.
Baza materiale ekzistuese i është dorëzuar Shoqërisë "S." Shpk sipas proces-verbalit të mbajtur nga komisioni i dorëzimit të mallit.
Shoqëria"S." Shpk ***ka filluar kompletimin me material sipas kontratës të cilët janë marrë në dorëzim nga komisioni i SUT-së dhe janë shpërndarë sipas grafikut****. Materialet që administrohen nga Shoqëria"S." Shpk* ***janë sipas specifikimeve teknike si dhe me logon e SUT-së dhe kohën e vënies në përdorim të tyre****. Shërbimi kryhet sipas rregullave dhe grafikeve të përcaktuar në kontratë".*
Së treti. SUT me shkresën nr. 1669 prot, datë 26.08.2020 i ka kërkuar Shoqërisë së sigurimeve Eurosig konfiskimin e vlerës 5,819,357 lekë nga sigurimi i kontratës.
Së katërti. Ju me SUT në situatë pos D. nuk keni si kontratë të par marrëveshjen kuadër, por kontratën nr. 40/18 datë 19.06.2020. Për pasojë për çfarë pretenduar si kosto shtesë i keni ezauruar në këtë kontratë.
Së pesti. Pretendimi i Juaj është në kundërshtim me:
- Marrëveshjen kuadër të lidhur me nr. 7/26 prot, datë 17.07.2020 ndërmjet SUT dhe operatori ekonomik "S. C." Shpk, ku është përcaktuar "kontraktori , me an të ofertës së tij, bie dakort të furnizoj mallra, ashtu siç janë specifikuar në kushtet e përcaktuara në këtë kontratë, formularin e deklarimit të ofertës, specifikimet teknike, formulari i çmimit të ofertës dhe dokumentet standard të tenderit".
- Kontratën të lidhur me nr. 7/32 prot., datë 20.07.2020 në vlerën 20,308,860 lekë me TVSh, nenet 8,12 dhe 14.
-Kontratën e lidhur me nr. 7/37 prot., datë 11.12.2020 ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës dhe operatorit/e shoqërisë "S.C." Shpk në vlerën 3,604,152 lekë me TVSh, nenet 8,12 dhe 14.
- Kontratën e lidhur me nr. 7/40 prot., datë 30.12.2020 ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës dhe operatorit/e shoqërisë "S. C." Shpk në vlerën 57,600,156 lekë me TVSh, nenet 8,12 dhe 14.
- Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 60, pika 1, e cila përcakton se: "1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese".
- Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", neni 419, 420, neni 659,698 dhe neni 690 në të cilin është shprehur ".....Mos përmbushja e detyrimeve përkatëse sjell lindjen e përgjegjësisë juridiko-civile për palën mos përmbushëse, përgjegjësi e cila konkretizohet në detyrimin për ti shpërblyer palës/palëve të tjera shpërblimin e dëmit të pësuar në formën dëmit efektiv dhe fitimit të munguar".
- Shtojca 5. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike dhe të Termave të Referencës nga operatori ekonomik "S. C." Shpk.
Mos respektimi i specifikimeve teknike është në kundërshtim me shtojcën 5, në të cilën operatori ekonomik është shprehur në ligjëratë të drejt ".....Përmbushim të gjitha specifikimet teknike të përcaktuar në dokumentet e tenderit dhe i vërtetojmë këtë me çertifikata dhe dokumentacion .date 20.05.2020.
-Materialin e butë (Çarçaf) në zbatim të kontratës nr. 40/18 datë 19.06.2020, nga operatori ekonomik "S. C." Shpk ka qenë në përdorim dhe nuk ka prezantuar problematikën e peshave, si dhe nuk ka bërë ankesë për specifikimet teknike (dokumentet e tenderit).
- Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.
Procedurat e prokurimit të audituara për punët publike.

1. Mbi auditimin e ushtruar për zbatimin e procedurës së prokurimit "Rikonstruksion i pavionit dhe ndërtim i sallave të operacionit të këmbës diabetike, në SUT".

Kjo procedurë është zhvilluar në tetor të vitit 2018. Rikonstruksioni është bërë për arsye të amortizimt të madh të ambienteve të godinës së pavionit të këmbës diabetike. Fondi limit është përllogaritur me vlerë 66,125,510.8 lekë. Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 9 OE, nga të cilët janë skualifikuar 4. Kontrata e rikonstruksionit është përfunduar dhe punimet janë marrë në dorëzim të përkohshëm me datë 17.09.2019.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit konstatohet që:

Titulli i Gjetjes: Mangësi në përllogaritjen e fondit limit.

Situata: Fondi limit është përllogaritur nga Shoqëria ñ6 ï PLò, me vlerë 56,125,510.8 lekë. Për punimet ndërtimore, çmimet janë bazuar në manualet teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analiza teknike të tyre, sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se fondi limit është përllogaritur gabim, pasi nga vlera pa TVSH është nxjerrë nga shuma totale me TVSH, pjesëtuar me 1.2, ndërkohë që një veprim i tillë ka ndikuar në pjesën e makineri pajisje të cilat nuk i nënshtrohen TVSH. Nga përllogaritja rezulton se fondi limit duhet të ishte me vlerë 56,749,042 lekë.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se fondi limit është përllogaritur gabim, pasi nga vlera pa TVSH është nxjerrë nga shuma totale me TVSH, pjesëtuar me 1.2, ndërkohë që një veprim i tillë ka ndikuar në pjesën e makineri pajisje të cilat nuk i nënshtrohen TVSH. Nga përllogaritja rezulton se fondi limit duhet të ishte me vlerë 56,749,042 lekë.

Nga verifikimi i analizave të çmimeve të përgatitura për llogaritjen e fondit limit, rezulton se ka gabime aritmetike për disa zëra punimesh, konkretisht furnizim vendosje kondicionerë. Për shpenzime të parashikuara në masën 1 %, vlera e përfshirë i përket masës 10 %. Po ashtu për zërin M-1.33, sipas preventivit, çmimi është 788,088 lekë për copë, ndërsa pas korrektimit çmimi rezulton 98,081 lekë për copë.

Pas korrektimit të gabimeve në zërat e preventivit nga M-1.27 deri M-1.37, rezulton se është përfshirë në mënyrë të pa argumentuar vlera 1,505,520 lekë. Kësaj shume i shtohet pjesa respektive e fondit rezervë 2,305,303 lekë (2,195,527 lekë x 5 %).

Bazuar në observacionet e paraqitura nga ana e njësisë së prokurimit janë bërë llogaritjet e preventivit nga ku ka rezultuar se ka diferencë të konsiderueshme si pasojë e gabimeve aritmetike me vlerë 7.6 milionë, gabime të cilat e kanë ulur vlerën e fondit limit, duke kompensuar në këtë mënyrë rritjen e pa argumentuar si pasojë e gabimeve në analizat e çmimeve. Është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 15.08.2007 ñPër informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të ndërtimitò i ndryshuar, pika 2 dhe 11.

Kriteri: VKM nr. 514, datë 15.08.2007 ñPër informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të ndërtimitò i ndryshuar, pika 2 dhe 11

Ndikimi: Pavarësisht faktit se gabimet në përllogaritjen e fondit limit nuk kanë dhënë pasoja financiare, gabimet e shumta kanë shkaktuar konfuzion në realizimin e procedurës së prokurimit për zbatimin e punimeve.

Shkaku: Mos realizimi me saktësi i analizave të çmimeve për zëra të ndryshëm të furnizim vendosje pajisje, si dhe të llogaritjeve aritmetike të preventivit, të cilat janë shoqëruar me gabime të theksuara.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: SUT të marrë masa që të verifikojë preventivat e paraqitura nga shoqëritë konsulente të përzgjedhura për realizimin e projektpreventivave, si në fazën e marrjes në dorëzim të shërbimeve konsulente, ashtu edhe në kuadër të përllogaritjes së fondit limit, me synim

shmangien e gabimeve që shkaktojnë blerjen e shërbimeve, mallrave apo punimeve me çmime më të larta se ato të tregut, apo të përcaktuara në aktet ligjore

Konkluzion:

Fondi limit është përllogaritur me gabime të theksuara si sa i përket referencës së çmimeve, hartimit të analizave teknike të çmimeve, ashtu edhe sa i takon përllogaritjes së vlerës së preventivit. Nga ana e njësisë së prokurimit nuk janë bërë verifikimet e domosdoshme për shmangien e këtyre gabimeve, duke krijuar konfuzion edhe tek operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender, por janë përfshirë në dokumentet e tenderit, dokumentet e paraqitura nga Shoqëria e kontraktuar për realizimin e projektpreventivit pa asnjë verifikim apo përmirësim të nevojshëm.

Ngarkohet me përgjegjësi Shoqëria "6 –PL" SHPK dhe njësia e prokurimit e përbërë nga G. P., M. S., A. T., G. H. dhe E. Xh. .

Titulli i Gjetjes: Mangësi në vlerësimin e ofertave.

Situata: Pas hapjes së ofertave në sistemin elektronik janë kualifikuar operatorët ñIn.ò SHPK, ñE-Aò SHPK, ñ4Xò SHPK dhe ñGjò SHPK, si dhe janë refuzuar ofertat e operatorëve ñE-Vlò SHPK, ñA T.ò SHPK, ñSha I.ò SHPK, ñE K.ò SHPK dhe ñB ï Xò SHPK. AK me shkresë nr. 57/15 prot., datë 11.10.2018, i ka kërkuar OE ñIn.ò SHPK korrigjimin e veprimeve aritmetike, të cilat janë rishikuar nga OE.

OE ñ4Xò SHPK dhe ñE-Aò SHPK kanë paraqitur ankesë pranë AK, pastaj pranë KPP. KPP me Vendim nr. 858/2018, ka vendosur të mos pranojë ankesën e OE ñE-Aò SHPK dhe të pranojë ankesën e OE ñ4Xò SHPK, duke kërkuar anulimin e vendimit të KVO për kualifikimin e OE ñIn.ò SHPK, ñE-Aò SHPK, ñV. K.ò. Anëtarja e KPP znj. V. Zh. ka shprehur mendimin kundër vendimit të KPP, sa i përket ankesës së OE ñ4Xò SHPK, duke arsyetuar ñ*Gjykoj se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "4X" SHPK për skualifikimin e OE "E-A." SHPK dhe "V. K." SHPK, nuk qëndron, si dhe Autoriteti Kontraktor duhet të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit*ò.

Nga verifikimi i dokumentacionit në rrugë elektronike u konstatua se:

KVO ka kualifikuar OE ñ4Xò edhe pse një anëtar i komisionit ka kundërshtuar me argumentimin: ñ*Oferta është e gabuar, pasi është bërë përllogaritja duke u nisur nga vlera totale me TVSH dhe e gjitha kjo është pjesëtuar me 1.2 dhe ka dalë vlera e ofertës pa TVSH. Kjo ofertë nuk është e saktë, pasi seksioni D "Pajisje dhe makineri" është pa TVSH*ò. Ky argumentim është bërë për gjithë OE pjesëmarrës në tender.

KPP është vënë në dijeni të një gabimi të tillë nëpërmjet Informacionit të AK nr. 2414/1 prot., datë 07.11.2018.

Kriteri: -Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 24, pika 1.ç.
-Dokumentet Standarde të Tenderit, pika 3.2 ñKorrigjimi i gabimeve dhe pjesët e hequraò

Ndikimi: Si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të KVO dhe KPP, është kontraktuar një OE, pavarësisht gabimeve në ofertë.

Shkaku: Mos vlerësimi i duhur i dokumentacionit të paraqitur nga OE në tender, si dhe mos marrja në konsideratë as të kundërshtimeve të bëra nga një anëtar i KVO dhe një anëtar i KPP.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: SUT të marrë masa për kontrollin e procedurave të zbatimit të cilat rezultojnë me mangësi të dukshme dhe të identifkuara, si nëpërmjet strukturave të auditimit të brendshëm, ashtu dhe në shqyrtimin me përgjegjshmëri të raportit të vlerësimit të ofertave dhe ankesave që paraqiten

Ngarkohet me përgjegjësi: KVO e përbërë nga D. Ll., E. T., B. V. dhe znj. M. P. .

- Anëtarët e KPP E. Sh., E. B., V. Zh., L. S. dhe M. Z.
Shënim: Anëtare e KVO znj. I. K. nuk ka kualifikuar asnjë nga ofertat e paraqitura, po ashtu, znj. V. Zh., ka shprehur qëndrim kundër vendimit të KPP.
Konkluzion:
Në procesin e vlerësimit të ofertave sipas procedurës së prokurimit ñRikonstruksion i pavionit dhe ndërtim i sallave të operacionit të këmbës diabetike, është konstatuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë paraqitur ofertën financiare me gabime, megjithatë ky fakt nuk është marrë në konsideratë. Edhe gjatë shqyrtimit të disa ankesave nga ana e KPP, megjithëse kanë qenë në dijeni të një gabimi të tillë, është vazhduar me vlerësimin duke mos anuluar procedurën e prokurimit.
Mbi auditimin e ushtruar për zbatimit të Kontratës "Rikonstruksion i pavionit dhe ndërtim i sallave të operacionit të këmbës diabetike, në SUT".
Kontrata e punimeve civile ñRikonstruksion i pavionit dhe ndërtim i sallave të operacionit të këmbës diabetike, në SUTò, është nënshkruar me datë 20.02.2019, me OE ñ4Xò, me vlerë 66,882,234 lekë. Për mbikëqyrjen e punimeve është përzgjedhur Shoqëria ñNXX S.ò SHPK, me të cilën është nënshkruar kontrata nr. 258/6 prot., datë 20.02.2019.
Afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar 3 muaj.
Bazuar në ofertën e paraqitur nga Kontraktori, preventivi parashikon punime ndërtimi me vlerë 16.8 milionë lekë, instalime elektrike me vlerë 16.9 milionë lekë, instalime hidronike me vlerë 16 milionë lekë dhe pajisje-makineri me vlerë 4 milionë lekë.
Punimet kryesisht kanë të bëjnë me përshtatje ambientesh, realizim shtresash, punime suvatimi, punime hidroizolimi, instalime elektrike, pajisje kondicionim ajri etj.
Sheshi i ndërtimit i është dorëzuar Kontraktorit me datë 18.03.2019. Punimet kanë filluar me datë 18.03.2019. Me shkresë nr. 139 prot., datë 10.06.2019, kontraktori ka kërkuar shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me 30 ditë. Argumentimi i shtyrjes së afatit të përfundimit të punimeve ka të bëjë me disa ndryshime të volumeve të disa zërave të punimeve me rritje dhe zbritje si dhe punime shtesë, sipas të cilave nuk mund të zbatohet grafiku paraprak i punimeve. Amendamenti përkatës është nënshkruar me nr. 57/29 prot., datë 28.06.2019. Kjo kontratë është përfunduar dhe punimet janë marrë në dorëzim me datë 17.09.2019.
Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet që:
Gjatë zbatimit të kontratës janë nevojitur ndryshime të disa zërave të punimeve me shtesa dhe zbritje si dhe përfshirje të zërave të rinj të punimeve. Në aplikimin e disa zërave të rinj të punimeve të cilat nuk janë pjesë e preventivit janë konstatuar mangësi si më poshtë:
Titulli i Gjetjes: Mangësi në aplikimin e çmimeve për disa zëra të rinj punimesh.
Situata: Bazuar në dokumentacionin e dosjes teknike rezulton se janë bërë ndryshime të volumeve të punimeve me rritje dhe zbritje si dhe zëra të rinj të punimeve, dalë e nevojshme gjatë zbatimit të kontratës. Kërkesa për rishikimin e volumit të punimeve është bërë nga Kontraktori me shkresë nr. 107 prot., datë 10.05.2019. Për aplikimin e çmimeve është mbajtur procesverbali i negocimit i datës 09.07.2019 nga përfaqësuesi i Kontraktorit, mbikëqyrësit të punimeve dhe Drejtorit të SUT z. A. Z., sipas të cilit, janë aplikuar çmimet e manualeve kur ka qenë e mundur, ndërsa për zëra të tjerë janë hartuar analiza çmimesh, bazuar në ofertat e operatorëve ekonomikë për materialet.
- Për zërin A.7.An ñF.V profil mbrojtës për muret MDFò është hartuar analiza për furnizim dhe vendosje me çmim 520 lekë/ml, ku është përfshirë materiali (sipas ofertave të OE) dhe vendosja. Nga verifikimi i dokumentacionit të ofertave të marrë nga OE të ndryshëm, rezulton se për këtë zë, nga ana e OE ñR.-Gò, është paraqitur çmimi 253 lekë ml, çmim i cili përfshin furnizimin e

materialit dhe vendosjen. Si rezultat, shpenzimet për vendosjen janë përfshirë dy herë. ***Vlera 98,790 lekë [370 ml x (520 – 253)], është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori "4X" SHPK dhe përbën dëm ekonomik.***

- Zëri A.4.An ñFurnizim vendosje davancale mermeri 2 cmò, është aplikuar çmimi referuar analizës së çmimeve nr. 2.273/1, me çmim 6,981 lekë/m^2. Kjo analizë çmimi i përket materialit granit dhe jo mermer. Bazuar në manualin e çmimeve të ndërtimit 2015, për këtë zë të ri punimi referenca e çmimit duhet të ishte marrë sipas analizës 2.273, që i përket materialit mermer, me çmim 4,488 lekë/m^2. Sasia e likuiduar sipas këtij zëri është 6.0 m^2. ***Vlera e përfituar më tepër nga Kontraktori "4A-M" SHPK është 11,346 lekë [6 m^2 x (6,981-5090)], vlerë e cila përbën dëm ekonomik.***

Kriteri: VKM nr. 514, datë 15.08.2007 ñPër informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të ndërtimitòi ndryshuar, pika 2 dhe 11.

- Udhëzimin e Këshillit Të Ministrave nr. 2, datë 08.05.2003 ñPër klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimitò.
- VKM nr. 629, datë 15.7.2015 ñPër miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyreò, pika 4.

Ndikimi: Referenca e gabuar e çmimeve të punimeve të disa zëra punimesh ka rezultuar me përfitim të padrejtë nga ana e kontraktorit me vlerë 110,136 lekë.

Shkaku: Referenca të gabuara si dhe mos refklektimi i duhur i ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë, në rastin e realizimit të studimit të tregut.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: SUT të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 110,136 lekë nga Kontraktori ñ4-AMò SHPK, përfituar si pasojë e referencave të gabuara në përcaktimin e çmimeve për zëra të rinj punimesh.

Ngarkohen me përgjegjësi monitoruesit e kontratës S. K., D. Ll. dhe G. P. dhe Drejtori i SUT A. Z.

Njoftimi për përfundimin e punimeve është bërë me shkresë nr. 177 prot., datë 18.07.2019. Aktkolaudimi është mbajtur me datë 16.09.2019. Certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve është lëshuar me datë 17.09.2019.

Situacioni përfundimtar është certifikuar me vlerë 56,411,585 lekë pa TVSH, ose 66,881,301 lekë me TVSH. Dosja teknike është e kompletuar me dokumentacionin ligjor të kërkuar.

Nga verifikimi i saktësisë së volumeve të përshkruara në librezën e masave, bazë për hartimin e situacionit përfundimtar, janë konstatuar disa gabime në llogaritje, të cilat paraqiten si më poshtë:

Titulli i Gjetjes: Përllogaritje me gabime në disa zëra punimesh të përshkruara në librezën e masave.

Situata: -Zëri A.4 2.198 ñHidroizolim me emulson bituminoz dhe 3 shtresa katramaò është likuiduar në sasinë 857 m^2. Nga verifikimi i saktësisë së volumeve për këtë zë punimi rezulton sasia 835 m^2, me diferencë 22 m^2. ***Vlera 26,400 lekë*** *(22 m^2 x 1,200 lekë/m^2)****, është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori "4X" SHPK dhe përbën dëm ekonomik***.

- Zëri A.5. An ñVeshje fasade me alukobondò certifikuar sasia 33 m^2. Në këtë sasi është përfshirë sasia 7.2 m^2, riparim alukobond ekzistues. ***Vlera 67,903*** *lekë (7.2 m^2 x 9,431 lekë/m^2)****, është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori "4X" SHPK dhe përbën dëm ekonomik.***
- Në lidhje me zërin e punimeve A.6.2.297/b, është përcaktuar ñTavan me kartonxhes (gips kundër lagështirës, jeshil) dopioò. Nga verifikimi i punimeve rezulton se është ndërtuar ñTavan i

varur me pllaka gipsi 60 x 60 cmò. Ky veprim është në kundërshtim me përcaktimin në preventiv dhe me specifikimet teknike Sek. 5, Pika 3 ñPunime suvatimi i veshjeò. Gjithsesi duhet theksuar se, referenca e analizës për këtë zë punimi e bërë nga projektuesi i përket analizës 2.297/b, që i përket punimeve ñTavan i varur me pllaka gipsi 60 x 60 cmò. Nga verifikimi i përllogaritjeve të bëra sipas librezës së masave konstatohet se në sipërfaqen e përgjithshme, nuk është zbritur sipërfaqja që zënë punimet elektrike, konkretisht vendosja e plafonierave me dimensione 60 x 60 cm, në sasinë 181 copë me sipërfaqe 65.8 m^2 [183 copë x (60 cm x 60 cm)]. ***Vlera 130,442 lekë (65.8 m^2 x 1,980 lekë/m^2), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori "4X" SHPK dhe përbën dëm ekonomik.***

Kriteri: Udhëzimi i KM nr. 2, datë 13.05.2005 ñPër zbatimin e punimeve të ndërtimitò, kreu 3, pika 4.

Ndikimi: Gabimet në llogaritje, kanë çuar në përfitim të padrejtë të kontraktorit me vlerë 224,745 lekë.

Shkaku: Gabime që kanë lidhje me zbritjen e sipërfaqes së tavanit të realizuar, për seksionet ku janë vendosur plafonierat, si dhe përfshirja e punimeve të rikonstruksionit si punime të reja sa i takon zërit alukobond.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: SUT të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 224,745 lekë nga Kontraktori ñ4Xò SHPK, përfituar si pasojë e volumeve të përfshira më tepër në situacionin e punimeve.

Në lidhje me saktësinë e volumeve në librezën e masave *ngarkohet me përgjegjësi Mbikëqyrësi i Punimeve Shoqëria "NXX S." SHPK.*

Konkluzion:

Nga auditimi i zbatimit të kontratës është konstatuar se janë bërë disa ndryshime, për të cilat nuk është treguar kujdesi i duhur për respektimin e çmimeve të manualeve të punimeve të ndërtimit. Nga krahasimi i librezës së masave, kanë rezultuar mangësi në përllogaritjen e volumeve, megjithëse krahasuar me vlerën e punimeve nuk janë në sasi dhe vlerë të konsiderueshme.

Nga verifikimi i punimeve të realizuara, në përgjithësi konstatohet se janë realizuar punime me cilësi të mirë dhe nuk u konstatua mos funksionim i sistemeve, si ai i dedektimit të zjarrit, sistemit të vëzhgimit, paisje apo defekte.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraportit të Auditimit, nga subjekti i audituar, nëpërmjet SUT, është paraqitur observacioni me shkresë nr. 370, datë 30.09.2021, nga sipërmarrësi i punimeve ñ4Xò, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

<u>Pretendimi i subjektit:</u>

Në lidhje me zërin "F.V profil mbrojtës për muret MDF", pretendohet se është zbritur fitimi në masën 7 % dhe se është bazuar në oferta të paraqitura nga OE.

Në lidhje me zërin "Veshje fasase me alukobond", pretendohet se punimi është realizuar në fasadën ekzistuese, duke ndërruar disa nga materialet e dëmtuara (alukobond me sipërfaqe 7.2 m^2).

Në lidhje me tavanet kartonxhes, pretendohet se në hapësirat ku janë vendosur ndriçuesit, konstruksioni është i ndërtuar, por në vend të gipsit vendosen ndriçuesit, gipse të cilat pretendohet se janë lënë rezervë në institucion.

<u>Qëndrimi i Grupit të auditimit:</u>

Në lidhje me zërin "F.V profil mbrojtës për muret MDF", grupi i auditimit është bazuar në dokumentacionin e dosjes teknike dhe oferta e paraqitur bashkëngjitur observacionit nuk është e njëjtë me atë të dosjes teknike, në këto kushte nuk merret në konsideratë.

Në lidhje me zërin "Veshje fasase me alukobond", sqarojmë se në preventivin e punimeve nuk ekziston zë riparim, por vetëm furnizim vendosje.
Në lidhje me zërin tavan kartonxhes, nga ana e kontraktorit nuk ka analizë të detajuar të çmimit të konstruksionit apo materialit. Në dosjen teknike nuk ka asnjë dokument se materiali është dorëzuar në institucion.

2. Mbi auditimin e ushtruar për zbatimit të procedurës së prokurimit dhe kontratës "Përgatitje e projektpreventivit për rikonstruksionine godinës trekatëshe dhe ndërtimin e urës lidhëse me korpusin qendror", realizuar në vitin 2020.

Kërkesa për realizimin e prokurimit ñPërgatitje e projektpreventivit për rikonstruksionine godinës trekatëshe dhe ndërtimin e urës lidhëse me korpusin qendrorò, është bërë nga Sektori i planifikimit pranë SUT me shkresë nr. 479/1 prot., datë 15.09.2020.

Për përcaktimin e fondit limit është aplikuar si vlerë e përafërt e rikonstruksionit shuma 189,262,015 lekë. Fondi limit është përcaktuar për godinën 3 katëshe me vlerë 10,475,822 lekë dhe për ndërtimin e depozitës së ujit, me vlerë 1,890,000 lekë.

Dokumentet e tenderit janë hartuar sipas procesverbalit nr. 1, datë 21.09.2020. Për kriteret e përcaktuara Agjencia e Prokurimit Publik, nëpërmjet email të datës 25.09.2020, ka sugjeruar përmirësimin e disa kritereve, që kanë të bëjnë kryesisht me licencimin. Procedura është pezulluar sipas Urdhrit të Titullarit të AK nr. 54/5, datë 02.10.2020. Bazuar në sa më sipër, nga ana e AK janë bërë ndryshimet e kërkuara duke eliminuar kërkesa të pa nevojshme dhe që nuk janë në përputhje me volumin e kontratës.

Ofertat janë hapur me datë 12.10.2020. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë tre operatorë ekonomikë, nga të cilët është skualifikuar një OE për mos plotësim të dokumentacionit të ofertës sipas kërkesave. Është shpallur fitues oferta e BOE ñC. Cò dhe ñC.E.C Groupò, me propozimin financiar më të ulët, me vlerë 12,278,166 lekë.

Kontrata e shërbimeve konsulente është nënshkruar me nr. 54/16 prot., datë 14.12.2020, me BOE ñC. Cò dhe ñC.E.C Gò, me vlerë 14,743,800 lekë. Afati për dorëzimin e shërbimit është përcaktuar 40 ditë.

Për marrjen në dorëzim të shërbimit të projektimit, me Urdhër nr. 54/17 prot., datë 15.12.2020, është ngritur Komisioni i Marrjes në Dorëzim i përbërë nga z. V. H., znj. D. Ll. dhe z. M. S..

Dokumentacioni i projektimit është marrë në dorëzim sipas procesverbalit nr. 54/18 prot., datë 22.12.2020, nga komisioni i mësipërm.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga BOE ñC. Cò dhe ñC.E.C Groupò, rezulton se është përgatitur projektpreventivi, bazë e të cilit është përgatitja e fondit limit për punimet e konstruksionit, konkretisht për godinën 3 katesh me vlerë 283,931,787.5 lekë pa TVSH dhe për urën metalike të lidhjes me Korpusin Qendror, me vlerë 42,841,723.9 lekë pa TVSH. Referuar periudhës së auditimit, është filluar procedura e prokurimit për realizimin e punimeve të rokonstruksionit, por kjo procedurë nuk është përfunduar.

Për përcaktimin e vlerës së punimeve, në masën më të madhe të zërave të punimeve, janë aplikuar çmimet sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015 ñPër miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyreò, por rezultojnë mangësi të cilat për disa zëra të verifikuara, paraqiten si më poshtë:

Titulli i Gjetjes: Përllogaritje me gabime në disa zëra punimesh të përshkruara në preventivin e punimeve që do të realizohen.

Situata: Sipas zërit A.5.5 ñShtresë termoizoluese me polisterol t=10 cmò, është aplikuar çmimi 2,658 lekë për m^2, për sasinë 1090 m^2. Për këtë zë punimi, referenca është marrë sipas analizës së çmimeve 2.239/a. Kjo analizë çmimi është hartuar me gabime sa i takon sasisë së polisterolit

që do të vendoset për njësinë m^2. Në analizë është përcaktuar sasia e polisterolit në masën 0.8 m^3, ndërkohë që trashësia 10 cm i përket sasisë 0.1 m^3. Nga ribërja e llogaritjeve për sasinë 0.1 m^3, rezulton se çmimi për njësi duhet të jetë në shumën 511 lekë për m^2. Për këtë zë punimi është parashikuar më shumë vlera 2,340,230 lekë [1090 m^2 x (2,658 lekë/m^2 ï 511 lekë/m^2)], vlerë e cila konsiderohet si e pa argumentuar në përllogaritjen e fondit limit.

- Sipas zërit C.3.4 ñF.V beton C 25/30, për soletën kompozite me h=14 cm, është aplikuar çmimi 15,615 lekë për m^3, për sasinë 135 m^2.

Analiza e çmimit për këtë zë punimi, është përllogaritur për njësinë m^2, me çmim 1,173 lekë për m^2, ndërkohë që në preventiv është paraqitur çmimi 15,615 lekë për m^3, pra është ndryshuar njësia nga m^2 në m^3. Nga ribërja e llogaritjeve rezulton se çmimi i duhur është 15,038 lekë/m^2. Për këtë zë punimi është parashikuar më shumë vlera 77,895 lekë [135 m^2 x (15,615 lekë/m^2 ï 15,038 lekë/m^2)], vlerë e cila konsiderohet si e pa argumentuar në përllogaritjen e fondit limit.

Vlera e fondit limit të pa argumentuar për këtë lot është 2,418,125 lekë.

Për lot nr. 2 "Ndërtimi i depos së ujit të Spitalit Universitar të Traumës".

Nga verifikimi i çmimeve të aplikuara konstatohet:

-Sipas zërit të preventivit 1.22 ñShtresë termoizoluse me polisterol t=10 cmò, është parashikuar sasia 85 m^2. Për këtë zë punimi, referenca është marrë sipas analizës së çmimeve 2.239/a. Kjo analizë çmimi është hartuar me gabime sa i takon sasisë së polisterolit që do të vendoset për njësinë m^2. Në analizë është përcaktuar sasia e polisterolit në masën 0.8 m^3, ndërkohë që trashësia 10 cm i përket sasisë 0.1 m^3. Nga ribërja e llogaritjeve për sasinë 0.1 m^3, rezulton se çmimi për njësi duhet të jetë në shumën 511 lekë për m^2. Për këtë zë punimi është parashikuar më shumë ***vlera 182,492 lekë*** [85 m^2 x (2,658 lekë/m^2 ï 511 lekë/m^2)], ***vlerë e cila konsiderohet si e pa argumentuar në përllogaritjen e fondit limit.***

Kriteri: Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar me Ligjin nr. 120/2020, datë 07.10.2020, ñPër disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, Neni 5/1 ñPërgjegjësia e projektuesitò, pika 2 dhe 3.

-VKM nr. 514, datë 15.08.2007 ñPër informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të ndërtimitò i ndryshuar, pika 2 dhe 11

-VKM nr. 629, datë 15.07.2015 ñPër miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyreò, pika 1.

Ndikimi: Hartimi i preventivit të punimeve me mangësi nuk jep efekt në këtë periudhë, por referenca për zbatimin e procedurës së prokurimit të zbatimit të punimeve, duke konsideruar vlerën e preventivit si fond limit, do të japë efekte sa i përket vlerës së kontratës që nënshkruhet.

Shkaku: Referenca të gabuara në aplikimin e çmimeve të ndërtimit dhe hartimit të analizave të tyre, ku për një rast gabimi në vlerën totale të çmimit është si pasojë e mos llogaritjes së saktë të volumit të materialit që do përdoret nga vetë përshkrimi i manualit të çmimeve të punimeve të ndërtimit i vitit 2015.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: SUT të marrë masa për analizimin e çmimeve të aplikuara të preventivave si në kuadrin e marrjes në dorëzim të shërbimeve konsulente, ashtu dhe në kuadër të hartimit të fondit limit, ku për referencë merret vlera e preventivit e hartuar nga konsulentë të përzgjedhur.

Konkluzione:

Preventivi i hartuar nga Kontraktori BOE ñCi. C.ò dhe ñC.E.C Groupò, ka mangësi sa i takon referencave në manualet e çmimeve të ndërtimit. Shmangia kryesore i përket analizës së çmimit 2.239/a, e cila ka të bëjë me shtresën e polisterolit, e cila është parashikuar gabim në muanualin e

çmimeve të ndërtimit. Sasia e polisterolit të parashikuar është 0.8 m^3/m^2, ndërkohë që kërkohet sasia 0.1 m^3/m^2.

Për mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi BOE "Ci. C." dhe "C.E.C Group" dhe Komisioni i Marrjes në Dorëzim i përbërë nga V. H., D. Ll. dhe M. S..

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 06, datë 01.10.2021, nga shoqëria projektuese ñC. C.ò, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

<u>Pretendimi i subjektit:</u>

Në lidhje me zërin A.5.5 "Shtresë termoizoluese me polisterol 10 cm", pretendohet se çmimi është bazuar në manualet e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2021, sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. Për këtë zë nuk është kërkuar hartimi i analizave të çmimeve, pasi ato janë hartuar konformë vendimit të mësipërm. Pretendohet se për këtë zë punimi, nga llogaritja duke marrë në konsideratë çmimin e tregut, rezulton vlera 2,658 lekë/m^2.

Në lidhje me zërin C.3.4 "F.V beton C 25/30 për soletën kompozite", pretendohet se konvertimi nga m^2 në m^3, është i saktë dhe nuk ka diferenca.

Në lidhje me zërin A.2.8 "F.V rrjetë suvatimi", është bërë analizë e veçantë, pasi në manualet e çmimeve të ndërtimit të miratuara nuk ka analizë të tillë. Çmimi i materialeve është bazuar në studimin e tregut dhe bashkëngjitur observacioneve janë paraqitur ofertat përkatëse.

<u>Qëndrimi i Grupit të auditimit:</u>

Në lidhje me shtresën e polisterolit, siç edhe është trajtuar në projektraport, gabimi është në analizën e çmimit sipas manualeve të çmimeve të miratuara, por duhet të ishin verifikuar zërat e analizës së çmimeve për të shmangur gabimet. Pavarësisht sa më sipër, bazuar edhe në dokumentacionin e paraqitur bashkëngjitur observacioneve, çmimi i materialit polisterol ka pësuar rritje të vazhdueshme, referuar periudhës së hartimit të tyre.

Sa i përket zërit C.3.4 "F.V beton C 25/30 për soletën kompozite", pretendimi nuk qëndron.

Sa i përket zërit A.2.8 "F.V rrjetë suvatimi", në kushtet kur ky zë punimi nuk është në manualet e çmimeve të punimeve të ndërtimit të miratuara, merret në konsideratë.

2.7. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.

Në mjedisin e kontrollit të brendshëm Spitali Universitar i Traumës është fokusuar në vendosjen e objektivave dhe politikave të cilat rrjedhin nga misioni Kushtetues. Struktura organizative e cila ka siguruar detyrat, hierarkike, linjat e raportimit dhe raportimin dhe përcaktimin e aktiviteteve të kontrollit. SUT ka përcaktuar riskun duke u referuar në ngjarjet të cilat mund të ndodhin edhe të cilat mund të kenë një impakt në përmbushjen e objektivave të SUT-së. Për çdo sektor, Shefat e sektorëve kanë kryer rolin e koordinatorit të riskut për sektorët përkatëse, të cilët kanë identifikuar dhe vlerësuar risqet sipas rasteve. Metodat e kontrollit të përdorura nga Spitali Universitar i Traumës janë si më poshtë: Kontroll para faktit ose parandalues, kontrolli pas faktit ose zbulues, kontroll drejtues ose menaxheria. Janë vendosur rregulla të brendshme për përshkrimin e proceseve kryesore operacionale dhe financiare, ndarjen e detyrave dhe delegimin. Është hartuar Deklarata Vjetore mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm. Në Spitalin Universitar të Traumës raportohet sistematikisht për çdo muaj nga menaxheret për aktivitetet dhe performancën e secilit sektor. Grupi i auditimit gjatë verifikimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizmit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij për të gjithë komponentët: Mjedisi i kontrollit,

menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informimi dhe komunikimi, si dhe monitorimi, në zbatimin e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò. Nga auditimi u konstatua se në Spitalin Universitar të Traumës, nuk janë implementuar plotësisht procedurat për respektimin e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò.

Titulli i Gjetjes: Mos zbatimi i të gjithë elementeve të ligjit.

Situata: Nuk funksionon sistemi i monitorimit për vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Nuk ka një procedurë të shkruar për mënyrën e komunikimit brenda institucionit dhe procedurat për qarkullimin e informacionit.

Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, identifikimin e shkaqeve dhe eliminimin e tyre.

Nuk ka regjistra risku të hartuara specifikisht për çdo drejtori.

Nuk ka manuale të procedurave për aktivitetet operacionale dhe financiare të bazuara në harta dhe në procese pune dhe në procedurat e shkruara sipas formateve të ofruara nga manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe të miratuara nga nëpunësi autorizues.

Kriteri: Ligji nr. 10 296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*.

Ndikimi/Efekti: Nga mos zbatimi i të gjithë elementeve të ligjit ka sjellë për pasojë mos funksionimin e duhur të strukturave të brendshme të Spitalit Universitar të Traumës.

Shkaku: Mos zbatimi i të gjithë elementeve të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Rëndësia: E mesme

Nga Drejtoria e Spitalit Universitar të Traumës të merren masa për hartimin dhe menaxhimin e regjistrit të riskut për çdo drejtori, monitorimin dhe vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve, krijimin e listave të proceseve kryesore dhe gjurmët e auditimit, me qëllim arritjen e mjaftueshme të aktiviteteve të kontrollit për identifikimin, kontrollin dhe reduktimin e risqeve, si edhe përfshirjen efektive të sektorëve të ndryshëm në procese, dokumentacionin përkatës, përgjegjësitë personale, mbështetjen e sistemeve të IT.

2.8. Mbi zbatimi i dispozitave ligjore për dhënien dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të kontratave të nënshkruara, dokumentacioni i arkëtimeve, dokumentacion padie etj., për dhënien e aseteve me qira konstatohet që:

Titullari i Autoritetit Kontraktor z. A. Z., me Urdhër nr. 299 prot., datë 12.03.2018, ka ngritur grupin e monitorimit dhe kontrollit të zbatimit të kontratave të qirasë të lidhura nga SUT të përbërë nga znj. E. R., z. V. S., znj. E. T., znj. D. Ll. dhe znj. A. D. Me Urdhër nr. 326 prot., datë 22.06.2020, znj. E. T. është zëvendësuar me z. B. S.

Në ambientet e Spitalit Universitar të Traumës, aktualisht janë të lidhura 3 kontrata marrje me qira të ambienteve, konkretisht me Shoqërinë ñA Hò për sipërfaqen 16134 m^2 , ñL. K.ò me sipërfaqe 10.08 m^2 dhe ñS. C.ò, për sipërfaqen 67.2 m^2.

Me Shoqërinë ñA. Hò SHA, janë nënshkruar kontrata si më poshtë:

Në VKM nr. 729, datë 18.10.2006 ñPër dhënien me qira pa konkurrim Shoqërisë ñUn. Albò SHA të disa ambienteve në Spitalin Ushtarak Qendror universitarò, përcaktohet dhënia me qira për një afat 20 vjeçar e sipërfaqes 15638 m^2.

- Me datë 28.12.2006, Ministria e Ekonomisë ka nënshkruar një kontratë me afat 20 vjeçar për sipërfaqen 15449 m^2, nga të cilat 807 m^2 nën objekt. Bazuar në aneksin nr. 1 të kësaj kontrate datë 13.07.2007, është shtuar sipërfaqja 500 m^2 (nën objekt) dhe në aneksin nr. 2, datë

03.03.2008 është shtuar sipërfaqja 185 m^2 (nën objekt). Pagesa e qirasë është përcaktuar 755,100 lekë në muaj. Bazuar në pikën 6.3 të kontratës së mësipërme, Qiramarrësi do të investonte 25 milionë Euro, nga të cilat:
- 1.2 milionë Euro të përcaktuar si fazë të parë për një periudhë 6 mujore, për rikonstruksionin e objekteve ekzistuese;
- 23.8 milionë Euro, për fazën e dytë të cilat do të bëheshin për ngritjen dhe pajisjen me aparatura të një spitali të ri.
- Me datë 27.07.2006, Ministria e Mbrojtjes ka nënshkruar Kontratën nr. 1, me afat 5 vjeçar për dhënien me qira të ambienteve të SUT me sipërfaqe 496 m^2. Marrëveshje të datës 23.11.2006, për postimin e sipërfaqes 496 m^2, të dhen me qira. Marrëveshje datë 30.08.2007, ku është shtuar sipërfaqja 347 m^2.
- Me datë 13.07.2007, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës ka nënshkruar aneksin nr. 1 të kontratës së nënshkruar me datë 28.12.2006, sipas të cilit është bërë ndryshimi duke shtuar sipërfaqen nën objekt në sasinë 500 m^2. Qiraja është përcaktuar 855,100 lekë në muaj.
- Me datë 03.03.2008, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës ka nënshkruar një aneks, sipas të cilit është bërë ndryshimi duke shtuar sipërfaqen nën objekt në sasinë 185 m^2. Me këtë shtesë, qiraja është përcaktuar 892,100 lekë në muaj.
Me datë 30.08.2013, Ministria e Ekonomisë ka nënshkruar kontratën me afat 10 vjeçar, për rinovimin e kontratës së lidhur me Ministrinë e Mbrojtjes të datës 27.07.2006, me sipërfaqe 496 m^2.
SUT ka bërë Kërkesë-Padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndaj Shoqërisë ñA.H.ò SHA me nr. 2697 prot., datë 13.12.2018.
Objekti i kërkesë padisë ka të bëjë me:
- Pagesën e detyrimit për sipërfaqet e rezultuara shtesë që përdoren pa kontratë qiraje.
- Pagesën e qirasë për ambientet te SUT që përdoren pa kontratë qiraje për periudhën 2011 deri 2013.
- Kamatë-vonesat e detyrimeve të mësipërme.
- Saktësimin e sipërfaqeve të ndërtuara pa leje brenda truallit të dhënë me qira të paditurit sipas VKM nr. 729, datë 18.10.2006 dhe përcaktimin e detyrimit për to, duke përfshirë edhe kamatëvonesat deri në momentin e lirimit të ambienteve ose lidhjen e kontratës nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për këto shtesa.
Bazuar në sipërfaqet e identifikuara nga specialisti topograf dhe punonjës të SUT, si dhe në përllogaritjet e ekspertit kontabël, deri në tetor 2018, Shoqëria ñA. H.ò, i detyrohet SUT vlerën 23,608,553 lekë.
Kjo vlerë është përcaktuar si më poshtë:
1. Kontrata e lidhur nga Ministria e Mbrojtjes me afat 5 vjeçar, për sipërfaqen 843 m^2, me vlerë 4,844,942 lekë [(843 m^2 x 200 lekë/m^2 x 25 muaj) + kamatë me vlerë 629,942 lekë]
2.1. Sipërfaqja 515.4 m^2, për periudhën 30.08.2013 deri 21.02.2014, me vlerë 578,556 lekë.
2.2. Sipërfaqja 515.4 m^2, për periudhën 21.02.2014 deri tetor 2014, me vlerë 9,292,662 lekë dhe kamatë ligjore e llogaritur nga eksperti kontabël me vlerë 242,125 lekë.
3.1. Detyrimi për sipërfaqet e ndërtuara pa leje mbi territorin dhe godinat e SUT, me sipërfaqe 267 m^2, për periudhën 10.07.2013 deri 28.10.2018, me vlerë 5,252,447 lekë [(267.03 m^2 x 300 lekë/m^2 x 63.7 muaj) + 148,374 lekë kamatë].
3.2. Platforma me konstruksion çeliku me sipërfaqe 202 m^2, për periudhën 10.07.2013 deri 28.10.2018, me vlerë 3,972,347 lekë [(202 m^2 x 300 lekë/m^2 x 63.7 muaj) + 112,127 lekë

kamatë]. **Theksojmë se për periudhën duke filluar nga muaji nëntor 2018, vlera e interesave për mos pagesa rritet.**

Nga sa më sipër konstatohet se nga ana e SUT (komisioneve të monitorimit), nuk është bërë monitorimi dhe raportimi periodik, mbi zbatimin e kontratës së qirasë. Nga ana e qiramarrësit, jo vetëm që nuk janë shlyer detyrimet konformë përcaktimeve kontraktore, por janë bërë edhe shtesa pa lejet përkatëse ligjore, për të cilat SUT duhet të kishte bërë denoncimet sipas ligjit. Ankimimi për mos zbatim të kontratës së qirasë duhet të bëhej periodikisht, sipas shkeljeve që konstatohen nga monitorimi i kontratave, gjatë periudhës së zbatimit të saj. Ky veprim është në mos plotësim të detyrimeve që rrjedhin nga VKM nr. 54, datë 05.04.2014 ñPër përcaktimin e kritereve, të procedurës e mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroreò, i ndryshuar, Sek. VI, Pika 6. 2. (c, ç, d, dh), ku përcaktohet:

Njësia monitoruese e kontratave të qirasë ose të enfiteozës kryen këto detyra:
c) Ndjek në vijueshmëri respektimin e kushteve të kontratave të qirasë ose të enfiteozës dhe çdo 6 (gjashtë) muaj harton akte rakordimi me subjektet qiramarrëse ose enfiteozëmarrëse.
ç) Dërgon në degën e shoqërive publike, pranë prefekturës, një kopje të kontratave të lidhura sipas shkronjave "a" dhe "b" të pikës 6 të kreut I, shoqëruar me kopje të genplanit të
objektit të dhënë me qira.
d) Për çdo kontratë të lidhur, në fund të 6-mujorit të parë, brenda datës 15 korrik, dhe në fund të vitit, brenda datës 20 janar, njësia monitoruese dërgon në degën e shoqërive publike,
pranë prefekturës përkatëse, një raport të hollësishëm për ecurinë e tyre, të konfirmuar për arkëtimet dhe nga degët e thesarit të rrethit përkatës.
dh) Për çdo ndryshim në dhëniet me qira dhe enfiteozë apo lirimin nga këto të drejta, hap pas hapi, kjo njësi njofton për ndryshimet menjëherë degën e shoqërive publike pranë prefekturës përkatëse, e cila bën ndryshimet në regjistrin e krijuar.

- Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 13, datë 26.04.2018 ñPër zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 05.02.2014 óPër përcaktimin e kritereve, të procedurës e mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroreò.

Deri në momentin e auditimit, kjo çështje rezulton në proces gjykimi.

SUT ka nënshkruar Kontratën e Qirasë nr. 2265 prot., datë 18.11.2020, me z. L. K., për dhënie me qira të sipërfaqes 11.52 m^2, me destinacion instalimin e 16 distributorëve automatikë (8 ekspres dhe 8 frigo). Për vitin 2018 dhe 2019, SUT ka patur kontratë qiraje edhe me subjektin ñCoffe Clubò, për sipërfaqen 3.12 m^2, me destinacion instalimin e distributorëve automatikë.

SUT ka nënshkruar kontratën e qirasë me nr. 7/41 prot., datë 09.02.2021, me Subjektin ñS. C.ò, për ambient nënndërtesë me sipërfaqe 67.2 m^2, me tarife 300 lekë/m^2, në muaj. Kontrata është nënshkruar për periudhën nga data 20.07.2020 deri me datë 20.01.2021. Në termat e kontratës nuk është përfshirë pagesa e energjisë elektrike dhe ujit, të nevojshme për proceset e punës, të përcaktuara në kontratën e shërbimit të lavanderisë.

Kjo kontratë është nënshkruar në shërbim të kontratës së nënshkruar nga ky OE për ñKryerje e shërbimit të lavanderisë për një periudhë 48 mujore në SUTò, nënshkruar me datë 17.07.2020.

Pagesa për periudhën 6 mujore është realizuar me datë 12.02.2021, me vlerë 120,960 lekë, vlerë e cila korrespondon me pagesën për sipërfaqen 67.2 m^2 dhe tarifë 300 lekë në muaj për m^2.

Në ambientet SUT të marra me qira nga Shoqëria ñA. H.ò, ushtrojnë aktivitet biznesi edhe subjekte të tjera si më poshtë:

- Aktivitet parkingu nga subjekti Shoqëria ñA. H.ò, me NIPT K61821002C, me sipërfaqe aktiviteti rreth 2750 m^2.
- Aktivitet bar kafe, nga subjekti M. V. me NIPT M02..17S, me sipërfaqe rreth 170 m^2. Ky subjekt është regjistruar në regjistrin tregtar me datë 09.11.2020, me qendër aktiviteti, Rruga ñLord Bajronò, brenda ambienteve të Spitalit Ushtarak (SUT).
- Aktivitet lavazh automjetesh nga subjekti A. F. me NIPT L71..08L, me sipërfaqe rreth 70 m^2. Ky subjekt është regjistruar me datë 03.07.2017, me qendër aktiviteti Njësia 11, Rruga ñLord Bajronò, brenda ambienteve të S.A.

Nga verifikimi i dokumentacionit, konstatohet se nuk ka miratime për këto aktivitete. Dhënia e ambienteve nga ana e qiramarrësit me nënqira pa miratim, si dhe për objekt veprimtarie që nuk ka lidhje me shëndetësinë, bie në kundërshtim me Kontratën e Qirasë, pika 6.7, ku përcaktohet:

> ñ*Qiramarrësi ka të drejtë të japë me nënqira,* ***me miratim të qiradhënësit,*** *mbas ngritjes së qendrës spitalore, ambiente të kësaj qendre për efekt të realizimit të shërbimeve të ndryshme të spitalit, si kateteri, restorant për spitalin,* ***si dhe për realizimin e shërbimeve të tjera shëndetësore*** *të kontraktuara nga qendra për specialitete të veçanta*ò.

Titulli i Gjetjes: Nga ana e Komisionit përkatës nuk ka një monitorim të vazhdueshëm dhe efikas të zbatimit të kontratave të dhënies me qira të ambienteve të SUT.

Situata: Nga auditimi konstatohet se nga ana e SUT (komisioneve të monitorimit), nuk është bërë monitorimi dhe raportimi periodik, mbi zbatimin e kontratës së qirasë. Ankimimi për mos zbatim të kontratës së qirasë me Subjektin ñA. H.ò duhet të bëhej periodikisht, sipas shkeljeve që konstatohen nga monitorimi i kontratave, gjatë periudhës së zbatimit të saj. Mungesa e monitorimit të vazhdueshëm të kontratës së qirasë si më sipër, është në mos plotësim të detyrimeve që rrjedhin nga VKM nr. 54, datë 05.04.2014 ñPër përcaktimin e kritereve, të procedurës e mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroreò, i ndryshuar, Sek. VI, Pika 6. 2. (c, ç, d, dh).

Në ambientet SUT të marra me qira nga Shoqëria ñA. H.ò, ushtrojnë aktivitet biznesi edhe subjekte të tjera si më poshtë:
- Aktivitet parkingu nga subjekti Shoqëria ñA. Hò, me NIPT K6..02C, me sipërfaqe aktiviteti rreth 2750 m^2.
- Aktivitet bar kafe, nga subjekti M. V. me NIPT M023090017S, me sipërfaqe rreth 170 m^2. Ky subjekt është regjistruar në regjistrin tregtar me datë 09.11.2020, me qendër aktiviteti, Rruga ñLord Bajronò, brenda ambienteve të Spitalit Ushtarak (SUT).
- Aktivitet lavazh automjetesh nga subjekti A. F. me NIPT L7..08L, me sipërfaqe rreth 70 m^2. Ky subjekt është regjistruar me datë 03.07.2017, me qendër aktiviteti Njësia 11, Rruga ñLord Bajronò, brenda ambienteve të S. A..

Dhënia e ambienteve nga ana e qiramarrësit me nënqira pa miratimi, si dhe për objekt veprimtarie që nuk ka lidhje me shëndetësinë, bie në kundërshtim me Kontratën e Qirasë, pika 6.7

Kriteri: - VKM nr. 54, datë 05.04.2014 ñPër përcaktimin e kritereve, të procedurës e mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroreò, i ndryshuar, Sek. VI, Pika 6. 2. (c, ç, d, dh).
- Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 13, datë 26.04.2018 ñPër zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 05.02.2014 óPër përcaktimin e kritereve, të procedurës e mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroreò.
-Kontratën e Qirasë me ñA Hò, pika 6.7

Ndikimi: Mos monitorimi i duhur, ka ndikuar mos ndjekjen e detyrimeve që subjektet kanë ndaj SUT, si dhe ka lejuar përdorimin e ambienteve për qëllime jashtë destinacionit të përcaktuar për përdorim.
Shkaku: Monitorimi i pamjaftueshëm dhe jo periodik.
Rëndësia: E mesme.
Rekomandimi: SUT të marrë masa për monitorimin e vazhdueshëm të ecurisë së kontratave për ambientet e dhëna me qira. Të ndiqen praktikat në proceset ligjore për mos zbatim kontratash dhe të kërkohet dëmshpërblim edhe për periudhën pasuese, referuar periudhës së padisë.
Rekomandimi: SUT tã kërkojë Subjektit ñA. H.ò, zhvillimin e akttiviteteve, sipas përcaktimeve në marrëveshje, duke mos lejuar ushtrimin e aktiviteteve tregtare që nuk ka lidhje me fushën e operimit.
Konkluzione:
Nga ana e administratës së SUT nuk janë realizuar monitorime periodike kryesisht për ambientet e marra me qira nga Shoqëria ñA. H.ò, për të përcaktuar:
- Nivelin e investimit apo numrin e të punësuarve, me të cilat lidhet niveli i qirasë apo miradministrimi i pronës sipas përcaktimeve kontraktore.
- Penalizimin e qiramarrësit për mos zbatim të mundshëm të nivelit të investimeve dhe numrit të punonjësve, apo për mos realizimin të pagesave të qirasë, sipas përcaktimeve kontraktore.
- Ndryshimet e pronës, ndërtimeve pa miratim të institucionit dhe organeve kompetente.
- Dhënies me nënqira të objekteve të caktuara pa miratim të qiradhënësit, si dhe për objekt veprimtarie i cili nuk ka lidhje me fushën e shëndetësisë siç janë parkingjet, lokalet jashtë objektit apo lavazhet e automjeteve.

Për veprimet e mosveprimet e mësipërme, (referuar periudhës së auditimit), ngarkohet me përgjegjësi:
Drejtori i SUT A. Z.
Grupi i Monitorimit i përbërë nga E. R., V. S., E. T. (deri me datë 22.06.2020), D. Ll., B. S. (nga data 22.06.2020) dhe znj. A. D.

2.9. Auditimi i fondeve të akorduara dhe shpenzuar për përballimin e situatës së pandemisë së COVID-19.

Në vitin 2020, për Covid-19, është planifikuar një fond në vlerën 234,641,632 lekë, dhe është realizuar në vlerën 46,344,924 lekë. Në mënyrë të detajuar sipas burimit të krijimit dhe në nivel artikulli ky fond paraqitet si më poshtë vijon:
Në mënyrë të detajuar të dhënat paraqiten paraqiten si më poshtë vijon.

Në lekë

Fonde CIVID -2019, viti 2020	Ministria e Mbrojtjes		Ministri e Shëndetësisë	
Art. buxhetor	**Plan**	**Fakt**	**Plan**	**Fakt**
602	181,314,000	0	20,000,000	5,065,4714
600	-00	7,951,818	33,327,632	33,327,632
601	-00	0	-00	-00
TOTAL	**181,314,000**	**7,951,818**	**53,327,632**	**38,393,106**

Burimi i të dhënave: Spitali Universitar i Traumës

Në vitin 2020, për Covid-19, SUT ka përfituar donacione në 5 raste në vlerën 51,293,846 lekë. Në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë vijon:

Në lekë

Nr	Donacione 2020	
1	QSUT	8,603,861
2	Shefqet Ndroqi	1,869,876
3	MSHMS- OBSH	2,285,754
4	MSHMS-Blerje	38,446,975
5	A. Far.	87,380
6	**Total**	**51,293,846**

Burimi i të dhënave: Spitali Universitar i Traumës

Në vitin 2020, për COVID-19, SUT ka zhvilluar 3 procedura prokurimi në vlerën 4,813,587 lekë.

Për Covid-19, nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) dhe Ministria e Mbrojtjes, janë vënë dispozicion fondet si më poshtë:

-*Shtesa e buxhetit për shërbimin spitalor, nga Fonditoi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) me:*

- Shkresa nr. 4985 prot., datë 04.08.2020, për buxhetin e vitit 2020 ***shtesë ,*** artikulli 600, produkti 91304AJ ñPacient të trajtuar me Covid-19ò në vlerën 9,753 mijë lekë dhe artikulli 602, produkti 91304AJ ñPacient të trajtuar me Covid-19ò në vlerën 20,000 mijë lekë.
- Shkresa nr. 7300/1 prot., datë 20.10.2020, për buxhetin e vitit 2020, artikulli 600, produkti 91304AA ñPacient të trajtuar me Covid-19ò në vlerën +20,000 mijë lekë.

-*Shtesa e buxhetit për shërbimin spitalor, nga Ministria e Mbrojtjes me:*

-Shkresa nr. 1732/2 prot., datë 16.04.2020, protokolluar në SUT me nr. 786 prot, datë 21.04.2020 dërguar për zbatim nga SUT shkresa nr. 5800/10 prot., datë 30.03.2020**,** të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (Drejtoria e menaxhimit të investimeve publike), mbi zbatimin e aktit normativ të nr. 6, datë 21.03.2020, për buxhetin e vitit 2020, shtohet artikulli 6020000, kod projektit 91704AF, në vlerën +431,314,000 lekë ñFond emergjence për masat anti Covid-19 (me VKM).

-Shkresa nr. 3308/6 prot., datë 03.08.2020, protokolluar në SUT me nr. 1529 prot, datë 04.08.2020), mbi zbatimin e aktit normativ të nr. 28, datë 02.07.2020, për buxhetin e vitit 2020, shtohet artikulli 6020000, kod projektit 91704AF, në vlerën -250,000,000 lekë.

Për marrjen e masave për COVID-19, përveç fondeve të vënë në dispozicion si më sipër, kanë dal për zbatim dhe urdhrat:

-Urdhri i Ministrit të Mbrojtjes nr. 1643, datë 24.12.2020, protokolluar në SUT me nr. 2465, datë 30.12.2020 ñPër dhënien e shpërblimit dhe miratimin e listës emërore të përfituesve, përfshirë ditët e angazhimit dhe diagnostikimin dhe trajtimin e personave të prekur nga COVID-19ò. Në zbatim të këtij urdhri, drejtori i SUT me urdhër nr. 741, datë 30.12.2020 ka urdhëruar, shpërblimin e personelit mjekësor të njësisë mjekësore ushtarake, e cila mbyllet me listën me nr. rendor 37.

Në fakt, Urdhri i Ministrit të Mbrojtjes nr. 1643, datë 24.12.2020, protokolluar në SUT me nr. 2465, datë 30.12.2020 ñPër dhënien e shpërblimit dhe miratimin e listës emërore të përfituesve, përfshirë ditët e angazhimit dhe diagnostikimin dhe trajtimin e personave të prekur nga COVID-19ò, edhe pse i referohet pikave nr. 1 dhe 2 të VKM nr. 207/2020, është në kundërshtim me këto pika pasi në mënyrë eksplicite:

Në pikën 1 të këtij vendimi është shprehur në mënyrë eksplicite se *"Dhënien e shpërblimit mujor, në masën 125 000 (njëqind e njëzet e pesë mijë) lekë, për personelin mjekësor, specialistë të shëndetit publik që merren me epidemiologjinë, infermierë dhe specialistë të shërbimit*

laboratorik, të angazhuar në diagnostikimin dhe trajtimin mjekësor të personave të prekur nga infeksioni i shkaktuar nga COVID- 19".
Në pikën 2 të këtij vendimi është shprehur në mënyrë eksplicite se *"Dhënien e shpërblimit mujor, në masën 65,000 lekë, për personelin mbështetës, i angazhuar në institucionet ku trajtohen personat e prekur nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19*ò.
Në pikën 6 të këtij vendimi është shprehur në mënyrë eksplicite se ñ*Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi*ò.
Së dyti. Që nga marsi 2020 që ka dal VKM nr. 207/2020, ky urdhër është dërguar nga Ministria e Mbrojtjes me nr. 7035/1 prot., datë 24.12.2020, protokolluar në SUT me nr. 2465, datë 30.12.2020, ***pra 9-muaj me vonesë, duke krijuar jo vetëm një situatë konfuze dhe të pa qartë për SUT, por duke i vënë mjekët e të njëjtit spital në standard të dyfishtë, disa të shpërblehen dhe disa jo.***
Shpërblimi i mjekëve për Covid 2019.
SUT ka 141 punonjës të cilët paguhen me fondet e MSHMS dhe 474 punonjës civil + ushtarak të cilët paguhen me fondet e MM.
Janë dhënë shpërblime :
Për 40 punonjës të Spitalit të cilët paguhen me fondet e MSHMS në bazë të Urdhrit të MSHMS nr. 313 dt. 13.05.2020 për periudhën nga muaji mars- nëntor 2020 në ***vlerën 33,327,632 leke.***
-Për 37 ushtarakak +140 civil të Spitalit të cilët paguhen me fondet e MM në bazë të Urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 7035/1 dt. 24.12.2020 për periudhën nga muaji mars- nëntor 2020 **ne vlerën 7,951,818 leke**. Këto shpërblime janë dhënë në muajin Dhjetor ka ardh urdhri i Ministrit te Mbrojtjes dhe janë përballuar me fondet e SUT. Nga auditimi nuk u konstatuan mangësi ne shpërblimin e mjekeve.
-Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 189, datë 19.03.2020 *"Për ndërprerjen e ndërhyrjeve kirurgjikale të urgjencës së shërbimit të kirurgjisë së përgjithshme I, shërbimi i kirurgjisë urologjike II, Shërbimi i kirurgjisë së përgjithshme digjestive II dhe ndërhyrjet kirurgjikale për patologjinë malinje në QSUT, si ndërhyrjet kirurgjikale të urgjencës për patologjitë malinje në Spitalin universitar "Shefqet Ndroqi" dhe transferimin e tyre në SUT*ò.
Pika 3, shprehet në mënyrë eksplicite se ñNdërhyrjet kirurgjikale të urgjencës së shërbimit të kirurgjisë së përgjithshme I, shërbimi i kirurgjisë urologjike II, Shërbimi i kirurgjisë së përgjithshme digjestive III dhe ndërhyrjet kirurgjikale për patologjinë malinje të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij urdhri, do të kryhen nga SUTò.
Pika 4 shprehet në mënyrë eksplicite se ñHemoragjitë digjestive dhe pankreatitet akute, të vlerësohen pranë urgjencës së sëmundjeve të brendshme të QSUT dhe nis kanë indikacion kirurgjikal të transferohen pranë SUTò.
Pika 5, shprehet në mënyrë eksplicite se ñQSUT të marr masa për të mbështetur SUT me burimet njerëzore të nevojshme, si dhe të sigurojë furnizimin me barna dhe pajisje mjekësore për këto ndërhyrje përgjatë gjithë periudhës që ndërhyrjet kirurgjikale të urgjencës në shërbimin e kirurgjisë së përgjithshme I, shërbimi i kirurgjisë urologjike II, Shërbimi i kirurgjisë së përgjithshme digjestive III dhe ato të patologjive malinje, do të zhvillohen pranë SUTò. Në zbatim të kësaj pike QSUT ka dërguar në SUT 8,603,861 lekë barna si dhe për periudhën mars-dhjetor 2020 mesatarisht 9.8 personel mjekësor (mjek, mjek specializant, specializant) në muaj.

Pika 5, shprehet në mënyrë eksplicite se Spitali ñShefqet Ndroqiò të marr masa për të mbështetur SUT me burimet njerëzore të nevojshme , si dhe të sigurojë furnizimin me barna dhe pajisje mjekësore për këto ndërhyrje përgjatë gjithë periudhës që ndërhyrjet kirurgjikale të urgjencës dhe ato të patologjive malinje, do të zhvillohen pranë SUTò.
Në zbatim të kësaj pike Spitali ñShefqet Ndroqiò i ka dërguar SUT 1,869,876 lekë barna si dhe për 6 muaj 4 personel mjekësor në muaj.
Me e-mailin e datës 24.03.2020 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dërgohet urdhri i kësaj Ministrie nr. 196, datë 24.03.2020, për marrjen në dorëzim referuar kontratës të lidhur datë 18.03.2020 ndërmjet MSHMS dhe Bashkimit të operatorëve Shoqëria ñEuò & Shoqëria ñF. N. A.ò, Shpk, për blerje materiale dhe mbrojtje personale (MMP) për Covid-19, me vlerë 346,105,800 lekë.
Shuma e barnave dhe pajisjeve mjekësore të ardhura në zbatim të kontratës së mësipërme është në vlerën 38,446,975 lekë. Të gjitha barnat dhe pajisjet mjekësore të furnizuara sipas kësaj kontrate nuk janë të shoqëruara me deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike.
Veprim në kundërshtim me nenin 4 kontratës ku është shprehur në mënyrë eksplicite se ñ*Mallrat, të cilat do të furnizohen nga kontraktuesi, do të kenë specifikimet teknike sipas dokumenteve të tenderit, formular të deklaratës mbi origjinën e mallit dhe deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike*ò.
Për mangësitë e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi grupet e kolaudimit të barnave me përbërje: E. N. me detyrë shefe e shërbimit të farmacisë, S. Gj. me detyrë kryeinfermiere e përgjithshme, E. R. me detyrë kryeinfermier i pranim urgjencës.
Materiale e mjekimit duhet të përmbushin standardet CE ose CE sipas direktivës MDD 93/42 EEC. Ato duhet të jenë të markuar me CE në momentin e lëvrimit të mallit. Afati i skadencës, për ato mallra të cilat kanë datë skadence, duhet të jetë jo me e vogël se 12 muaj, nga data e lëvrimit të mallit. Ofertuesi duhet të përmbush specifikimet teknike të materialeve mjekësor detyrimisht, sipas përcaktimit të bërë në përshkrimin e mallrave në DT të kësaj procedure.
Neni 5 ñAfati i lëvrimit dhe marrja në dorëzimò, ka të përcaktuar ñE gjitha sasia e mallit duhet të lëvrohet, pranë MSHMS dhe më pas në varësi të planit të shpërndarjes do të çohet në depot e institucioneve shëndetësore që do të jenë përfituese, sipas grafikut që do tëju vihet në dispozicion. Malli do të shoqërohet me faturë dhe do të nënshkruhet dhe procesverbali i kolaudimit në lidhje me sasinë dhe specifikimet teknikeò.
Për zbatimin e kësaj kontrate në farmaci më datën 04.03.2021, u krye verifikimi kontabël dhe fizik ku rezultuan gjendje katër artikuj, konkretisht: Çizme plastike mbrojtëse palë. 10 x 2160 lekë = 17280, disifektant steril flakon 14 x 556 = 7,7784, ekran mbrojtës copë 1517 x 415= 630,005 lekë dhe syze copë 2342 x 556 =1,302,090 lekë.
U verifikua skadenca dhe specifikimet teknike të katër artikujt dhe u konstatua se artikulli çizme plastike mbrojtëse, me datë skadence të vendosur 31.01.2025 nuk është i saktë, pasi jo vetëm nuk ishte përfshirë në deklaratën mbi origjinën e mallit dhe deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, por nuk kishte asnjë dokument provues për këtë datë kadence, si dhe nuk ishte në listën e artikujve të përcaktuar në kontratë.
1. Titulli i gjetjes: Urdhri i Ministrit të Mbrojtjes nr. 1643, datë 24.12.2020 ñ Për diagnostikimin dhe trajtimin e personave të prekur nga COVID-19ò, është nxjerr në kundërshtim me VKM nr. 207/2020, pika 1 dh 2, si dhe është dërguar me 9-muaj me vonesë në SUT.
Situata: Urdhri i Ministrit të Mbrojtjes nr. 1643, datë 24.12.2020, protokolluar në SUT me nr. 2465, datë 30.12.2020 ñPër dhënien e shpërblimit dhe miratimin e listës emërore të përfituesve, përfshirë ditët e angazhimit dhe diagnostikimin dhe trajtimin e personave të prekur nga COVID-

19ò, edhe pse i referohet pikave nr. 1 dhe 2 të VKM nr. 207/2020, është në kundërshtim me këto pika pasi në mënyrë eksplicite:

Në pikën 1 të këtij vendimi është shprehur në mënyrë eksplicite se *"Dhënien e shpërblimit mujor, në masën 125 000 (njëqind e njëzet e pesë mijë) lekë, për personelin mjekësor, specialistë të shëndetit publik që merren me epidemiologjinë, infermierë dhe specialistë të shërbimit laboratorik, të angazhuar në diagnostikimin dhe trajtimin mjekësor të personave të prekur nga infeksioni i shkaktuar nga COVID- 19".*

Në pikën 2 të këtij vendimi është shprehur në mënyrë eksplicite se *"Dhënien e shpërblimit mujor, në masën 65,000 lekë, për personelin mbështetës, i angazhuar në institucionet ku trajtohen personat e prekur nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19*ò.

Në pikën 6 të këtij vendimi është shprehur në mënyrë eksplicite se ñ*Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi*ò.

Së dyti. Që nga marsi 2020 që ka dal VKM nr. 207/2020, ky urdhër është dërguar nga Ministria e Mbrojtjes me nr. 7035/1 prot., datë 24.12.2020, protokolluar në SUT me nr. 2465, datë 30.12.2020, pra 9-muaj me vonesë, duke krijuar një situatë të pa qartë për administratën e SUT, për shpërblimin e mjekëve, pasi mjekët e të njëjtit spital për vonesën 9-muaj të urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes, janë vënë në një standard të dyfishtë, mjekët civil të shpërblehen, ndërsa ushtarakët jo.

Kriteri: Ligji nr. 207, datë 10.3.2020 ñPër dhënie shpërblimi për personelin, mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerëò.

Ndikimi/efekti: Ka krijuar një situatë të pa qartë për administratën e SUT, për shpërblimin e mjekëve, pasi mjekët e të njëjtit spital për vonesën 9-muaj të urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes, janë vënë në një standard të dyfishtë, mjekët civil të shpërblehen, ndërsa ushtarakët jo.

Shkaku: Neglizhencë nga Ministria e Mbrojtjes

Rëndësia: E lart

Rekomandimi: Nga Drejtor i Spitalit ti bëhet prezent Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, problematika e krijuar në SUT referuar Urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 1643, datë 24.12.2020 ñPër dhënien e shpërblimit dhe miratimin e listës emërore të përfituesve, përfshirë ditët e angazhimit dhe diagnostikimin dhe trajtimin e personave të prekur nga COVID-19ò, me qëllim marrjen e masave për korrigjimin e kësaj praktike, por edhe për të parandaluar në të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

2. Titulli i gjetjes: Barnat dhe pajisjet mjekësore për Covid-19, nuk janë të shoqëruara me deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, si dh në një artikull nuk provohet data e skadencës.

Situata: Me e-mailin e datës 24.03.2020 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dërgohet urdhri i kësaj Ministrie nr. 196, datë 24.03.2020, për marrjen në dorëzim referuar kontratës të lidhur datë 18.03.2020 ndërmjet MSHMS dhe Bashkimit të operatorëve Shoqëria ñEu.ò & Shoqëria ñF. N. A.ò Shpk, për blerje materiale dhe mbrojtje personale (MMP) për Covid-19, me vlerë 346,105,800 lekë.

Shuma e barnave dhe pajisjeve mjekësore të ardhura në zbatim të kontratës së mësipërme është në vlerën 38,446,975 lekë. Të gjitha barnat dhe pajisjet mjekësore të furnizuara sipas kësaj kontrate nuk janë të shoqëruara me deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike.

Veprim në kundërshtim me nenin 4 kontratës ku është shprehur në mënyrë eksplicite se ñ*Mallrat, të cilat do të furnizohen nga kontraktuesi, do të kenë specifikimet teknike sipas*

*dokumenteve të tenderit, formular të deklaratës mbi origjinën e mallit dhe deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike*ò.
Nga kjo kontratë në farmaci më datën 04.03.2021, që u krye verifikimi kontabël dhe fizik rezultuan gjendje katër artikuj, konkretisht: Çizme plastike mbrojtëse palë. 10 x 2160 lekë = 17280, disifektant steril flakon 14 x 556 = 7,7784, ekran mbrojtës copë 1517 x 415= 630,005 lekë dhe syze copë 2342 x 556 =1,302,090 lekë.
U verifikua skadenca dhe specifikimet teknike të katër artikujt dhe u konstatua se artikulli çizme plastike mbrojtëse, me datë skadence të vendosur 31.01.2025 nuk është i saktë, pasi jo vetëm nuk ishte përfshirë në deklaratën mbi origjinën e mallit dhe deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, por nuk kishte asnjë dokument provues për këtë datë kadence, si dhe nuk ishte në listën e artikujve të përcaktuar në kontratë.
Për mangësitë e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi grupet e kolaudimit të barnave me përbërje: E. N. me detyrë shefe e shërbimit të farmacisë, S. Gj. me detyrë kryeinfermiere e përgjithshme, E. R. me detyrë kryeinfermier i pranim urgjencës.
Kriteri: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 60, pika 1, e cila përcakton se: ñ1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fitueseò, Kontrata e lidhur datë 18.03.2020 ndërmjet MSHMS dhe Bashkimit të operatorëve Shoqëria ñEu.ò & Shoqëria ñF. N A.ò, Shpk, nenin 4.
Shkaku: Mos vlerësim nga grupet e kolaudimit të barnave.
Rëndësia: E mesme
Rekomandimi: Për shkeljet dhe parregullsitë e konstatuara në zbatimin e kontratës datë 18.03.2020 ndërmjet MSHMS dhe Bashkimit të operatorëve Shoqëria ñE.ò & Shoqëria ñF. N. A.ò Shpk, për barnat dhe pajisjet mjekësore për Covid-19, është e domosdoshme marrja e masave urgjente për korrigjimin e kësaj praktike, por edhe për të parandaluar në të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

2.10. Zbatimi i procedurave për arkivimin e dokumentacionit referuar VKM nr. 4, datë 19.06.2017 "Për miratimin e Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë", dal në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat".
Organizmi dhe funksionimi i arkiv-protokoll përgjithësisht është konform në Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, ñPër arkivinò dhe aktet nënligjore dhe rregullatorë në funksion tij.
Të gjitha dokumentet që kanë dalë nga Spitali Universitar i Traumës janë të përpiluara me: Logon e miratuar dhe emërtimin e Institucionit, siglën e njësisë përpiluese, numrin e protokollit të korrespondentit, formulën në përgjigje ose vijim të shkresës, numrin e lidhjeve, tekstin e dokumentit, funksionin, emrin e personit që nënshkruan dokumentin dhe nënshkrimin e tij, numrin e kopjeve, datën e punimit, numrin e kopjeve, afatin e ruajtjes si dhe vulën. Këto dokumente kanë datën, numrin e protokollit dhe firmën e titullarit.
Titulli i Gjetjes: Mosrespektim i të gjithë kritereve ligjore nga zyra e protokoll/arkives.
Situata: Nga auditimi i Zyrës së Protokoll/Arkivës, u konstatua mos plotësimi i të gjithë kërkesave të Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 ñPër arkivatò dhe Rregullores ñNorma tekniko-profesionale dhe metodologjike e shërbimit arkivor ne RSHò si më poshtë:
- Spitali Universitar të Traumës, në kundërshtim me nenin 5, të VKM nr. 4, datë 19.06.2017, ñPër miratimin e Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisëò, *nuk ka ngritur komisionin e ekspertizës.*

- Spitali Universitar të Traumës në kundërshtim me nenin 6, të VKM nr. 4, datë 19.06.2017, *nuk ka aprovuar afatet e ruajtjes së dokumenteve.*
- Spitali Universitar të Traumës, në kundërshtim me nenin 8, të VKM nr. 4, datë 19.06.2017, ñPër miratimin e Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisëò, *nuk ka kryer përpunimin tekniko-shkencor të dokumenteve të prapambetura, si përcaktimin e përkatësisë së fondit dhe klasifikimin e dokumenteve sipas fondit.*
- Spitali Universitar të Traumës, në kundërshtim me nenin 9, të VKM nr. 4, datë 19.06.2017, *nuk është kryer ekspertiza e vlerës së ruajtjes.*
- Spitali Universitar të Traumës, në kundërshtim me nenin 10, të VKM nr. 4, datë 19.06.2017, *nuk është kryer ruajtja e dokumenteve në përputhje normativat.*
- Spitali Universitar të Traumës, në kundërshtim me nenin 11, të VKM nr. 4, datë 19.06.2017, *nuk është kryer ruajtja e dokumenteve në përputhje normativat lidhur me temperaturën e ambientit dhe lagështirën.*

Zyra Arkivore e Spitalit Universitar të Traumës bazohet në Ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003 ñPër arkivatò dhe ne Rregulloren ñNorma tekniko-profesionale dhe metodologjike e shërbimit arkivor ne RSHò administrimi i dokumenteve në Zyrën Arkivore të Spitalit Universitar të Traumës, bëhet nëpërmjet pranimit të dokumenteve nga sekretaria e sektorët, si dhe evidentimi i tyre në regjistrin e inventarit të fondit. Megjithatë nuk ka një rregullore të miratuar nga Spitali Universitar të Traumës për funksionimin e arkivës.

Kriteri: Ligji nr. 9154 datë 06.11.2003 ñPër arkivatò dhe ne Rregulloren ñNorma tekniko-profesionale dhe metodologjike e shërbimit arkivor ne RSHò.

Ndikimi/Efekti: Mos ruajtja e dokumenteve sipas kushteve të paracaktuara rrit riskun për dëmtimin e tyre.

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandime: Nga Drejtoria e Spitalit Universitar të Traumës të merren masa për të ngritur komisionin e ekspertizës, përpunimin tekniko-shkencor të dokumenteve të prapambetura dhe ruajtja e dokumenteve të bëhet ambiente në përputhje normativat e përcaktuara.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: KLSH ka rikërkuar zbatimin e **tre** rekomandime të cilat kanë rezultuar në proces zbatimi referuar shkresës së KLSH nr. 470/38 prot., datë 14.08.2019, protokolluar në SUT me nr. 2235 prot., datë 20.08.2019, të cilat përsa i përket kompetencave ligjore të SUT janë pranuar dhe janë zbatuar plotësisht dy rekomandime, ndërsa një është zbatuar pjesërisht.

Konkretisht është zbatuar pjesërisht rekomandimi: ñ*Të punohet për plotësimet në draftin e rregullores së re, të miratohet brenda një afati të shkurtër, me qëllim përputhjen e saj me strukturat aktuale të funksionimit të Spitalit Universitar të Traumës",* pasi Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), ka shfaqur një qasje aspak bashkëpunuese, ndaj kërkesave të përsëritura të SUT, duke bërë që angazhimi i Spitalit Universitar të Traumës për zbatimin e këtij detyrimi, të mbetet i pambështetur, për mungesë bashkëpunimi nga ana e MSHMS, në shkelje të parashikimeve normative, të cilat kushtëzojnë këtë dikaster të përmbushë detyrimet e veta funksionale. Konkretisht Drejtori i Spitalit A. Z. , i ka kërkuar dhe rikërkuar zyrtarisht Ministres së MSHMS, në cilësinë e Kryetares së Bordit, me shkresat nr. 1355 prot.,

datë 20.05.2019, nr. 2780 prot., datë 16.10.2019 dhe nr. 1365 prot, datë 14.07.2020, mbledhjen e bordit për miratimin e buxhetit të SUT, miratimin e statusit të SUT, miratimin e rregullores të organizimit dhe funksionimit të SUT, miratimin e organikës sipas propozimeve përkatëse, në zbatim të parashikimeve të nenit 10 të VKM nr. 66, datë 03.02.2017 ñ*Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për ngritjen e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore Universitare*ò.
Deri në datën 07.05.2021 që përfundoj auditimi, nga Ministrja e MSHMS, Znj. O.M., në cilësinë e Kryetares së Bordit, nuk është kthyer asnjë përgjigje për sa kërkuar në mënyrë të përsëritur nga SUT. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 14-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
1.1.Rekomandimi: Nga Bordi i Spitalit Universitar i Traumës, të merren masa për miratimin e statutit, rregulloren e organizimit dhe funksionimit, strukturës organizative, projektbuxhetin dhe buxhetin, raportin vjetor të veprimtarisë financiare, rregullat dhe procedurat e punësimit të strukturës shëndetësore universitare.

Brenda datës 31.12.2021

2. Gjetje nga auditimi: Në 10 raste për vlerën 24,831 mijë lekë shpenzimet për blerje materiale, për shërbime etj, nuk janë paraqitur në llogarinë e duhur kontabël të klasifikimit buxhetor në nivel 7-shifror, po ashtu janë kapitalizuar në mbyllje të vitit ushtrimor. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 47-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
Rekomandimi 2.1: Menaxhmenti, duhet të siguroj menaxhim të mirë dhe të forcojë kontrollet në realizimin e shpenzimeve, të siguroj klasifikimin e duhur të tyre për një pasqyrim të drejt dhe të saktë financiar.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në 2 raste për vlerën 471,600 lekë me TVSH janë kryer shpenzime për shërbim gjelbërimi pa dokumentacion të plotë vërtetues. Konkretisht nuk ka plan vendosje se ku do të mbillen pemët dekorative me distancat respektive, speciet përkatëse, preventiv, certifikata fito-sanitare qe do ti shoqërojnë. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 ñ*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*ò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 6, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik*ò, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35, Ligjin nr. 8732, datë 24.01.2001 ñ*Për materialin mbjellës bimor*ò, me ndryshimet vijuese të tijô, neni 7/b,c,ç, neni 20 pika 1 dhe 2, neni 23, VKM nr. 157, date 25.4.2002 ñ*Për kriteret dhe rregulla të përpunimit, ambalazhimit, ruajtjes, etiketimit dhe përmbajtjes se etiketës për materialin mbjellës, bimor*ò, neni 6, Udhëzimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit nr. 107 datë 2.12.2002 ñ*Për krijimin, shumëzimin, përpunimin, tregtimin, kontrollin, vlerësimin e farave dhe fidanëve dhe ruajtjen e trajtimin e materialit gjenetik bimor*ò, neni 11, b,c,d, neni 21/a,d, neni 39/a,b,c. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 47-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
Rekomandimi 3.1: Nga sektori i shërbimeve të brendshme të merren masa që shpenzimet e shërbim gjelbërimit të kryhen me dokumentacion specifik që i përkasin këtij shërbimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Në 2 raste për vlerën 69,000 lekë janë kryer shpenzime përmbarimore pa dokumentacion të plotë vërtetues (faturë) dhe nuk janë paraqitur në llogarinë e duhur kontabël të klasifikimit buxhetor në nivel 7-shifror, po ashtu janë kapitalizuar në mbyllje të vitit

ushtrimor. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 47-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 4.1: Nga sektori i financës të merren masa që shpenzimet përmbarimore të kryhen me dokumentacion të plotë vërtetues (faturë) dhe të paraqiten në llogarinë e duhur kontabël të klasifikimit buxhetor në nivel 7-shifror.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi:

Me urdhër shpenzimin nr. 900, datë 18.12.2018 për vlerën 448,000 lekë, është likuiduar Instituti i Modelimeve në Biznes për shpenzimin që ka të bëjë me azhurnim softi WEB Buxhetor (Program financiar që përdoret në kontabilitetin e këtij institucioni) me dokumentet vërtetuese përkatës.

Nga auditimi konstatohet se grupi i përgatitjes së specifikimeve teknike, akt rakordimi për kryerjen e shërbimit dhe komisioni i blerjes me vlera të vogla, nuk kanë në përbërjen e tyre specialist të IT. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 47-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 5.1:

Nga sektori i prokurimeve të merren masa që grupet e përgatitjes së specifikimeve teknike, komisionet e blerjes me vlera të vogla për procedurat e shërbimit të teknologjisë së informacionit të kenë në përbërjen e tyre specialist IT.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Pasqyrat financiare vjetore nuk janë miratuar nga Bordi i Spitalit Universitar i Traumës (miratimi i raportit vjetor të veprimtarisë financiare), veprim në kundërshtim Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 66, datë 03.02.2017 ñ*Për përcaktimin e kritereve e të procedurave për ngritjen e organizimin e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitare*ò, pika 10/c. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 58-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 6.1: Nga Bordi i Spitalit Universitar i Traumës të merren masa për miratimin e përvitshëm të pasqyrave financiare vjetore.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nuk janë përgatitur pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara sipas udhëzimeve të MF-së. Pra pasqyrat financiare të Ministrisë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me kod buxheti ñ13ò dhe Ministrisë e Mbrojtjes me kod buxheti ñ17ò, janë hartuar secila më vehte, pra nuk janë konsoliduar ose gjendja e tyre financiare nuk është paraqitur në aneksin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit SUT, përpjesëtimisht me pjesën takuese, veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*ò, kapitulli IV, pika 98-111. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 58-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 7.1: Nga sektori i financës të merren masa për përgatitur pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara të përvitshme dhe të paraqiten në përputhje me standardet kontabël kombëtare, duke pasqyruar gjendjen e tyre financiare në aneksin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit SUT.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Pasqyrat financiare vjetore, edhe pse janë depozituara në Degën e Thesarit të Rrethit Tiranë, nuk provohet nga ana shkresore të jetë bërë konfirmimi nga kjo e fundit, pastaj të dërgoheshin në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe në Ministrinë e Mbrojtjes (vetëm provohet protokollimi në Degën e Thesarit), veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*ò, kapitulli IV, pika 117. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 58-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 8.1: Nga Drejtoria e SUT, sektori i financës të merren masa që pasqyrat financiare vjetore të dërgohen në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe në Ministrinë e Mbrojtjes, pasi të jenë konfirmuar paraprakisht nga Dega e Thesarit të Rrethit Tiranë.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se Formati 12 ñ*Pyetësor dhe shënime shpjeguese"* dhe relacioni shpjegues për pasqyrat financiare, në të dy bilancet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me kod buxheti ñ13ò dhe Ministrisë se Mbrojtjes me kod buxheti ñ17ò, është plotësuar pjesërisht dhe nuk janë përfshirë të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen, në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar ku të japin informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë dhe të qartë të pasqyrave financiare. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 58-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 9.1: Nga Sektori i Financës të merren masat që në vijimësi, pyetësori dhe shënimet shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore (formati nr. 12), të përgatiten dhe paraqiten në përputhje me standardet kontabël kombëtare dhe ky seksion të plotësohet me të dhëna të sakta për elementë të ndryshme të raportimit financiar të njësisë.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Në pasivin e bilancit kontabël të Spitalit Universitar të Traumës për Ministrinë e Mbrojtjes nuk pasqyrohet në llogarinë 12, rezultat i mbartur nga viti i kaluar. Në këtë zë të pasqyrës së pasivit nuk është pasqyruar rezultat i mbartur për të bërë krahasimin ndërmjet gjendjes në çelje të tij, shtesën përgjatë vitit dhe përdorimin e tij në rezultat për të financuar shpenzimet korente apo kapitale, në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò, Aneksi 1, analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik. Në pasiv është pasqyruar vetëm Llogaria 85 ñRezultati i ushtrimit sipas të cilës pasqyrohet në vlerën ï 1,402,928 lekë për Bilancin Kontabël të Spitalit Universitar të Traumës për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe në vlerën 10,865,810 lekë për Bilancin Kontabël të Spitalit Universitar të Traumës për Ministrinë e Mbrojtjes, si pasojë e diferencës ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve korente. Nga lëvizja e pasqyruar në pasqyrën e lëvizjes së fondeve, veprimet e rregullimit të kësaj llogarie janë ato të mbylljes së rezultatit të ushtrimit të vitit të kaluar dhe ato të njohjes së rezultatit të këtij viti. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 58-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 10.1: Nga Sektori i Financës të merren masat që në vijimësi, pasqyrat financiare të përgatiten dhe paraqiten në përputhje me standardet kontabël kombëtare duke pasqyruar në pasivin e bilancit rezultat i mbartur nga viti i kaluar ñ*Llogaria 12*ò, për të bërë krahasimin ndërmjet gjendjes në çelje të tij, shtesën përgjatë vitit dhe përdorimin e tij në rezultat për të financuar shpenzimet korente apo kapitale.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Në pasivin e bilancit kontabël të Spitalit Universitar të Traumës për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nuk është evidentuar shuma e ndalesave të tjera të mbajtura nga paga në shumën 23,000 lekë, si të pagueshme nga të tretët dhe që janë mbajtur nga paga, që për efekt raportimi duhet të dalin si llogari më vete të detyrimit në fund të periudhës, çka ngarkon me përgjegjësi Sektorin e Financës. Veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*ò, Aneksi 1, Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik ñ*Llogaritë e personelit, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe llogaritë e tatimeve e taksave me shtetin (42 e 43*)ò. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 58-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 11.1: Nga Sektori i Financës të merren masat që në vijimësi, pasqyrat financiare të përgatiten dhe paraqiten në përputhje me standardet kontabël kombëtare, duke evidentuar shuma e mbajtura nga paga si të pagueshme nga të tretët, dhe të dalin si llogari më vete të detyrimit në fund të periudhës, për efekt raportimi.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Në 7 procedura prokurimi për vlerën 522,153 mijë lekë, përllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, i spitaleve te tjera (QSUT, Shefqet Ndroqi etj), veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 59, pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 63-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 12.1: Nga Autoriteti Kontraktor të merren masa që përllogaritja e vlerës së kontratave të prokurimit publik, të vlerësohet si një operacion mjaftë i vështirë dhe në të njëjtën kohë mjaftë i rëndësishëm, për shkak se zbatimi i procedurave të përzgjedhjes të prokurimit publik, do të varet përkatësisht nga përcaktimi i kësaj vlere, por dhe efektiviteti maksimal i shpenzimeve publike. Pikërisht për këtë arsye, duhet zbatuar me rigorozitet legjislacioni i posaçëm për këtë procedurë specifike, kjo edhe për të mënjanuar shmangien nga rregullat e prokurimit nëpërmjet ndarjes apo pjesëtimit të vlerës së kontratave të prokurimit publik.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Për 8 procedura prokurimi për vlerën 548,163 mijë lekë në hartimin e dokumenteve të tenderit, për kriteret e veçanta për kualifikimit nuk është dhënë asnjë argument për përcaktimin e tyre dhe nuk është dokumentuar me procesverbal ky përcaktim, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të

prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 61, pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 63-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 13.1: Autoriteti Kontraktor, në vijim duhet të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim/specifikimet teknike, që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mos diskriminim dhe konkurrencë. Kërkesat/specifikimet teknike duhet të jenë të shkruara në mënyrë të tillë që të argumentohet nevoja që dikton vendosjen e këtyre kritereve, duke parandaluar në këtë mënyrë para përzgjedhjen paraprake të kandidatit fitues, në zbatim me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Në 4 procedura prokurimi për vlerën 428,225 mijë lekë, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñ*Për prokurimin publik*ò, i ndryshuar, neni 46, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Rregullat e Prokurimit*ò, i ndryshuar, neni 63 pika 3, neni 67, Ligjin nr. 44/2015 ñKodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisëò nenet 108-118. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 63-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 14.1: Nga Institucioni t`i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi rëndësia e procesit të shqyrtimit, kualifikimit dhe shpallja fitues të operatorëve është me rëndësi kapitale.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Për 8 proçedura prokurimi për vlerën 557,425 mijë lekë lidhja e kontratave është realizuar mbi bazën e marrëveshjeve kuadër, e cila pavarësisht ka ndikuar në uljen e çmimit për njësi, por si shpenzim ka shkuar tek fondi limit, duke rritur numrin e pjesëve/njësive dhe në rastet e audituara asnjëherë uljen e numrit të pjesëve/njësive si dhe pakësimin jo vetëm të fondit limit por edhe as të vlerës së prokuruar, dhe mbart në të ardhmen riskun e lart të përzgjedhjes së pjesëve/njësive me vlerë më të lart, duke mos arritur në këtë mënyrë uljen e kostove të blerjeve/shërbimeve. Veprime në kundërshtim me Udhëzim e APP nr. 6, datë 16.01.2018 ñ*Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*ò, me ndryshimet vijuese të tij, pikat 7.1,7.2 dhe 7.3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 63-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 15.1: Lidhja e kontratave mbi bazën e marrëveshjeve kuadër, duhet konsideruar si rast i veçantë dhe Autoriteti Kontraktor nuk duhet në asnjë rast të abuzojë me përdorimin e këtij instrumenti, me qëllim shtrembërimin e konkurrencës. Përdorimi i kësaj forme prokurimi detyrimisht duhet të arrij reduktimin e kostove transaksionale, përmirësimin e vazhdueshëm në harkun e marrëdhënieve afat-gjatë ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Operatorëve Ekonomik, në interes të konsumatorit, në rastin konkret përmirësimin e shërbimit të pacientit në spital.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Në zbatimin e kontratës ñBlerje aparat radiografie me krah Cò në vlerën 16,667 mijë lekë, viti 2020, pajisja nuk shoqërohet me etiketën e përkthyer në gjuhën shqipe, veprim në kundërshtim me nenin 20 të Ligjit nr. 89/2014 ñ*Për pajisjet mjekësore*ò, i

ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 63-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 16.1: Titullari i Autoritetit Kontraktor duhet të nxjerri urdhër/urdhra me qëllim ndjekjen me përpikmëri të zbatimit të kontratave, duke përfshirë dhe marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara, për sasinë, cilësinë, llojin si dhe dokumentacionin shoqërues të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Urdhri i Ministrit të Mbrojtjes nr. 1643, datë 24.12.2020, protokolluar në SUT me nr. 2465, datë 30.12.2020 ñ*Për dhënien e shpërblimit dhe miratimin e listës emërore të përfituesve, përfshirë ditët e angazhimit dhe diagnostikimin dhe trajtimin e personave të prekur nga COVID-19",* edhe pse i referohet pikave nr. 1 dhe 2 të VKM nr. 207/2020, është në kundërshtim me këto pika pasi në mënyrë eksplicite:

Në pikën 1 të këtij vendimi është shprehur në mënyrë eksplicite se *"Dhënien e shpërblimit mujor, në masën 125 000 (njëqind e njëzet e pesë mijë) lekë, për personelin mjekësor, specialistë të shëndetit publik që merren me epidemiologjinë, infermierë dhe specialistë të shërbimit laboratorik, të angazhuar në diagnostikimin dhe trajtimin mjekësor të personave të prekur nga infeksioni i shkaktuar nga COVID- 19".*

Në pikën 2 të këtij vendimi është shprehur në mënyrë eksplicite se *"Dhënien e shpërblimit mujor, në masën 65,000 lekë, për personelin mbështetës, i angazhuar në institucionet ku trajtohen personat e prekur nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19*ò.

Në pikën 6 të këtij vendimi është shprehur në mënyrë eksplicite se ñ*Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi*ò.

Së dyti. Që nga marsi 2020 që ka dal VKM nr. 207/2020, ky urdhër është dërguar nga Ministria e Mbrojtjes me nr. 7035/1 prot., datë 24.12.2020, protokolluar në SUT me nr. 2465, datë 30.12.2020, pra 9-muaj me vonesë, duke krijuar një situatë të pa qartë për administratën e SUT, për shpërblimin e mjekëve, pasi mjekët e të njëjtit spital për vonesën 9-muaj të urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes, janë vënë në një standard të dyfishtë, mjekët civil të shpërblehen, ndërsa ushtarakët jo. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqe 144-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 17.1: Nga Drejtor i Spitalit ti bëhet prezent Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, problematika e krijuar në SUT referuar Urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 1643, datë 24.12.2020 ñPër dhënien e shpërblimit dhe miratimin e listës emërore të përfituesve, përfshirë ditët e angazhimit dhe diagnostikimin dhe trajtimin e personave të prekur nga COVID-19ò, me qëllim marrjen e masave për korrigjimin e kësaj praktike, por edhe për të parandaluar në të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Brenda datës 30.11.2021

18. Gjetje nga auditimi: Me e-mailin e datës 24.03.2020 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dërgohet urdhri i kësaj Ministrie nr. 196, datë 24.03.2020, për marrjen në dorëzim referuar kontratës të lidhur datë 18.03.2020 ndërmjet MSHMS dhe Bashkimit të operatorëve Shoqëria ñE.ò & Shoqëria ñF....ò, Shpk, për blerje materiale dhe mbrojtje personale (MMP) për Covid-19, me vlerë 346,105,800 lekë.

Shuma e barnave dhe pajisjeve mjekësore të ardhura në zbatim të kontratës së mësipërme është në vlerën 38,446,975 lekë. Të gjitha barnat dhe pajisjet mjekësore të furnizuara sipas kësaj kontrate nuk janë të shoqëruara me deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, veprim në kundërshtim me nenin 4 kontratës ku është shprehur në mënyrë eksplicite se ñ*Mallrat, të cilat*

*do të furnizohen nga kontraktuesi, do të kenë specifikimet teknike sipas dokumenteve të tenderit, formular të deklaratës mbi origjinën e mallit dhe deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike*ò.
Për zbatimin e kësaj kontrate në farmaci më datën 04.03.2021, u krye verifikimi kontabël dhe fizik ku rezultuan gjendje katër artikuj, konkretisht: Çizme plastike mbrojtëse palë. 10 x 2160 lekë = 17280, disifektant steril flakon 14 x 556 = 7,7784, ekran mbrojtës copë 1517 x 415= 630,005 lekë dhe syze copë 2342 x 556 =1,302,090 lekë.
U verifikua skadenca dhe specifikimet teknike të katër artikujve dhe u konstatua se artikulli çizme plastike mbrojtëse, me datë skadence të vendosur 31.01.2025 nuk është i saktë, pasi jo vetëm nuk ishte përfshirë në deklaratën mbi origjinën e mallit dhe deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, por nuk kishte asnjë dokument provues për këtë datë kadence, si dhe nuk ishte në listën e artikujve të përcaktuar në kontratë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqe 144-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
<u>Rekomandimi 18.1</u>: Për shkeljet dhe parregullsitë e konstatuara në zbatimin e kontratës datë 18.03.2020 ndërmjet MSHMS dhe Bashkimit të operatorëve Shoqëria ñE.ò & Shoqëria ñFa. N....ò, Shpk, për barnat dhe pajisjet mjekësore për Covid-19, është e domosdoshme marrja e masave urgjente për korrigjimin e kësaj praktike, por edhe për të parandaluar në të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Titulli i Gjetjes: Procedura e prokurimit ñRikonstruksion i pavionit dhe ndërtim i sallave të operacionit të këmbës diabetike, në SUTò, është zhvilluar në tetor të vitit 2018. Rikonstruksioni është bërë për arsye të amortizimit të madh të ambienteve të godinës së pavijonit të këmbës diabetike. Fondi limit është përllogaritur me vlerë 66,125,510.8 lekë. Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 9 OE, nga të cilët janë sõkualifikuar 4. Kontrata e rikonstruksionit është përfunduar dhe punimet janë marrë në dorëzim të përkohshëm me datë 17.09.2019.
Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se fondi limit është përllogaritur gabim, pasi nga vlera pa TVSH është nxjerrë nga shuma totale me TVSH, pjesëtuar me 1.2, ndërkohë që një veprim i tillë ka ndikuar në pjesën e makineri pajisje të cilat nuk i nënshtrohen TVSH. Nga përllogaritja rezulton se fondi limit duhet të ishte me vlerë 56,749,042 lekë.
Nga verifikimi i analizave të çmimeve të përgatitura për llogaritjen e fondit limit, rezulton se ka gabime aritmetike për disa zëra punimesh, konkretisht furnizim vendosje kondicionerë. Për shpenzime të parashikuara në masën 1 %, vlera e përfshirë i përket masës 10 %. Po ashtu për zërin M-1.33, sipas preventivit, çmimi është 788,088 lekë për copë, ndërsa pas korrektimit çmimi rezulton 98,081 lekë për copë.
Pas korrektimit të gabimeve në zërat e preventivit nga M-1.27 deri M-1.37, rezulton se është përfshirë në mënyrë të pa argumentuar vlera 1,505,520 lekë. Kësaj shume i shtohet pjesa respektive e fondit rezervë 2,305,303 lekë (2,195,527 lekë x 5 %).
Veprim në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 15.08.2007 ñ*Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të ndërtimit*ò i ndryshuar, pika 2 dhe 11. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 63-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
<u>Rekomandimi 19.1:</u> SUT të marrë masa që të verifikojë preventivat e paraqitura nga shoqëritë konsulente të përzgjedhura për realizimin e projekt preventivave, si në fazën e marrjes në dorëzim të shërbimeve konsulente, ashtu edhe në kuadër të përllogaritjes së fondit limit, me synim shmangien e gabimeve që shkaktojnë blerjen e shërbimeve, mallrave apo punimeve me çmime më të larta se ato të tregut, apo të përcaktuara në aktet ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Në procesin e vlerësimit të ofertave në procedurën e prokurimit ñRikonstruksion i pavijonit dhe ndërtim i sallave të operacionit të këmbës diabetike, KVO ka kualifikuar OE ñA...Mò edhe pse një anëtar i komisionit ka kundërshtuar me argumentimin: ñOferta është e gabuar, pasi është bërë përllogaritja duke u nisur nga vlera totale me TVSH dhe e gjitha kjo është pjesëtuar me 1.2 dhe ka dalë vlera e ofertës pa TVSH. Kjo ofertë nuk është e saktë, pasi seksioni D ñPajisje dhe makineriò është pa TVSHò. Ky argumentim është bërë për gjithë OE pjesëmarrës në tender.
KPP është vënë në dijeni të një gabimi të tillë nëpërmjet Informacionit të AK nr. 2414/1 prot., datë 07.11.2018. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 24, pika 1.ç, si dhe me Dokumentet Standarde të Tenderit, pika 3.2 ñKorrigjimi i gabimeve dhe pjesët e hequraò. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 63-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
Rekomandimi 20.1: SUT të marrë masa për rritjen e kontrollit të procedurave të auditimit të cilat rezultojnë me mangësi të dukshme dhe të identifikuara, si nëpërmjet strukturave të auditimit të brendshëm, ashtu dhe në shqyrtimin me përgjegjshmëri të raportit të vlerësimit të ofertave dhe ankesave që paraqiten.

Menjëherë dhe në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Kontrata e shërbimeve konsulente ñ*Përgatitje e projekt preventivit për rikonstruksionin e godinës trekatëshe dhe ndërtimin e urës lidhëse me korpusin qendror*ò, është nënshkruar me nr. 54/16 prot., datë 14.12.2020, me BOE ñC....ò dhe ñC....ò, me vlerë 14,743,800 lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga shoqëria konsulente, rezulton se në preventivin e paraqitur i cili është bazë për fondin limit në procedurën që do zhvillohet për realizimin e punimeve, u konstatuan mangësi në lidhje me referencat e çmimeve, duke e rritur atë në mënyrë të pa argumentuar si më poshtë:
Për lot 1, sipas zërit A.5.5 ñShtresë termoizoluese me polisterol t=10 cmò, është aplikuar çmimi 2,658 lekë për m^2, për sasinë 1090 m^2. Për këtë zë punimi, referenca është marrë sipas analizës së çmimeve 2.239/a. Kjo analizë çmimi është hartuar me gabime sa i takon sasisë së polisterolit që do të vendoset për njësinë m^2. Në analizë është përcaktuar sasia e polisterolit në masën 0.8 m^3, ndërkohë që trashësia 10 cm i përket sasisë 0.1 m^3. Nga ribërja e llogaritjeve për sasinë 0.1 m^3, rezulton se çmimi për njësi duhet të jetë në shumën 511 lekë për m^2. Për këtë zë punimi është parashikuar më shumë vlera 2,340,230 lekë [1090 m^2 x (2,658 lekë/m^2 ï 511 lekë/m^2)], vlerë e cila konsiderohet si e pa argumentuar në përllogaritjen e fondit limit.
- Sipas zërit C.3.4 ñF.V beton C 25/30, për soletën kompozite me h=14 cm, është aplikuar çmimi 15,615 lekë për m^3, për sasinë 135 m^2. Analiza e çmimit për këtë zë punimi, është përllogaritur për njësinë m^2, me çmim 1,173 lekë për m^2, ndërkohë që në preventiv është paraqitur çmimi 15,615 lekë për m^3, pra është ndryshuar njësia nga m^2 në m^3. Nga ribërja e llogaritjeve rezulton se çmimi i duhur është 15,038 lekë/m^2. Për këtë zë punimi është parashikuar më shumë vlera 77,895 lekë [135 m^2 x (15,615 lekë/m^2 ï 15,038 lekë/m^2)], vlerë e cila konsiderohet si e pa argumentuar në përllogaritjen e fondit limit.
Për lot nr. 2 ñNdërtimi i depos së ujit të Spitalit Universitar të Traumësò.
Sipas zërit të preventivit 1.22 ñShtresë termoizoluse me polisterol t=10 cmò, është parashikuar sasia 85 m^2. Për këtë zë punimi, referenca është marrë sipas analizës së çmimeve 2.239/a. Për këtë zë punimi është parashikuar më shumë vlera 182,492 lekë [85 m^2 x (2,658 lekë/m^2 ï 511

lekë/m^2)]. VKM nr. 514, datë 15.08.2007 ñPër informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të ndërtimitò i ndryshuar, pika 2 dhe 11. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 63-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 21.1. SUT të marrë masa për analizimin e aplikimit të çmimeve të preventivave si në kuadrin e marrjes në dorëzim të shërbimeve konsulente, ashtu dhe në kuadër të hartimit të fondit limit, ku për referencë merret vlera e preventivit e hartuar nga konsulentë të përzgjedhur.

Vazhdimisht

Rekomandimi 21.2. Gjatë zbatimit të kontratës së punimeve civile, të kërkohet reflektimi i saktësisë faktike të polisterolit që vendoset në vepër, duke reflektuar çmimin e polisterolit, në mënyrë që të shmanget gabimi në analizën e çmimit në manualet e çmimeve të ndërtimit të miratuara në vitin 2015.

Gjatë zbatimit të kontratës

22. Gjetje nga auditimit: Nga ana e SUT janë nënshkruar disa kontrata për dhënie me qira të aseteve në administrim. Nga ana e komisioneve të monitorimit, nuk është bërë monitorimi specifik në lidhje me destinacionin e përdorimit të pronës.

Në ambientet e SUT të marra me qira nga një shoqëri, ushtrojnë aktivitet biznesi edhe subjekte të tjera të nën kontraktuara nga qiramarrësi, aktivitete për të cilat nuk ka miratim nga SUT, si dhe nuk i përkasin destinacionit për të cilin është nënshkruar kontrata e qirasë. Dhënia e ambienteve nga ana e qiramarrësit me nën qira pa miratimi, si dhe për objekt veprimtarie që nuk ka lidhje me shëndetësinë, bie në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.04.2014 ñ*Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*ò, i ndryshuar, Sek. VI, Pika 6. 2. (c, ç, d, dh), Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 13, datë 26.04.2018, si dhe Kontratën e Qirasë, pika 6.7 . *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 140-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 22.1: SUT të marrë masa për ndjekjen e procedurave për shlyerjen e detyrimeve shoqëruar me kamatë vonesat përkatëse ndaj qiramarrësve të aseteve në administrim. Kontraktorëve tâu kërkohet që të zhvillojë aktivitete sipas përcaktimeve në marrëveshje, duke mos lejuar ushtrimin e aktiviteteve tregtare që nuk ka lidhje me fushën e operimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2018 Titullarit të Autoritetit Kontraktor, nuk ka ngritur në fillim të vitit kalendarik 2018 komisionin për prokurimet me vlerë të vogël, por ky komision është ngritur rast pas rasti për çdo procedurë specifike të prokurimi me vlerë të vogël. Mos ngritja në fillim të vitit kalendarik 2018, e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël ka lënë pa informacion APP - në për personat e ngarkuar fillimisht, me administrimin e procedurave të prokurimeve me vlerë të vogël, veprim në kundërshtim me Udhëzimin APP, nr. 3 datë 08.01.2018 ñ*Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*ò, i ndryshuar, pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 18-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

24. Gjetje nga auditimi: Raportet e monitorimit të buxhetit të vitit 2018, referuar shkresave nr. 1911 prot., datë 27.09.2018, nr. 1954 prot., datë 02.10.2018, nr. 834 prot., datë 25.03.2019, nr. 833 prot., datë 25.03.2019, kanë përcjellë tek MM dhe FSDKSH, një relacion jo të plotë, me mangësitë si më poshtë:

-Paraqitja e informacionit: ñRelacion për monitorimin e buxhetit të SUT të 4 mujorit....ò është bërë pa plotësimin e një liste përmbajtjeje të raportit të monitorimit;
-Mungon ñHyrjaò ku jepet një përshkrim i përgjithshëm mbi procesin e monitorimit;
-Të dhënat e raportuara në raportin e monitorimit nuk janë në përputhje me formatet e përcaktuara dhe specifikisht:
-Aneksi nr. 1, ñRaporti i shpenzimeve sipas Programeveò mungon, dhe paraqitet versioni i vjetër, Formati nr.7;
-Aneksi nr. 2. ñRaporti i shpenzimeve të Programit sipas Artikujve buxhetorëò mungon, por paraqitet versioni i vjetër, Formati nr. 6;
-Aneksi nr. 3, "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës /produkteve të programit" mungon, etj.
-Relacionet e monitorimit dhe zbatimit të buxhetit për vitin 2018, nuk kanë analizë të produkteve, shumë nga produktet identifikohen me projektet e investimeve dhe raportohen këto të fundit si produkte, me arsyen se PBA për programin ñMbështetja për Shëndetësinëò nuk është trajtuar në nivel objektivi, treguesish performance dhe produkteve të tyre, në mënyrë që të interpretohet në relacion mbi bazën e këtij standardi.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 22, datë 17.11.2016 ñ*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore*ò, Kreun IV, paragrafi 49. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 18-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
Rekomandimi 24.1: Menaxhmenti i SUT duhet të sigurojë administrim të mirë, të forcojë kontrollet në monitorimin e buxhetit, si dhe të marrë masa që raportet e monitorimit të buxhetit të jenë të përpiluara me përfshirjen e të gjitha standarteve, si ato të formës, ashtu dhe ato të përmbajtjes, duke synuar mos përsëritjen e rasteve të tilla në të ardhmen.

Në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Raportet vjetor të monitorimit të buxhetit për 2018, referuar shkresave nr. 834 prot. dhe nr. 833 prot., janë përcjellë pranë Ministrisë së Mbrojtjes dhe Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm Kombëtar Shëndetësor me vonesë, më datë 25.03.2019. Vonesa e dërgimit të raportit të monitorimit të buxhetit ndikon në proceset e vlerësimin e ecurisë financiare të institucionit dhe zbatimit të buxheteve të akorduara nga dy institucionet, ndaj të cilave SUT ka varësi buxhetore. Kjo vonesë është në shkelje të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 9, datë 20.03.2018, ñ*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*ò, Kreu VI, paragrafi 270. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 18-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
Rekomandimi 25.1: Spitali Universitar i Traumës të marrë masa që raportet e monitorimit të buxhetit të jenë të përpiluara dhe dërguara në kohë tek dy institucionet ndaj të cilave SUT ka varësi buxhetore.

Në vijimësi

26. Gjetje nga auditimi: Gjatë gjithë procesit të monitorimit të buxhetit nga njësia shpenzuese SUT, përkatësisht: të vitit 2018, të vitit 2019, të vitit 2020, paraqitja e informacionit, si dhe të dhënat e raportuara në raportin e monitorimit të buxhetit për këto vite, me burim financimi nga FSDKSH, nuk ka qenë në përputhje me përcaktimet e bëra në Udhëzimin Nr. 22, datë 17.11.2016 ñ*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes*

*Qendrore*ò, meqë tabelat financiare nuk janë ato të formateve të përcaktuara në paragrafin 49, të këtij udhëzimi.
Arsyet që kushtëzojnë një raportim jo të plotë, lidhur me zbatimin dhe monitorimin e buxhetit, me burim financimi nga FSDKSH, sipas SUT ï së, lidhen me këto argumente:
Në rastin e marrëdhënies buxhetore mes SUT ï së dhe FSDKSH, nuk mund të flitet për një zbatim të mirëfilltë të një PBA ï je, me dy faza, sikurse realizohet në marrëdhënien buxhetore me Ministrinë e Mbrojtjes. Në marrëdhënien me FSDKSH realizohet zbatimi vetëm i Fazës së II i PBA ï së, i cili bazohet në Shtojcën 7 A, që përmban në formatet e saj treguesit aktual të çdo viti, sipas artikujve buxhetorë përkatës dhe parashikim në një format të kërkesave për artikullin buxhetor 602. Nga FSDKSH, në lidhje me udhëzimet e PBA, shkresat vijnë për fazën e dytë, me kërkesën për plotësimin e Shtojcës 7A);
Nga ana e FSDKSH ï së, njësisë shpenzuese SUT, nuk i dërgohen tavane buxhetore;
Nga ana tjetër, Shtojca 7-A nuk përmban formate në respektim të tavaneve në nivel qëllimi, objektivash, treguesish performance, produktesh, në mënyrë që të analizohet dhe raportohet çdo 4 muaj ecuria e treguesve, për buxhetin që i akordohet SUT ï së, nga FSDKSH ï ja, ndryshe nga si raportohet me raportet e zbatimit dhe monitorimit të buxhetit, me burim financimi nga MM;
Kontratat e lidhura çdo vit, mes SUT dhe Drejtorisë së Shërbimeve Spitalore Universitare dhe Kontrollit Spitalor të FSDKSH, nuk referojnë në asnjë pikë apo paragraf, të dhëna mbi zbatimin dhe monitorimin e një PBA të mirëfilltë, në rastin e buxhetimit nga FSDKSH, pavarësisht se SUT financohet nga MSHMS, me afro një vlerë fondesh që arrin në 30%, të fondeve të alokuara nga Buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.
Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 22, datë 17.11.2016 ñ*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore*ò, Kreu IV, paragrafi 49. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 18-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
Rekomandimi 26.1: Spitali Universitar i Traumës të marrë masa dhe të bashkërendojë veprimet me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm Kombëtar Shëndetësor dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në kërkim të një zgjidhjeje për plotësimin e formateve, për të parandaluar në të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Menjëherë dhe në vijimësi

27. Gjetje nga auditimi: Raportet e monitorimit të buxhetit, për periudhën objekt auditimi, janë afishuar, apo publikuar pjesërisht (vetëm si Programi ñMbështetje për Shëndetësinëò), në raportin financiar të MM ï së, por nuk janë publikuar as në faqen web të SUT, as integralisht në ndonjërën faqe të të dy ministrive, ndaj të cilave SUT ka varësi buxhetore.
Si i tillë këto raporte monitorimi janë të panjohur për të interesuarit dhe mospublikimi është në shkelje të parimit të transparencës publike.
Veprim në kundërshtim me Udhëzimi e Ministrisë së Financave nr. 22, datë 17.11.2016 ñ*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore*ò, Kreu IV, neni 49. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 18-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
Rekomandimi 27.1: Drejtori i Spitalit Universitar të Traumës të marrë masa që raportet e monitorimit të paraqiten në faqen zyrtare të institucionit, duke rritur kështu nivelin e transparencës dhe të llogaridhënies, si dhe duke nxitur debatin publik mbi menaxhimin e Institucionit. Kjo do të kontribuojë që grupet e interesit të monitorojnë më mirë zbatimin e planeve të Buxhetimit Afatmesëm me Bazë Performancën, apo orientimin e politikave të përgjithshme në drejtim të objektivave strategjikë të Sistemit Shëndetësor.

Menjëherë dhe në vijimësi

28. Gjetje nga auditimi: Nuk funksionon sistemi i monitorimit për vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
Nuk ka një procedurë të shkruar për mënyrën e komunikimit brenda institucionit dhe procedurat për qarkullimin e informacionit.
Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, identifikimin e shkaqeve dhe eliminimin e tyre.
Nuk ka regjistra risku të hartuara specifikisht për çdo drejtori.
Nuk ka manuale të procedurave për aktivitetet operacionale dhe financiare të bazuara në harta dhe në procese pune dhe në procedurat e shkruara sipas formateve të ofruara nga manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe të miratuara nga nëpunësi autorizues *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 , faqe 138-140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
Rekomandimi 28.1: Nga Drejtoria e Spitalit Universitar të Traumës të merren masa për hartimin dhe menaxhimin e regjistrit të riskut për çdo drejtori, monitorimin dhe vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve, krijimin e listave të proceseve kryesore dhe gjurmët e auditimit, me qëllim arritjen e mjaftueshme të aktiviteteve të kontrollit për identifikimin, kontrollin dhe reduktimin e risqeve, si edhe përfshirjen efektive të sektorëve të ndryshëm në procese, dokumentacionin përkatës, përgjegjësitë personale, mbështetjen e sistemeve të IT.

Menjëherë dhe në vijimësi

29. Gjetje nga auditimi:
Nga auditimi rezulton se SUT, nuk ka ngritur komisionin e ekspertizës, nuk ka aprovuar afatet e ruajtjes së dokumenteve, nuk ka kryer përpunimin tekniko-shkencor të dokumenteve të prapambetura, si përcaktimin e përkatësisë së fondit dhe klasifikimin e dokumenteve sipas fondit, nuk është kryer ekspertiza e vlerës së ruajtjes, nuk është kryer ruajtja e dokumenteve në përputhje normativat, veçanërisht lidhur me temperaturën e ambientit dhe lagështirën, në kundërshtim me nenin 5,6,8,9,10,11 të VKM nr. 4, datë 19.06.2017 ñPër miratimin e Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10, faqe 149-150 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
Rekomandimi 29.1: Nga Drejtoria e Spitalit Universitar të Traumës të merren masa për të ngritur komisionin e ekspertizës, përpunimin tekniko-shkencor të dokumenteve të prapambetura dhe ruajtja e dokumenteve të bëhet ambiente në përputhje normativat e përcaktuara.

Brenda datës 30.11.2021

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Kontrata e punimeve civile ñ*Rikonstruksion i pavionit dhe ndërtim i sallave të operacionit të këmbës diabetike, në SUT*ò, është nënshkruar me datë 20.02.2019, me OE ñA...Mò, me vlerë 66,882,234 lekë. Për mbikëqyrjen e punimeve është përzgjedhur Shoqëria ñN...ò SHPK, me të cilën është nënshkruar kontrata nr. 258/6 prot., datë 20.02.2019. Gjatë zbatimit të kontratës janë nevojitur ndryshime të disa zërave të punimeve me shtesa dhe zbritje si dhe përfshirje të zërave të rinj të punimeve. Në aplikimin e disa zërave të rinj të punimeve të cilat nuk janë pjesë e preventivit, si dhe nga verifikimi i saktësisë së volumeve të përshkruara në librezën e masave, janë konstatuar mangësi si më poshtë:

-Për zërin A.7.An ñF.V profil mbrojtës për muret MDFò është hartuar analiza për furnizim dhe vendosje me çmim 520 lekë/ml, ku është përfshirë materiali (sipas ofertave të OE) dhe vendosja. Nga verifikimi i dokumentacionit të ofertave të marrë nga OE të ndryshëm, rezulton se për këtë zë, nga ana e OE ñR...ò, është paraqitur çmimi 253 lekë/ml, çmim i cili përfshin furnizimin e materialit dhe vendosjen. Si rezultat, shpenzimet për vendosjen janë përfshirë dy herë. Vlera **98,790** lekë [370 ml x (520 ï 253)], është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori ñA...Mò SHPK dhe përbën dëm ekonomik.
- Zëri A.4.An ñFurnizim vendosje davancale mermeri 2 cmò, është aplikuar çmimi referuar analizës së çmimeve nr. 2.273/1, me çmim 6,981 lekë/m^2. Kjo analizë çmimi i përket materialit granit dhe jo mermer. Bazuar në manualin e çmimeve të ndërtimit 2015, për këtë zë të ri punimi referenca e çmimit duhet të ishte marrë sipas analizës 2.273, që i përket materialit mermer, me çmim 4,488 lekë/m^2. Sasia e likuiduar sipas këtij zëri është 6.0 m^2. Vlera e përfituar më tepër nga Kontraktori ñA...Mò SHPK është **11,346** lekë [6 m^2 x (6,981-5090)], vlerë e cila përbën dëm ekonomik.
-Zëri A.4 2.198 ñHidroizolim me emulson bituminoz dhe 3 shtresa katramaò është likuiduar në sasinë 857 m^2. Nga verifikimi i saktësisë së volumeve për këtë zë punimi rezulton sasia 835 m^2, me diferencë 22 m^2. Vlera **26,400** lekë (22 m^2 x 1,200 lekë/m^2), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori ñA...Mò SHPK dhe përbën dëm ekonomik.
- Zëri A.5. An ñVeshje fasade me alukobondò certifikuar sasia 33 m^2. Në këtë sasi është përfshirë sasia 7.2 m^2, riparim alukobond ekzistues. Vlera **67,903** lekë (7.2 m^2 x 9,431 lekë/m^2), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori ñA...Mò SHPK dhe përbën dëm ekonomik.
- Në lidhje me zërin e punimeve A.6.2.297/b, është përcaktuar ñTavan me kartonxhes (gips kundër lagështirës, jeshil) dopioò, nga verifikimi i përllogaritjeve të bëra sipas librezës së masave konstatohet se në sipërfaqen e përgjithshme, nuk është zbritur sipërfaqja që zënë punimet elektrike, konkretisht vendosja e plafonierave me dimensione 60 x 60 cm, në sasinë 181 copë me sipërfaqe 65.8 m^2 [183 copë x (60 cm x 60 cm)]. Vlera **130,442** lekë (65.8 m^2 x 1,980 lekë/m^2), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori ñA...Mò SHPK dhe përbën dëm ekonomik.
Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 15.08.2007 ñ*Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të ndërtimit*ò i ndryshuar, pika 2 dhe11, si dhe Udhëzimin e Këshillit Të Ministrave nr. 2, datë 08.05.2003 ñPër klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimitò. *Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 63-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
Rekomandimi: 1.1 SUT të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e ***vlerës 334,881 lekë*** nga Kontraktori ñA...Mò SHPK, përfituar si pasojë e referencave të gabuara në përcaktimin e çmimeve për zëra të rinj punimesh.

Brenda datës 31.12.2021

2. Gjetje nga auditimi: Nga mos zbatimi i specifikime teknike të kontratave në marrëveshjen kuadër ñP*ër kryerjen e shërbimit të lavanterisë dhe hotelerisë për një periudhë 48 mujore*ò në vlerën 199,290 mijë lekë pa TVSH, viti 2020, për periudhën tetor 2020 deri më mars 2021 operatori ekonomik ñS...ò Shpk, ka përfituar padrejtësisht vlerën ***3,536,421 lekë, duke krijuar në këtë mënyrë dëm ekonomik në të njëjtën vlerë.*** Mos zbatimi i specifikimeve teknike lidhet me materialin e butë; çarçaf i poshtëm, çarçaf i sipërm dhe çarçaf zarf, ku peshat përkatësisht nga 0.77 kg, 0.77 kg dhe 1.1 kg gjatë zbatimit të kontratës (likuidimeve) kanë rezultuar në 1.1 kg, 1.1 kg dhe 1.3 kg. Veprim në kundërshtim me:

-Marrëveshjen kuadër të lidhur me nr. 7/26 prot, datë 17.07.2020, ndërmjet SUT dhe operatori ekonomik ñS...ò Shpk, ku është përcaktuar ñkontraktori me anë të ofertës së tij, bie dakord të furnizoj mallra, ashtu siç janë specifikuar në kushtet e përcaktuara në këtë kontratë, formularin e deklarimit të ofertës, specifikimet teknike, formulari i çmimit të ofertës dhe dokumentet standard të tenderitò.
- Kontratat e lidhur me nr. 7/32 prot., datë 20.07.2020, nr. 7/37 prot., datë 11.12.2020 nr. 7/40 prot., datë 30.12.2020, ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës dhe operatorit/e shoqërisë ñS...ò Shpk, nenet 8,12 dhe 14.
- Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñ*Për prokurimin publik*ò, i ndryshuar, neni 60, pika 1, e cila përcakton se: ñ1. *Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese*ò.
- Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 ñ*Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë*ò, nenet 419, 420, nenet 659, 698 dhe neni 690 në të cilin është shprehur ñ.....Mos përmbushja e detyrimeve përkatëse sjell lindjen e përgjegjësisë juridiko-civile për palën mos përmbushëse, përgjegjësi e cila konkretizohet në detyrimin për ti shpërblyer palës/palëve të tjera shpërblimin e dëmit të pësuar në formën dëmit efektiv dhe fitimit të munguarò.
- Shtojca 5. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike dhe të Termave të Referencës nga operatori ekonomik ñS...ò Shpk. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 63-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
<u>Rekomandimi 2.1</u>: SUT të marrë masa dhe të ndjekë të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e ***vlerës së 3,536,421 lekë*** nga shoqëria ñS...ò Shpk. Kjo vlerë ka të bëjë me mos zbatimin e specifikime teknike, pjesë e kontratave në marrëveshjen kuadër të lidhur me nr. 7/26 prot., datë 17.07.2020 ñ*Për kryerjen e shërbimit të lavanterisë dhe hotelerisë për një periudhë 48 mujor*ò.

Brenda datës 31.12.2021

D. MASA DISIPLINORE
D.1. PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE

D.1.a. Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 ñKodi i Punësò, i ndryshuar, kontratës kolektive të punës nr. 1308/1 prot., datë 26.02.2018 neni 19 pika 2/a,c, kontratave individuale të punës neni 15, i kërkojmë Drejtorit të Spitalit, që në varësi të kompetencave ligjore të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

"Pushim nga puna"
Ose
"Vërejtje me shkrim me paralajmërim për largim nga puna"

1. V. S. , me detyrë përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve, për arsye se:
a. Të mos zbatimit të specifikimeve teknike të kontratave në marrëveshjen kuadër ñPër kryerjen e shërbimit të lavanterisë dhe hotelerisë për një periudhë 48 mujoreò në vlerën 199,290 mijë lekë pa TVSH, viti 2020, për periudhën tetor 2020 deri më mars 2021, si pasojë e së cilës operatori ekonomik ñS...ò Shpk, ka përfituar padrejtësisht vlerën ***3,536,421 lekë, duke krijuar në këtë mënyrë dëm ekonomik në të njëjtën vlerë.*** Mos zbatimi i specifikimeve teknike lidhet me materialin e butë; çarçaf i poshtëm, çarçaf i sipërm dhe çarçaf zarf, ku peshat përkatësisht nga 0.77 kg, 0.77 kg dhe 1.1 kg gjatë zbatimit të kontratës (likuidimeve) kanë rezultuar në 1.1 kg, 1.1 kg dhe 1.3 kg. Veprim në kundërshtim me:

-Marrëveshjen kuadër të lidhur me nr. 7/26 prot, datë 17.07.2020, ndërmjet SUT dhe operatori ekonomik ñS...ò Shpk, ku është përcaktuar ñKontraktori me an të ofertës së tij, bie dakord të furnizoj mallra, ashtu siç janë specifikuar në kushtet e përcaktuara në këtë kontratë, formularin e deklarimit të ofertës, specifikimet teknike, formulari i çmimit të ofertës dhe dokumentet standard të tenderitò.
- Kontratat e lidhur me nr. 7/32 prot., datë 20.07.2020, nr. 7/37 prot., datë 11.12.2020 nr. 7/40 prot., datë 30.12.2020, ndërmjet Spitalit Universitar të Traumës dhe operatorit/e shoqërisë ñS...ò Shpk, nenet 8,12 dhe 14.
- Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 60, pika 1, e cila përcakton se: ñ1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fitueseò.
- Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 ñKodi Civil i Republikës së Shqipërisëò, nenet 419, 420, nenet 659, 698 dhe neni 690 në të cilin është shprehur ñ.....Mos përmbushja e detyrimeve përkatëse sjell lindjen e përgjegjësisë juridiko-civile për palën mospërmbushëse, përgjegjësi e cila konkretizohet në detyrimin për ti shpërblyer palës/palëve të tjera shpërblimin e dëmit të pësuar në formën dëmit efektiv dhe fitimit të munguarò.
-Shtojca 5. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike dhe të Termave të Referencës nga operatori ekonomik ñS...ò Shpk**.**
b. Në 2 raste për vlerën 471,600 lekë me TVSH janë kryer shpenzime për shërbim gjelbërimi pa dokumentacion të plotë vërtetues. Konkretisht nuk ka plan vendosje se ku do të mbillen pemët dekorative me distancat respektive, speciet përkatëse, preventiv, certifikata fito-sanitare qe do ti shoqërojnë. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 6, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35, Ligjin nr. 8732, datë 24.01.2001 ñPër materialin mbjellës bimorò, me ndryshimet vijuese të tijô, neni 7/b,c,ç, neni 20 pika 1 dhe 2, neni 23, VKM nr. 157, date 25.4.2002 ñPër kriteret dhe rregulla të përpunimit, ambalazhimit, ruajtjes, etiketimit dhe përmbajtjes se etiketës për materialin mbjellës, bimorò, neni 6, Udhëzimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit nr. 107 datë 2.12.2002 ñPër krijimin, shumëzimin, përpunimin, tregtimin, kontrollin, vlerësimin e farave dhe fidanëve dhe ruajtjen e trajtimin e materialit gjenetik bimorò, neni 11, b,c,d, neni 21/a,d, neni 39/a,b,c.
c. Në procedurën e prokurimit me objekt "Kryerje e shërbimit të lavanterisë dhe hotelerisë për një periudhë 48 mujore në SUTò, viti 2020, kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik ñS...ò Shpk është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 46, neni 53 pika 3, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñRregullat e Prokurimitò, i ndryshuar, neni 66 pika 3, Ligjin nr. 44/2015 ñKodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisëò nenet 108-118.
Vo: Masa disiplinore të jepet, duke marrë në konsideratë shkeljet ligjore dhe përgjegjësive respektive të cituar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të performancës së punës, si dhe të masave disiplinore të dhëna më parë.

Menjëherë

"Vërejtje me shkrim me paralajmërim për largim nga puna"

Ose

“Tërheqje vëmendje”

1. G.H., me detyrë përgjegjës i Sektorit te Prokurimit, për arsye se në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit:
-Në procedurën e prokurimit me objekt ñBlerje aparat radiografie me krah Cò, viti 2020.
-Në procedurën e prokurimit me objekt ñFurnizim me pajisje mjekimi (materiale konsumi) për shërbimin e Ortopedisë ne SUTò, viti 2019.
-Në proçedurën e prokurimit me objekt ñBlerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e Kirurgjisë vaskulare dhe Kirurgjisë maksilofaciale në SUT"ndarë në dy lote (një operator një lot)ò, viti 2019.
Në proçedurën e prokurimit me objekt *“*Kryerje e shërbimit të lavanterisë dhe hotelerisë për një periudhë 48 mujore në SUTò, viti 2020**.**
Në procedurën e prokurimit me objekt objekt ñTrajtimin e mbetjeve spitalore për SUTò, viti 2020, ñTrajtimin e mbetjeve spitalore për SUTò, viti 2018 dhe viti 2019.
-Në përcaktimin e kërkesave për kualifikim nuk janë dhënë arsye konkrete, të argumentuara ligjërisht, në raport me natyrën dhe përmasat e objektit të prokuruar, në kundërshtim me nenin 61, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij.
-Nuk ka një dokument shkresor (procesverbal etj) të njësisë së, ku të jenë miratuar dokumentet e tenderimit (D.T.), dhe në veçanti nuk ka një dokument shkresor ku të jenë përcaktuar kriteret e vlerësimit, edhe pse në SPE është përcaktuar çmimi më i ulët, në kundërshtim me nenin 61, pika 1, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij.
Në procedurën e prokurimit me objekt **“**Kryerje e shërbimit të lavanterisë dhe hotelerisë për një periudhë 48 mujore në SUTò, viti 2020, kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik ñS...ò Shpk është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 46, neni 53 pika 3, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñRregullat e Prokurimitò, i ndryshuar, neni 66 pika 3, Ligjin nr. 44/2015 ñKodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisëò nenet 108-118.
2. G. P., me detyrë përgjegjës inxhinier biomedikal për arsye se, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, anëtarit të komisionit marrjes në dorëzim:
-Në procedurën e prokurimit me objekt ñBlerje aparat radiografie me krah Cò, viti 2020.
-Në procedurën e prokurimit me objekt ñTrajtimin e mbetjeve spitalore për SUTò, viti 2020 dhe viti 2019.
-Në përcaktimin e kërkesave për kualifikim nuk janë dhënë arsye konkrete, të argumentuara ligjërisht, në raport me natyrën dhe përmasat e objektit të prokuruar, në kundërshtim me nenin 61, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij.
-Nuk ka një dokument shkresor (procesverbal etj) të njësisë së, ku të jenë miratuar dokumentet e tenderimit (D.T.), dhe në veçanti nuk ka një dokument shkresor ku të jenë përcaktuar kriteret e vlerësimit, edhe pse në SPE është përcaktuar çmimi më i ulët, në kundërshtim me nenin 61, pika 1, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij.
- Në procedurën e prokurimit me objekt ñBlerje aparat radiografie me krah Cò, viti 2020, pajisja nuk shoqërohet me etiketën e përkthyer në gjuhën shqipe, veprim në kundërshtim me neni 20 të Ligjit nr. 89/2014 ñPër pajisjet mjekësoreò i ndryshuar, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se

ñÇdo pajisje mjekësore, që vendoset në treg dhe vihet në shërbim, duhet të përmbajë etiketën në gjuhën shqipe, e cila duhet të paraqitet në një formë të dukshme dhe të lexueshmeò, theksojmë se etiketa është vetëm në gjuhën angleze.
-Në procedurën e prokurimit me objekt ñBlerje materiale Respiratori dhe Monitori për Reminacioninò, viti 2020, pajisjet nuk kanë asnjë dokument vërtetues (shoqërues) në kundërshtim me neni 17 të kontratës është përcaktuar në mënyrë eksplicite se ñFurnizuesi i mallit që është objekt i kësaj kontrate, i paraqet blerësit certifikatën e origjinës dhe të cilësisë së mallit së bashku me faturën e shitjesò. Veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik, me ndryshimet vijuese të tij, pika 54.
3. M. Xh., me detyrë mjek për arsye se, në cilësinë e anëtarit të komisionit marrjes në dorëzim:
- Në procedurën e prokurimit me objekt ñBlerje aparat radiografie me krah Cò, viti 2020. Pajisja nuk shoqërohet me etiketën e përkthyer në gjuhën shqipe, veprim në kundërshtim me neni 20 të Ligjit nr. 89/2014 ñPër pajisjet mjekësoreò i ndryshuar, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se ñÇdo pajisje mjekësore, që vendoset në treg dhe vihet në shërbim, duhet të përmbajë etiketën në gjuhën shqipe, e cila duhet të paraqitet në një formë të dukshme dhe të lexueshmeò, theksojmë se etiketa është vetëm në gjuhën angleze.
-Në procedurën e prokurimit me objekt ñBlerje materiale Respiratori dhe Monitori për Reminacioninò, viti 2020, pajisjet nuk kanë asnjë dokument vërtetues (shoqërues) në kundërshtim me neni 17 të kontratës është përcaktuar në mënyrë eksplicite se ñFurnizuesi i mallit që është objekt i kësaj kontrate, i paraqet blerësit certifikatën e origjinës dhe të cilësisë së mallit së bashku me faturën e shitjesò dhe me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik, me ndryshimet vijuese të tij, pika 54.
-Në procedurën e prokurimit me objekt ñBlerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e Kirurgjisë vaskulare dhe Kirurgjisë maksilofaciale" ndarë në dy lote (një operator një lot)ò, viti 2019, kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik ñO...ò Shpk, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 46 pika neni 53 pika 3, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñRregullat e Prokurimitò, i ndryshuar, neni 66 pika 3, Ligjin nr. 44/2015 ñKodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisëò nenet 108-118.
4. B. H., me detyrë mjeke për arsye se, në cilësinë e anëtarit të komisionit marrjes në dorëzim, në cilësinë e anëtarit të komisionit marrjes në dorëzim, në procedurën e prokurimit me objekt ñBlerje aparat radiografie me krah Cò, viti 2020.
-Pajisja nuk shoqërohet me etiketën e përkthyer në gjuhën shqipe, veprim në kundërshtim me neni 20 të Ligjit nr. 89/2014 ñPër pajisjet mjekësoreò i ndryshuar, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se ñÇdo pajisje mjekësore, që vendoset në treg dhe vihet në shërbim, duhet të përmbajë etiketën në gjuhën shqipe, e cila duhet të paraqitet në një formë të dukshme dhe të lexueshmeò, theksojmë se etiketa është vetëm në gjuhën angleze.
5. M. S., me detyrë përgjegjës specialist prokurimi (jurist), për arsye se në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit:
-Në procedurën e prokurimit me objekt ñblerje aparat radiografie me krah Cò, viti 2020.
-Në procedurën e prokurimit me objekt ñFurnizim me pajisje mjekimi (materiale konsumi) për shërbimin e Ortopedisë ne SUTò, viti 2019.
-Në procedurën e prokurimit me objekt ñBlerje materiale Respiratori dhe Monitori për Reaminacioninò, viti 2020;

-Në procedurën e prokurimit me objekt **"**Kryerje e shërbimit të lavanterisë dhe hotelerisë për një periudhë 48 mujore në SUTò, viti 2020**.**
-Në përcaktimin e kërkesave për kualifikim, nuk janë dhënë arsye konkrete, të argumentuara ligjërisht, në raport me natyrën dhe përmasat e objektit të prokuruar, në kundërshtim me nenin 61, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij.
-Nuk ka një dokument shkresor (procesverbal etj) të njësisë së, ku të jenë miratuar dokumentet e tenderimit (D.T.), dhe në veçanti nuk ka një dokument shkresor ku të jenë përcaktuar kriteret e vlerësimit, edhe pse në SPE është përcaktuar çmimi më i ulët, në kundërshtim me nenin 61, pika 1, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij.
-Në procedurën e prokurimit me objekt ñFurnizim me pajisje mjekimi (materiale konsumi) për shërbimin e Ortopedisë ne SUTò, viti 2019, kualifikimi dhe shpallja fitues e shoqërisë operatorit ekonomik ñO...ò Shpk, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 46 pika neni 53 pika 3, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñRregullat e Prokurimitò, i ndryshuar, neni 66 pika 3, neni 74, pika 1 dhe 2, Ligjin nr. 44/2015 ñKodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisëò nenet 108-118.
-Në procedurën e prokurimit me objekt ñBlerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e Kirurgjisë vaskulare dhe Kirurgjisë maksilofaciale në SUT"ndarë në dy lote (një operator një lot)ò, viti 2019, kualifikimi dhe shpallja fitues e shoqërisë operatorit ekonomik ñO...ò Shpk, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 46 pika neni 53 pika 3, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñRregullat e Prokurimitò, i ndryshuar, neni 66 pika 3, Ligjin nr. 44/2015 ñKodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisëò nenet 108-118.
-Në procedurën e prokurimit me objekt **"**Kryerje e shërbimit të lavanterisë dhe hotelerisë për një periudhë 48 mujore në SUTò, viti 2020, kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik ñS...ò Shpk është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 46, neni 53 pika 3, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñRregullat e Prokurimitò, i ndryshuar, neni 66 pika 3, Ligjin nr. 44/2015 ñKodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisëò nenet 108-118.
6. V. R., me detyrë përgjegjës mjek pedagog nga Fakulteti i Mjekësisë për arsye se, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit:
- Në procedurën e prokurimit me objekt ñFurnizim me pajisje mjekimi (materiale konsumi) për shërbimin e Ortopedisë ne SUTò, viti 2019.
-Në përcaktimin e kërkesave për kualifikim, nuk janë dhënë arsye konkrete, të argumentuara ligjërisht, në raport me natyrën dhe përmasat e objektit të prokuruar, në kundërshtim me nenin 61, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publi*kò, me ndryshimet vijuese të tij.
-Nuk ka një dokument shkresor (procesverbal etj) të njësisë së prokurimit, ku të jenë miratuar dokumentet e tenderimit (D.T.), dhe në veçanti nuk ka një dokument shkresor ku të jenë përcaktuar kriteret e vlerësimit, edhe pse në SPE është përcaktuar çmimi më i ulët, në kundërshtim me nenin 61, pika 1, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij.
-Në procedurën e prokurimit me objekt **"**Kryerje e shërbimit të lavanterisë dhe hotelerisë për një periudhë 48 mujore në SUTò, viti 2020, kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik ñS...ò Shpk është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin

publikò, i ndryshuar, neni 46, neni 53 pika 3, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñRregullat e Prokurimitò, i ndryshuar, neni 66 pika 3, Ligjin nr. 44/2015 ñKodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisëò nenet 108-118.
7. M. P., me detyrë specialiste planifikimi në Sektorin e Planifikimit për arsye se, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit:
- Në procedurën e prokurimit me objekt ñFurnizim me pajisje mjekimi (materiale konsumi) për shërbimin e Ortopedisë ne SUTò, viti 2019.
-Në procedurën e prokurimit me objekt **"**Kryerje e shërbimit të lavanterisë dhe hotelerisë për një periudhë 48 mujore në SUTò, viti 2020**.**
-Në përcaktimin e kërkesave për kualifikim nuk janë dhënë arsye konkrete, të argumentuara ligjërisht, në raport me natyrën dhe përmasat e objektit të prokuruar, në kundërshtim me nenin 61, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij. Nuk ka një dokument shkresor (procesverbal etj) të njësisë së, ku të jenë miratuar dokumentet e tenderimit (D.T.), dhe në veçanti nuk ka një dokument shkresor ku të jenë përcaktuar kriteret e vlerësimit, edhe pse në SPE është përcaktuar çmimi më i ulët, në kundërshtim me nenin 61, pika 1, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij.
-Në zbatimin e procedurës së prokurimit ñRikonstruksion i pavionit dhe ndërtim i sallave të operacionit të këmbës diabetike, në SUTò, në cilësinë e anëtarëve të KVO, kanë kualifikuar operatorë ekonomikë megjithëse kanë paraqitur gabime në ofertën financiare.
8. B. G., me detyre Shef i Shërbimit te Ortopedisë, për arsye se në procedurën e prokurimit me objekt ñFurnizim me pajisje mjekimi (materiale konsumi) për shërbimin e Ortopedisëò, viti 2019, kualifikimi dhe shpallja fitues operatorit ekonomik ñO.E.S D.ò Shpk, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 46 pika neni 53 pika 3, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñRregullat e Prokurimitò, i ndryshuar, neni 66 pika 3, neni 74, pika 1 dhe 2, Ligjin nr. 44/2015 ñKodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisëò nenet 108-118.
9. B. V., me detyre jurist për arsye se, në cilësinë anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, në procedurën e prokurimit me objekt ñFurnizim me pajisje mjekimi (materiale konsumi) për shërbimin e Ortopedisëò, viti 2019. kualifikimi dhe shpallja fitues e shoqërisë operatorit ekonomik ñO...ò Shpk, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 46 pika neni 53 pika 3, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñRregullat e Prokurimitò, i ndryshuar, neni 66 pika 3, neni 74, pika 1 dhe 2, Ligjin nr. 44/2015 ñKodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisëò nenet 108-118.
-Në procedurën e prokurimit me objekt **"**Kryerje e shërbimit të lavanterisë dhe hotelerisë për një periudhë 48 mujoreò, viti 2020, kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik ñS...ò Shpk, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 46, neni 53 pika 3, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñRregullat e Prokurimitò, i ndryshuar, neni 66 pika 3, Ligjin nr. 44/2015 ñKodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisëò nenet 108-118.
-Në procedurën e prokurimit me objekt ñTrajtimin e mbetjeve spitalore për SUTò, viti 2020 dhe viti 2019.
-Në përcaktimin e kërkesave për kualifikim nuk janë dhënë arsye konkrete, të argumentuara ligjërisht, në raport me natyrën dhe përmasat e objektit të prokuruar, në kundërshtim me nenin 61, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij. Nuk ka një dokument shkresor (procesverbal etj) të njësisë së, ku të

jenë miratuar dokumentet e tenderimit (D.T.), dhe në veçanti nuk ka një dokument shkresor ku të jenë përcaktuar kriteret e vlerësimit, edhe pse në SPE është përcaktuar çmimi më i ulët, në kundërshtim me nenin 61, pika 1, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij.
-Në zbatimin e procedurës së prokurimit ñRikonstruksion i pavionit dhe ndërtim i sallave të operacionit të këmbës diabetike, në SUTò, në cilësinë e anëtarëve të KVO, kanë kualifikuar operatorë ekonomikë megjithëse kanë paraqitur gabime në ofertën financiare.
Në procedurën e prokurimit me objekt ñBlerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e Kirurgjisë vaskulare dhe Kirurgjisë maksilofaciale" ndarë në dy lote (një operator një lot)ò, viti 2019, kualifikimi dhe shpallja fitues e shoqërisë operatorit ekonomik ñO...ò Shpk, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 46 pika neni 53 pika 3, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñRregullat e Prokurimitò, i ndryshuar, neni 66 pika 3, Ligjin nr. 44/2015 ñKodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisëò nenet 108-118.
10. E.T., me detyrë inxhinier elektronik për arsye se në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit:
-Në procedurën e prokurimit me objekt ñBlerje materiale Respiratori dhe Monitori për Reaminacioninò, viti 2020.
Në përcaktimin e kërkesave për kualifikim, nuk janë dhënë arsye konkrete, të argumentuara ligjërisht, në raport me natyrën dhe përmasat e objektit të prokuruar, në kundërshtim me nenin 61, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij.
-Nuk ka një dokument shkresor (procesverbal etj) të njësisë së, ku të jenë miratuar dokumentet e tenderimit (D.T.), dhe në veçanti nuk ka një dokument shkresor ku të jenë përcaktuar kriteret e vlerësimit, edhe pse në SPE është përcaktuar çmimi më i ulët, në kundërshtim me nenin 61, pika 1, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij.
11. E. Xh., me detyrë specialiste planifikimi në Sektorin e Planifikimit për arsye se, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit.
Në procedurën e prokurimit me objekt ñBlerje materiale Respiratori dhe Monitori për Reaminacioninò, viti 2020.
Në përcaktimin e kërkesave për kualifikim, nuk janë dhënë arsye konkrete, të argumentuara ligjërisht, në raport me natyrën dhe përmasat e objektit të prokuruar, në kundërshtim me nenin 61, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij.
-Nuk ka një dokument shkresor (procesverbal etj) të njësisë së, ku të jenë miratuar dokumentet e tenderimit (D.T.), dhe në veçanti nuk ka një dokument shkresor ku të jenë përcaktuar kriteret e vlerësimit, edhe pse në SPE është përcaktuar çmimi më i ulët, në kundërshtim me nenin 61, pika 1, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij.
12. E. O., me detyrë përgjegjëse e Sektorit te Planifikimit për arsye se, në cilësinë e anëtarit të grupit të marrjes në dorëzim në procedurën e prokurimit me objekt ñBlerje materiale Respiratori dhe Monitori për Reminacioninò, viti 2020, pajisjet nuk kanë asnjë dokument vërtetues (shoqërues) në kundërshtim me nenin 17 të kontratës ku është përcaktuar në mënyrë eksplicite se ñFurnizuesi i mallit që është objekt i kësaj kontrate, i paraqet blerësit certifikatën e origjinës dhe

të cilësisë së mallit së bashku me faturën e shitjesò dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik, me ndryshimet vijuese të tij, pika 54.

13. B. P., me detyrë kirurg i përgjithshëm Shërbimi i Kirurgjisë Plastike Ri konstruktive, Angiokirurgjise dhe Këmba Diabetike për arsye se, në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit:

-Në procedurën e prokurimit me objekt ñBlerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e Kirurgjisë vaskulare dhe Kirurgjisë maksilofaciale" ndarë në dy lote (një operator një lot)ò, viti 2019

-Në përcaktimin e kërkesave për kualifikim nuk janë dhënë arsye konkrete, të argumentuara ligjërisht, në raport me natyrën dhe përmasat e objektit të prokuruar, në kundërshtim me nenin 61, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij.

-Nuk ka një dokument shkresor (procesverbal etj) të njësisë së, ku të jenë miratuar dokumentet e tenderimit (D.T.), dhe në veçanti nuk ka një dokument shkresor ku të jenë përcaktuar kriteret e vlerësimit, edhe pse në SPE është përcaktuar çmimi më i ulët, në kundërshtim me nenin 61, pika 1, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij.

14. E. T., me detyrë juriste për arsye se, në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit:

-Në procedurën e prokurimit me objekt ñBlerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e Kirurgjisë vaskulare dhe Kirurgjisë maksilofaciale në SUT" ndarë në dy lote (një operator një lot)ò, viti 2019.

-Në përcaktimin e kërkesave për kualifikim, nuk janë dhënë arsye konkrete, të argumentuara ligjërisht, në raport me natyrën dhe përmasat e objektit të prokuruar, në kundërshtim me nenin 61, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij.

-Nuk ka një dokument shkresor (procesverbal etj) të njësisë së, ku të jenë miratuar dokumentet e tenderimit (D.T.), dhe në veçanti nuk ka një dokument shkresor ku të jenë përcaktuar kriteret e vlerësimit, edhe pse në SPE është përcaktuar çmimi më i ulët, në kundërshtim me nenin 61, pika 1, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij.

Në zbatimin e procedurës së prokurimit ñRikonstruksion i pavionit dhe ndërtim i sallave të operacionit të këmbës diabetike, në SUTò, në cilësinë e anëtarëve të KVO, kanë kualifikuar operatorë ekonomikë megjithëse kanë paraqitur gabime në ofertën financiare.

15. Dr. L. B., me detyrë mjeke kirurge maksilofaciale për arsye se, në cilësinë e anëtarit të KVO: Në proçedurën e prokurimit me objekt ñBlerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e Kirurgjisë vaskulare dhe Kirurgjisë maksilofaciale" ndarë në dy lote (një operator një lot)ò, viti 2019, kualifikimi dhe shpallja fitues e shoqërisë operatorit ekonomik ñO...ò Shpk, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 46 pika neni 53 pika 3, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñRregullat e Prokurimitò, i ndryshuar, neni 66 pika 3, Ligjin nr. 44/2015 ñKodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisëò nenet 108-118.

16. I.P., me detyrë kryeinfermier në Shërbimin e ORL, Okulistik, Kirurgji Maksilofaciale për arsye se, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, në proçedurën e prokurimit me objekt **"**Kryerje e shërbimit të lavanterisë dhe hotelerisë për një periudhë 48 mujoreò, viti 2020, kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik ñS....ò Shpk është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 46,

neni 53 pika 3, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñRregullat e Prokurimitò, i ndryshuar, neni 66 pika 3, Ligjin nr. 44/2015 ñKodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisëò nenet 108-118.

17. A. G., me detyrë kryeinfermier Sh.Kirurgji Nr.2 për arsye se, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, në proçedurën e prokurimit me objekt ñTrajtimin e mbetjeve spitalore për SUTò, viti 2020.

-Në përcaktimin e kërkesave për kualifikim nuk janë dhënë arsye konkrete, të argumentuara ligjërisht, në raport me natyrën dhe përmasat e objektit të prokuruar, në kundërshtim me nenin 61, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij.

-Nuk ka një dokument shkresor (procesverbal etj) të njësisë së, ku të jenë miratuar dokumentet e tenderimit (D.T.), dhe në veçanti nuk ka një dokument shkresor ku të jenë përcaktuar kriteret e vlerësimit, edhe pse në SPE është përcaktuar çmimi më i ulët, në kundërshtim me nenin 61, pika 1, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij.

18. V. H., me detyrë shef Shërbimi i Sëmundjeve te Brendshme Nr.2 për arsye se, në cilësinë e anëtarit të komisioni të marrjes në dorëzim në zbatimin e procedurës së prokurimit dhe kontratës ñPërgatitje e projekt preventivit për rikonstruksionin e godinës trekatëshe dhe ndërtimin e urës lidhëse me korpusin qendrorò, realizuar në vitin 2020, pasi preventivi i hartuar nga Kontraktori BOE ñC...ò dhe ñC...C.ò, ka mangësi sa i takon referencave në manualet e çmimeve të ndërtimit me vlerë 2,953,227 lekë.

19. D. Ll., me detyrë inxhiniere ndërtimi për arsye se:

-Në zbatimin e procedurës së prokurimit ñRikonstruksion i pavionit dhe ndërtim i sallave të operacionit të këmbës diabetike, në SUTò, në cilësinë e anëtarit të KVO, ka kualifikuar operatorë ekonomikë megjithëse kanë paraqitur gabime në ofertën financiare.

20. S. K., me detyrë inxhinier elektronik për arsye se, në cilësinë e monitoruesit të zbatimit të Kontratës ñRikonstruksion i pavionit dhe ndërtim i sallave të operacionit të këmbës diabetike, pasi Kontraktori ñA...ò SHPK, ka përfituar padrejtësisht në vlerën 110,136 lekë, si pasojë e referencave të gabuara në përcaktimin e çmimeve për zëra të rinj punimesh.

Vo: Masa disiplinore të jepet, duke marrë në konsideratë shkeljet ligjore dhe përgjegjësive respektive të cituar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të performancës së punës, aftësive profesionale në legjislacionin e prokurimit (profesioni dhe vendi i punës, për shembull mjek, apo jurist, ekonomist), numrit të procedurave me shkelje të konstatuara (në një ose më shumë se një) si dhe të masave disiplinore të dhëna më parë.

D.1.b. Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 ñKodi i Punësò, i ndryshuar, kontratës kolektive të punës nr. 1308/1 prot., datë 26.02.2018 neni 19 pika 2/a,c, kontratave individuale të punës neni 15, pasi të jenë identifikuar përgjegjësitë në lidhje me shkeljet e konstatuara e të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i rekomandohet Drejtorit të Spitalit, marrjen/ose jo të masave disiplinore ndaj personelit tjetër që nuk është përcaktuar në pikën D.1, duke marrë në konsideratë jo vetëm shkeljet por dhe të performancës së punës së tyre.

Menjëherë

KONTROLI I LARTË I SHTETIT